

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS  
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS  
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

INSTITUCIONALIZIMI I  
REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË  
ZGJEDHJET PARLAMENTARE  
DHE PRESIDENCIALE  
TË VITIT 1992

Simpozium shkencor

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS  
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS  
SECTION OF SOCIAL SCIENCES

# INSTITUTIONALIZATION OF THE REPUBLIC OF KOSOVA IN THE PARLIAMENTARY AND PRESIDENTIAL ELECTIONS OF 1992

Scientific symposium  
(24 May 2022)

Prepared for publication by: Correspondent member Frashër Demaj

Organizing Committee:

Jusuf Bajraktari, Isa Mustafa, Arsim Bajrami, Gjyljeta Mushkolaj, Frashër Demaj.

Editor: Correspondent member Gjyljeta Mushkolaj, Secretary of the Section of Social Sciences.



AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS  
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS  
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

# INSTITUCIONALIZIMI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË ZGJEDHJET PARLAMENTARE DHE PRESIDENCIALE TË VITIT 1992

Simpozium shkencor  
(24 maj 2022)

Përgatiti për botim: anëtar korrespondent Frashër Demaj

Këshilli organizues:

Jusuf Bajraktari, Isa Mustafa, Arsim Bajrami, Gjyljeta Mushkolaj, Frashër Demaj.

Redaktor: Anëtare korrespondente Gjyljeta Mushkolaj, Sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore.



Copyright © ASHAK

## PËRMBAJTJA

Jusuf BAJRAKTARI

PROGRAMET E PARTIVE POLITIKE DHE PJEËMARRJA E  
TYRE NË ZGJEDHJET E VITIT 1992..... 7

Isa MUSTAFA

KONTRIBUTI FINANCIAR I DIASPORËS NË FAZËN E PARË  
TË SHITETNDËRTIMIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS..... 17

Arsim BAJRAMI

AKTET KUSHTETUESE DHE POLITIKE TE LINDJES SE  
REPUBLIKËS SË KOSOVËS..... 41

Bujar BUKOSHI

QEVERIA E PËRKOHSHME E KOALICIONIT TË  
REPUBLIKËS SË KOSOVËS (1991) PARA DHE PAS  
ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE DHE PRESIDENCIALE ..... 77

Valentina DUKA

NJOHJA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS NGA SHTETI  
SHQIPTAR ..... 101

Ksenofon KRISAFI

DEKLARATA KUSHTETUESE E 2 KORRIKUT DHE  
KUSHTETUTA E KAÇANIKUT NE VËSHTRIMIN JURIDIKO-  
NDËRKOMBËTAR..... 111

Frashër DEMAJ

QËNDRIMI I POLITIKËS NDËRKOMBËTARE NDAJ  
ÇËSHITJES SË KOSOVËS NË FILLIM TË VITEVE '90..... 135

Fehmi REXHEPI

THEMELIMI DHE FUNKSIONIMI I INSTITUCIONEVE TË  
REPUBLIKËS SË KOSOVËS (1990 – 2000)..... 159

Rexhep OSMANI

GJENDJA, PROBLEMET DHE ZHVILLIMET E ARSIMIT NË  
KOSOVË..... 177

Haqif MULLIQI

PËRPJEKJET PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONALIZIMIN  
E PARLAMENTIT TË KOSOVËS TË VITIT 1992..... 211

Teki KURTI

QËNDRIMI I MINISTRISË SË MBROJTJES NDAJ GRUPEVE  
TË PARA TË REKRUTËVE KOSOVARË NË PËRGATITJET  
USHTARAKE NË SHQIPËRI MË 1991..... 225

Qerim LITA

QËNDRIMI I PARTIVE POLITIKE SHQIPTARE NË  
MAQEDONI NDAJ ZGJEDHJEVE TË VITIT 1992 NË KOSOVË.. 233



Jusuf Bajraktari

## PROGRAMET E PARTIVE POLITIKE DHE PJESËMARRJA E TYRE NË ZGJEDHJET E VITIT 1992

### Përmbledhje

Zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale janë padyshim një provë dhe test i veçantë për shkallën e demokratizimit të marrëdhënieve politike e shoqërore të secilit vend, bile edhe të atyre me demokraci të konsoliduar dhe me traditë të gjatë në jetën plurale politike.

Ndërkaq në rrethanat tejet të ndërlikuara të një vendi shumëkombësh me kontradikta të thella politike e shoqërore, por me një propagandë të sofistikuar të sistemit monist, i cili kishte aureolën e një liberalizmi të kamufluar në rrethanat e ish-Jugosllavisë paraqet një rëndësi të dyfishtë. Ky fakt dukej si një vështirësi e pakalueshme, shumëfish më e ndërlikuar në krahasimin e Kosovës me vendet e tjera të atyre viteve, qoftë brenda sistemit jugosllav, apo në krahasim me viset e tjera të shteteve të ish-blokut socialist në Evropë.

Pra, Kosova ishte vërtet një rast *Sui Generis*, i pashoq në marrëdhëniet ndërkombëtare të viteve '90 të shek. XX.

Në këtë trajtesë do të përpiqemi mbi bazën e burimeve historike të proviniencave të ndryshme të analizohet roli i programeve politike të PP të Kosovës në këto rrethana kundërthënëse historike. Do të përpiqemi ta bëjmë analizën e mirëfilltë të programeve politike të PP të Kosovës, dallimet, ngjashmëritë, synimet dhe në fund duhet të theksohen rezultatet e zgjedhjeve të vitit 1992 dhe të përcaktohet vlera e tyre

politike si përpjekje ekzistenciale të një populli që luftonte për liri dhe pavarësi dhe që ishte i shtypur padrejtësisht, siç ishte Kosova.

*Fjalë çelës:* Republika e Kosovës, programet, partitë politike, zgjedhjet

Vitet 90' të shekullit XX paraqesin momentin më deciziv për shpërbërjen e një kreature shtetërore të quajtur Jugosllavi. Kjo krijesë e rrjedhave dhe e situatave ndërkombëtare të pas Luftës së Parë Botërore, do të arrijë të qëndrojë për 81 vjet si një xhandar famëkeq në pjesën qendrore të Evropës Juglindore. Shembja e Jugosllavisë së Versajës apo e AVNOJ-it është si pasojë e kontradiktave të thella midis atyre përbërësve që artificialisht ishin bashkuar për të shtypur popujt më të vegjël, siç ishin gjermanët, shqiptarët, hungarezët etj. Për gjatë gjithë këtyre viteve Jugosllavia qëndroi përballë kundërthënive të veta duke shembur identitetet e kombeve më të vogla, të cilët jetonin të shtypur e pa të drejtat më elementare të pakicave kombëtare.

Pikërisht pra, rritja e kundërthënive të brendshme të atij shteti artificial lejoi edhe imponimin e aspiratave të faktorëve të jashtëm që luanin rolin përmbyllës të një kaptine të historisë ballkanike.

Për këtë nuk është e vështirë të dëshmohet se pikërisht hegjemonizmi serb, që përbën burimin kryesor të antagonizmave ndërnacionale, të cilët e rrënonin Jugosllavinë qysh prej fillimeve të saj, me shkallëzimin e tij euforik në fund të viteve tetëdhjetë me iluzionet e tij serbo-mëdha, me programin e tij të qartë të dominimit mbi të tjerët, me brutalitetin e pashembullt në realizimin e këtij programi të hegjemonisë, me koncepcionet, vlerat dhe praktikën që i solli, esencialisht të ngjashme ose identike me ato të fashizmit, e bëri të pamundshëm ekzistimin e Jugosllavisë<sup>1</sup>!

Shqiptarët, viktima e parë e madhe e grykësisë së shovinistëve serbë, nuk kanë pse të ankohen për shembjen e kësaj Jugosllavie. Ata ishin të shtypur e të ndjekur gjatë tërë periudhës së ekzistimit të këtij shteti. Por, edhe sot, pas rrënimit të Jugosllavisë, Serbia edhe pas kaq vitesh të pavarësisë së Kosovës, njëlloj pretendon ta mbajë atë, ta trajtojë si pjesë integrale të saj<sup>2</sup>.

---

<sup>1</sup> Fehmi Agani, *Demokracia, Kombi, Vetëvendosja*, ShB "Dukagjini", Pejë 1994, f.8

<sup>2</sup> Po aty, f.8,9

Serbia e sotme, përveç forcës dhe dhunës të cilat janë “argumentet” kryesore të saj, pretendimet e veta përpiqet t’i racionalizojë e mbrojë edhe me “argumentin historik” që, në të vërtetë, është një histori e shpifur, më tepër trillim e legjendë, histori e mit, ose, thënë më saktësisht miti si histori dhe me pseudoargumente teorike. Kontributin themelor të këtij pseudoargumentimi teorik e përbëjnë ndarja dikotomike e absolutizuar e komuniteteve nacionale në kombe e pakica kombëtare, në “popuj sovranë” të ish-Jugosllavisë dhe pakica kombëtare<sup>3</sup>.

Errësimi i shumëllojshmërisë e të veçantive për hir të përligjjes të dominimit mbi pakicat: pohimi se shqiptarët në ish-Jugosllavi ishin pakicë kombëtare dhe mohimi i të drejtës së pakicave kombëtare për vetëvendosje.

Në mendimin dhe praktikën serbo-shoviniste statusi i pakicës nuk përcaktohet vetëm në raport me vetëvendosjen, nuk reduktohet vetëm e drejta e shkëputjes. Përkundrazi, të jesh pakicë do të thotë të mos jesh në vendin tënd, të jesh në shtet të huaj dhe në mëshirë të huaj. Ilustrativ është fjalimi i Milosheviçit në Ushçë, në fillim të vitit 1989, në fazën kur serbo-shovinizmi agresiv ishte në shkallëzim dhe kriza në Kosovë, pas grevave të pandërprera, po merrte përmasa dramatike. Mendimi themelor i tij dhe pohimet kryesore ishin: Kosova është Serbi; por shqiptarët mund të jetojnë në të, sepse Serbia është zemërgjerë; ata mund të jetojnë mirë, por të mos jenë të këqij dhe të prapshtë! Natyrisht, nuk eksplikohet çdo të thotë të jesh i keq dhe i prapshtë. Kjo mbetet çështje e interpretimit dhe e sanksionimit arbitrar të pushtetit serb. Por, sa është i qëndrueshëm argumentimi i sipërm dhe sa kanë mbështetje pretendimet serbe për Kosovën dhe viset me shumicë shqiptare, kur të merret parasysh zhvillimi i sotëm politik, afirmimi i të drejtave të popujve, normat dhe mbrojtja ndërkombëtare e tyre dhe qenia kombëtare e Kosovës.<sup>4</sup> Nga ana tjetër, sa gjejnë mbështetje në realitetin kombëtar, shoqëror e politik të Kosovës dhe në normën ndërkombëtare kërkesat e lëvizjes politike shqiptare, që çështja e Kosovës dhe e viseve me shumicë shqiptare të zgjidhet në bazë të parimit të së drejtës së popujve për vetëvendosje<sup>5</sup>?

Motivi i organizimit të Simpoziumit shkencor, që pikërisht më 24 maj 2022 po e rrumbullakon një periudhë 30-vjeçare, është jo vetëm homazh për një ngjarje të shënuar dhe sakrificat e popullit të Kosovës,

<sup>3</sup> Po aty, f.9

<sup>4</sup> Po aty, f.9

<sup>5</sup> Po aty, f.9

por edhe reflektim për një akt dhe një ditë që tashmë është pjesë e historisë sonë moderne.

Kjo datë simbolikisht shënon përfundimin e ëndrrës grabitqare serbe për ta ngjuar Kosovën në çfarëdo modeli jugosllav, sikurse e hapi rrëmbyeshëm derën për ardhmërinë e Republikës së Kosovës, me një president të zgjedhur nga vullneti politik i një populli të nëpërkëmbur nga dhuna serbe që zgjati rreth 100 vjet. Ky popull me këtë akt legjitim të zgjedhjeve demokratike, parlamentare, përfundimisht e vulosi fatin e tij jashtë konturave të një shteti shtypës e brutal siç ishte Jugosllavia e komanduar nga Serbia diktatoriale. Këtë aspiratë Kosova e damkosi në mënyrën më legjitime, duke e dëshmuar para syve të botës se nuk do të lejonte përsëritjen e gabimeve të së kaluarës. Ky akt dinjitoz i prirë nga një filozofi politike e re me synim për të ndërtuar jetën në liri dhe pavarësi të plotë, dhe kështu për të lëshuar një perde në mbylljen e aktit sundues nga një okupator primitiv siç ishte Serbia. Promotor dhe realizator i këtij synimi u bë dr. Ibrahim Rugova, lideri që vuri themelet e një Kosove demokratike me orientim perëndimor, rrugë kjo që, sipas mendimit tonë, duhet ndjekur edhe sot dhe në të ardhmen.

Barazia e popujve të Ballkanit të trazuar, sa herë që përmendej si ide që kishte frymëzuar ndër shekuj popujt e Evropës dhe si e tillë çmohej ndër idetë më fisnike, mbi të cilën renditeshin epitetet më mikluese e progresive për të gjitha vendet e civilizimit botëror.

Shtrohet pyetja e natyrshme, që mund të kuptohej në të gjitha gjuhët e popujve të botës, të mëdhenj apo të vegjël qofshin ata: *Epo ç' ishte ky mallkim aq kobzi që rrinte mbi kokën e një populli të lashtë, të urtë, dhe joviolent, por i ishte mohuar kjo e drejtë universale dhe e natyrshme me do farë nenesh famëkëqija të koncileve ndërkombëtare, të cilat në një anë lavdëronin të gjitha lëvizjet dhe luftërat çlirimtare të popujve të vet, nga ana tjetër, e mohonin paturpësisht këtë të drejtë për popullin e Kosovës (nga disa me keqardhje dhe me gjysmë zëri), por nga shumica dërrmuese e tyre që vetëquheshin me mburrje "si roja e rregullatorëve diplomatikë të një bote të re e të drejtë për ardhmërinë e qytetërimit evropian".*

Duke mos dashur të dalë nga kornizat e temës bosht, po u kthehem historisë dhe pasojave të zgjedhjeve të para 30 vjetësh, se si u organizuan, si u mbikëqyrën dhe si i pritë populli liridashës i Kosovës ato, çka fituan, çka mësuan subjektet politike shqiptare të asaj kohe dhe ku i qiti "xhemia" shqiptarët siç thotë populli ynë i shumëvujtur.

Qëllimi kryesor politik i Lidhjes Demokratike të Kosovës, organizata absolutisht më e fuqishme politike në vend, u përkrah fuqimisht

edhe nga partitë e tjera politike shqiptare të Kosovës për realizimin e idesë për pavarësinë e Kosovës. Shih për këtë, ajo në bashkëpunim me partitë e tjera në Këshillin Koordinues të Partive Politike (KKPP) dhe Kuvendin që vepronte jashtë për shkak të represionit fizik e politik serb<sup>6</sup>. Ky referendum përveç që iu dha legjitimitet qëllimeve të Partive Politike të Kosovës, si LDK-ja; Partia Fshatare e Kosovës; Partia Parlamentare e Kosovës; Partia Shqiptare Demokristiane; Partia Social-Demokrate e Kosovës, etj duke vënë në spikamë vullnetin e pakontestueshëm të popullit shqiptar për bërjen e *Kosovës shtet të pavarur dhe sovran*.

Duhet të pohohet këtu, se vlimet politike në ish-Jugosllavi po merrnin përmasa të një konfrontimi midis tendencave të pushtetit centralist që manifestohej nga apetitet shoviniste serbomëdha dhe shqiptarëve, si dhe kombeve të tjera që kërkonin më shumë liri dhe demokraci për tërë bashkësinë shtetërore federative. Dukej qartë se konfrontimi ishte i pashmangshëm.

Në bazë të dokumenteve autentike të Komisionit zgjedhor, të cilin Kuvendi i Republikës së Kosovës e kishte emëruar më 2 maj 1992 dhe i cili në bazë të dispozitave kushtetuese i kishte shpallur zgjedhjet e lira shumëpartiake dhe zgjedhjen e Presidentit të Republikës më 24 maj 1992.

Kuvendi po ashtu me vendimin e së njëjtës datë kishte emëruar Komisionin zgjedhor:

1. Tadej Rodiqi, jurist i diplomuar - kryetar
2. Destan Rukiqi, sekretar
3. Bajram Kelmendi, anëtar
4. Dr. Zenel Kelmendi, anëtar
5. Hasan Hoti, anëtar
6. Luigj Sereqi, anëtar
7. Mustafë Radoniqi, anëtar, si dhe anëtarët e njësive zgjedhore nëpër komunat e Kosovës<sup>7</sup>.

Në bazë të dispozitave ligjore Komisioni ka vepruar në mënyrë rigoroze dhe shumë profesionale edhe për shkak të kushteve dhe rrethanave specifike në të cilat gjendej Kosova. Janë zgjedhur 100 deputetë në mënyrë të drejtpërdrejtë në vendvotime. Ndërsa, 30 deputetë të tjerë në bazë të sistemit proporcional, meqë Kuvendi duhej të kishte 130 deputetë.

---

<sup>6</sup> Në shtator të vitit 1991 partitë politike e organizuan Referendumin për pavarësinë e Kosovës

<sup>7</sup> Raporti përfundimtar i Komisionit Zgjedhor...

Në zgjedhje kanë marrë pjesë 122 subjekte zgjedhore të cilët brenda afatit ligjor kanë kandiduar kandidatët e vet në listat kandiduese.

Për president të Republikës së Kosovës, kandidaturën e ka paraqitur vetëm Lidhja Demokratike e Kosovës, përmes kandidatit dr. Ibrahim Rugova.

Në bazë të këtij dokumentacioni zyrtar në zgjedhjet e drejtpërdrejta LDK-ja ka fituar 76.44 % të votave. Partia Parlamentare e Kosovës ka fituar 4.86%, Partia Fshatare e Kosovës 3.15%, Partia Shqiptare Demokristiane 3.10%, prandaj sipas Ligjit këto tri parti meqë kanë fituar mbi 3% të votave të përgjithshme, kanë fituar të drejtën sipas sistemit proporcional në zgjedhjen e 30 deputetëve të tjerë, ndërkaq, “kandidatët e pavarur” prej subjekteve të tjera zgjedhore, të cilët kanë fituar më pak se 3% të votave të përgjithshme, nuk marrin pjesë në ndarjen proporcionale të këtyre 30 vendeve, ndonëse kanë fituar 3.29% të votave, sepse nuk ishin subjekt partiak<sup>8</sup>.

Subjektet e tjera që morën pjesë në zgjedhje kanë fituar më pak se 3% të votave duke filluar prej 1.87% e deri në 0.02%, prandaj sipas Ligjit nuk fituan të drejtën për të marrë pjesë në Parlament sipas sistemit proporcional<sup>9</sup>.

Sipas rezultatit të zgjedhjeve numri i vendeve në Parlament dukej kështu:

1. LDK - 96 deputetë
2. PPK - 12 plus 1 deputet
3. PFK - 7 deputetë
4. PSHDK - 7 deputetë
5. “Kandidat të pavarur” - 2 deputetë<sup>10</sup>

Pjesëtarët e nacionalitetit mysliman sipas përqindjes së popullsisë, i kanë 4 deputetë në Parlament në bazë të sistemit proporcional plus 1 deputet, i cili është kandiduar si i koalicionit LDK-PAD. Kështu që në Parlament janë zgjedhur 5 deputetë të nacionalitetit mysliman.

Pjesëtarët e nacionalitetit turk në zgjedhjet e drejtpërdrejta kanë fituar 2 vende në Parlament përmes LDK-së, kurse sipas sistemit proporcional në raport me numrin e popullsisë u ka takuar edhe 1 vend në Parlament, i cili edhe u është ofruar nga ana e Komisionit zgjedhor, por ata kanë deklaruar se janë të përfaqësuar në mënyrë të mjaftueshme

---

<sup>8</sup> Po aty

<sup>9</sup> Po aty

<sup>10</sup> Po aty

përmes 2 deputetëve të këtij nacionaliteti që kanë fituar në zgjedhjet e drejtpërdrejta, prandaj nuk kërkojnë që në Parlament ta kenë edhe 1 vend deputeti sipas sistemit proporcional.

Në zgjedhje përveç shqiptarëve kanë marrë pjesë edhe pjesëtarë të nacionalitetit mysliman, turk, rom dhe kroat. Si dhe një numër i vogël i pjesëtarëve të nacionalitetit serb e malazez. Meqë serbët e malazezët nuk morën pjesë në votime atëherë, sipas përqindjes së popullsisë të këtyre dy nacionaliteteve janë lënë 14 vende të lira, numër ky që është adekuat me përqindjen e popullatës së këtyre dy nacionaliteteve. Pra, Parlamenti i Republikës së Kosovës sipas Ligjit mbi Zgjedhjet duhet t'i ketë së paku 130 deputetë, aq sa janë zgjedhur në rastin konkret në mënyrë efektive kurse 14 vende të tjera për deputetë të nacionalitetit serb e malazez janë të paplotësuara, dhe si të tilla mbesin të lira<sup>11</sup>.

Gjithnjë sipas procesverbalit të Komisionit zgjedhor, tri partitë politike që kanë fituar mbi 3% të votave të përgjithshme dhe kanë fituar të drejtën në zgjedhjen e deputetëve sipas sistemit proporcional, pas vërtetimit të përqindjes së votave janë marrë vesh që 1 vend për deputet t'ia lënë Partisë Socialdemokrate të Kosovës në mënyrë që kandidati i caktuar nga kryesia e asaj partie të hyjë në listën proporcionale të Partisë Parlamentare të Kosovës dhe në Parlament të marrë pjesë në grupin e kësaj partie. Pastaj kryesia e PSDK-së e ka caktuar për deputet Shkëlzen Maliqin dhe emri i tij është evidentuar në listën proporcionale PPK-së, kurse ai si deputet në Parlament paraqitet në kuadër të grupit parlamentar të Partisë Parlamentare të Kosovës<sup>12</sup>.

Si përfundim, Komisioni zgjedhor deklaron se zgjedhjet janë zhvilluar në harmoni me dispozitat e Ligjit mbi Zgjedhjet dhe rezultatet e tyre janë plotësisht valide. Po ashtu, ky Komision, ka konkluduar se gjatë zgjedhjeve nuk ka pasur ndonjë vërejtje apo lëshim esencial që do të ndikonte në rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve. Komisioni ka konstatuar edhe në bazë të raporteve të komisioneve dhe këshillave zgjedhore se procesi i zgjedhjeve ka rrjedhur normalisht përveç disa rasteve ku janë rrahur e keqtrajtuar anëtarët e komisioneve dhe këshillave zgjedhorë nga policia serbe, me ç'rast në 2-3 vendvotime

<sup>11</sup> Po aty

<sup>12</sup> Qëndrimi i Zenel Kelmendit nga LDK-ja ishte kundër koordinimit të përfaqësuesve të tri partive të tjera që me marrëveshje i bashkuan votat dhe vendosën për ta nxjerrë një deputet nga PSDK-ja. Ky fakt e ilustron më së miri respektin që kishin partitë politike të Kosovës për procesin e pluralizmit si proces shoqëror, si dhe vendosmërinë për të kundërshtuar hegjemonizmin njëpartiak, pavarësisht nga respekti që ruanin për Lidhjen si partia politike e parë dhe më e madhe.

është marrë edhe një pjesë e materialit zgjedhor nga ana e asaj policie të dhunshme. Në fund, materiali zgjedhor i është dorëzuar Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe ruhet në vend të caktuar, thuhet në Raportin përfundimtar që është mbajtur në Prishtinë me datën 8 qershor 1992 dhe është nënshkruar nga kryetari i Komisionit Zgjedhor dhe të gjithë anëtarët e atij Komisioni të Republikës së Kosovës.

Një kopje të këtij raporti e disponon dhe e ruan me kujdes edhe autori i kësaj kumtese. Këtë kopje ia bashkëngjiti kumtesës sime me rastin e botimit si provë materiale<sup>13</sup>.

Rezultatet e votimit të datës 24.05.1992 në zonën nr. IV në njësinë zgjedhore Gjakovë. Kandidati i LDK-së Ismet Bardhoshi ka fituar gjithsej 3422 vota. Kandidati i PFK-së, Jusuf Bajraktari, ka fituar gjithsej 2126 vota. Që do të thotë se të dy janë zgjedhur deputet të kësaj njësie zgjedhore.<sup>14</sup>

Si përfundim del se subjektet politike shqiptare dhe të pakicave turke dhe myslimane i pranuan zgjedhjet si akt i rëndësishëm i demokracisë. Është e kuptueshme se serbët dhe malazezët e Kosovës me shumicë absolute i kundërshtuan zgjedhjet e partive politike shqiptare, prej nga rezultoi dalja e Parlamentit të parë pluralist në Kosovë, si dhe zgjedhja e Presidentit Rugova si rezultat i shprehjes së lirë të vullnetit të popullit të Kosovës. Megjithatë kishte eksponentë shqiptarë, të cilët pavarësisht nga orientimi politik i tyre, të majtë apo të djathtë, të kuq apo të zi, u spikatën si figura të dështuara politike.

Mirëpo, ata duke përfituar nga situata e kohëve të errëta, nga brutaliteti i pushtetit policor-ushtarak serb, spikasin me qëndrimet e tyre publike kundër Alternativës Shqiptare të asaj kohe. Megjithatë, duhet konstatuar se sa i përket shkallës së unitetit kombëtar të partitë politike të Kosovës ishte në nivelin më të lartë të tolerancës ndërpartiake dhe të midis shtresave të shoqërisë shqiptare të asaj kohe. Bile, edhe në qoftë se e krahasojmë me situatën e sotme, edhe pas 30 vjetëve ky unitet jo vetëm që nuk është rritur, por çka është më keq është përkeqësuar.

Sidoqoftë, ky stabilitet nuk do të zgjatë aq shumë. Për habinë më të madhe të opinionit tonë, çarjet filluan aty ku më së paku pritej nga opinionit i gjerë. Nga kulmi “po pikonte çatia” thotë fjala popullore. Një ndër më të zëshmit në këtë kohë (2001) doli ish-deputeti i Kamenicës Bajram Kosumi, i cili votat e deputetit i kishte fituar si kandidat i Partisë Parlamentare të Kosovës, në aleancë me LDK-në e Rugovës. Ai i prirë

---

<sup>13</sup> Raporti i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve...

<sup>14</sup> Kopja e Raportit të rezultateve të votimit në Gjakovë.

nga ambiciet karrieriste, si një ish- i burgosur politik, dhe si ish-kryetar i Partisë Parlamentare të Veton Surroit kishte shkruar një farë biçim programi politik të ashtuquajtur “*Koncept për mendimin e ri politik*”<sup>15</sup>... Në këtë dokument, Kosumi, në mënyrën më vulgare do të tallej me personalitetin e Rugovës, të cilin në program do ta prezantonte si një “*shakaxhi odash*”, që sipas tij, “*në kohën e krijimit të rendit demokratik në Kosovë... populli shqiptar aty po degjenerohej në një masë njerëzish pa qëllim, pa ideal dhe pa hapësirë për jetë...ajo që sundonte atje është një zbrazëti dhe ai që sundon është trup njeriu i balsamosur përkatësisht i vdekur*”. Pra, kështu e përshkruante një “teoricien” të cilit i ishte mbushur mendja se ishte *specializuar* për të hartuar programe politike siç kishte shkruar dikur i adhuruari i tij Stalini”. Po ky “ideolog”, më vonë do të bëhej kryeministër i Republikës së Kosovës nën presidencën e Rugovës! Ky fakt flet bindshëm për vlerat apo ma mirë të thuhet, për antivleratë, që përfaqësonin një strukturë personash, që rrihnin gjoks se tashmë kishte ardhur koha e “*njerëzve të rinj*”, të cilëve gjoja po iu digjej zemra dhe shpirti për gjendjen e keqe të popullit të Kosovës. Në rrafshin e jetës reale ata po dilnin si demagogë e karrieristë hipokritë.

Ndërkaq kësaj “valleje të prapshtë” do t’i bashkëngjitej edhe një bashkëpunëtor i ngushtë i Rugovës. Është këtu fjala për një nga penat e njohura të gjeneratës së re të letrave shqipe të asaj periudhe në Kosovë. Bile, ai do të jetë hiç më pak se ish-zëdhënësi i Rugovës (LDK-së) në fazën e parë të afirmimit të politikës paqësore - Mehmet Kraja. Ai nga një ish-mik i Rugovës e dorë e djathtë e tij u shndërrua në një “*teoricien të rendit të ri demokratik*”. Në një botim voluminoz prej 315 faqesh, me titull simbolik “*Vite të humbura*”, botimi i parë “Eurolinda”, 1995 Tiranë dhe botimi i dytë në “Rozafa”, në Prishtinë, 2003<sup>16</sup>.

Kraja këtë libër “*Vite të humbura*”, do ta shkruante sigurisht me porosi për ta “kthjellë e ndihmuar popullin e Kosovës që të mendojë esëll e të largohet nga broçkullat e opinionit të Rugovës”!!! Ai tashmë si “ekspert” e kishte kryer edhe stazhin e një “*ambasadori special*” të Rugovës në zyrat e Muzeut Kombëtar të Tiranës (1992-1993). Këto dy figura, por jo vetëm këto, me angazhimet e tyre do të provojnë forcën e tyre politike dhe ndikimin intelektual, por për fatkeqësinë e tyre, këta zëra disonantë do të humbasin shpejt në shkretëtirë! Bile as vetë Rugova nuk do të denjojë që të merrej me këto “*zbulime shkencore*” të një

<sup>15</sup> Bajram Kosumi, *Koncept për mendim e ri politik*, Prishtinë, 2001, Botimi ka rreth 165 faqe.

<sup>16</sup> Mehmet Kraja, *Vitet e humbura*, 1995 dhe 2003.

rektori të tashëm të Universitetit të Gjilanit dhe një kryetari aktual të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës!!!

Përderisa po përgatitesha për t’i dhënë dorën e fundit punimit tim që duhet të dalë në përmbledhjen e veçantë nga materialet e Simpoziumit të 24 majit 2022, në shenjë të 30-vjetorit të zgjedhjeve të para parlamentare dhe presidenciale në Kosovë, të cilat në atë kohë luajtën një rol shumë pozitiv, më ra në dorë libri i doktorit të shkencave politike dhe autorit të librit “78 ditë të bombardimit të NATO-s - Lufta në Kosovë” e vlerësuar nga mediet kryesore italiane, e cila edhe e mori shpërblimin e parë ndërkombëtar – Mario Panuzzio (2016). Shih për këtë Panuzzio midis të tjerash shkruante se i kishte përcjellë me interesim të madh dhe kujdes të veçantë ngjarjet e Kosovës dhe të Ballkanit duke nënvizuar se edhe në këto errësira, urrejtje, lufta e masakrime dr. Rugova ishte dhe mbeti figurë pozitive me besim në paqe, liri, demokraci, dialog, falje, bashkëpunim dhe bashkëjetesë mes popujve, feve, traditave, kulturave dhe qytetërimeve të ndryshme<sup>17</sup>.

Unë besoj fuqimisht se nëse i krahasojmë këto vlerësime kontradiktore, të dy “shkencëtarëve” tanë dhe studiuesit italian diferencat janë shumë të mëdha.

Bile do të konstatoja me kënaqësi se “profetët politikë” dhe smirëzinjtë nga Kosova, janë të mundur me rezultat të thellë nga analisti dhe specialisti i krizave botërore. Këta “filozofët” tanë së paku do të duhej t’i kërkonin falje publikisht opinionit tonë dhe natyrisht të shkonin të varri i Rugovës dora-dorës me një tufë lule dhe dy qirinj të ndezur!!!

Për sa u tha më sipër, mund të konkludojmë se Kosova ishte një rast *Sui Generis*, i pashoq në marrëdhëniet ndërkombëtare të viteve ‘90 të shek. XX. Prandaj do të thosha, se vetëm mudi i singertë i të parëve tanë dhe gjaku i patriotëve shqiptarë u bën shkas që më në fund, diplomacia botërore ta mirëkuptojë vlerën reale të qëndresës sonë gjatë historisë.

Në mbështetje të burimeve historike të provinencave të ndryshme dhe në analizën e programeve të Partive Politike të Kosovës që përputheshin me idenë e pavarësisë dhe sovranitetit të Kosovës, u arrit përkrahja e armatosur e NATO-s me luftën e UÇK-së për çlirimin përfundimtar nga Serbia gjenocidale.

---

<sup>17</sup> LUCA DE POLI, *Ibrahim Rugova-Rrugëtim në kujtesën e tij mes Kosovës dhe Italisë*, Prishtinë, 2017, F10 – 14.



Isa Mustafa

## KONTRIBUTI FINANCIAR I DIASPORËS NË FAZËN E PARË TË SHKETNDËRTIMIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

### Përmbledhje

Punimi pasqyron organizimin, mobilizimin dhe përkrahjen e diasporës, por edhe të shqiptarëve në Kosovë në një periudhë historike, për të siguruar mbijetesën dhe për të mbështetur pavarësinë dhe ndërtimin e shtetit të Kosovës. Varfëria, papunësia padrejtësitë politike, shkelja e të drejtave të njeriut, represioni politik dhe luftërat, shihen si burime të konsiderueshme të flukseve të emigrimit. Përfshirja e diasporës në konflikte të atdheut dhe në zgjidhjen e tyre është dokumentuar nga kërkime dhe përvoja të vendeve të ndryshme. Ka shumë dëshmi se diaspora luan një rol të madh në evoluimin dhe përfundimin e konflikteve në vendin e origjinës përmes formave të ndryshme, siç janë lobimi politik, mbështetja financiare partive politike dhe grupeve të armatosura, ndihmat humanitare, ndikimi në vendin e tyre në transferimin e preferencave për demokracinë deri te përfshirja e drejtpërdrejtë në luftë. Diaspora kosovare (dhe ajo shqiptare në përgjithësi) u karakterizua me kontribute të ndryshme, nga ato financiare për mbijetesë në Kosovë, lobimet për pavarësi dhe pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë në luftën çlirimtare. Organizimi i grumbullimit të mjeteve financiare si ndihma për Kosovën dhe pastaj “si Buxhet i Kosovës”, fillimisht nga

LDK-ja në diasporë dhe në vazhdim nga Qeveria e Përkohshme e Koalicionit të Republikës së Kosovës, ishte origjinal në rrethana specifike me pjesëmarrje të një numri të madh të veprimtarëve në vendet e Perëndimit, por dhe në Kosovë. Ky organizim vështrohet edhe me rastet krahasuese të organizimit të diasporës në disa vende karakteristike në botë për të ndihmuar atdheun e tyre. Punimi mbështetet në dokumentet dhe raportet e Qeverisë së Përkohshme të Koalicionit të Republikës së Kosovës, e cila veprimi në ekzil nga themelimi i saj, më 19 tetor 1991 deri më 20 qershor 1999 kur është kthyer në Kosovë dhe përfundimin e punës më 31 janar 2000. Shfrytëzohen dokumente, shkrime dhe burime të ndryshme të autorëve dhe të organizatave ndërkombëtare.

*Fjalë çelës:* diaspora, financat, Qeveria në ekzil, Republika e Kosovës, buxheti, lufta çlirimtare

## Hyrje

Roli i diasporës kosovare trajtohet në periudhën nga viti 1990 deri në përfundimin e luftës në Kosovë në qershor të vitit 1999. Fushëveprimi, organizimi dhe veçoritë e kësaj diaspore vështrohen në mënyrë krahasuese me diasporat e disa vendeve të tjera, duke prezantuar përvoja dhe praktika të ndryshme të involvimit dhe të ndihmave të pjesëtarëve të diasporës për vendet e tyre në konflikt, në luftëra dhe në post-konflikte. Në këtë aspekt janë veçuar përvojat e diasporës së Izraelit, Kroacisë, Irlandës, Sri Lankës dhe Armenisë për të nxjerrë elemente të rëndësishme krahasuese për modalitetet e ndihmave financiare, por edhe tek aspektet e tjera ekonomike, sociale, kulturore dhe integruese që veçojnë ato.

Impulset që shprehnin njerëzit nga Kosova në shtetet e Perëndimit në fundshekullin e kaluar, të cilët jetonin, punonin dhe vepronin në një ambient liberal demokratik me mundësi të lirë të shprehjes, nuk mund të përputheshin me kushtet në të cilat vepronin shqiptarët dhe institucionet e tyre në Kosovë, të privuar nga të gjitha të drejtat dhe të kërceuuar çdo ditë nga veprimet policore e ushtarake të pushtetit serb. Kjo krijonte, jo rrallë, moskuptime për orientimet, politikat dhe metodat që aplikonte udhëheqja në Kosovë kundrejt pikëpamjeve dhe kërkesave që shfaqeshin jashtë Kosove.

Fillimi i themelimit të fondeve humanitare nga Lidhja Demokratike e Kosovës, veçmas, ose së bashku me subjektet e tjera politike që kishin zënë shtat në Perëndim, disa më herët e disa pas fillimit të pluralizmit politik në Kosovë shënoi fillimin e një periudhe, kur jo vetëm familjet që kishin të punësuar jashtë, por edhe Kosova si tërësi po gjente mbështetje konkrete financiare në diasporë. Trajtimi i objektivave, organizimit të grumbullimit të ndihmave jashtë Kosovës, shtrirja, karakteri i fondeve dhe burimet e tyre, si dhe ndërlidhja me institucionet financiare që u organizuan brenda Kosovës, jep përgjigje në pyetjen se si u mbijetoi Kosova presionit dhe segregimit ekonomik e social nga Serbia. Ambiguiteti në cilësimin e fondeve jashtë Kosove, si shoqata (fonde humanitare) nga organet zyrtare të shteteve ku ato organizoheshin dhe vepronin dhe si Buxhet i Republikës së Kosovës, nga kontributdhënësit, institucionet dhe qytetarët e Kosovës ndihmoi në respektimin e rendit ligjor në shtetet ku ato vepruan, si dhe në mobilizimin e njerëzve për të kontribuar.

Kosova e kishte proklamuar veten shtet, por ishte shtet që nuk kishte mundësi të kryente funksionet e tij në ekonomi, qoftë në rregullimin e funksionimit të tregut, në ofrimin e të mirave dhe shërbimeve publike ose në rishpërndarjen e të ardhurave. Nuk i hynin në punë as teoritë e financave publike nga asnjë fazë dhe nga asnjë koncept ekonomik. Qoftë ajo e Konsumit Joprodhues; e Shkëmbimit; e Shpërndarjes; e Produktivitetit; e Shkollës politike; ajo Socialdemokrate; e Kenjsit. As faktet që në një shtet normal, burime të buxhetit janë të hyrat fiskale dhe jofiskale. Asnjëra nga këto! Rruga e vetme ishte që vullneti dhe solidarizimi politik të transformohen edhe në solidarizim material, jashtë dhe brenda Kosovës.

## Konteksti kohor

Kosova në fundin e shekullit të kaluar përjetoi ndryshime rrënjësore. Asaj iu desh të përjetojë dhe promovojë paralelisht dy procese historike, atë të pluralizmit politik dhe atë të ndërtimit të institucioneve të veta të pavarura nga Serbia dhe ish-Jugosllavia. Ajo u bë prijëse në Evropën Juglindore në promovimin e pluralizmit politik me themelimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës më 23 dhjetor të vitit 1989 si “parti e parë shqiptare me orientim djathtist dhe frymë perëndimore”.<sup>1</sup> LDK-

---

<sup>1</sup> Jusuf Buxhovi, *KOSOVA Nga Konferenca e Londrës deri te protektorati ndërkombëtar*, “Faik Konica” Prishtinë, “Jalifat Publishing” – Houston 2012, f. 467

ja mori përgjegjësinë për organizimin e rezistencën politike e qytetare; organizoi jetën sociale, politike e publike. Pas themelimit të LDK-së, u themeluan edhe subjekte të tjera politike, një pjesë e të cilave organizuan edhe degët e tyre në diasporë.

Në vitin 1989 Serbia nëpërmjet organeve policore dhe ushtarake bëri pushtimin klasik të Kosovës, në kundërshtim me pozitën kushtetuese të saj në ish- Federatën jugosllave. Në raportin e Komisionit të pavarur ndërkombëtar për Kosovën<sup>2</sup> thuhet se “Revokimi i autonomisë së Kosovës në vitin 1989 u pasua nga një politikë e Beogradit që synonte ndryshimin e përbërjes etnike të Kosovës dhe krijimin e një shoqërie të ngjashme me aparteidin”. Me këtë veprim u abrogua subjektiviteti kushtetues i Kosovës në ish-Jugosllavi, si njëra nga tetë njësitë federative të barabarta, si dhe u suspendua struktura institucionale e autonomisë politike dhe territoriale. Buxheti i vitit 1990, i aprovuar për herë të fundit në Kuvendin e Krahinës së Kosovës, ishte ekuivalent me 934 milionë DM (rreth 470 milion Euro). Shpenzimet më të mëdha, prej 65 për qind ishin për nevoja operative dhe investime, kurse në shpenzimet buxhetore, pagat merrnin pjesë me 35 për qind.

Pas suprimimit të autonomisë, tatimet që grumbulloheshin në Kosovë përdreshin për qëllime okupuese dhe jo për nevoja publike për qytetarët, shumicën dërmuese të të cilëve e përbënin shqiptarët. E gjithë kjo ndodhi kur si pasojë e shpenzimeve të luftës që bënte Serbia dhe bllokadës që i bëri Perëndimi, (ndërmjet viteve 1992-1994) u shënuar inflacion, i cili llogaritet se ishte deri atëherë i dyti më i larti në botë (pas atij të vitit 1946 në Hungari), me normë ditore prej 65%, ku dyfishimi i çmimit shkonte në çdo 34 orë. Edhe pse u bënë katër denominime, gjendja u tejkalua shumë ngadalë dhe kishte pasojë të rënda edhe në Kosovë, e cila mbahej si territor i okupuar nga Serbia.

Me suprimimin e autonomisë, përveç përvetësimit të buxhetit të Kosovës, Serbia plaçkiti kursimet pensionale, zbatoi masa të dhunshme në ndërmarrjet ekonomike dhe përjashtoi shqiptarët nga puna, sikurse edhe përjashtoi nxënësit, arsimtarët dhe profesorët nga shkollat dhe fakultetet e tyre. Në një gjendje të tillë ishte e domosdoshme të kërkoheshin dhe të gjendeshin zgjidhjet, para së gjithash për vazhdimin e arsimit shqip, mbështetjen e shëndetësisë dhe ngjalljen e sektorit privat të ekonomisë, si alternativë e krijimit të vendeve të punës por edhe të pavarësisë ekonomike nga masat diskriminuese serbe. Paralelisht me

---

<sup>2</sup> The Kosovo Report Conflict \*International Response\* Lesson Learned\* The Independent International Commission on Kosovo, Oxford University Press 2000, f.1

ketë duhej të punohej në sigurimin e mjeteve për luftë, sepse kishte filluar shkatërrimi i ish- Jugosllavisë dhe lufta e armatosur në disa republika.

Në Programin e Komisionit Evropian dhe të Bankës Botërore për rekonstruktim dhe rindërtim të Kosovës (1999) konstatohet se kosovarët të ballafaquar me vështirësitë, iu qasën zgjidhjes së problemeve në tri mënyra bazike:<sup>3</sup> (i) *Emigracioni, kryesisht në vendet perëndimore çoi në këmbë diasporën, e cila do të luajë një rol të rëndësishëm në rikuperimin ekonomik;* (ii) *Kthimi në zonat rurale rezultoi në më shumë se dyfishimin e popullsisë aktive në sektorin e agrikulturës ndërmjet viteve 1990-1997; dhe* (iii) *Zhvillimi i një ekonomie të shtrirë joformale, kundrejt asaj të natyrës legale.*

Kontributi i diasporës kosovare ishte i një rëndësie shumë të madhe për të përballuar gjendjen sociale dhe ekonomike, si kundërpërgjigje ndaj masave të Serbisë. Ky kontribut ka qenë i shumëllojshëm.

Aktivizimi i njerëzve të përjashtuar nga punë në sektorin e bujqësisë, pemëtarisë, blegtorisë dhe kulturave të tjera në zonat rurale, por edhe në rrethinat e qyteteve ishte një alternativë tjetër për të fituar të ardhura nga ata që ishin larguar me dhunë nga puna.

Papunësia kronike në Kosovë kishte ndikuar që edhe më parë shumë qytetarë të orientohen në sektorin individual, siç trajtohej atëherë në ish- sistemin socialist sektori privat. Kryesisht në tregti, shërbime, bujqësi, ndërtimtari dhe zeytari. Ishin krijuar përvoja të caktuara në këtë sektor, prandaj ai mori hov pas largimit masiv të punëtorëve nga puna në sektorët që financoheshin nga buxheti dhe nga ndërmarrjet në pronësi shoqërore (publike). Sektori privat (dhe ekonomia joformale që u cilësua nga Komisioni Evropian dhe Banka Botërore) ishte në shënjestër të organeve serbe, sepse vepronte si formë paralele e mbi-jetesës për shqiptarët dhe e rezistencës ekonomike ndaj pushtetit serb. Nuk kishte vullnet dhe as arsye që pushtetit serb, si pushtet okupues, t'i paguhen të gjitha tatimet dhe kontributet dhe t'i paraqiten të gjitha të ardhurat, fitimet dhe të punësuarit. Ekonomia e tillë ndihmonte mbi-jetesën individuale dhe kolektive të shqiptarëve.

---

<sup>3</sup> Toward Stability and Prosperity, A program for Reconstruction and Recovery in Kosovo, November 3, 1999, prepared by European Commission and the World Bank in Support of the United Nations Mission in Kosovo, f. 7

## Koncepti politik dhe social i diasporës dhe roli i saj

Koncepti i diasporës i referohet njëkohësisht një forme shoqërore të krijuar nga shpërndarja dhe zhvendosja e një popullsie në formë të identifikimit shoqëror dhe kulturës së shprehjes. Duke i referuar shpërndarjes së popullit hebre, cilësimi diasporë ka fituar një kuptim të gjerë për t'u përdorur për të gjitha emigrimet dhe shpërndarjet e një populli.<sup>4</sup> Prandaj, sot me diasporë iu referohet jo vetëm hebrenjve që jetojnë jashtë Izraelit, por edhe grupeve të tjera të njerëzve që u shpërndanë jashtë atdheut të tyre për arsye të ndryshme.

Në komunikimin me njerëzit që e kishin lëshuar Kosovën dhe ishin vendosur në shtetet perëndimore që nga vitet 60' të shekullit të kaluar, atyre u referohej më shumë si bashkatdhetarë sesa si diasporë nga fakti i ndërlidhjes së tyre të fortë me Kosovën, por edhe nga ndjeshmëria që të mos trajtohen se janë ndarë nga Kosova. Në të vërtetë, me kalimin e kohës ata gjithnjë e më shumë morën karakter të diasporës, duke e pasur parasysh integrimin e gjeneratës së mesme dhe të re në jetën dhe institucionet e vendeve ku jetojnë, por edhe vetë mekanizmat që i aplikojnë për ruajtjen e identitetit kombëtar dhe lidhjet me atdheun.

Ekziston një ndërlidhje kauzale ndërmjet madhësisë së diasporës dhe ndikimit të saj në konflikte dhe luftëra dhe kontributin për ndërtimin e paqes. Instituti për Progres Demokratik DPI (2014), gjatë analizës së rolit të diasporës në konflikte, konstaton se do të ishte një gabim për t'i parë financimet (remitancat) e kohës së luftës thjesht si prishëse të paqes, sepse ato "mund të veprojnë si frenuese ndaj dhunës dhe zbutës së tensioneve destabilizuese socio-ekonomike".<sup>5</sup> Në një studim për armenët thuhet se "grupet e diasporës kanë luajtur role shumë të rëndësishme në nxitjen dhe mbështetjen e konflikteve në vende të ndryshme si në Etiopi, Kosovë, Nagorno-Karabakh, Kashmir, Izrael dhe Palestinë. Konstatohet se konflikti në atdhe është shpesh tregues i identitetit të diasporës, prandaj grupet e diasporës kanë një tendencë për të ndërlikuar proceset e paqes dhe mund t'i bëjë konfliktet e atdheut të

---

<sup>4</sup> Suzane Rutland, Chapter Jewish Diaspora, Projects: Jewish Education in Australia. January 2014 The University of Sydney, f. 25

<sup>5</sup> Democratic Progress Institute, Makers or Breakers of Peace The Role of Diasporas in Conflict Resolution, London, Avgust 2014, f. 11

zgjasin edhe më shumë”.<sup>6</sup> Arsyet historike para emigrimit të popullsisë janë një faktor i rëndësishëm në mënyrën se si funksionojnë organizatat bashkëkohore të diasporës.

*Diaspora hebreje* ka mbajtur gjithmonë, siç thuhet nga studiuesit, “një lidhje të fortë me Tokën e Izraelit (Eretz Yisrael), lidhje që ishte kryesisht fetare dhe emocionale”.<sup>7</sup> Si e tillë ajo nga shekulli njëzet u transformua në veprim praktik duke i ndihmuar drejtpërsëdrejti shtetit të tyre, Izraelit. David Ben-Gurion, themeluesi dhe kryeministri i parë i Izraelit, ishte shprehur: "i vetmi aleat absolutisht i besueshëm i Izraelit është hebrenja botërore, pastaj vijnë hebrenjtë amerikanë - hebrenjtë më të fuqishëm në botë në kombin më të fuqishëm në botë".<sup>8</sup> Diaspora e Izraelit është një shembull, të cilin e kanë ndjekur shumë mërgata të tjera sa i përket organizimit për t'i ndihmuar vendit të tyre. Merret edhe si shembull paradigmatic, si diasporë e përfshirë në konflikt të atdheut. Që nga themelimi i Izraelit, më 1948, hebrenjtë në diasporë kanë vazhduar t'i japin shtetit të tyre mbështetje vitale ekonomike dhe politike, mbështetje që u rrit shumë me kalimin e kohës, kur hebrenjtë e diasporës në pjesën dërmuese përqaftuan sionizmin si lëvizje për mbrojtjen e kombit hebre pas Holokaustit. Komuniteti më i pasur dhe më i rëndësishëm hebre i diasporës është ai amerikan (që llogaritet se përbën pothuajse 70 për qind të hebrenjve të diasporës). Vlerësohet se hebrenjtë amerikanë japin miliarda dollarë amerikanë çdo vit për organizatat dhe bamirësitë në Izrael. Dov Waxan<sup>9</sup> (2017) thekson se për Izraelin, mbështetja financiare, politike dhe morale që merr nga diaspora hebraike është një burim jashtëzakonisht i vlefshëm; për këtë arsye theksohet rregullisht rëndësia e forcimit të identitetit hebre mes hebrenjve të diasporës. Komiteti për Marrëdhënie Publike Amerikane Izraelite (AIPAC), për dekada të tëra llogaritet të jetë grupi kryesor i lobit pro-izraelit në Uashington DC dhe, për shkak të ndikimit në Kongres, luan rol kritik në sigurimin e ndihmave për Izraelin.

---

<sup>6</sup> DIASPORA DESIGN VERSUS HOMELAND REALITIES: CASE STUDY OF ARMENIAN DIASPORA Bahar Baser and Ashok Swain\*, CAUCASIAN REVIEW OF INTERNATIONAL AFFAIRS VOL. 3 (1) – 2009, <https://cadmus.eui.eu/handle/1814/10967>, f. 48

<sup>7</sup> Dov Waxman, University of California, *Palestinian Conflict, Part of the Problem or Part of the Solution: AMERICAN JEWS AND THE ISRAELI-PALESTINIAN CONFLICT*, June 2016, f. 316

<sup>8</sup> Dov Waxman, *American Jews and the Israeli-Palestinian Conflict: Part of the Problem or Part of the Solution?: AMERICAN JEWS AND THE ISRAELI-PALESTINIAN CONFLICT* Article in *Political Science Quarterly*, June 2017, Los Angeles, f.315- 318

<sup>9</sup> Po aty, f. 322

*Diaspora kroate* ishte aktivizuar shpejt dhe në mënyrë efektive rreth Bashkimit Demokratik Kroat (HDZ) në krye me Franjo Tugjmanin. Tugjmani filloi me mobilizimin e diasporës kroate në Kanada, ku shtroi tezat themelore për Bashkimin Demokratik Kroat.<sup>10</sup> Mbledhja e fondeve në diasporën kroate ishte një element thelbësor i ndërlidhjes së saj me ngjarjet në atdhe, dhe kjo ishte faktor kyç i ndikimit efektiv të diasporës kroate në ngjarjet në Kroaci. Mbledhja e fondeve u përcoll me retorikën e pajtimit kombëtar dhe të kthimit në atdhe. Vlerësohet se ndihma të konsiderueshme financiare u dërguan në Kroaci në vitin 1988 e tutje. Para se të pëlcas lufta, shumica e fondeve të diasporës ishin përdorur për aktivitete politike të opozitës antikomuniste, veçanërisht për fushatën zgjedhore të HDZ-së më 1989. Me shpërthimin e luftës, diaspora kroate ndihmoi financiarisht luftën dhe mori pjesë drejtpërdrejt në luftë. Nga studimet për rolin e diasporës në konflikte, vlerësohet se “pjesëmarrja financiare ishte pothuajse e detyrueshme për emigrantët kroatë për mjetet që u përdorën si për luftë, ashtu edhe për fushata në vendet të ndryshme për të kërkuar mbështetje për njohje të shtetit të ri”.<sup>11</sup>

*Diaspora irlandeze* merret si shembull se si ajo, si aktor i fuqishëm, mund të mbështesë dhe pengojë procesin e paqes në atdhe. Konflikti i Irlandës Veriore ilustron si shembull i potencialit pozitiv dhe negativ që mund të përdoret nga diaspora për të ndikuar në procesin e paqes. Gjatë viteve 1970 dhe 1980, u formuan shumë OJQ nga diaspora irlandezo-amerikane, të cilat krijuan një fluks parash për grupet republikane militante brenda Irlandës Veriore. Edhe pse shkuan fonde të mëdha për të mbajtur gjallë konfliktin në Irlandën Veriore, vlerësohet se shumë më tepër para u dhuruan për paqe sesa për qëllime të dhunshme. Ndihamat e tilla u përdorën edhe për të mbështetur familjet e të burgosurve dhe luftëtarët. Në konfliktin e Irlandës Veriore, përfaqësuesit e diasporës irlandeze në SHBA gjetën një mekanizëm për të punuar me të dy komunitetet e përfshira në konflikt.<sup>12</sup> Qëndrimi politik i Irlandës është i rrënjësor në nenin 2 të Kushtetutës së Irlandës, ku thuhet se "kombi irlandez vlerëson lidhjen e tij të veçantë me njerëzit

---

<sup>10</sup> Paul Hockenos, *Homeland Calling Exile Patriotism & the Balkan Wars*, Cornell University, 2003 (42-43)

<sup>11</sup> Fabio Mariani, Marion Mercier, Thierry Verdier, *Diasporas and conflict*, *Journal of Economic Geography*, Volume 18, <https://doi.org/10.1093/jeg/lby014>, Published: 26 March 2018, f. 761-793

<sup>12</sup> *Masis Mayilian*, The role of the diaspora in Northern Ireland and mechanisms for engaging it the transformation of the conflict, <http://theanalyticon.com/?p=5-343&lang=en>

me prejardhje irlandeze që jetojnë jashtë vendit, të cilët ndajnë identitetin dhe trashëgiminë e tij kulturore"<sup>13</sup>, që shpreh një lidhje dhe përkushtim të fortë për diasporën.

*Diaspora tamile* nga Sri Lanka, identitetin e saj e ruajti përmes organizatave të shumta kulturore që punuan në kultivimin e gjuhës tamile dhe të traditave fetare. Nga fillimi i viteve 1980, emigrantët tamilë ofruan mbështetje të fortë financiare për tamilët e armatosur si grup në Sri Lanka, Tigrat Çlirimtarë të Tamil Eelam (LTTE)".<sup>14</sup> Për LTTE-në thuhet se në njërën anë punoi në shpërndarjen e propagandës së saj në diasporë për të mobilizuar tamilët atje dhe në anën tjetër bashkërenditi burimet dhe mbledhjen e kontributeve të diasporës për nevojat e saj në Sri Lanka. Kjo diasporë njihet si "ekonomike" si shtylla kurrizore e grumbullimit të fondeve për aksione militante, qofshin ato përmes detyrimeve apo në formë vullnetare. Vlerësohet se "Tigrat Çlirimtarë të Tamil Eelam (LTTE) krijuan zyra dhe qeliza të tyre në të paktën 40 vende dhe nuk krahasohen me asnjë organizatë tjetër kryengritëse".<sup>15</sup> Sipas kësaj edhe kohëzgjatja e konfliktit i atribuohet kontributeve financiare, të cilat LTTE ka marrë nga diasporën tamile.

*Diaspora armene*<sup>16</sup> llogaritet se ka bërë shumë në nxitjen e fluksit të investimeve drejt vendit të tyre dhe në lobim për mbështetje financiare nga shumë vende, por edhe në integrimin gradual të Armenisë në botë. Armenët e diasporës arritën të bashkohen rreth Republikës Armene për të mbështetur lëvizjen e Karabagut, kontribuan në vendosjen e demokracisë dhe ofruan kontribute materiale për të. Janë bërë, po ashtu, tentativa të shumta për të shfrytëzuar potencialin e biznesit të diasporës për zhvillimin e vendit. Numri i madh i armenëve të shpërndarë në shumë shtete ka ndikuar në shumëllojshmërinë e komuniteteve në diasporën armene, si specifike e veçantë e saj. Kjo në një masë të caktuar ka ndërlikuar bashkërenditjen e veprimeve ndërmjet tyre. Qëndrimi i gjatë i tyre dhe adaptimin në një territor të një vendi ka

<sup>13</sup> Global Irish, Ireland's Diaspora Policy Policy March 2015, Department of Foreign Affairs and Trade, f.10

<sup>14</sup> Fabio Mariani, Marion Mercier, Thierry Verdier: *Diasporas and conflict*, *Journal of Economic Geography*, Volume 18, Issue 4, July 2018, f. 761–793, <https://doi.org/10.1093/jeg/lby014>, Published: 26 March 2018

<sup>15</sup> Hazel Smith and Paul Stares, *Diasporas in conflict: Peace-makers or peace-wreckers*, C. Christine Fair: The Sri Lankan Tamil diaspora: Sustaining conflict and pushing for peace, f. 172

<sup>16</sup> ARMENIAN INTERNATIONAL POLICY RESEARCH, Working Paper No. 04/14, Tatoul Manaseryan Member of the Parliament, DIASPORA THE COMPARATIVE ADVANTAGE FOR ARMENIA, [tatoulm@parliament.am](mailto:tatoulm@parliament.am) January 2004.

ndikuar që disa nga këto komunitete ta mohojnë të qenit diasporë, duke e ndier veten pjesë të territorit ku gjenden. Në diasporën armene u organizuan struktura të ndryshme për të mbledhur dhe ofruar ndihma dhe donacione individuale në të gjitha komunitetet e diasporës. Në studimin Smith & Stares<sup>17</sup> (2007) thuhet se ajo që veçon armenët etnikë në diasporë është një kombinim i tre karakteristikave: ata kujdesen për të afërmit në atdhe dhe gjetkë, kështu që shqetësimet e tyre janë edhe lokale edhe transnacionale; ata krijojnë dhe financojnë institucione që gëzojnë në mënyrë aktive kujdesin ndaj tyre, duke përfshirë edhe lobimin; dhe ata bëjnë përpjekje të vazhdueshme të “diasporizojnë” vetëdijen dhe identitetin e të afërmeve të tyre etnik, me veprime kulturore, sociale dhe politike.

## Diaspora kosovare

Ashtu sikurse edhe në vendet e tjera, diaspora kosovare kontribuoi kryesisht: (a) me kontribute financiare, (b) me involvim politik dhe drejtpërsëdrejti në luftë dhe (c) përmes lobimit. Angazhimi i diasporës kosovare kapërcen relacionet e vendit ku ata janë vendosur dhe atdheut të tyre, Kosovës. Ajo ishte e integruar dhe e lidhur ndërmjet vete në vende të ndryshme dhe me institucionet e këtyre vendeve ku ushtroi ndikim të rëndësishëm.

Emigrimet e mëdha nga Kosova marrin hov me cikle të ndryshme gjatë gjithë shekullit të kaluar. Fillimisht emigrimi i shqiptarëve në Turqi i shtytur me masa shtetërore pastaj nga vitet gjashtëdhjetë shkuarja e një pjese të kosovarëve për të gjetur punë në Gjermani, Zvicër dhe vendet e tjera evropiane, si dhe shpërndarja nëpër botë e një numri të konsiderueshëm të tyre për shkak të represionit politik. Për më shumë shih studimin e akademik Hivzi Islami<sup>18</sup> (2021). Diaspora kosovare është ilustruar në formë karakteristike nga një studim që i është bërë kësaj diaspore në Zvicër, si ambient “ku përzihen Gastarbeiter-ët me disidentët politikë dhe refugjatët e luftës”<sup>19</sup>. Diaspora kosovare

---

<sup>17</sup> *Diasporas in conflict: Peace-makers or peace-wreckers?*, Edited by Hazel Smith and Paul Stares, United Nations University Press, 2007, f. 108-109

<sup>18</sup> Hivzi Islami, *Demografia e Kosovës, Evolucioni i popullsisë, migrimet, gjeopolitikën ekspansioniste serbe dhe spastrimet etnike të shqiptarëve*, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Prishtinë f. 293-437

<sup>19</sup> DIASPORA AS A DRIVING FORCE FOR DEVELOPMENT IN KOSOVO: MYTH OR REALITY? SUMMARY, Forumi për Iniciativë Demokratike, Gjakovë, qershor 2009, mbështetur nga Swiss Cooperation Office Kosovo (4)

përfshin njerëz me interesa dhe arsye të ndryshme për të qenë jashtë Kosovës dhe për të mbajtur pikëpamje të ndryshme, si për Kosovën ashtu për vendet pritëse të tyre. Ajo është njaftë heterogjene, si pasojë e arsyeve dhe kushteve të shpërndarjes jashtë atdheut.<sup>20</sup>Në shtetet përrëndimore, një numër i konsiderueshëm i kosovarëve kishte shkuar në punë të përkohshme me mbështetje të institucioneve të Krahinës së Kosovës (kryesisht në Gjermani Zvicër dhe Austri). Grupin tjetër e përbënin të ikurit politikë të krahëve të ndryshëm që ishin vendosur, përpos në Zvicër dhe Gjermani edhe në Suedi, Belgjikë e SHBA. Ata nuk ishin pajtuar me pushtetin në ish-Jugosllavi, por kishin mospajtime ideologjike edhe ndërmjet veti. Një komunitet të veçantë e përfaqësonin ata që për nevoja ekonomike kishin siguruar qëndrim jashtë përmes lidhjeve dhe kanaleve familjare, duke e tërhequr njeri-tjetrin dhe formave të tjera, si në Itali, Holandë, Francë, Mbretëri të Bashkuar, në shtetet skandinave dhe vende të tjera.

Në vitet nëntëdhjetë, një pjesë e rëndësishme e diasporës vepronte e politikisht si filiale të partive politike në Kosovë të orientimit të djathtë, që i përbënin kryesisht LDK-ja dhe PSHDK-ja, sikurse edhe në ato të majta, të cilat ishin zhvilluar jashtë vendit si parti dhe lëvizje, si: Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK), Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK), Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK). Një numër i rëndësishëm i shqiptarëve organizohej dhe frekuentonte klubet, shoqatat dhe qendrat e ndryshme si forma të bashkëpunimit dhe të reflektimit të lidhjeve ndërmjet tyre dhe me Kosovën. Edhe pse të organizuar në parti të spektrave të kundërta dhe të ndryshme politike sikurse edhe në klube dhe shoqata, njerëzit i lidhte gjithherë ideali për pavarësinë e Kosovës, pavarësisht se si e kishin menduar dhe ëndërruar atë më parë (si shtet demokratik, të bashkuar me Shqipërinë apo si shtet në shembullin e Shqipërisë së regjimit të Enver Hoxhës). Pikëpamjet për pavarësimin e Kosovës silleshin nga ato me mjete paqësore deri në luftë. Këto pikëpamjet individuale nuk përputheshin gjithherë me organizimin e tyre partiak. Shumë nga ata që ishin ushqyer një kohë të gjatë me literaturë dhe organizime marksiste-leniniste dhe me pikëpamje të majta për shtetin, edhe pse vazhdonin të jetonin në

---

<sup>20</sup> Thuhet se në Kosovë, secila familje do të dëshironte të kishte gjashtë djem: Dy për të shkuar jashtë vendit për të punuar, dy për të qëndruar në shtëpi dhe për t'u kujdesur për familjen dhe dy të për të vdekur për atdheun, duke luftuar për liri. (marrë nga botimi: Diaspora as Driving Force for Development in Kosovo: Myth or Reality? Forumi për Iniciativë Demokratike, Gjakovë, qershor 2009, mbështetur nga Swiss Cooperation Office Kosovo, f. 4

shtete kapitaliste, së fundi Ibrahim Rugova i kishte bërë për vete dhe tani kishin përqaftuar demokracinë dhe orientimin perëndimor euro-atlantik. Hockenos<sup>21</sup> (2003) theksonte se në Kosovë, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) më në fund tha atë që qarqet e diasporës donin të dëgjonin dhe “diaspora u dynd drejt saj”.<sup>22</sup>

Qeveria e Kosovës, menjëherë pas themelimit të saj kishte hapur zyrat e saj, në shumë vende të rëndësishme, përmes së cilave bashkërenditej puna me diasporën. Në SHBA shqiptarët ndihmonin me lobimet me kongresmenë dhe senatorë për zgjidhje të drejtë të çështjes së Kosovës. Në Gjermani, Austri dhe Mbretërinë e Bashkuar po ashtu ishin krijuar lidhje të mira me qarqet të caktuara diplomatike dhe opinionbërëse. Presidenti Rugova bashkëpunonte me të gjitha vendet perëndimore, por besonte se me përkrahjen e SHBA-së do të bëhet zgjidhja përfundimtare. Lidhja Qytetare Shqiptaro-Amerikane me bazë në New York bënte hapa të rëndësishëm për lobimin.

Kthim përmbajtësor në disponimin komunitetit jashtë Kosovës, por edhe të një pjese në Kosovë ndodhi në vitin 1995 kur çështja e të ardhmes politike të Kosovës nuk mori vëmendjen në vendimet e Marrëveshjes së Dejtonit e që u përcoll me pushtimin gjithnjë e më shumë të hapësirës së gjerë politike nga ata që preferonin alternativë të militarizimit në vend të zgjidhjes politike. Në Raportin e Komisionit të Pavarur Ndërkombëtar për Kosovën (2000) thuhet se “lëvizjes së rezistencës jo të dhunshme, e cila krijoi institucionet e veta paralele dhe që arriti të parandalojë në një masë dhunën në shkallë të gjerë në Kosovë deri në vitin 1997 iu dha një mbështetje e pamjaftueshme”.<sup>23</sup>

Në studimin e saj “Aktivizimi i diasporës shqiptare në SHBA dhe në Mbretërinë e Bashkuar për pavarësinë e Kosovës” Maria Koinova<sup>24</sup> (2013) përshkruan se diaspora kosovare kaloi katër lloje të mobilizimit. Sipas saj në periudhat e dhunës së lartë në vendlindje kishte më shumë gjasa të nxitej mobilizimi radikal, ndërsa periudhat e dhunës së nivelit të ulët moderonin

---

<sup>21</sup> Paul Hockenos në librin e tij *Homeland calling, exile patriotism and the Balkan wars*, 2003, jep një pasqyrim karakteristik të diasporës ballkanike, aty edhe të Kosovës.

<sup>22</sup> Marrë nga Maria Koinova, *Conditions and Timing of Moderate and Radical Diaspora Mobilization: Evidence from Conflict-Generated Diasporas, Global Migration and Transnational Politics*, Working Paper no. 9, October 2009, George Mason University, f. 3

<sup>23</sup> The Kosovo Report Conflict \* International Response \* Lesson Learned\* The Independent International Commission on Kosovo, Oxford University Press 2000, f.4

<sup>24</sup> Koinova, Maria. Four types of diaspora mobilization: Albanian diaspora activism for Kosovo independence in the US and the UK. *Foreign Policy Analysis*, Volume 9 (number 4).. ISSN 1743-8586, THE UNIVERSITY OF WARWICK, 2013, f. 433-453

sjelljen politike. Nivelet e ulëta dhe nivelet e larta të dhunës çonin në nivele të veçanta të mobilizimit të diaspora kosovare. Ajo veçon ndërlidhjet e sjelljeve të diasporës me gjendjen në Kosovë. Sipas saj, politika dhe sjellja shumë e moderuar, konvergonte me nivelin më të ulët të dhunës në atdhe, por se lidhja për pavarësi e diasporës me vendin ishte e fortë. Në anën tjetër, radikalizmi i fortë, ishte si pasojë e nivelit të lartë të dhunës dhe krijoi lidhjen e fortë për pavarësi. Radikalizmin e butë e manifestuan individët dhe grupet, të cilët nga motivet dhe interesat e tyre personale për rregullim të statusit të tyre në vendet perëndimore nuk treguan përkrahje të nevojshme financiare dhe përkrahje tjetër për atdheun, edhe pse situata në Kosovë ishte shumë rëndë.

*Shpjegime konjunkturorë për katër llojet e mobilizimit të diasporës*

Karakteristikat	Tipi 1 Fortë i moderuar	Tipi 2 Pak i moderuar	Tipi 3 Fortë radikal	Tipi 4 Pak radikal
Niveli i dhunës në atdhe Lidhjet e elitave kryesore secesioniste me diasporën	i ulët e fortë	i ulët e dobët	i lartë e fortë	i lartë e dobët

*Burimi: Koinova Maria (2013) fq.9*

Tipi i moderimit të fortë të diasporës mund të thuhet se vazhdoi deri në vitin 1995, kurse më vonë pason moderimi i butë dhe radikalizmi i fortë në diasporën tonë. Radikalizëm i fortë ndodhi gjatë viteve 1998 dhe pjesën e parë të vitit 1999 kur u mobilizua diaspora kosovare, si pasojë e shkallëzimit të luftës në Kosovë. Kjo u shpreh edhe në mbledhjen e fondeve për Kosovën. Krahas kësaj, nga diaspora shkuan shumë të rinj për t’iu bashkuar luftës në Kosovë. Një pjesë e konsiderueshme e komandantëve të UÇK-së ishin nga diaspora, veçanërisht nga Zvicra, Gjermania, Suedia. Edhe oficerët, të cilët u rekrutuan nga Qeveria Bukoshi në Forcat e Armatosura të Kosovës që luftuan si pjesë e UÇK-së ishin nga radhët e atyre që kishin shërbyer në Kroaci, Bosnjë e Hercegovinë dhe shumica e tyre kishin statusin e refugjatëve në vendet perëndimore.

Qasja, mentaliteti, veprimi, organizimi dhe kultura e diasporës ishte në korrelacion me përqendrimin dhe integrimin kosovarëve në vendet ku jetonin, si dhe me lidhjet dhe bashkëpunimin me shqiptarët nga Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi dhe Lugina e Preshevës. Aty ku ishte koncentrimi më i madh, ishte edhe organizimi më i fortë, sidomos në Gjermani dhe Zvicër.

## Format dhe karakteristikat e kontributit financiar të diasporës kosovare

Diaspora kontribuoi me:

- Fondet e organizuara nga LDK-ja dhe subjektet e tjera të organizuara në Perëndim deri në themelimin e Qeverisë së Përkohshme të Koalicionit të Republikës së Kosovës;
- Fondeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës;
- Aksione të veçanta të organizuara nga Qeveria ose nga vetë bashkatdhetarët;
- Ndhima të ndryshme nga shoqatat dhe klubet jashtë Kosove,
- Remitanca të përcjella në Kosovë në kanale të ndryshme;
- Pagesat në këshillat komunale për financim në Kosovë në emër të familjeve që kishin të punësuar jashtë;

### *1. Fondet e organizuara nga LDK dhe subjektet tjera*

Në Gjermani, LDK-ja kishte themeluar “Fondin për vetëmbrojtje” me seli në Stuttgart, nga i cili u financua edhe aktiviteti i Qeverisë në fillimin e punës së saj, si dhe i organeve të tjera republikane. Fondi administrohej nga dega e LDK-së për Gjermani. Nga ky fond, derisa u themelua Qeveria, përkrahej LDK-ja në Kosovë, mbuloheshin shpenzimet e delegacioneve të LDK-së jashtë Kosove që punonin në procesin e informimit për okupimin dhe represionin serb dhe lobonin për përkrahje për pavarësi. Përkrahej edhe Shqipëria në hapat e saj të parë të ndërtimit të institucioneve pas rënies së sistemit diktatorial. Në Gjermani ishte themeluar edhe fondi, i cili më tepër i shërbente LDK-së i njohur si “Fondi i Ahenit”, me seli në Ahen.

Në Zvicër, Këshilli Koordinues i Subjekteve Politike Shqiptare kishte themeluar “Fondin Humanitar Gjithëkombëtar”. Fondi kishte dhënë ndihma për nevoja të ndryshme në Kosovë por edhe në Shqipëri. Më 4 dhjetor 1991 Këshilli Koordinues i Subjekteve Politike Shqiptare në Zvicër ia dorëzoi këtë fond në administrim Qeverisë së Republikës së Kosovës së bashku me të gjitha mjetet.

Dorëzimi i fondeve nga subjektet politike në administrim të qeverisë kishte si rezultat ndryshimet e nevojshme, por shumë të rëndësishme në administrimin e fondeve, në evidencën kontabël të tyre, në

raportim dhe llogaridhënie. Qeveria praktikoi grumbullimin e mjeteve vetëm përmes llogarive bankare, evidencë strikte të përdorimit të tyre dhe të çdo lloj shpenzimi veç e veç.

## *2. Fondet e Qeverisë së Kosovës*

Kuvendi i Republikës së Kosovës më 19 tetor 1991, zgjodhi Qeverinë e Përkohshme të Koalicionit të Republikës së Kosovës në krye me dr. Bujar Bukoshi.<sup>25</sup> Për shkak të pamundësisë që të veprojë në Kosovë, Qeveria veproi në ekzil, si qeveri e koalicionit, por mbështetjen kryesore dhe bashkërenditjen e kishte me Lidhjen Demokratike të Kosovës. Fokusimi fillestar ishte sigurimi i mjeteve financiare; bashkërenditja e organizimit të mësimit shqip në Kosovë dhe bashkërenditja me institucionet që vepronin në Kosovë në fushën e organizimit për mbrojtje dhe çlirim.

Në qershor të vitit 1991 në Kosovë kishte filluar organizimi për të mbajtur gjallë shkollën shqipe. Ky organizim kishte iniciuar themelimin e Këshillit Qendror për Vetëfinancim.<sup>26</sup> Më 10 nëntor të vitit 1991 Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi Projektin e Sistemit të Sigurimit të Mjeteve për Financimin Intervenues në Republikën e Kosovës, të përgatitur nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave. Përmes këtij projekti viheshin bazat e ndërtimit të sistemit të themelimit dhe administrimit të fondeve, ngarkesat orientuese për bashkatdhetarët dhe mënyra e qeverisjes së fondeve. Më 20 nëntor të vitit 1991 Qeveria filloi procedurat për themelimin e Fondacionit në Gjenevë, kurse në dhjetor të po atij viti, Qeveria miratoi Vendimin mbi Grumbullimin e Mjeteve Financiare për Republikën e Kosovës.<sup>27</sup> U përcaktua që bazë e grumbullimit të mjeteve të jetë paga neto e punëtorëve me ngarkesë prej tre për qind. Grumbullimi i mjeteve parashihej të bëhej mbi baza vullnetare duke llogaritur në gatishmërinë e bashkatdhetarëve tanë për të ndihmuar Kosovën. Me këtë vendim u përcaktua nevoja dhe koha e dorëzimit të fondeve partiake në administrim të Qeverisë, që në esencë ishte një proces dhe akt i vullnetit të mirë të këtyre fondeve, i cili ishte në vazhdim e sipër.

---

<sup>25</sup> ASHAK, Aktet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, 2 Korrik 1990-2 Maj 1992, Prishtinë 2005, f. 124 deri 143

<sup>26</sup> Këshilli Qendror për Vetëfinancim u themelua më 28 qershor të vitit 1991 me qëllim të financimit të arsimit shqip në Kosovë. Ky këshill i parapriu themelimit Këshillit Qendror për Financim, i cili u themelua në mars të vitit 1992.

<sup>27</sup> Vendimin nr. 7/81 mbi Grumbullimin e Mjeteve Financiare për Republikën e Kosovës, 15.12.1991

Sipas Vendimit të Qeverisë nr.7/81 të datës 15 dhjetor 1991, në çdo shtet mund të hapej vetëm një fond. Me këtë vendim rregullohej udhëheqja dhe organizimi i fondeve në mënyrë unike nga organi qeveritar i autorizuar për financa në bashkëpunim me komisionet e fondeve dhe këshillat drejtuese të fondeve.

Organizimi i fondeve jashtë vendit dhe drejtimi i tyre nuk ishte pa sfida. Ato kryesisht konsistonin në tre elemente të rëndësishme:

- Organizimi i grumbullimit të fondeve në vende të tjera pa instrumente detyruese bëhej nga një qeveri e panjohur nga ato vende, por që e konsideronte veten qeveri e vendit të saj;

- Sigurimi i kushteve dhe rrethanave që fondet të shfrytëzohen me destinim; të krijohen instrumente për mbrojtjen e tyre nga grabitja dhe shpërdorimi dhe të ketë transparencë për tre palë: organet ligjore të shteteve ku grumbullohen mjetet, qytetarët kontributdhënës dhe organet legjitime shqiptare në Kosovë të cilave u përgjigjej Qeveria e Republikës së Kosovës si menaxhuese e këtyre fondeve;

- Ndërtimi i mekanizmave dhe rrugëve për përcjelljen e fondeve në Kosovë, në situatën kur të gjitha bankat në Kosovë kontrolloheshin nga regjimi okupes serb.

Në Objektivat e Fondeve përcaktohej se Fondet organizohen për grumbullimin e mjeteve financiare për qëllime humanitare në Kosovë, si dhe për nevoja të tjera ekzistenciale të popullit të Kosovës.<sup>28</sup>

Qeveria në bashkëpunim me subjektet politike dhe organizimet e tjera në diasporë organizoi apo bashkërenditi hapjen dhe funksionimin e fondeve në: Gjermani, Zvicër, Austri, Suedi, Itali, Norvegji, Danimarkë, Belgjikë, Holandë, Francë, Mbretëri e Bashkuar, Finlandë, Luksemburg, Slloveni, Kroaci, Shqipëri, SHBA, Australi dhe Çeki. Fondi i Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës u vu në dispozicion të organeve të Republikës së Kosovës, por për dallim nga fondet e tjera, për arsye ligjore dhe të nevojave konkrete, gjatë gjithë kohës u administrua nga Këshilli i Fondit në SHBA dhe jo nga Qeveria e Republikës së Kosovës, edhe pse Qeveria u informua për destinimet dhe shpenzimet e këtij fondi.

---

<sup>28</sup> Republika e Kosovës, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, 02Nr.01/94, Prishtinë 26.03.1994 Rregullore mbi organizimin dhe Punën e Fondeve të Republikës së Kosovës.

Fondet ishin të organizuara si organizata joqeveritare, jopërfituese, jokomerciale, me karakter humanitar.<sup>29</sup> Kontributet konsideroheshin si obligim qytetar i bashkatdhetarëve tanë ndaj Kosovës, por nuk ishin detyrime, sepse detyrime kishin të drejtë të përcaktojnë vetëm qeveritë e vendeve ku vepronin fondet, por jo Qeveria e Kosovës, që ishte në ekzil.

Në Gjermani ishte fituar mirëkuptimi i organeve financiare në Neu Ulm, ku ishte selia e fondit, që shumat e ndihmave, të cilat i paguanin bashkatdhetarët në Fond të Republikës së Kosovës t'u zbriten nga tatimi në të ardhura, mbi bazën e dëshmisë që lëshonte fondi për çdo pagesë që e kërkonin kontribuuesit. Kjo kërkonte evidencë të veçantë të të gjitha hyrjeve dhe daljeve në fond dhe nga fondi që u prezantohej organeve të financës, por njëkohësisht kërkonte edhe respektim të plotë të qëllimeve për të cilat ishin themeluar dhe regjistruar fondet. Çdo devijim nga kushtet e përcaktuara me statut kishte konsekuenca ligjore për fondin, deri në mbylljen e tij. Ministria për Ekonomi dhe Financa përgatiste raporte vjetore (por edhe raporte të tjera sipas nevojës) për shfrytëzimin e fondeve në Gjermani dhe në Zvicër dhe ua paraqiste institucioneve të këtyre vendeve. Në vendet e tjera, këtë e bënin organet e fondeve.

Mjetet në fonde paguheshin nëpërmjet llogarisë bankare dhe nuk praktikoheshin grumbullimi i parave të gatshme. Kjo mundësonte evidencë të saktë të të gjitha transaksioneve financiare dhe llogaridhënie pranë organeve zyrtare në shtetet e jashtme dhe në Kosovë.

Kontrolli financiar i fondeve të jashtme është zhvilluar nga Komisioni i Kontrollit, nga ana e organeve zyrtare të shteteve përkatëse ku ekzistonin fondet, të cilat kërkonin raporte dhe dëshmi për shfrytëzimin me destinim të tyre si dhe nga mekanizmat bankarë për të siguruar që mjetet e fondeve po përdoren për qëllimet për të cilat ishin themeluar.

Organizimi i fondeve dhe pajtueshmëria për nivelin e kontributeve rezultoi pas shumë takimeve dhe konsultave në diasporën kosovare, trajtime këto në modelin e “studimeve të rastit”. Takimet organizoheshin nëpër shtëpi, në klube dhe shoqata, seli të subjekteve politike, në të cilat shpjegoheshin nevojat, ofroheshin ide, shtroheshin pyetje dhe testoheshin modalitete për organizim dhe kontribute. Si rezultat i kon-

---

<sup>29</sup> STATZUNG des “Fonds der Republik von Kosova”, 11.11.1992, Neu-Ulm, i plotësuar më 26.05.1995.

sultave me bashkatdhetarë në Gjermani, Zvicër, Austri, në shtetet skandinave dhe në vendet e tjera, si me ata që ishin të organizuar në LDK, në PSHDK, por edhe me subjekte të tjera dhe me klubet dhe shoqatat ku vepronin shqiptarët, si dhe me bizneset u arrit përkrahja për organizimin e fondeve. Sa i përket lartësisë së kontributeve, në opsion ishin disa ide e propozime për pagesë, nga një deri në pesë për qind, edhe dhjetë për qind, por që shumica silleshin te tre për qind. Normë kjo për të cilën konsiderohej se nuk e rrezikonte standardin e jetesës së tyre. Ndërkaq po të paguanin të gjithë, llogaritjet ishin se do të grumbullohej një shumë solide për mbijetesë në disa fusha në Kosovë. Konsultat për mënyrën e grumbullimit të ndihmave jashtë dhe në Kosovë u zhvilluan paralelisht edhe me subjektet dhe institucionet në Kosovë. Të rëndësishme ishin edhe konsultat me vendet që kishin kaluar përvoja të tilla, si Kroacia dhe Bosnja e Hercegovina, sikurse edhe me ekspertë dhe zyrtarë të vendeve perëndimore.

Takime konsultative për kontribute që u organizuan në shumë mjedise në shtetet perëndimore, me përqendrim të veçantë në Gjermani dhe Zvicër, kishin peshë të madhe sepse sistemi ndërtohej si përkatësi e atyre që financonin. Prandaj vendimi ishte në pronësi të përbashkët të diasporës dhe të Qeverisë. Në raportin e Komisionit të Pavarur për Kosovën<sup>30</sup> thuhet: Kosovarëve iu vendosën taksa “vullnetare” prej 3% të të ardhurave të tyre; një sistem i kompjuterizuar i gjurmonte të dhënat “taksore” të familjeve individuale dhe kishte mospërputhje të ulët”.

Në financat publike, fuqia tatimore është ndër elementet thelbësore të tatimit. Shuma e tatimit të mbledhur dhe fuqia ekonomike që i mbetet tatimpaguesit pasi ta paguajë tatimin, varet drejtpërsëdrejti nga lartësia e përqindjes tatimore. Në rastin e kontributeve vullnetare për fondet ishte e nevojshme të balancohet jo vetëm ndërmjet nevojave për mjete dhe ruajtjes së standardit të kontributdhënësve por edhe të gjetjes së një niveli që do të ishte vullnetarisht i pranueshëm dhe nxitës për shtimin e numrit të atyre që japin kontribute.

Jo vetëm grumbullimi i parave jashtë Kosovës, por edhe bartja apo transferimi i tyre, në kushtet kur në Kosovë nuk mund të shfrytëzohej infrastruktura e asnjë banke, kërkonte zgjidhje të sigurt dhe praktike. Transferimi i mjeteve në Kosovë fillimisht bëhej në formë fizike, përmes rrjetit të besueshëm të njerëzve, pa asnjë interes dhe

---

<sup>30</sup> The Kosovo Report Conflict \* International Response \* Lesson Learned\* The Independent International Commission on Kosovo, Oxford University Press 2000, f. 47.

pagesë për shërbime, ose kur bizneset që kishin nevojë për pagesa jashtë vendit, dorëzonin shuma të caktuara të parave në Këshillin Qendror për Financim, kurse Ministria e Financave, mbi bazën e dëshmimeve këtyre firmave ua kompensonte mjetet jashtë vendit për nevoja të importeve apo për qëllime të tjera. Nga viti 1992 transferimi filloi të bëhet në Shqipëri përmes Bankës Kombëtare Tregtare, kurse nga fillimi i vitit 1994 përmes “Dardania Bank”. Paratë nga Shqipëria në Kosovë barteshin fizikisht nga njerëz të besueshëm dhe biznese të besueshme. Në këtë relacion nuk është shënuar shmangie e parave apo humbje e tyre.

Për të lehtësuar bartjen e mjeteve në Kosovë dhe për t’u ndihmuar bizneseve të Kosovës në qarkullimin e parave të tyre, Qeveria e Republikës së Kosovës, mbi bazën e marrëveshjes paraprake të Kryeministrit Bukoshi me Presidentin Rugova dhe me institucionet e Shqipërisë, në vitin 1993 themeloi bankën, “Dardania Bank”<sup>31</sup> në Tiranë. Banka u themelua, si bankë rezidente në Shqipëri, duke u bazuar në Ligjin mbi Sistemin Bankar të Shqipërisë dhe në Ligjin mbi Bankën e Shqipërisë. Kapitali themeltar ishte siguruar nga fondet e jashtme të Republikës së Kosovës. Kjo bankë dha një kontribut të jashtëzakonshëm në të gjitha vitet e okupimit në Kosovë. Kreu të gjitha punët bankare si bankë e nivelit të dytë në Shqipëri, siguroi transferin e mjeteve për në Kosovë dhe i ndihmoi qytetarët e Kosovës në periudhën më të rëndë të luftës, kur u deportuan në Shqipëri.

Qeverisja me fondet ishte një sistem miks ose i kombinuar i Qeverisë dhe përfaqësuesve të fondeve nga bashkatdhetarët tanë. Menaxhimi, filluar nga planifikimi, organizimi, drejtimi, personeli dhe kontrolli kishte një rëndësi të madhe për mbarëvajtjen e punës së fondeve. Përmes menaxhimit synohet të krijohej një urë lidhëse ndërmjet resurseve humane dhe materiale dhe të motivohen njerëzit për të arritur qëllimet e përbashkëta të këtij organizimi.

### *Aksione të veçanta të organizuara nga Qeveria dhe nga bashkatdhetarët*

Përmes iniciativave të veçanta kishte filluar grumbullimi i mjeteve në diasporë për të ndihmuar Kosovën që nga viti 1990. Me mjetet e diasporës u përkrahën fillimisht stërviçjet ushtarake të grupeve të para kosovare në Shqipëri në fund të vitit 1991 dhe në vitin 1992 dhe në vazhdim organizimin e strukturave të mbrojtjes, përfshirë Ministrinë

---

<sup>31</sup> Statuti i Dardania Bank, Tiranë, gusht 1993.

e Mbrojtjes dhe atë të Punëve të Brendshme, përkrahjen dhe organizimin për luftë të oficerëve shqiptarë të karrierës që e kishin braktisur ushtrinë jugosllave.

Pas Dejtonit, u intensifikua organizimi i grumbullimit të mjeteve të veçanta për luftë me aksione të veçanta të Qeverisë dhe të bashk-atdhetarëve. U zhvilluan aksione të veçanta të Qeverisë me bashk-atdhetarët që ndërlihdeshin me luftën dhe pasojat e saj si: aksioni “Ndhima për Pavarësinë e Kosovës”; Aksioni për ta ndihmuar Drenicën; Ndihamat emergjente. Aksione të tjera të organizuara ishin: Aksioni për Shkollën Shqipe; Ndhima për Minatorët; Ndhima për sindikatat e pavarura, Ndhima për Unionin e Studentëve dhe Universitetin e Prishtinës, “Ndhima për Shqipërinë”. Sipas Raportit të Punës së Qeverisë<sup>32</sup> shihet se mjetet që mblidheshin përmes aksioneve të veçanta përcillleshin për subjektin apo për destinimin që ishin mbledhur. Aksioni “Gjithçka për Pavarësinë e Kosovës” u zhvillua me organizim të posaçëm përmes lëshimit të bonove të donacionit nga Qeveria si dëshmi të kontributeve.

Krahas fondeve të Qeverisë të Republikës së Kosovës (Qeverisë Bukoshi), Fondi “Vendlindja Thërret”, i organizuar nga LPK-ja jashtë vendit, grumbullonte para të gatshme, të cilat i proklamonte se po destinohen për të përkrahur luftën në Kosovë. Grumbullimi i mjeteve nga diaspora përmes dy kanaleve u shpreh negativisht në unifikimin e saj për qëllimin e pavarësisë, që ishte synim i përbashkët. Pas masakrës në Prekaz, Qeveria bëri përpjekje për unifikim të mbledhjes së mjeteve dhe shfrytëzim të përbashkët, por kjo nuk u arrit.

Diaspora grumbullonte mjete edhe me iniciativa të saj të kohëpaskohshme, përmes partive politike, shoqatave dhe klubeve për raste të veçanta, për regjione të caktuara në Kosovë, për minatorë, për mbështetje të shkollave, për familje që ishin persekutuar; grumbullonin ndihma edhe për raste të veçanta në Shqipëri. Njerëzit nga diaspora kosovare u kishin dalë në ndihmë edhe delegatëve të Kuvendit të Kosovës, të cilët e shpallën Kushtetutën në Kaçanik, e të cilët u detyruan të ikin jashtë Kosovës, sepse ndiqeshin nga pushteti serb. Ishin këta shqiptarët nga Kosova, por edhe nga Maqedonia në Slloveni, Kroaci, Zvicër, Gjermani, Austri e vende të tjera që ua hapën dyert delegatëve të Kuvendit dhe u kujdesën për ta në kohërat më të vështira.

---

<sup>32</sup> Raporti i Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës për Periudhën 1991-1999 (pjesa financiare deri në shtator të vitit 1999) Prishtinë, janar 2000.

### *3. Shoqatat dhe klubet jashtë vendit*

Shoqatat e ndryshme sikurse edhe klubet që tubonin shqiptarët në diasporë, drejtpërdrejt ose të lidhura me shoqatat e tjera humanitare në Perëndim kanë përcjellë ndihma, fillimisht për arsim dhe shëndetësi, e sidomos në kohë të luftës dhe të deportimit të shqiptarëve në Shqipëri dhe Maqedoni.

### *4. Remitencat*

Kontribut i çmuar për Kosovën dhe qytetarët e saj ishin remitencat që dërgoheshin në Kosovë nga punëtorët që punonin jashtë. Ato ishin një infuzion me peshë të madhe për konsumin familjar por edhe për fillimin e bizneseve që lindën në atë periudhë në Kosovë.

I vetmi studim që trajton disa tregues makroekonomikë është studimi i Moalla-Fetini etj. (2005), i publikuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN). Ky studim, ndër të tjera, paraqit edhe treguesin e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) për periudhën 1981-2003.

Duke pasur parasysh se të dhënat e para për remitencat janë vlerësuar përgjatë viteve 2001-2003, e vetmja mënyrë që të kemi një vlerësim të përafërt të remitencave për periudhën 1990-1999 do të ishte nëse aplikojmë raportin e remitencave ndaj PBB-së (remitencat si përqindje e PBB-së) sipas të dhënave të prezantuara në studimin e Moalla-Fetini<sup>33</sup> (2005). Nga ky studim rezulton se raporti i remitencave ndaj PBB-së përgjatë viteve 2001-2003 ishte 25%, në një situatë kur PBB-ja ishte shumë e ulët.

Megjithatë, në kalkulimin e remitencave për periudhën e paraluftës, ka edhe shumë faktorë të tjerë të cilët do të duhej të merreshin parasysh, si për shembull niveli i papunësisë në Kosovë, produkti i brendshëm bruto, standardi i përgjithshëm i jetesës, madhësia e sektorit privat, niveli i çmimeve në vend, madhësia e diasporës ose numri i emigrantëve nga Kosova. Gjithashtu, rol të rëndësishëm në shumën e dërgesave luajnë edhe faktorët e ekonomisë pritëse siç janë, standardi i jetës në vendet ku diaspora është e koncentruar, statusi i punësimit, niveli i të ardhurave e të tjera. Kjo për faktin se të gjithë këta faktorë mund të ndikojnë në vendimet e diasporës për të dërguar remitenca, varësisht nga nevoja për financim të

---

<sup>33</sup> Rakioa Moalla-Fetini, Heikki Hatanpaa, Shehada Hussein, and Natalia Koliadina: Kosovo: Gearing Policies toward Growth and Development; July 13, 2005, f. 10-11

shpenzimeve të ekonomive familjare në Kosovë, por edhe nga mundësitë e tyre për të dërguar para në Kosovë. Sidoqoftë, për të gjithë këta faktorë, ka mungesë të të dhënave dhe është tejet e vështirë për të dhënë një opinion më konkret për nivelin e saktë të remitencave.

### *5. Pagesat në këshillat komunale për financim*

Familjet që kishin të punësuar jashtë, kontribuonin me një pjesëmarrje të veçantë në këshillat komunale për financim, që vepronin në Kuadër të Këshillit Qendror për Financim në Kosovë. Në Kosovë, përmes Këshillit Qendror për Financim dhe këshillave komunale nga muaji mars i vitit 1992 filloi të aplikohet sistemi 5 për qind nga pagat neto mujore sikurse edhe kontributet e tjera nga ndërmarrjet dhe dyqanet private, veprimtaritë e pavarura, familjet e të punësuarave jashtë, ekonomitë familjare, toka bujqësore, zejtarët dhe serviset, nga qiraja dhe kontributet e pensionistëve. Në bazë të propozimit të subjekteve politike në Kosovë, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e saj të mbajtur më 16 mars 1992, mori Vendimin mbi Emërimin e Këshillit Qendror për Financim të Kosovës<sup>34</sup>. Vënia e bazave të “sistemit të tre përqindëshit” jashtë Kosove dhe të nomenklaturës së kontribuesve në Kosovë u bë me një bashkërenditje të plotë me Presidentin, Kuvendin, organet e LDK-së që vepronin në Kosovë dhe subjektet politike, me organet që punonin në fushën e arsimit si dhe Sindikatën e Pavarur.

Nuk është bërë ndonjë analizë se kush tregoi gatishmëri më të madhe e kush më të ulët nga diaspora në solidarizimin financiar dhe ekonomik për Kosovën. Ata që kishin shkuar të punojnë në vendet perëndimore, disidentët politikë apo refugjatët e luftës? Nëse iu referohet kërkesave të bashkatdhetarëve për dëshmi për pagesa, që i shfrytëzonin për lirim nga një pjesë e tatimit (në Gjermani), mund të konkludohej se pjesa dërmuese e tyre ishin nga radhët e punëtorëve. Ndërkaq në sferën e organizimit dalloheshin disidentë politikë dhe ata që kishin migruar viteve të fundit.

Qeveria administroi fondet jashtë vendit nga themelimi i saj deri më 31 janar të vitit 2000, kur zyrtarisht e përfundoi punën. Edhe pse në Kosovë u mbajtën zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale më 24 maj 1992, si dhe ato më 22 mars të vitit 1998, për shkak të situatës së rëndë në Kosovë edhe pas përfundimit të zgjedhjeve nuk u bënë ndryshime në qeveri dhe nuk u zgjodh qeveria e re. Kjo nuk ndodhi as pas një

---

<sup>34</sup> Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 01 Nr.01/32 dt. 16.03.1992

akordimi në Rambuje, më 24 shkurt 1999 për themelimin e një qeverie të re të koalicionit. Si në rastin e zgjedhjeve të vitit 1992, ashtu edhe të atyre të vitit 1998 Qeveria kishte përgatitur raportet dhe saldon e mjeteve për t'ia dorëzuar në administrim organit që do ta caktonte Parlamenti i Kosovës dhe Presidenti i Republikës.

*Vlerësim i kondensuari*<sup>35</sup>

- Nga fondet e grumbulluara në diasporë nga viti 1991 deri në vitin 1999, arsimi në Kosovë ishte financuar me rreth 49 për qind, kurse me rreth 51 për qind ishte financuar nga mjetet e brendshme;

- Organizimi për mbrojtje, shpenzimet për luftë dhe nevoja emergjente në zonat e luftës morën pjesë me rreth 30 për qind në totalin e shpenzimeve të qeverisë deri në vitin 1999;

- Bashkatdhetarët në Gjermani e dhanë kontributin më të madh financiar, prej rreth 44 për qind, ata në Zvicër rreth 40 për qind, kurse në të gjitha vendet e tjera janë grumbulluar rreth 16 për qind të kontributeve për Kosovën.

- Me kontribute të diasporës u siguroa informimi përmes Projektit Satelitor, i organizuar me TV Shqiptar dhe një kohë në Radio Zagreb; u financuan organizata të fuqishme të lobimit, sidomos në SHBA dhe në Mbretërinë e Bashkuar, takime të niveleve më të larta të vendim-marrjes botërore të Presidentit Ibrahim Rugova, Kryeministrit Bukoshi dhe Qeverisë së Kosovës.

- Remitencat nga bashkatdhetarët gjatë viteve 1990-1999 mund të vlerësohen se mbuluan rreth 25 për qind e konsumit familjar dhe investiv në Kosovë.

- Pas përfundimit të Luftës, bazuar në të dhënat e Unionit të Fondeve për Rindërtim të Kosovës<sup>36</sup>, pjesa e mbetur e mjeteve të pashpenzuara të fondeve, rreth 21 për qind, nga të hyrat, u vënë në shërbim të rindërtimit të vendit nga pasojat e luftës përmes menaxhimit nga drejtuesit e fondeve nga diaspora, të organizuar në Unionin e Fondeve për Rindërtimin e Kosovës. Mjetet e mbetura, fondet nuk ia dorëzuan administratës së OKB-së në

<sup>35</sup> Burimi i të dhënave nga Raporti i Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës për periudhën 1991-1999 dhe nga dokumentacioni i Unionit të Fondeve për Rindërtimin e Kosovës (UFORK).

<sup>36</sup> Unioni i Fondeve për Rindërtim të Kosovës ishte organizatë në të cilën u tubuan fondet, pas përfundimit të punës së Qeverisë, me qëllim që mjetet e mbetura t'i sjellin dhe t'i investojnë në Kosovë. Investimet u publikuan më 9 prill 2001 në gazetën "Bota sot" dhe u raportuan në Përmbledhjen e projekteve të lejuara, të kontraktuara dhe të realizuara deri me dt. 19 tetor 2002.

Kosovë, pasi ato nga institucionet e vendeve ku u mbledhën u cilësuan si ndihma humanitare (të zbritshme nga tatimi në Gjermani) dhe jo si mjete të buxhetit.<sup>37</sup> Me këto mjete ishte mbështetur themelimi i Universitetit Amerikan në Prishtinë (RIT Kosovo), rindërtimi i plotë fshatit Çabër, furnizimet me material ndërtimor për shtëpi të rrënuara, ndërtimi dhe meremetimi i mbi 40 shkollave dhe projekte të tjera.

## Përfundimi

Diaspora kosovare dha një kontribut të pamohueshëm në vënien e bazave të shtetndërtimit të Kosovës sikurse edhe në luftën për liri dhe pavarësi. Financimi i nevojave në Kosovë nga diaspora ndihmoi mbijetesën dhe qëndresën. Grumbullimi i mjeteve jashtë Kosovës, por edhe i atyre në Kosovë, mbështeti tranzicionin demokratik e politik; evoluoi në grumbullimin e mjeteve për mbajtjen e shkollës shqipe dhe kulmoi në financimin e institucioneve të Republikës së Kosovës dhe të luftës për çlirimin e Kosovës. Për dallim nga shumë raste të tjera, organizimi dhe funksionimi i fondeve jashtë Kosove respektoi plotësisht rregullat dhe ligjet e vendeve ku ato vepruan. Kosova themeloi institucionet e saj të para financiare jashtë vendit, fondet e Republikës së Kosovës dhe Bankën “Dardania” në Shqipëri, ndërkaq brenda vendit Këshillin Qendror për Financim si infrastrukturë për grumbullimin dhe shpërndarjen e mjeteve financiare. Sistemi i financimi jo vetëm në parim, por në esencë ishte vullnetar, sepse pushteti “paralel” i Kosovës nuk kishte dhe nuk zbatonte asnjë instrument detyrues dhe represiv për grumbullimin e mjeteve. Organizimi vullnetar i grumbullimit të ndihmave për Kosovën e dallon këtë sistem nga ajo që zbatuan shumica e organizimeve të diasporës në vendet e tjera. Ishte sistem që peshonte në ndërgjegjen dhe idealin e atyre që mbështesnin rezistencën paqësore dhe atë me luftë, ose të dyja njëkohësisht. Mjetet nga diaspora dhe ato të grumbulluara në Kosovë ishin arkë e mbijetesës së arsimit në gjuhën shqipe; mbijetesës ekonomike të rasteve sociale; organizimit të rezistencës kundrejt pushtetit serb dhe luftës për pavarësi. Diaspora kosovare dëshmoi se i shfrytëzoi drejt burimet, aftësitë dhe kontaktet për të ndihmuar ndryshimin e rrjedhës së ngjarjeve në Kosovë. Këto resurse u shfrytëzuan për të siguruar lirinë, paqen dhe rindërtimin e vendit.

<sup>37</sup> Letra e Finanzamt Neu Ulm, Bestaetigung, Herr Greeske, 15.02.2000



Arsim Bajrami

## AKTET KUSHTETUESE DHE POLITIKE TE LINDJES SE REPUBLIKËS SË KOSOVËS

### Përmbledhje

Procesit i shpërbërjes së Federatës Jugosllave nisi në fillim të vitit 1989 si rezultat i politikave ekspansioniste serbe për krijimin e Serbisë së Madhe në një model centralist të Federatës. Republikat e atëhershme perëndimore jugosllave, Sllovenia dhe Kroacia, ishin të parat të cilat e braktisën Federatën dhe deklaruan pavarësinë e tyre. Kosova në këtë kohë ndërmori të gjitha veprimet e nevojshme që të mbrohet nga okupimi serb dhe nxori të gjitha aktet kushtetuese dhe politike me të cilat e filloi rrugëtimin e saj drejt pavarësisë. Më 2 korrik të vitit 1990 Kuvendi i Kosovës e miratoi Deklaratën Kushtetuese të 2 Korrikut, një akt historik me të cilin Kosova përcaktohej si njësi e barabartë brenda Federatës dhe Konfederatës Jugosllave.

Padyshim që 2 Korriku është fillim i procesit të shtetndërtimit të Kosovës, është fillim i një tranzicioni statusor të Kosovës drejt rrugës së lirisë dhe pavarësisë. Vetëm tri ditë pas miratimit të Deklaratës, me 5 korrik, Jugosllavia shpalli gjendjen e jashtëzakonshme në Kosovë, Serbia ushtroi puq kushtetues në Kosovë dhe rrënoi në tërësi Kushtetutën e Kosovës të vitit '74, vendosi juridiksionin e kushtetutës së saj, suprimoi rendin kushtetues duke e ndaluar punën e Kuvendit të

Kosovës, të Qeverisë së Kosovës, të Presidencës së Kosovës dhe të të gjitha institucioneve të tjera që i kishte Kosova.

Në ndërkohë deputetët e legjislaturës së Deklaratës Kushtetuese, më 7 shtator të vitit 1990 në Kaçanik miratuan Kushtetutën e Republikës së Kosovës e cila hapi rrugën e ndërtimit të institucioneve shtetërore të pavarura të Kosovës. Vetëm një vit më vonë, kësaj kushtetute iu shtuan edhe të gjashtë amendamentet me të cilat, në fakt, hapej rruga për mbajtjen e referendumit për shpalljen e Kosovës shtet sovran dhe të pavarur. Më 24 maj të vitit 1991 u mbajt referendumi për Kosovën shtet sovran dhe të pavarur dhe populli i Kosovës në mënyrë plebishitare, pra me më shumë se 99.7 për qind e atyre që dolën në votim votuan pro pavarësisë. Ky referendum bëri të mundur që Kosova të fillojë ndërtimin e institucioneve të pavarura në zgjedhjet e vitit 1992, në zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale, pastaj në zgjedhjet e vitit 1998 po ashtu parlamentare dhe presidenciale.

Lindja e Republikës së Kosovës ishte një proces logjik i shkatërrimit të Federatës Jugosllave, i ushtrimit të së drejtës së vetëvendosjes së popullit shqiptar të Kosovës që të ketë shtetin e vet, të vendosë për fatin e vet pas shkatërrimit të Federatës Jugosllave dhe i krijimit të rrethanave gjeopolitike si pasojë e fundit e sistem komunist dhe lindjes së sistemeve demokratike. Rruga drejt realizimit të aspiratave të shprehura në Deklaratën Kushtetuese dhe në Kushtetën e Kaçanikut në fillimet e vitit 1991 nuk ishte aspak e lehtë, sepse në këtë kohë filloi odiseada tragjike e shpërbërjes së Jugosllavisë, pra luftat në territorin e Jugosllavisë fillimisht në Slloveni, Kroaci dhe pastaj në Bosnjë dhe në Kosovë. Kosova deri në vitin 1995-1896 kishte zgjedhur rrugën paqësore, rrugën joviolente të udhëhequr nga Presidenti Ibrahim Rugova për t'i ikur një tragjedie me përmasa shumë më të mëdha dhe tragjike për popullin shqiptar të Kosovës.

*Fjalë çelës:* Federate jugosllave, Deklarata kushtetuese, Kushtetuta e Kosovës, Republika, referendum, zgjedhjet

## RRËNIMI KUNDËRKUSHTETUES I SUBJEKTIVITETIT POLITIK-KUSHTETUES TË KOSOVËS

### Karakteristikat e përgjithshme të procesit të rrënimit kundërkushtetues të subjektivitetit politik të Kosovës

Rrënimi kundërkushtetues i pozitës kushtetuese të Kosovës të përcaktuar me Kushtetutën e vitit 1974 u bë me një mori veprimesh dhe aktesh kundërkushtetuese me të cilat pushteti serb, duke filluar që nga viti 1981 e gjer më sot *de facto* rrënoi çdo atribut kushtetues dhe politik me të cilin shprehej individualiteti territorial e politik i Kosovës.

Pozita kushtetuese juridike e Kosovës, e përcaktuar me zgjedhjet kushtetuese të vitit 1974, ka qenë vazhdimisht objekt i kritikave dhe sulmeve, në fillim i forcave nacionaliste dhe shoviniste serbe e pas vitit 1981 edhe e politikës zyrtare serbe. Jo shumë vonë pas nxjerrjes së Kushtetutës së vitit 1974 u hartua i ashtuquajtimi “Libri i kaltër” në të cilin, në kuadër të kreut politik të Serbisë, ishte përcaktuar strategjia e veprimit politik në drejtim të ngushtimit dhe rrënimit të mëvetësisë kushtetuese dhe politike të Kosovës.

Sulmet ndaj pozitës kushtetuese të Kosovës posaçërisht u intensifikuan pas demonstratave masive të shqiptarëve të vitit 1981 në Kosovë, ku si kërkesë dominante politike, si në demonstratat e vitit 1968, ishte kërkesa legjitime për barazi të plotë të Kosovës, përkatësisht për statusin republikë të saj në Federatën Jugosllave. Kjo kërkesë e ligjshme e popullit shqiptar u shfrytëzua për krijimin e programeve politike antishqiptare si në Serbi, ashtu edhe në nivelin federativ (nën ndikimin serb). Esencën e këtyre programeve antishqiptare e paraqiste angazhimi për ndërrimin radikal të pozitës kushtetuese të Kosovës të përcaktuar me zgjidhjet kushtetuese të vitit 1974. (*Shih Programin jugosllav të masave që do të ndërmerren në Kosovë, nr. 06-3/1990 i datës 18 janar 1990*).

Avancimi i pozitës kushtetuese të Kosovës si njësi e mëvetësishme politike-territoriale dhe si pjesë e barabartë dhe konstitutive e federalizmit jugosllav, e në këtë kontekst edhe afirmimi e emancipimi kombëtar i popullit shqiptar, ishte i papranueshëm për forcat nacionaliste serbe, të cilat Kosovën dhe shqiptarët kanë tentuar gjithmonë t’i mbajnë nën sundim dhe ndaj tyre të udhëheqin një politikë diskriminuese dhe antikombëtare.

Në këtë kontekst para procesit të fillimit të rrënimit institucional dhe jashtinstitucional të pozitës kushtetuese të Kosovës të përcaktuar me Kushtetutën e vitit 1974, pushteti serb në sajë të politikës nacionaliste dhe shoviniste krijoi një histeri nacionaliste dhe paranojë kolektive në opinionin serb “mbi gjoja rrezikimin e popullit serb në Jugosllavi dhe copëtimin e tij territorial”. Në këtë drejtim strategët e projektit nationalist mbi “Serbinë e Madhe” si hallkë të parë të shkatërrimit të Federatës Jugosllave zgjodhën pikërisht rrënimin kundër-kushtetues të mëvetësisë politike-territoriale të Kosovës dhe vënien e saj nën administrim të plotë të Serbisë. Ngjarjet që pasuan pas zhbërjes së Federatës Jugosllave (shkëputja dhe njohja ndërkombëtare e katër njësive federale, shpërthimi i luftës së përgjakshme në Slloveni, Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë) më së miri vërtetoi tezën tonë se rrënimi i pozitës kushtetuese të Kosovës ishte çelës për demontimin e tërësishëm të strukturës shtetërore dhe politike të ish-Jugosllavisë.

Në funksion të arritjes së qëllimit të përcaktuar politik (rrënimin të pozitës kushtetuese të Kosovës), pushteti serb krahas forcave nacionaliste e shoviniste instrumentalizoi tërë potencialin e vet politik, shkencor dhe profesional. Në këtë drejtim që nga viti 1981, e posaçërisht në vitet 1988-1989, gjatë debateve kushtetuese në opinionin serb dhe atë jugosllav u plasuan tezat e pasakta shkencore mbi gjoja “pabarazinë e Serbisë me njësitë e tjera federale të Jugosllavisë, për shkak se në përbërjen e saj gjenden dy njësi autonome”, teza “mbi federalizmin e kësaj njësie federale” etj. Esenca e këtyre tezave ishte mohimi i strukturës shtetërore dhe federale të ish-Jugosllavisë të përcaktuar me zgjidhjet kushtetuese të vitit 1974 dhe mohimi i qenies së njësive autonome me një shkallë të gjerë të mëvetësisë politike dhe si subjekt të barabartë dhe konstituiv të Federatës. Të gjitha këto atakime ndaj pozitës kushtetuese të Kosovës u bënë në mënyrë të koordinuar dhe në bazë të platformës politike të përgatitur në qarqet më të larta politike, shkencore dhe shtetërore të Serbisë (shih: Memorandumi i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë). Në arritjen e qëllimit të përcaktuar politik, pushteti serb nuk u hamend shumë që të zgjedhë metodat dhe instrumentet për rrënimin e pozitës kushtetuese të Kosovës. Ai publikisht në këtë drejtim u deklarua se për arritjen e këtij veprimi do të veprojë institucionalisht dhe jashtëinstitucionalisht me metoda juridike dhe ato të dhunës shtetërore, përmes lëvizjeve populiste, shovinizmit dhe histerisë së hapur nacionaliste, ushtrimit të formave me bestial të dhunës ndaj popullit shqiptar. *(Duke analizuar presionet e pushtetit serb për rrënimin e pozitës kushtetuese të Kosovës*

*sipas Kushtetutës së 1974, akademik Gazmend Zajmi përmend disa lloje të presioneve politike: 1. Presioni ideologjik partiak nëpërmjet diferencimeve dhe degradimeve publike të personaliteteve intelektuale dhe politike shqiptare që mbronin pozitën kushtetuese të Kosovës, ose mendohej se mund të jenë faktorë pengues për rivendikimet serbe në planin e raporteve kushtetuese; 2. Presionet nëpërmjet të procedurave policore dhe atmosferës së ndjekjes; 3. Presionet masmediale të Bordit me frekuencë dhe proporcione enorme etj).*

Më 20-28 shkurt 1989 nisi greva e minatorëve të kompleksit “Trepça”. Këta minatorë dolën në mbrojtje të pozitës kushtetuese të Kosovës, që kërcënohej nga ngritja në pushtetin komunist të Serbisë të Slobodan Milosheviçit. Greva e minatorëve synonte të mbronte autonominë e Kosovës të garantuar me Kushtetutën e vitit 1974.

Një çerekshekulli më parë, më 23 mars të vitit 1989, në Kuvendin e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në kundërshtim me vullnetin e qytetarëve, do të ndryshohet Kushtetuta e vitit 1974, me çka suprimohet autonomia e Kosovës në Federatën Jugosllave, duke e lënë Kosovën si pjesë përbërëse të Serbisë.

Më 23 mars në sallë të Kuvendit trysnia fillon me gjoja mysafirët e ftuar në seancë. Gjysma e tyre (“mysafirëve”) pozicionohen në rendet e para të ulëseve të Kuvendit. Pas tyre ishin përcaktuar vendet e delegatëve. Gjithçka ishte planifikuar të bëhej lojë me imazhe, me gishtat e parë të ngritur pro ndryshimeve – në ulëset e para, që do të dominon çdo vendim ndryshe.

Gjithçka ishte bërë me qëllim. Numri i madh i “mysafirëve” të pranishëm ishte sinjal për vendime antishqiptare, për manipulime me vota. Sipas dëshmimeve qoftë nga dëshmitarët e edhe nga stenogramet e asaj kohe, komploti zbulohet nga Riza Lluka, delegat nga Peja. Nga foltorja e Kuvendit Lluka kërkon që të ndalohet votimi i “mysafirëve”, e që të merret parasysh vetëm vullneti i delegatëve. Kështu, kufizohet vota e tyre. Por, fatkeqësisht, kjo nuk u arrit në tërësi.

Kosova ishte nën shtettrëthim. Suprimimi i autonomisë së Kosovës ishte vendim që siguronte supremacinë serbe në Federatën e atëherëshme jugosllave, sidomos kur dihet se Serbia kishte realizuar dominimin në Vojvodinë dhe në Mal të zi. Komploti ishte i organizuar nën presionet politike dhe kërcënimet e makinerisë ushtarake e policore (jo vetëm serbe) jashtë ndërtesës së Kuvendit. Sidoqoftë, brenda në sallë ishin disa deputetë shqiptarë që nuk u frikësuan dhe i ngritën gishtat kundër heqjes së autonomisë së Kosovës. Nga 190 delegatë të tri dhomave sa kishte atëherë Kosova, në disa studime del se Riza Lluka,

Melihate Tërmerkoll, Shkëlzen Gusinja, Ukë Bytyçi, Sadik Zuka, Remzi Hasani, Menduh Shoshi, Bajram Buçani, Mehdi Uka dhe Avdi Berisha votojnë kundër suprimimit të asaj autonomie. Dy delegatë thuhet se abstenojnë, ndërsa 25-30 mungojnë në seancë.

Duke analizuar procesin e rrënimit kundërkushtetues të subjektivitetit politik të Kosovës, mund të konstatojmë se ai është thellësisht kundërkushtetues, jodemokratik dhe krejtësisht antidemokratik. Këtë konstatim e bazojmë në këto argumente:

1. Karakteristikat kryesore të procesit të rrënimit të mëvetësisë së Kosovës të përcaktuara me zgjidhjet kushtetuese të vitit 1974 është karakteri i tij kundërkushtetues. Në të vërtetë, tërë ky proces u zhvillua në kundërshtim të thellë me të gjitha aktet kushtetuese dhe ligjore të ish-RSFJ-së, RS të Serbisë dhe KSA të Kosovës që ishin në fuqi. Faktikisht ky proces filloi pas vitit 1981, kur filluan të paraqiten problemet e para në realizimin e funksioneve kushtetuese të organeve të Kosovës. Në pikëpamje institucionale rrënimi i pozitës kushtetuese të Kosovës filloi me miratimin e amendamenteve kushtetuese (në Kushtetutën e RS të Serbisë të vitit 1974) në vitin 1989, nxjerrjen e Kushtetutës së Serbisë në vitin 1990 dhe nxjerrjen e një morie ligjesh të tjera kundërkushtetuese me të cilat u bë deinstitutionalizimi kushtetues e politik i Kosovës, zhveshja e attributeve shtetërore dhe vënia e saj nën kontroll të plotë të pushtetit serb. Të gjitha këto veprime kundërkushtetuese ndikuan që Kosova nga subjekti autonom me mëvetësi të gjerë politike dhe territoriale të trajtohet me Kushtetutën në fuqi të Serbisë si formë e thjeshtë e autonomisë territoriale, koncept ky që është në kundërshtim me qenien historike dhe politike të Kosovës;

2. Rrënimi kundërkushtetues i subjektivitetit politik të Kosovës, krahas veprimeve institucionale kundërkushtetuese u shoqërua me aplikimin e dhunës shtetërore, me të cilën pushteti serb *de facto* bëri okupimin policor dhe ushtarak të të gjitha institucioneve shtetërore, politike, ekonomike, arsimore, informative dhe të institucioneve të tjera në Kosovë. Duke aplikuar forma të ndryshme të dhunës në Kosovë dhe duke mbajtur gjendjen e represionit permanent në Kosovë, pushteti serb në mënyrë flagrante shkeli dhe vazhdoi të shkelë të gjitha të drejtat individuale dhe kolektive të popullit shqiptar dhe të shkatërrojë tërë sistemin kushtetues dhe politik në Kosovë. Në këtë mënyrë Kosova dhe shqiptarët praktikisht u vunë “jashtë ligjit dhe Kushtetutës” dhe për ta u përcaktuan rregulla dhe masa të posaçme. Të gjitha këto veprime tregojnë karakterin jodemokratik të pushtetit serb dhe shprehin dhunën shtetërore të të ashtuquajturit “shtet policor” i cili nuk ka asgjë të

përbashkët me shtetin ligjor (juridik), por për shkaqe demagogjike proklamohet si demokratik nga Serbia;

3. Qëllimi kryesor i masave kundërkushtetuese dhe represive, të cilat pushteti serb i aplikoi në Kosovë ndaj shqiptarëve, është inkriminimi i vullnetit politik të tyre për liri dhe pavarësi. Siç dihet, aspiratat historike të popullit shqiptar për liri dhe pavarësi janë shumë të hershme, ndërkaq në kuadër të Jugosllavisë ato burojnë që nga Konferenca e Bujanit kur u përcaktua e drejta e vetëvendosjes së popullit shqiptar, duke përfshirë këtu edhe të drejtën e bashkimit me shtetin amë - Shqipërinë. Këto aspirata legjitime u përsëritën në vitin 1968 dhe 1981, për t'u institucionalizuar në vitin 1990, kur me qëllim të materializimit të vullnetit politik të popullit shqiptar u nxorën aktet burimore kushtetuese dhe politike me të cilat u përcaktua shtetësia e Kosovës në formë të Republikës sovrane dhe të pavarur. Kjo shprehje autentike e vullnetit politik të popullit shqiptar, sikurse edhe i popujve të tjerë të Jugosllavisë, pas zhbërjes së Federatës Jugosllave bëri vetëpërcaktimin e vet politik, ishte e papranueshme për pushtetin serb, i cili duke e inkriminuar atë e kualifikoi si të ndëshkueshëm dhe me masa kundërkushtetuese, tenton që ta inkriminojë këtë vullnet legjitim politik të popullit shqiptar në vazhdimësi. Vështruar nga aspekti historik, këto përpjekje të pushtetit serb janë në kundërshtim me rrjedhat demokratike në Evropë dhe në botë, ku në saje të demokratizimit të marrëdhënieve shoqërore, të gjitha kombet dhe entitetet kombëtare realizojnë të drejtën e vetëvendosjes, duke përfshirë edhe të drejtën e vetëpërcaktimit të tyre kushtetues dhe politik. Vështruar nga ky kënd, përpjekjet e pushtetit serb për të mbajtur nën kontroll (okupim) Kosovën dhe më se dy milionë shqiptarë janë jocivilizuese, anakronike dhe që në filllet e saj të gjykuara për dështim.

### **Veprimet kryesore kundërkushtetuese me të cilat Serbia rrënoi subjektivitetin politik të Kosovës**

Veprimet dhe aktet kundërkushtetuese me të cilat pushteti serb rrënoi subjektivitetin politik të Kosovës janë të shumta dhe të ndryshme. Me këtë rast nder veprimet kryesore kundërkushtetuese të Serbisë po përmendim sa vijon:

1. Amendamentet 4-49 në Kushtetutën e Serbisë të datës 28 mars 1989;

2. Vendimi i Serbisë për aplikimin e rrethanave të posaçme në Kosovë më 26 qershor 1990;
3. Ligji mbi veprimin e organeve republikane në rrethana të posaçme i datës 26 qershor 1990;
4. Kushtetuta e Republikës së Serbisë e datës 28 qershor 1990;
5. Ligji mbi ndalimin e punës së Kuvendit të Kosovës dhe Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Kosovës i datës 5 korrik 1990;
6. Ligji mbi marrëdhëniet e punës në rrethana të posaçme i datës 26 korrik 1990;
7. Ligji mbi suspendimin e punës së Kryesisë së KSA të Kosovës i datës 18 mars 1991 dhe Vendimi i Kuvendit të Serbisë;
8. Kushtetuta e të ashtuquajturës “RF e Jugosllavisë” e datës 27 prill 1992;
9. Ligjet dhe aktet e tjera kundërkushtetuese.

Renditja e këtyre veprimeve kundërkushtetuese të Serbisë që janë ndërmarrë ndaj Kosovës është bërë në bazë të kriterit kohor, do të thotë kohës së nxjerrjes së tyre. Me qëllim të konstatimit të karakterit kundërkushtetues të këtyre veprimeve, me këtë rast do të ndalemi në analizën e shkurtër të këtyre veprimeve, duke u kufizuar posaçërisht në analizën kushtetuese të këtyre veprimeve.

**1. Amendamentet 9-49 në Kushtetutën e RS të Serbisë (të vitit 1974) të datës 28 mars 1989** paraqiten hapin e parë institucional me të cilin Serbia filloi procesin e rrënimit kundërkushtetues të pozitës së Kosovës të përcaktuar me Kushtetutën e vitit 1974 dhe vënien e saj nën juridiksionin e shtetit unik serb. Në saje të fushatës së organizuar gjatë diskutimeve kushtetuese kundër pozitës së njësive autonome, e në kundërshtim me vullnetin politik të popullit shqiptar të shprehur gjatë këtij debati kushtetues anembanë Kosovës, Kuvendi i Serbisë ia arriti që (sipas interpretimit serb) të marrë pëlqimin nga Kuvendi i Kosovës dhe më 23 mars të vitit 1989 të miratojë amendamentet kushtetuese në Kushtetutën e RS të Serbisë të vitit 1974.

Marrja e dhunshme dhe e imponuar e pëlqimit nga Kuvendi i Kosovës i hapi rrugën pushtetit serb që në rrugën institucionale (edhe pse ekzistonte kërcënimi nga kreu politik serb se po qe se është nevoja ky pëlqim do të merrej edhe në rrugën jashtinstitucionale) të fillojë procesin e vënies së Kosovës nën juridiksionin e plotë të Serbisë. Me gjithë presionet politike dhe policore, të cilave u ishin ekspozuar ish-

delegatët e Kuvendit të Kosovës me rastin e deklarimit të tyre për këto amendamente, mendojmë se ata është dashur të jenë këmbëngulës në respektimin e rezultateve të diskutimit publik dhe të mos e japin pëlqimin për miratimin e këtyre amendamenteve kushtetuese. Kur e japim këtë konstatim kemi parasysh rrethanat politike që kanë ekzistuar në momentin e dhënies së këtij pëlqimi. Pasojat si në rastin e parë ashtu edhe në të dytin, sipas mendimit tim, do të ishin pothuajse identike për pozitën kushtetuese të Kosovës. Ky konstatim mund të konfirmohet me ngjarjet që pasuan më vonë nga të cilat u pa se Kosova ishte hallka e parë përmes së cilës pushteti serb shkatërroi strukturën federative të ish-Jugosllavisë. Mirëpo mosdhënia e pëlqimit nga ana e Kuvendit të Kosovës do t'i paraqitë pengesë pushtetit serb në deklarimet e tij në opinionin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar, që ndërrimin e pozitës kushtetuese të njërive autonome e ka bërë në procedurë dhe rrugë institucionale, përkatësisht kushtetuese.

Ndryshimet kushtetuese të aplikuara me amendamentet kushtetuese të vitit 1989 nga pushteti serb u cilësuan si “ndryshime minimale” me qëllim të rivendosjes së shtetësisë së Serbisë në tërë territorin administrative të saj. Është me rëndësi të theksohet fakti se pozita kushtetuese e Kosovës e përcaktuar me Kushtetutën e RSFJ-së të vitit 1974 në aspektin e zgjidhjeve kushtetuese ngeli e pandryshuar në Federatë. Ky fakt tregon karakterin absurd dhe kundërkushtetues të këtyre amendamenteve kushtetuese, ngase:

- në një anë këto zgjidhje kufizojnë subjektivitetin politik të Kosovës në shumë sfera duke zgjeruar funksionet e organeve republikane;
- në anën tjetër pozita kushtetuese e Kosovës në Federatë vazhdon të jetë e pandryshuar.

Përderisa amendamentet kushtetuese të Serbisë kufizojnë dukshëm mëvetësinë e Kosovës në shumë sfera, ajo edhe pas miratimit të tyre vazhdon të trajtohet si njësi e mëvetësishme federale me të gjitha atributet e subjektit të barabartë dhe konstitutiv.

Nga kjo rrjedh se këto amendamente kanë qenë në kundërshtim më parimet themelore të Kushtetutës së RSFJ-së të vitit 1974 të cilat kanë përcaktuar dhe garantuar mëvetësinë politike të Kosovës.

Me qëllim të kuptimit të karakterit të amendamenteve kushtetuese të vitit 1989, me këtë rast shkurtimisht do ta analizojmë përmbajtjen e atyre zgjidhjeve kushtetuese të cilat kufizojnë mëvetësinë e Kosovës dhe të organeve të saj në sfera të ndryshme. Nga gjithsej 41 amendamente kushtetuese, 8 prej tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë i referohen

pozitës së njësisve autonome, përkatësisht zgjerimit të funksioneve unike të organeve republikane të Serbisë.

Amendamenti XXVII kufizon dukshëm të drejtat e njësisve autonome në sferën e rregullimit ligjor të përdorimit zyrtar të gjuhëve dhe shkrimeve të kombeve dhe kombësive në territorin e njësisve autonome. Derisa me Kushtetutën e vitit 1974 njësitë autonome në mënyrë të pavarur me ligjet e veta kanë rregulluar përdorimin zyrtar të gjuhëve dhe shkrimeve të kombeve dhe kombësive në territorin e tyre, me zgjidhjet e këtij amendamenti sanksionohet pabarazia juridike e gjuhëve dhe e shkrimeve të kombeve që jetojnë në njësitë autonome. Në të vërtetë, me këtë amendament gjuha serbokroate përcaktohet si gjuhë zyrtare, kurse gjuhët e kombeve dhe të kombësive të tjera mund të jenë në përdorim zyrtar në pajtim me ligjin. (*Shih Amendamenti XXVII, pika 1 dhe 2.*)

Me këtë zgjidhje gjuhët e kombeve dhe kombësive të tjera në njësitë autonome vihen në pozitë të pabarabartë, ngase njëra gjuhë (serbokroate) përcaktohet si zyrtare me akt kushtetues, kurse gjuhët e tjera mund të jenë në përdorim zyrtar në pajtim me ligjin, i cili përcakton kushtet për përdorimin e tyre.

Me amendamentin XXIX zgjerohen kompetencat e Gjykatës Kushtetuese të Serbisë në atë mënyrë që kjo Gjykatë tani autorizohet që të bëjë vlerësimin se a është Kushtetuta e njësisë autonome në pajtim me Kushtetutën e Serbisë.

Në këtë drejtim përcaktohet autorizimi i ri i kësaj gjykate, që kur ajo konstaton se dispozitat e caktuara të kushtetutave të njësisve autonome nuk janë në pajtim me Kushtetutën e RSS, për këtë ajo njofton Kuvendin përkatës të njësisë autonome, i cili ka qenë i obliguar që në afat prej një viti të mënjanojë këtë mospajtueshmëri. Po qe se Kuvendi nuk mënjanon këtë mospajtueshmëri të Kushtetutës së njësisë autonome me Kushtetutën e RSS-së, dispozitat kushtetuese nuk mund të aplikohen. Ky zgjerim i kompetencave të Gjykatës Kushtetuese të Serbisë në fakt ka paraqitur presedan në praktikën e gjyqësisë kushtetuese në Jugosllavi. Në të vërtetë, në praktikën dhe teorinë kushtetuese jugosllave ka dominuar mendimi se kushtetutat si akte më të larta juridike dhe politike nuk mund të jenë objekt i vlerësimit dhe kontrollit nga ana e gjykatave kushtetuese. Duke u bazuar në këtë qëndrim, Kushtetuta e RSFJ-së e vitit 1974, me rastin e përcaktimit të funksioneve të Gjykatës Kushtetuese të Jugosllavisë nuk e ka autorizuar këtë Gjykatë që të vlerësojë pajtueshmërinë e kushtetutave të republikave dhe krahinave autonome me Kushtetutën Federative. Kjo ka qenë

shprehja e konceptit dominues kushtetues sesa kompetent për të interpretuar kushtetutën kanë qenë vetëm organet që i kanë nxjerrë ato, d.m.th. kuvendet e njësive federale.

Kontrolli i kushtetutave të njësive autonome nga ana e Gjykatës Kushtetuese të Serbisë në esencë ka kufizuar funksionin e kushtetutëdhënies së tyre. Kushtetuta sipas kësaj zgjidhjeje nuk është akt ordiner me të cilën njësia autonome përcakton vetorganizimin e saj politik. Ajo sipas kësaj zgjidhjeje duhet të jetë në pajtim me Kushtetutën e Serbisë dhe me sistemin kushtetues që e përcakton ajo.

Amendamenti XXXI ka përcaktuar raporte të reja midis organeve republikane dhe atyre krahinore në sferën e zbatimit të ligjeve unike republikane, që janë aplikuar në tërë territorin e Serbisë. Sipas zgjidhjeve kushtetuese të vitit 1974, ligjet unike republikane i kanë zbatuar në mënyre të pavarur organet republikane dhe krahinore, secila në territorin e saj. Si kriter për përcaktimin e kompetencave për zbatimin e këtyre ligjeve ka qenë “përgjegjësia për zbatimin e tyre”. Kur këtë përgjegjësi e kanë pasur organet republikane, ato njëkohësisht kanë zbatuar këto ligje. Dhe, anasjelltas, njësitë autonome kanë zbatuar këto ligje kur me kushtetutat e tyre ka qenë e përcaktuar përgjegjësia e tyre në këtë sferë.

Në këtë sferë me ndryshimet që aplikon ky amendament sanksionohen parimet e reja që bazohen në hierarkinë dhe subordinimin e organeve krahinore ndaj atyre republikane. Organet republikane tani autorizohen që të ushtrojnë kontrollin e punës së organeve krahinore në zbatimin e ligjeve unike republikane, me të drejtën e dhënies së instruksioneve të obligueshme për veprimin e caktuar të këtyre organeve. Në raste të caktuara organet republikane kanë qenë të autorizuar, që, po qe se organet e njësive autonome nuk ndërmarrin masa adekuate për zbatimin e ligjeve republikane, të cilat aplikohen në mënyrë unike, të marrin përsipër vetë zbatimin e këtyre ligjeve. (Amendamenti XXXI, pika 3-8.)

Me këto zgjidhje praktikisht është kufizuar mëvetësia e organeve të njësive autonome dhe është institucionalizuar kontrolli politik i punës së tyre nga ana e organeve republikane. Kjo ka ndikuar që organet krahinore të administratës, krahas përgjegjësisë së tyre ndaj kuvendeve dhe këshillave ekzekutive, për punën e vet t’u përgjigjen në mënyrë të drejtpërdrejtë organeve republikane të administratës.

Funksionet unike të RS të Serbisë, që janë realizuar në vëllim dukshëm më të zgjeruar, janë përcaktuar në amendamentin XXXIII. Këto funksione, sipas Kushtetutës së RS të Serbisë të vitit 1974, kanë

pasur një shtrirje mjaft të kufizuar (neni 300). Pikërisht në këtë lëmi gjatë debatit kushtetues në qarqet profesionale serbe ka pasur më së shumti kërkesa për zgjerimin e rregullativës unike ligjore të Republikës, përkatësisht përkufizimin e autorizimeve të njësive autonome në shumë lëmenj.

Duke u nisur nga kjo, ky amendament zgjeron dukshëm funksionet unike të Republikës në sferën e përdorimit të simboleve kombëtare, të përdorimit zyrtar të gjuhëve dhe të shkrimeve të kombeve dhe të kombësive, të përdorimit të flamujve kombëtarë, në sferën e mbrojtjes popullore dhe të sigurimit shtetëror, mbrojtjes penalo-juridike të qytetarëve etj. (Amendamenti XXXXIII, pika 15.)

Ky zgjerim i legjislacionit unik republikan ka kufizuar qenësisht mëvetësinë e Kosovës në sferën legjislative. Kjo, ngase një pjesë e çështjeve dhe e marrëdhënieve që deri atëherë i rregullonte Kosova në mënyrë të mëvetësishme me ligjet e veta, tani kaloi në kompetencë të Kuvendit të Serbisë. Se për çfarë kufizimi të funksioneve legjislative të Kosovës ishte fjala tregon edhe fakti se vetëm deri në fund të vitit 1990 në bazë të zgjidhjeve të këtij amendamenti u nxorën 90 ligje me veprim unik në tërë territorin e Serbisë.

Në amendamentin XL janë përcaktuar zgjidhjet e reja në përfaqësimin e njësive autonome në organe të Republikës së Serbisë. Sipas këtij amendamenti përcaktohet se në realizimin e politikës kadrovike në organet e Republikës do të merret parasysh përfaqësimi i kombeve dhe kombësive nga territori i Republikës si tërësi. Nga kjo rrjedh se në vend të përfaqësimit të njësive autonome, ky amendament aplikon parimin e përfaqësimit të kombeve dhe kombësive që jetojnë në njësitë autonome. Kjo padyshim ka nënkuptuar zbehjen e mëvetësisë së tyre dhe reduktimin e së drejtës në pjesëmarrjen e përfaqësuesve të tyre në organet shtetërore të Republikës. Me amendamentin XLIV zgjerohen kompetencat e Gjykatës Kushtetuese të Serbisë në vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së akteve dhe dispozitave të përgjithshme juridike për të cilat është konstatuar se janë në kundërshtim me Kushtetutën e RS të Serbisë, ligjet unike republikane dhe dispozitat dhe aktet e tjera të përgjithshme që i nxjerrin organet republikane e që aplikohen në mënyrë unike në tërë territorin e Republikës.

Dhe në fund, me amendamentin XLVII është përcaktuar procedura e re për ndryshimin e Kushtetutës së Serbisë. Esenca e këtij ndryshimi konsiston në përjashtimin e njësive autonome në vendosjen për ndryshimin e Kushtetutës së Serbisë dhe eliminimi i mundësisë që ato të bllokojnë procesin e ndryshimeve kushtetuese në Serbi. Në të vërtetë,

me këtë zgjidhje të re pëlqimi i kuvendeve të njësive autonome tani zëvendësohet me institutin “e dhënies së mendimit”. Në esencë, mendimet e kuvendeve të njësive autonome nuk kanë pasur kurrfarë ndikimi, ngase kanë pasur karakter fakultativ dhe nuk kanë penguar Kuvendin e RS të Serbisë që të miratojë ndryshimet e Kushtetutës në mënyrë të pavarur. E tërë pesha juridike e mendimeve të kuvendeve të njësive autonome ka konsistuar në atë se po qe se ai ka qenë negativ, procedura e miratimit të ndryshimeve ka mund të shtyhet për gjashtë muaj dhe pas kalimit të këtij afati. Kuvendi i njësisë autonome ka pasur të drejtë që të propozojë shpalljen e referendumit kushtetues (Ky formulim kushtetues ka qenë rezultat i kompromisit të arritur në Komisionin për çështje kushtetuese të Kuvendit të RS të Serbisë dhe ai u fut në këtë amendament me insistimin e përfaqësuesve nga Kosova). *Ky formulim ka pasur për qëllim sigurimin e një forme të pjesëmarrjes së krahinave autonome në procedurën e ndryshimit të Kushtetutës së Serbisë. Përpos deklarimit juridik ai nuk pati ndonjë rëndësi tjetër, ngase ai nuk ka pasur ndonjë ndikim të posaçëm në këtë procedurë).*

Në pikën 2 të këtij amendamenti në mënyrë shprehimore ka qenë e përcaktuar se me ndryshimet e Kushtetutës së RS të Serbisë nuk mund të ndryshohen të drejtat dhe detyrat e krahinave të përcaktuara me Kushtetutën e RSFJ-së të vitit 1974.

Se sa demagogjik ka qenë ky formulim juridik nuk ka nevojë të bëhet fjalë, më tepër në mënyrë të veçantë. Aq më parë kur të kihet parasysh se vetë këto ndryshime kushtetuese, që u aplikuan me amendamentet e cituara kushtetuese, drejtpërdrejt cenuan pozitën kushtetuese të Kosovës dhe mëvetësinë e përcaktuar të saj. Ndryshimet që më vonë u sanksionuan pas miratimit të Kushtetutës së Serbisë me 28 qershor 1990 më së miri treguan demagogjinë e pushtetmbajtësve të regjimit politik serb, i cili në rrënimin e pozitës kushtetuese të Kosovës nuk u kujdes shumë që të zgjedhë mjetet dhe metodat për arritjen e këtij qëllimi politik.

**2. Vendimi i Kuvendit të Serbisë për aplikimin e rrethanave të posaçme në Kosovë.** - Këtë vendim kundërkushtetues e miratoi Kuvendi i Serbisë më 26 qershor 1990. (*Shih: Vendimi për aplikimin e rrethanave të posaçme në Kosovë i datës 26 qershor 1990, "Gazeta zyrtare e RS të Serbisë" nr. 30/90).*

Ky vendim kundërkushtetues u nxor nën ndikimin e vlerësimeve politike të kreut politik serb dhe jugosllav mbi gjoja “rrezikimin e rendit

kundërkushtetues në Kosovë”. Si bazë për marrjen e këtij vendimi kundërkushtetues merret si vijon:

1. ndërmarrja e aktiviteteve të orientuara në rrënimin e rendit të vendosur me Kushtetutë dhe të tërësisë territoriale,
2. moszbatimi i ligjeve dhe dispozitave të tjera,
3. ndërmarrja e veprimeve të cilat mund të shkaktojnë rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve,
4. kur të drejtat dhe obligimet e përcaktuara me këtë Kushtetutë dhe me ligj kryhen në atë mënyrë që dëmtohen rëndë interesat shoqërore, si dhe kur shfrytëzohen ato për realizimin e qëllimeve që janë të kundërta me Kushtetutën.

Qëllimi kryesor i marrjes së këtij vendimi kundërkushtetues, në esencë, ka qenë shkatërrimi i sistemit kushtetues të Kosovës dhe krijimi i kushteve që Serbia, duke i shpallur rrethanat e posaçme në Kosovë (në kundërshtim me Kushtetutën Federative në fuqi) të marrë autorizimet e organeve krahinore dhe ato t’i bartë në organet e saj republikane.

**3. Ligji mbi veprimin e organeve republikane në rrethana të posaçme.** - Ky ligj u nxor krahas marrjes së vendimit për aplikimin e rrethanave të posaçme në Kosovë dhe qëllimi themelor i tij ishte përcaktimi i kompetencave të organeve republikane në Kosovë gjatë kohës sa janë në fuqi “rrethanat e posaçme”. Në aspektin kushtetues ky ligj ka paraqitur instrumentin kryesor më të cilin pushteti serb ndërhyri në mënyrë kundërkushtetuese në sistemin kushtetues dhe politik të Kosovës dhe me të cilin ai bëri desubjektivizimin dhe deinstitutionalizimin politik të saj. Karakteristikat themelore që e zhveshin këtë ligj nga karakteri i tij kushtetues janë:

1. Mungesa e bazës juridike për nxjerrjen e tij;
2. Inkompetenca;
3. Qëllimi politik i tij dhe
4. Karakteri diskriminues i tij.

A) Mungesa e bazës kushtetuese për nxjerrjen e këtij ligji është e evidente dhe ajo lehtë mund të argumentohet. Në thelb, në dispozitat e këtij ligji është mohuar pozita kushtetuese e Kosovës e përcaktuar dhe e garantuar si pjesë konstitutive e Federatës me Kushtetutën në fuqi të RSFJ-së të vitit 1974. Njëkohësisht, me dispozitat e ligjit në fjalë është mohuar e drejta shprehimore e Federatës për aplikimin e masave në

rrethana të posaçme. Së këndejmi, me këtë ligj është bërë shkelje e shumëfishtë e Kushtetutës dhe e ligjeve federative. Përveçse është në kundërshtim thelbësor me Kushtetutën e RSFJ-së të vitit 1974, ky ligj ka qenë në kundërshtim të thellë edhe me legjislacionin federativ, veçanërisht me Ligjin e procedurës penale, Ligjin e procedurës së përgjithshme administrative, Ligjin e konflikteve administrative dhe ligjet e tjera federative. Shih më hollësisht lidhur me këtë dr. Esat Stavileci, "Ligjet dhe masat kundërkushtetuese të Serbisë dhe aplikimi i tyre në ndërmarrjet dhe në institucionet në Kosovë", "Përparimi" nr. 5-6/91, fq. 34-35, Prishtinë, 1991.

B) Inkompetenca e organit që e ka nxjerrë këtë ligj konsiston në faktin se me asnjë dispozitë kushtetuese në fuqi nuk ka qenë e përcaktuar e drejta e Kuvendit të Serbisë që të miratojë ligjet e posaçme, të cilat do të aplikohen vetëm në një pjesë të territorit, ku shpallen të ashtuquajturat "rrethana të posaçme". Me Kushtetutën e Kosovës të vitit 1974 Kuvendi i Kosovës ka gëzuar mëvetësi të gjerë në sferën legjislative dhe ai me ligje burimore ka rregulluar të gjitha çështjet me interes për territorin e Kosovës. Funkcionet e Kuvendit të Kosovës në këtë sferë kanë qenë të kufizuara vetëm me të ashtuquajturin legjislacion themelor federativ dhe legjislacionin unik republikan.

Pasi ligji në fjalë nuk është nxjerrë në bazë të legjislacionit themelor federativ, përkatësisht atij unik republikan (neni 300 i Kushtetutës së RS të Serbisë të vitit 1974), mund të konstatojmë se ai është nxjerrë nga organi jokompetent dhe jolegjitim. Qëllimi kryesor i këtij ligji ishte i karakterit politik. Me këtë ligj kundërkushtetues pushteti serb mori kompetenca të organeve legale dhe legjitime të Kosovës dhe ato i barti në organet e veta republikane.

Si qëllim kryesor i këtij ligji autori i tij (Kuvendi i RS të Serbisë) përcakton sigurimin e kundërkushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, lirive demokratike, të drejtave, obligimeve dhe përgjegjësisë së qytetarëve dhe barazinë e tyre në tërë territorin e RS të Serbisë.

38 Ligji mbi veprimin e organeve republikane në rrethana të posaçme, neni 1.

Karakterit ironik dhe demagogjik i këtyre qëllimeve më së miri mund të pasqyrohet duke theksuar këto dy kundërgjegjësi: e para, ky ligj nuk ka pasur kurrfarë pretendimi që të sigurojë kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë në Kosovë. Përkundrazi, ai është akti kryesor që hapi rrugën për shkeljen flagrante të kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë në Kosovë.

## Riokupimi i Kosovës dhe vendosja e gjendjes së jashtëzakonshme në Kosovë

Në fund të vitit 1988 dhe në fillim të vitit 1989 grevat e minatorëve dhe e studentëve shqiptarë nga data 19 deri më 29 shkurt 1989 shënuan kulmin e një rezistence të fuqishme kundër fushatës shoviniste të Milosheviçit për rrënimin e autonomisë së Kosovës.

Mirëpo Qeveria serbe nuk përfilli vullnetin e shqiptarëve dhe në vend të kësaj edhe një herë vendosi gjendjen e jashtëzakonshme, që i përngjante një shtetrrethimi ushtarak.

Më 23 mars të vitit 1989, nën rrethimin policor e ushtarak të Parlamentit të Kosovës, u imponua votimi dhe numërimi i votave u bë në mënyrë jokorrekte dhe jotransparente dhe kësioj Kosova humbi autonominë e saj.

Më 28 mars 1989 në Beograd festohej me pompozitet shfuqizimi i autonomisë së Kosovës dhe shpallej “unifikimi” i Serbisë, ndërsa në Kosovë vazhdonte edhe më tej torturimi, burgosja dhe vrasja e shqiptarëve, të cilët atëbotë manifestonin në mënyrë paqësore kundër shfuqizimit të të drejtave të tyre nga regjimi neofashist i Milosheviçit.

Sipas skenarit më herët të përgatitur në Beograd, në krye të piramidës për burgosje u gjetën Azem Vllasi dhe udhëheqësit e “Trepçës” dhe disa minatorë (Aziz Abrashi, Burhan Kavaja, Avdi Uka, Veli Osmani). Pastaj Lazër Krasniqi, drejtor i KEK-ut etj. Ata u akuzuan për vepër penale të dënueshme sipas ligjit penal edhe me vdekje.

Pas kësaj kohe pushteti jugosllav, përkatësisht ai serb, i hyri planit të ri me qëllim të rikolonizimit të Kosovës me popullatë sllave, perkatësisht organizimin e aksionit kinse të kthimit të serbëve dhe malazezëve të shpërngulur nga Kosova. Pushteti serb, i mbështetur nga ai jugosllav e herë-herë edhe nga ai kosovar, duke e shfrytëzuar këtë klimë filluan të miratojnë vlerësime, platforma, rezoluta e programe kinse për kthimin e serbëve dhe malazezëve në Kosovë, në të vërtetë, përgatitej vala tjetër e kolonizimit të Kosovës me elementin sllav.

Pushteti serb filloi lëvizjet për suprimimin e autonomisë së Kosovës. Shërbimet e fshehta serbe nxitnin serbët e malazezët e Kosovës që të ngriteshin në demonstrata – protesta kundër pozitës “inferiore” që kishin përballë shqiptarëve. Çerdhja e organizatorëve të demonstratave ishte në Fushë-Kosovë. Ata si moto përdorshin edhe kthimin e serbëve

dhe malazezëve të shpërngulur kinse me dhunë nga Kosova në periudhat e mëhershme. Kjo fushatë antishqiptare u përshpejtua dhe u motivua me ardhjen në pushtet të Slobodan Milosheviçit, ndërsa u frymëzua nga Memorandumi i ASHS-së, ku u organizuan shumë mitingje me karakter antishqiptar dhe për sus-pendimin e autonomisë së Kosovës. Përveç kësaj, qeveria e Beogradit arriti të mobilizojë gjithë popullin nën parullën “Serbi unike”. Disa vjet rresht u organizuan me qindra mitingje e demonstrata antishqiptare. Për të bërë kthesa nacionaliste nga Qeveria Serbe u organizuan marshime dhe demonstrata shoviniste në Kosovë, në Serbi dhe para organeve serbojugosllave në Beograd. Parullat e tyre ishin: “Kosova është Serbi”, “Kosova është zemra e Serbisë”, “Kosova është tokë e shenjtë serbe”, “Ne do të luftojmë për këtë vend të tokës së vjetër serbe”, “Serbi mos e lësho Kosovën nga dora” etj. Kjo qeveri serbe para organeve shtetërore përdori si paravan shpërnguljen nga Kosova të serbomalazezëve. Ky ishte vetëm një pretekst i pabazë dhe jashtë çdo realiteti.

Në këtë kohë në Kosovë u vendos gjendja e jashtëzakonshme dhe ora policore nën presionin e 30 mijë policëve të sjellë nga Serbia. Kështu, më 23 mars 1989 nën gjendjen e jashtëzakonshme dhe nën kërcënimin e armëve, si dhe me anë të votave joparlamentare, Kuvendi i Kosovës miratoi amendamentet për ndërrimin e Kushtetutës së vitit 1974, kështu që edhe *de jure* u suprimua autonomia e Kosovës. Më 28 mars 1989 në Beograd Kuvendi Federativ i Jugosllavisë ratifikoi vendimin e Kuvendit të Kosovës, ndërsa në korrik të vitit 1990 pushteti serb e okupoi Kosovën.

Përkritazi me politikën gjenocidale dhe qëllimet e hapura të pushtetit serb më së miri na paraqet një letër e akademik Mark Krasniqit dërguar Kryetarit të Kryesisë së RFS të Jugosllavisë nga Prishtina më 1 shkurt 1990, ku mes të tjerash shkruan: “....me marrjen e autonomisë së Kosovës në pranverën e vitit 1989 është realizuar suksesi i parë i asaj politike, e pjesërisht edhe më gjerë. Siç është e njohur, autonomia e Kosovës është rrënuar me tanke, me policinë speciale dhe me viktime të shumta të nacionalitetit shqiptar, e cila, me manifestime masive në tërë Kosovën në mënyrë plebishitare është shprehur kundër heqjes së Kushtetutës të vitit 1974 dhe kundër amendamenteve të RS të Serbisë, ka shkaktuar probleme të shumta, të cilat ajo mendon t’i zgjidhë nëpërmjet masave represive drastike ndaj shqiptarëve, të cilët në Kosovë përbëjnë 80% të popullatës së përgjithshme, duke i larguar në mënyrë masive nga puna, me burgime dhe me vrasje të reja të njerëzve të pafajshëm, që mund të ketë pasoja të paparashikuara tragjike të

përmasave të gjera. Këtë politikë të rrezikshme të Serbisë është duke i dënuar tërë bota demokratike liridashëse, me disa përjashtime, por të gjitha këto i shikon me duarkryq. (*Shih: Letra e akademik Mark Krasniqit dërguar Kryesisë së RSF të Jugosllavisë, Prishtine, 1 shkurt 1990.*)

## LINDJA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS 1990 - 1998

Shpërbërja e ish-Federatës Jugosllave, e filluar me rrënimin e konceptit kushtetues të pozitës së Kosovës në vitin 1989, me shkëputjen dhe njohjen ndërkombëtare të katër njësive federale, si dhe fillimin e luftës në truallin e ish-Jugosllavisë, hapën procese të reja politike që karakterizohen nga dezintegrimi i shtetit federativ dhe krijimi i shteteve të reja sovrane e të pavarura. Duke u nisur nga fakti se koncepti federativ i Jugosllavisë, i bazuar në vendimet e Mbledhjes së Dytë të KAÇKJ-së, pushoi së ekzistuari dhe pasi dështuan të gjitha bisedimet politike rreth ripërkufizimit të Jugosllavisë në formë të federatës a të konfederatës, filloi procesi i dekompozimit të saj.

Në dekompozimin e ish-Federatës Jugosllave ndikuan shumë faktorë nga të cilët po veçojmë:

1. Rrënimin kundërkushtetues të subjektivitetit politik të njësive autonome të përcaktuar me zgjedhjet e Kushtetutës së vitit 1974, me amendamentet kushtetuese të Kushtetutës së RS të Serbisë datë 23 mars 1990;

2. Nxjerrjen e një morie ligjesh në njësitë federale me të cilat në territorin e tyre u bë suspendimi i aplikimit të legjislacionit federativ. Përmes këtyre ligjeve (të cilat në fillim u nxorën në Serbi e më vonë edhe në Slloveni e Kroaci) republikat morën kompetencat e organeve federative dhe në mënyrë të njëanshme braktisën aplikimin e legjislacionit federativ;

3. Dështimin e bisedave të kreut më të lartë politik e shtetëror të gjashtë njësive federale (gjashtë kryetarëve të republikave lidhur me ripërkufizimin e Federatës Jugosllave. Këto biseda ishin jolegjitime, ngase nga to në mënyrë kundërshtuese ishte përjashtuar Kosova, e cila ashtu si edhe republikat, sipas Kushtetutës së RFJ-së të vitit 1974, ishte subjekt i barabartë dhe konstitutiv i federalizmit;

4. Fillimin e luftës në Jugosllavi, në fillim në Slloveni dhe pastaj në Kroaci dhe në Bosnjë e Hercegovinë;

5. Shkëputjen dhe njohjen ndërkombëtare të katër republikave të ish-Jugosllavisë, të cilat u konstituuan si shtete sovraane dhe të pavarura;

6. Krijimin e të ashtuquajturës RF e Jugosllavisë, e cila në aspektin kushtetues “rrumbullakësoi” procesin e shpërbërjes së Federatës Jugosllave, duke shpallur të vetëquajturin shtet federativ të përbërë nga dy njësi federale - Serbia dhe Mali i Zi (unioni u shpërbë ndërkohë dhe u krijuan shtete sovraane).

Procesi i shpërbërjes së ish-Jugosllavisë bëri aktualizimin e çështjes së realizimit të së drejtës së vetëvendosjes së popujve që jetonin në ish-Jugosllavi. Duke u inkorporuar në proceset politike, që lindën në sajë të shpërbërjes së RSFJ-së, edhe populli shqiptar si një nga popujt numerikisht më të mëdhenj të Jugosllavisë (i treti për nga numri i banorëve), nëpërmjet organeve të veta legjitime (kuvendit) dhe në vetëpërcaktim gjithëpopullor (referendumit) shprehu vullnetin dhe të drejtën natyrore që të jetë i lirë dhe i mëvetësishëm në përcaktimin e statusit të vet kushtetues dhe politik.

Në këtë drejtim, më 2 korrik të vitit 1990 të 111 delegatët e Kuvendit të Kosovës miratuan dhe shpallën Deklaratën Kushtetuese të Kosovës si njësi e pavarur dhe e barabartë në kuadër të Federatës-Konfederatës së Jugosllavisë, si subjekt i barabartë me njësitë e tjera federale në Federatë-Konfederatë.

Materializimin e vet kushtetues Deklarata Kushtetuese e 2 Korrikut e mori më 7 Shtator të vitit 1990, kur në Kaçanik Kuvendi i Kosovës miratoi dhe shpalli Kushtetutën e Republikës së Kosovës me të cilën bëhej avancimi i pozitës kushtetuese juridike i Kosovës nga njësia autonome në republikë të pavarur, në kuadër të bashkësisë së Jugosllavisë.

Pas fillimit të procesit të shpërbërjes së ish-Federatës Jugosllave dhe pas shkëputjes nga ish-Jugosllavia të katër republikave, edhe populli shqiptar në referendumin gjithëpopullor të mbajtur më 26-30 shtator 1991, në mënyrë plebishitare u deklarua për konstituimin e Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur. Në pajtim me këtë deklaram politik të popullit shqiptar, Kuvendi i Kosovës më 18 tetor 1991 miratoi Rezolutën për Kosovën shtet sovran dhe i pavarur.

Deklarimi i Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur krijoi situatë të re kushtetuese, e cila imponoi ndryshimet adekuate në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim Kuvendi i Kosovës më 19 tetor 1991 miratoi Amendamentin I, me të cilin Republika e Kosovës, përcaktohet si shtet sovran dhe i pavarur dhe me Amendamentet II-VI, me të cilat instituti i Kryesisë së Kosovës zëvendësohet me Kryetarin e

Republikës si shef individual i shtetit, si dhe bëhet bartja e kompetencave të Kuvendit në Qeverinë e Kosovës gjatë kohës derisa të zgjasin rrethanat e jashtëzakonshme.

Miratimi i amendamenteve kushtetuese në Kushtetutën e Republikës së Kosovës mundësoi mbetjen e zgjedhjeve të para shumëpartiake parlamentare dhe presidenciale më 24 maj 1992, kur u zgjodhën deputetët për kuvendin e Kosovës dhe Kryetari i Republikës së Kosovës.

Edhe pse Republika e Kosovës u shfaq në kohën kur shteti serb në mënyrë kundërkushtetuese rrënoi mëvetësinë politike të Kosovës (dhe bëri okupimin policor e ushtarak të të gjitha institucioneve të saj), lindja dhe krijimi i saj nuk duhet vështruar si kundërpozicion i popullit shqiptar ndaj masave kundërkushtetuese dhe represive të Serbisë në Kosovë. Republika e Kosovës para së gjithash bëri realizimin e intencave dhe aspiratave historike të popullit shqiptar për liri dhe pavarësi dhe përcaktimin demokratik të tij që të jetojnë në mëvetësi me ligjet e veta dhe me organizim të pavarur.

### Aktet burimore kushtetuese dhe politike me të cilat lindi Republika e Kosovës

Nga kjo që u theksua më lart rrjedh se Republika e Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur lindi dhe u krijua me këto akte kryesore kushtetuese dhe politike:

1. Deklarata Kushtetuese e 2 Korrikut të vitit 1990;
2. Kushtetuta e Republikës së Kosovës e 7 Shtatorit të vitit 1990 (Kushtetuta e Kaçanikut);
3. Referendumi gjithëpopullor për Kosovën shtet sovran dhe i pavarur i mbajtur më 26-30 shtator të vitit 1991;
4. Rezoluta e Kuvendit të Kosovës për Kosovën shtet sovran dhe i pavarur, miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 19 tetor 1991;
5. Amendamentet kushtetuese në Kushtetutën e Republikës së Kosovës të miratuara nga Kuvendi i Kosovës më 19 tetor 1991;
6. Zgjedhjet e lira dhe shumëpartiake për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe për zgjedhjen e Kryetarit të Republikës të mbajtura më 24 maj 1992 dhe për të dytën më 22 mars të vitit 1998.

Renditja e akteve dhe veprimeve të lartpërmendura është bërë në mbështetje të kohës së nxjerrjes së tyre, ngase ato paraqesin një proces të pashkëputshëm me të cilin është bërë rrumbullakësimi kushtetues dhe politik i Republikës së Kosovës.

## Deklarata Kushtetuese e 2 Korrikut 1990

Menjëherë pas miratimit të amendamenteve kushtetuese (në Kushtetutën e RS të Serbisë të vitit 1974) në vitin 1989 pushteti serb përmes një morie ligjesh dhe aktesh të tjera kundërkushtetuese filloi procesin e deinstitutionalizimit politik të Kosovës. Ky proces kishte për qëllim kryesor krijimin e të ashtuquajturës Serbi unike dhe vënien e Kosovës nën juridiksionin e plotë të saj. Nëpërmjet këtyre masave kundërkushtetuese Kuvendi i Serbisë shkatërroi tërë sistemin politik, kushtetues, juridik, ekonomik, arsimor, kulturor, informativ dhe segmentet e tjera të jetës në Kosovë.

Me qëllim të ndaljes së këtij procesi kundërkushtetues të shkatërrimit të mëvetësisë së Kosovës, Kuvendi i Kosovës (i konstituuar në zgjedhjet e vitit 1989) bëri përpjekje për kthimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë në Kosovë. Këtu, para së gjithash, veçojmë përpjekjet e këtij organi për ruajtjen e subjektivitetit politik të Kosovës dhe për anulimin e shumë akteve dhe veprimeve kundërkushtetuese të Kuvendit të Serbisë me të cilat u bënë integritete të dhunshme të ekonomisë së Kosovës me atë të Serbisë si dhe plaçkitja e ekonomisë së Kosovës. Në anën tjetër orvatjet e Kuvendit të Kosovës ishin të orientuara edhe në drejtim të anulimit të ligjeve të tjera të Kuvendit të Serbisë me të cilat u morën autorizimet e organeve të Kosovës dhe ato u bartën në organet republikane të Serbisë.

Veprimi i këtillë i Kuvendit të Kosovës u bë pengesë për realizimin e konceptit nacionalist mbi “Serbinë unike”, i cili u proklamua me Kushtetutën e Serbisë të vitit 1990. Me qëllim të evitimit të kësaj pengese pushteti serb nëpërmjet kryetarit të Kuvendit të Kosovës filloi obstrukcionin e punës së Kuvendit legjitim të Kosovës. Ky obstrukcion posaçërisht shprehej në mosçaktivimin e mbledhjeve të Kuvendit, ndërprerjet e paarsyeshme të punës së tij e deri te mbyllja e ndërtesës së Kuvendit të Kosovës nga ana e forcave policore dhe moslejimin e delegatëve shqiptarë që të mbajnë mbledhje.

Në këtë periudhë në hapësirën jugosllave aktualisht zhvilloheshin bisedimet politike rreth ripërkufizimit të Jugosllavisë në formë të

federatës (koncepti serbo-malazias) apo konfederatës (koncepti slloveno-kroat). Në këto bisedime në mënyrë kundërkushtetuese ishin përjashtuar shqiptarët dhe organet legjitime të Kosovës, edhe pse Kosova sipas Kushtetutës së RSFJ-së të vitit 1974 kishte të drejtë pjesëmarrjeje të barabartë në procesin e vendosjes politike lidhur me ardhmërinë e Jugosllavisë.

Të ballafaquar me një situatë të tillë, kur pushteti serb haptazi suprimoi institucionin kryesor politik - Kuvendin e Kosovës dhe kur shqiptarët dhe Kosova në mënyrë kundërkushtetuese u përjashtuan nga bisedimet për rregullimin e ardhshëm të Jugosllavisë, 111 delegatët e Kuvendit të Kosovës më 2 Korrik të vitit 1990, para platosë së ndërtesës së Kuvendit miratuan dhe publikisht shpallën Deklaratën Kushtetuese me të cilën deklarohet pozita e re kushtetuese e Kosovës. Në mbështetje të së drejtës sovrane të popullit të Kosovës, duke përfshirë këtu edhe të drejtën e vetëvendosjes dhe duke u nisur nga vullneti i shfaqur vendosmërisht anëmbanë Kosovës nga pjesa dërmuese e popullatës së Kosovës, i sublimuar edhe në Deklaratën e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës me Deklaratën Kushtetuese, Kosova shpallet njësi e pavarur dhe e barabartë në kuadër të Federatës-Konfederatës së Jugosllavisë si subjekt i barabartë me njësitë e tjera federale në Federatë-Konfederatë.

Roli i akademik Gazmend Zajmit ishte iniciator dhe autor i Apelit 215 të intelektualëve shqiptarë në mars të vitit 1989. Në vitin 1990 ishte kryehartuesi i Deklaratës së Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës për pozitën e re kushtetuese të Kosovës dhe përpilues i tekstit të Deklaratës Kushtetuese të 2 Korrikut 1990 dhe dokumenteve të tjera për avancimin e pozitës konstitucionale-juridike të Kosovës.

Akademik Zajmi në veprat e tij argumentoi në mënyrë shkencore të drejtën e Kosovës për vetëvendosje dhe pavarësi të plotë. Pozita kushtetuese hibride e Kosovës, siç e quante akademik Gazmend Zajmi, “në kuadrin e Federatës së ish-Jugosllavisë dhe pjesë konstitutive e saj dhe njëkohësisht e strukturuar në kuadër të Serbisë, ishte synim balancimi që shkaktohej përmes tendencave konfliktore për status plotësisht të barabartë të Kosovës në Federatë, që nënkuptonte pavarësinë e Kosovës dhe daljen e saj nga përbërja kushtetuese e Serbisë dhe tendencat për mbajtjen e Kosovës në suaza kushtetuese të Serbisë në shkallë sa më të theksuar të unitarititetit që ishte e mundur”. (*Akademik Gazmend Zajmi, “Rrjedhat e konfliktësisë shqiptaro-serbe në rrafshin kushtetues të ish-Federatës multinacionale të Jugosllavisë”, “E drejta”,*

nr. 1/96, Prishtinë, 1996. 2 Ibid. 43 Akademik Gazmend Zajmi, “Çështja shqiptare dhe federalizmi”, “Zëri”, Prishtinë, 5 nëntor 1994.)

Strukturimi i Kosovës në kuadër të kornizave kushtetuese juridike të Serbisë ishte një pozitë vërtet paradoksale, jo vetëm nga aspekti formal-juridik, por edhe nga aspekti politik-kushtetues, që nuk ka mundur të quhej ndryshe veçse një logjikë kushtetuese juridike e panatyrshme, pra një palogjikshmëri në aspektin kushtetues politik, e cila nuk mund të mbrohet së paku jo për të arsyetuar qenien e Kosovës “në kuadër të strukturës komplekse kushtetuese të Republikës së Serbisë në emër të integruesis të përbashkët”.

Një pozicion i këtillë i Kosovës në kuadrin e Republikës së Serbisë nuk ishte në përputhje me vullnetin e popullit shumicë të Kosovës. Së këndejmi, akademik Zajmi me të drejtë pohon se Kosova si njësi me kushtetutë të vetën dhe pjesë konstitutive e Federatës, sipas Kushtetutës së saj dhe kushtetutës së Federatës multinacionale të Jugosllavisë nuk ishte pjesë e Serbisë, por vetëm ishte në kuadër të strukturës komplekse kushtetuese sipas prezumpcionit të vetë vullnetit të Kosovës. Në të kundërtën, vazhdon Zajmi, do të kishim situatë paradoksale juridike “të inkuadrimit të Serbisë në Serbi” dhe të inkuadrimit të tri Serbive me tri vota në Federatë, ndërsa njësitë e tjera do të kishin nga një votë. Se Kosova nuk ishte pjesë e Serbisë, prof. dr. Esat Stavileci thekson këto të dhëna historike dhe juridike:

**E para**, Kosova nuk ishte në përbërje të shtetit sovran dhe të pavarur të Serbisë me subjektivitet juridik-ndërkombëtar të pranuar në Kongresin e Berlinit 1878;

**E dyta**, Kosova nuk ishte pjesë në Kuvendin e Dytë të AVNOJ-it (1943);

**E treta**, Kosova nuk ishte në përbërjen e Serbisë gjatë konstituimit të saj si njësi federale në Këshillin Antifashist të Çlirimit Popullor (1944);

**E katërta**, Kosova nuk ishte në përbërje të Serbisë në strukturën e Asamblesë Kushtetutdhënëse të Jugosllavisë me rastin e shpalljes së Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë. (Esat Stavileci, “Çështja e Kosovës në veprën e Gazmend Zajmit”, *Shoqata e Juristëve të Kosovës, Prishtinë 1997, fq. 15-25.*)

**E pesta**, Kosova nuk ishte e inkuadruar në Serbinë sovranë dhe të pavarur, veçse në përbërje të “Serbisë Federale në kuadrin e Jugosllavisë Federale” (1945), me ç’rast klauzola juridike *Rebus Sic Stand-tibus* me logjikën e vet domosdo imponon edhe në jetën politike

ndryshime të mëdha strukturore. Kuvendi i Kosovës sipas zgjidhjeve Kushtetuese të vitit 1974 ka dhënë pëlqimin për ndryshimin e Kushtetutës së Serbisë, pëlqim ky (sikurse te ndryshimi i Kushtetutës Federative) që ka pasur karakter konstitutiv juridik, ngase pa dhënien e tij nuk ka mund të bëhen kurrfarë ndryshimesh kushtetuese në Serbi.

## Përgatitja e Deklaratës Kushtetuese të 2 Korrikut 1990

Avancimi i pozitës kushtetuese të Kosovës si njësi e barabartë dhe e mëvetësishme politiko-territoriale dhe si pjesë e barabartë e konstitutive e federalizmit jugosllav, e në këtë kontekst edhe afirmimi dhe emancipimi kombëtar i popullit shqiptar, ishte i papranueshëm për forcat nacionaliste serbe të cilat Kosovën dhe shqiptarët kanë tentuar gjithmonë t'i mbanin nën sundim (ose t'i zhdukjin) dhe ndaj tyre të udhëheqin një politikë diskriminuese.

Në mbështetje të së drejtës sovrane të popullit të Kosovës, duke përfshirë këtu edhe të drejtën e vetëvendosjes dhe duke u nisur nga vullneti i shfaqur vendosmërisht anëmbanë Kosovës nga pjesa dërmuese e popullatës së Kosovës, i sublimuar edhe në Deklaratën e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës me Deklaratën Kushtetuese, Kosova shpallet njësi e pavarur dhe e barabartë në kuadër të Federatës-Konfederatës së Jugosllavisë si subjekt i barabartë me njësitë e tjera federale në Federatë-Konfederatë. Duke miratuar Deklaratën Kushtetuese, Kuvendi i Kosovës, si Kuvend legjitim dhe legal në kuadrin e strukturës së atëhershme të federalizmit multinacional të Jugosllavisë vendosi për barazinë e Kosovës me njësitë e tjera federale të Jugosllavisë në kuadër të Federatës-Konfederatës. Vështruar nga këndi historik, Deklarata Kushtetuese riafirmoi përcaktimin politik të popullit shqiptar për vetëvendosje të shprehur që në Rezolutën e Konferencës së Bujanit. Me këtë Deklaratë Kushtetuese të karakterit konstitutiv politik, përveç të tjerash “*ispo jure*” u bë derogimi i Rezolutës së Kuvendit të Prizrenit të vitit 1945 mbi bashkimin e Kosovës me “Serbinë federale”. *Leges posteriores priores contrarias abrogant (Ligji i mëvonshëm anulon marrëveshjen e mëhershme)*.

Në favor të këtij argumenti të saktë shkencor duhen theksuar këto dy fakte:

1. Në Rezolutën e Kuvendit kontestues të mbajtur në Prizren më 8, 9 dhe 10 korrik të vitit 1945 konfirmohet se Kosova “në bazë të dëshirës së popullit të saj vendosi t'i bashkohet Serbisë Federale”. Nga

ky formulim, që jepet në këtë Rezolutë vërtetohet bashkimi vullnetar i Kosovës me Serbinë Federale në kuadër të Jugosllavisë Federative;

2. “Hyrja vullnetare” e Kosovës në kuadër të Serbisë nuk e konsumon të drejtën e saj që të shkëputet nga kjo lidhje me Serbinë pas shpërbërjes së ish-RSFJ-së në kushtet kur populli shumicë i Kosovës deklarohet me metoda demokratike për sovranitet dhe pavarësi të saj. Në këtë drejtim, pas ndërrimit të rrethanave politike, në sajë të procesit të shpërbërjes së Federatës Jugosllave, populli shqiptar artikuloi vullnetin e vet politik në Deklaratën Kushtetuese me të cilën Kosova u përcaktua njësi sovrane dhe e pavarur.

Duke miratuar Deklaratën Kushtetuese, Kuvendi i Kosovës si Kuvend legjitim dhe legal në kuadrin e strukturës së atëhershme të federalizmit multinacional të Jugosllavisë, vendosi për barazinë e Kosovës me njësitë e tjera federale të Jugosllavisë në kuadër të Federatës-Konfederatës. Vështruar nga këndi historik Deklarata Kush-tetuese riafirmoi përcaktimin politik të popullit shqiptar për vetëvendosje të shprehur që në Rezolutën e Konferencës së Bujanit. Me këtë Deklaratë Kushtetuese të karakterit konstitutiv politik, përveç të tjerash “*ispo jure*” u bë derogimi i Rezolutës së Kuvendit të Prizrenit të vitit 1945 mbi bashkimin e Kosovës me “Serbinë federale”. *Leges posteriores priores contrarias abrogant* (Ligji i mëvonshëm anulon marrëveshjen e mëherëshme).

Deklarata Kushtetuese është në thelb një akt politik që përmban edhe qëndrimin juridik dhe vendimin e Kuvendit të Kosovës me të cilin anulohet vendimi i tij i mëparshëm për dhënien e pëlqimit për amendamentet kushtetuese në Kushtetutën e RS të Serbisë (23 mars 1989), që madje as që ekzistonte.

Vështruar nga aspekti kushtetues, Deklarata paraqit akt konstitutiv me të cilin bëhet avancimi i pozitës kushtetuese të Kosovës nga njësia autonome në njësi të pavarur dhe të barabartë me njësitë e tjera federale të ish-Jugosllavisë. Teksti i Deklaratës është mjaft i shkurtër, dhe ai, përpos preambulës së shkurtër, përmban gjashtë pika. Në pikën e parë të Deklaratës jepet konstatimi se përmes saj shfaqet dhe shpallet vullneti burimor kushtetues i popullatës kosovare dhe i Kuvendit si akt i vetëvendosjes së tij politike në kuadër të Jugosllavisë. Në pikën e dytë, në mbështetje të parimit të demokracisë autentike mbi respektimin e vullnetit të njerëzve dhe të kolektiviteteve njerëzore e nacionale, Kuvendi i Kosovës pret definimin e këtij akti konstituiv në Kushtetutën e Jugosllavisë dhe pranimin e tij nga ana e opinionit demokratik jugosllav dhe atij ndërkombëtar. Pika 3 e Deklaratës bën avancimin e

popullit shqiptar si popull shumicë dhe njërin prej popujve numerikisht më të mëdhenj të Jugosllavisë nga pozita e kombësisë (pakicë kombëtare) në komb të barabartë me kombet e tjera të ish-Jugosllavisë. Anulimi, përkatësisht shfuqizimi i vendimit të Kuvendit të Kosovës për dhënien e pëlqimit në amendamentet kushtetuese në Kushtetutën e RS të Serbisë të vitit 1989 bëhet në pikën 4 të Deklaratës, ku theksohet se deri në zbatimin përfundimtar juridik të kësaj Deklarate Kushtetuese, Kuvendi dhe organet e pushtetit të Kosovës raportet e veta në rregullimin kushtetues të Jugosllavisë i mbështesin në Kushtetutën e RSFJ-së të vitit 1974. Në pikën 5 Kuvendi i Kosovës shpreh mospranimin e emërtimit serb të Kosovës dhe orientimin e tij që publikisht të komunikojë vetëm me emrin Kosovë. Dhe në fund, në pikën 6 thuhet se Deklarata hyn në fuqi ditën e miratimit të saj.

### Deklarata Kushtetuese – gurthemel i pavarësisë së Kosovës

Miratimi i kësaj deklarate ishte padyshim një akt me rëndësi vendimtare për historinë më të re të Kosovës e të popullit shqiptar. Ky akt politiko-juridik ishte shprehje e aspiratave të popullit të Kosovës për liri dhe mëvetësi në rrethanat e reja që po krijoheshin asokohe ndër shqiptarët dhe në gjithë rajonin e Ballkanit. Shuarja e autonomisë po shënonte fillimin e serbizimit të Kosovës dhe në të njëjtën kohë paraqiste hyrje në një periudhë tepër të rëndë për shqiptarët, të cilët po trajtoheshin jo vetëm si qytetarë të rendit të dytë, por edhe po u nënshtrroheshin torturave sistematike nga regjimi kriminal serb.

Duke qenë të vetëdijshëm për momentin historik para të cilit ndodhej Kosova, delegatët e atëhershëm të Kuvendit të Kosovës më 2 korrik të vitit 1990 miratuan publikisht (para Kuvendit të Kosovës) Deklaratën Kushtetuese me të cilën Kosova u shpall njësi e veçantë në kuadër të Federatës së atëhershme jugosllave. Ky ishte një akt historik i pritur moti dhe që shprehte aspiratat shekullore të popullit të Kosovës për mëvetësi shtetërore e territoriale nga Serbia.

Moment politik me rëndësi në ato rrethana ishte fakti se në Kosovë tashmë po vepronte një lëvizje e fuqishme demokratike shtetformuese në krye me LDK-në. Ishte kjo koha kur në horizont tashmë dukej shpërbërja e qartë e ish-RSFJ-së, krijesë kjo artificiale dhe krejtësisht antishqiptare e dominuar kryesisht nga ambicjet dhe politika hegjemoniste serbe.

Dy muaj pas shpalljes së Deklaratës Kushtetuese, që në popull njihet edhe si Deklarata e Pavarësisë, pra më 7 shtator të vitit 1990 të njëjtët delegatë nxorën aktin më të lartë juridik - Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me këtë ata edhe formalisht Kosovën e shpallën Republikë.

Por, sikundër pritej edhe në ato momente dramatike, Serbia fill pas shpalljes së Deklaratës Kushtetuese vendosi gjendjen e jashtëzakonshme në Kosovë, duke suprimuar me forcën e tankeve të gjitha institucionet e Kosovës, duke filluar nga Kuvendi e Këshilli Ekzekutiv i tij dhe deri te të gjitha institucionet e tjera shkencore, arsimore e kulturore.

Nuk ka asnjë dyshim se Deklarata Kushtetuese e 2 Korrikut e vitit 1990 shënon pikënisjen e shtetësisë së Kosovës, që do të shpjerë deri në ditët e sotme, kur Kosova tashmë gjendet në prag edhe të pavarësisë formale si shtet. Në rrethanat e tashme dhe pas përfundimit të luftës, të masakrimeve, të eksodit masiv të popullit të Kosovës e të shkatërrimeve të tmerrshme, mund të thuhet se ekziston një kontinuitet i fuqishëm i përpjekjeve të popullit të Kosovës për liri, për pavarësi e për shtetësi.

Ky kontinuitet nuk mund të mohohet nga askush dhe kjo që po përjeton tash Kosova është meritë e popullit, e atyre që për lirinë e Kosovës u angazhuan politikisht dhe ushtarakisht, e atyre që u sakrifikuan dhe që dhanë jetën për lirinë, për demokracinë dhe për pavarësinë e Kosovës. Ka kaluar një kohë e gjatë nga 2 Korriku i vitit 1990. Shumë ngjarje kanë pasuar pas saj, por unë kisha dashur t'i kujtoj lexuesit se në atë kohë kishin filluar të shihen shenjat e para të dekompozimit të ish-Jugosllavisë dhe, siç bënë të gjitha ish-republikat e ish-Jugosllavisë, edhe ne aspironim për njësi federale, edhe ne ishim të detyruar të ndërmerim hapa mbrojtës kushtetues, juridikë e politikë, në mënyrë që të jetësohet vullneti i popullit shqiptar. Qysh atëherë ishte fare e qartë se Kosova do të jetë shtet sovran dhe i pavarur. Ishte kohë e karakterizuar edhe me një lëvizje jashtëzakonisht të fuqishme politike, që rrjedhimisht ka filluar në Kosovë me paraqitjen e partive të reja politike, konkretisht të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe të partive të tjera, të cilat e artikulonin vullnetin e popullit të Kosovës. Natyrisht, delegatët e Kuvendit të Kosovës e përcjellin në mënyrë shumë të përpiktë vullnetin e popullit për Kosovën shtet sovran dhe të pavarur. Ishte kjo faza e parë e një veprimi të tillë legal të institucioneve legale në mënyrë që vullnetit të popullit t'i jepej forma kushtetuese juridike.

Nuk duhet harruar se fillimisht është paraqitur Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës me deklaratën për pozitën kushtetuese

juridike të Kosovës dhe me pozitën e shqiptarëve në kushtet e reja të krijuara. Në deklaratën e ASHAK-ut ishte formuluar shumë qartë pozicioni politik dhe kushtetues e juridik, që kërkohej për Kosovën dhe për popullin e saj. Mund të themi se rëndësia e Deklaratës Kushtetuese për atë kohë ka qenë se ka filluar përfundimisht që Kosova ta marrë një rrugë të mëvetësisë për ta përcaktuar fatin e saj dhe të popullit të vet.

Të gjitha ngjarjet që kanë ndodhur më pas kanë një lidhshmëri dhe janë pjesë e një procesi, e cila shpresoj se do të përfundojë këtë vit me pranimin e Kosovës shtet sovran dhe të pavarur nga bashkësia ndërkombëtare.

Deklarata Kushtetuese atëherë dhe sot e ka një rëndësi të veçantë, sepse e definon shumë qartë vullnetin e popullit të Kosovës. Ky ishte mesazh shumë i qartë sa i përket faktorit ndërkombëtar dhe ishte një akt që i bashkoi qytetarët e Kosovës në rrugën e tyre për pavarësi dhe për krijimin e shtetit sovran dhe të pavarur.

## Kushtetuta e Republikës së Kosovës e 7 Shtatorit 1990 (Kushtetuta e Kaçanikut)

Duke u nisur nga e drejta e vetëvendosjes, duke respektuar vullnetin sovran të popullit shqiptar të shprehur në mënyrë plebishitare në tërë Kosovën lidhur me subjektivitetin politik dhe juridik të Kosovës, e më qëllim të materializimit kushtetues të Deklaratës Kushtetuese të 2 Korrikut të vitit 1990, Kuvendi i Kosovës në mbledhjen e përbashkët të tri dhomave të tij mbajtur më 7 shtator të vitit 1990 në Kaçanik, aprovoi dhe shpalli Kushtetutën e Republikës së Kosovës me të gjitha dokumentet përcjellëse dhe nxori Ligjin e zgjedhjeve dhe mori edhe disa vendime të tjera të nevojshme për punën e Kuvendit të Kosovës dhe marrjen e vendimit në Kuvendin e RSFJ-së. Kushtetuta e Republikës së Kosovës është një akt historik me të cilin populli shqiptar realizoi aspiratat e veta historike, aspirata që gjatë pesë dekadave të kaluara u ndëshkuan dhe u inkriminuan nga pushteti serb dhe ai jugosllav.

Nxjerrja e kësaj Kushtetute shënoi kurorëzimin e kërkesave legjitime, të cilat në skenën politike jugosllave filluan të artikulohen në demonstratat masive të shqiptarëve të viteve 1968 dhe 1981, ku kërkesë parësore dhe dominante politike ishte konstituimi i Kosovës republikë me të drejta të barabarta me republikat e tjera të ish-Jugosllavisë.

Për dallim nga Kushtetuta e KSA të Kosovës e vitit 1974, Kushtetuta e Republikës së Kosovës e 7 Shtatorit të vitit 1990 përmban një

tekst mjaft të shkurtër, i cili përcakton organizim krejtësisht të pavarur politik dhe kushtetues të Kosovës. Duke u shërbyer me zgjidhjet pozitive dhe kushtetuese dhe me përvojat e shteteve demokratike të Evropës dhe botës, me Kushtetutën e Republikës së Kosovës konstituohet aso forme e rregullimit shtetëror të mbështetur në sovranitetin e popullit dhe të qytetarëve, lirinë e organizimit dhe veprimit politik të qytetarëve, pluralizmin e formave të pronës, ekonomisë së tregut dhe kushtetutshmërinë e ligjshmërinë si bazë e sistemit kushtetues dhe politik.

## Referendumi për pavarësinë e Kosovës

Pas nxjerrjes së Kushtetutës së Kosovës në vitin 1990, jetën politike në Kosovë e karakterizoi radikalizmi i dhunës serbe në të gjitha sferat e jetës. Në saje të veprimit kundërkushtetues, e duke përdorur metodat e okupimit policor, pushteti serb shkatërroi ekonominë kosovare, shëndetësinë, arsimin në të gjitha nivelet, institucionet kulturore dhe informative, e mbi të gjitha bëri largimin masiv nga puna të punëtorëve shqiptarë të punësuar në këto institucione.

Ndërkohë në truallin e ish-Jugosllavisë, si pasojë e dështimit të bisedave politike rreth përkufizimit të Federatës, filloi procesi i dezintegritimit të saj, që u realizua nëpërmjet shpalljes së pavarësisë së katër njëjësive federale, të cilat me referendume miratuan deklaratat për pavarësi dhe sovranitet të tyre. Duke u inkuorporuar në këto procese demokratike, Kuvendi i Kosovës në shtator të vitit 1990 miratoi Rezolutën për Republikën e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran dhe mori vendim që të mbahet referendumi popullor lidhur me këtë Rezolutë. Ky referendum u mbajt në Kosovë më 26 - 30 shtator 1991 dhe me shumicë absolute (mbi 99% të zgjedhësve nga 87% të trupit elektoral që votoi në referendum) u deklarua për Kosovën shtet sovran dhe i pavarur.

Referendumi popullor për Kosovën shtet i pavarur dhe sovran është një akt i vetëpërcaktimit demokratik e politik të popullit shqiptar lidhur me statusin kushtetues dhe politik të Kosovës pas shpërbërjes së Federatës Jugosllave. Duke përkrahur konceptin për Republikën e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran, populli shqiptar në mënyrë demokratike u deklarua për liri, pavarësi dhe sovranitet të plotë të Kosovës. Së këndejmi, mund të përfundojmë se ky referendum është një akt legjitim i deklarimit politik të popullit shqiptar, i cili sikur popujt e tjerë të Jugosllavisë u inkuorporua në proceset e reja demokratike që secilit

popull (pra edhe popullit shqiptar) iu krijuan kushte për realizimin e së drejtës për vetëvendosje.

Duke u mbështetur në rezultatet e referendimit të mbajtur në Kosovë, Kuvendi i Kosovës më 19 tetor të vitit 1991 shpalli Rezolutën për Republikën e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran. Me këtë Rezolutë konfirmohet deklarimi pozitiv i popullit shqiptar lidhur me sovranitetin dhe pavarësinë e Kosovës.

Rezoluta në thelb është një akt politik me të cilin konstatohet sovraniteti dhe pavarësia e Kosovës, si dhe shkëputja e kontinuitetit kushtetues të Republikës së Kosovës me ish-Jugosllavinë. Nxjerrja e kësaj Rezolute është rrjedhojë logjike e procesit të dekompozimit të Federatës Jugosllave dhe krijimit të shteteve të reja në trollin e saj. Rezoluta të ngjashme më parë nxorën republikat e tjera si Sllovenia, Kroacia, Bosnja e Hercegovina dhe Maqedonia. Në kushte kur nga Federata Jugosllave u shkëputën katër njësi federale, mbetja e Kosovës në Federatën e cunguar me Serbinë dhe Malin e Zi ka qenë e papranueshme dhe e paqëndrueshme. Hyrja even-tuale e Kosovës në kuadër të kësaj krijese artificiale qoftë edhe me status të Republikës, nuk është zgjidhje e pranueshme për popullin shqiptar, ngase ai në kushtet e Federatës së cunguar në çdo kohë i nënshtrohet majorizimit dhe politikës hegjemoniste serbe.

Duke u nisur nga kjo, përcaktimi i Rezolutës për Republikën e Kosovës shtet sovran dhe i pavarur, me pozitë neutrale dhe të hapur (ndaj Serbisë dhe Shqipërisë) është opcion real, që bën të mundshëm prosperitetin kombëtar të popullit shqiptar. Ky opcion gjithnjë e më shumë po bëhet pjesë e pandashme e vetëdijes kombëtare të popullit shqiptar, i cili të gjitha aspiratat e veta politike i lidh me sovranitetin dhe pavarësinë e plotë të Kosovës.

## Amendamentet kushtetuese në Kushtetutën e Republikës së Kosovës

Miratimi i Rezolutës për Republikën e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran krijoi një gjendje të re konstitucionale, e cila kërkon ndryshime dhe plotësime adekuate në Kushtetutën e Republikës së Kosovës të 7 shtatorit të vitit 1990. Në këtë drejtim Kuvendi i Kosovës më 19 tetor të vitit 1991 miratoi amendamentin I dhe amendamentet II-VI, me të cilat bëri ndryshimin e dispozitave adekuate të Kushtetutës së Republikës së

Kosovës. Meqenëse këto amendamente përcaktojnë zgjidhje të reja kushtetuese, me këtë rast shkurtimisht do ta analizojmë përmbajtjen e tyre.

Me amendamentin I Republika e Kosovës shpallet shtet sovran dhe i pavarur. Me këtë përcaktim ndryshohet neni 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili supozonte qenien e Kosovës në kuadër të bashkësisë jugosllave. Duke u nisur nga ky ndryshim, ky amendament ka karakter konstitutiv, sepse sanksionon zgjidhje të re kushtetuese të pozitës së Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur dhe shkëputjen e saj nga ish-Jugosllavia.

Amendamenti II aplikon institutin e Kryetarit të Republikës si shef individual i shtetit i cili merr të gjitha kompetencat e caktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Në amendamentin III përcaktohen funksionet e Kryetarit të Republikës së Kosovës. Sipas këtij amendamenti Kryetari i Republikës përfaqëson Republikën e Kosovës në vend dhe në botë dhe është komandant suprem i forcave të armatosura të saj. Krahas funksioneve të mëparshme që i kishte Kryesia e Kosovës, në pikat 6, 7, 8, 9 dhe 11 të këtij amendamenti përcakton funksionet e reja të Kryetarit të Republikës. Në alinenë e dytë të këtij amendamenti përcaktohen dis-pozitat e reja të mbrojtjes së Republikës, gjendjen e luftës dhe gjendjen e jashtëzakonshme.

Amendamenti IV përcakton kushtet dhe procedurën për zgjedhjen e Kryetarit të Republikës. Sipas këtij amendamenti Kryetarin e Republikës e zgjedhin qytetarët e Republikës në zgjedhjet e lira të drejtpërdrejta me vota të fshehta, në pajtim me ligjin. Në pikën 5 të këtij amendamenti përcaktohet se, në rastet kur ekziston gjendje lufte apo gjendje e jashtëzakonshme, Qeveria, në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin miraton dekrete me fuqi ligjore. Autorizimi i Qeverisë për të miratuar dekrete me fuqi ligjore zgjat derisa të përfundojë gjendja e luftës apo gjendja e jashtëzakonshme dhe për këtë vendos Kuvendi. Kjo zgjidhje kushtetuese ka pasur për qëllim që autorizimet e Kuvendit të Kosovës (për shkak të moskonstituimit të tij) gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme t'i bartë në Qeverinë e Kosovës, e cila autorizohet që të miratojë dekrete me fuqi ligjore.

Amendamentet V dhe VI kryesisht kanë karakter teknik, sepse përcaktojnë zgjidhje teknike që kanë të bëjnë me zëvendësimin e shprehjes “Kryesia e Republikës”, me shprehjen “Kryetari i Republikës”, si dhe përcaktojnë se për zbatimin e amendamenteve II-V do të nxirret ligji i veçantë kushtetues.

## Zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale në vitin 1992

Pas miratimit të amendamenteve kushtetuese, në Kushtetutën e Republikës së Kosovës u krijua baza kushtetuese për mbajtjen e zgjedhjeve të para demokratike, të lira dhe shumëpartiake për zgjedhjen e Kuvendit të Kosovës dhe kryetarit të Republikës.

Këto zgjedhje u mbajtën më 24 maj të vitit 1992 me pjesëmarrjen masive të popullit shqiptar, i cili për herë të parë kishte mundësinë e deklarimit të lirë për zgjedhjet e organeve kryesore të Republikës së Kosovës. Në këto zgjedhje, në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin mbi zgjedhjet, u zgjodhën 100 deputetë për Kuvendin e Kosovës, si edhe u zgjodh kryetari i Republikës. Në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet kandidatët për deputetë të Kuvendit të Kosovës u propozuan nga partitë politike, lëvizjet politike, shoqatat e qytetarëve dhe subjektet e tjera të përcaktuara me këtë ligj. Meqenëse ky ligj zbaton kombinimin e parimit të shumicës me parimin proporcional, në këto zgjedhje nga 130 deputetë sa ka Kuvendi i Kosovës, u zgjodhën 100 në bazë të rezultateve zgjedhore, kurse 30 të tjerë sipas parimit të përfaqësimit proporcional të partive politike që kanë fituar përqindje të caktuar të votave të trupit elektorale dhe përfaqësimit adekuat të partive politike që tubojnë pakicat kombëtare të cilat jetojnë në Kosovë. Zgjedhja e kryetarit të Republikës u bë në mënyrë demokratike, me votim të fshehtë. Cikli i dytë i zgjedhjeve parlamentare u zhvillua në kushtet e okupimit serb dhe në kohën kur konflikti i armatosur ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe kishte filluar në Drenicë më 22 mars të vitit 1998, me ç'rast u zgjodh Kuvendi i Kosovës dhe kryetari i saj. Mirëpo si edhe në rastin e zgjedhjeve të vitit 1992, pas këtyre zgjedhjeve nuk pasoi konstituimi i organeve dhe funksionimi i tyre sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës të vitit 1990.

## Bibliografia

1. Arsim Bajrami, “Kosova-political, international law and constitutional arguments”, bashkautor me Dr. E. Stavilecin dhe Mr. B. Reken, Prishtinë, 1996.
2. Arsim Bajrami, “Mëvetësia e Kosovës në sferën normative në periudhën 1974-1994”, disertacion i doktoratës, Prishtinë, 1995.
3. Arsim Bajrami, “Aspektet kushtetuese dhe politike të mëvetësisë së Kosovës”, Prishtinë 1996.
4. Arsim Bajrami, “Neka aktuelna pitanja u vezi sa postupkom revizije Ustava SFRJ i Ustava SRS”, Nasa zakonitost nr.5/88. Zagreb, 1988.
5. Arsim Bajrami dhe Mr.sc.Florent Muçaj, “Aspektet e ndryshimeve kushtetuese me theks të veçantë në Republikën e Kosovës”, botoi Biznesi-revistë shkencore e Kolegjit Universitar Biznesi, fq. 31-59, Prishtinë 2011.
6. Aurela Anastasi, “Historia e të Drejtës Kushtetuese në Shqipëri 1912-1939”, Tiranë, 2007.
7. “Cambridge International Dictionary of English”, Cambridge University Press, 1995.
8. Denis MacShane “Why Kosovo Still Matters”, 2011.
9. Esat Stavileci, “Çështja shqiptare në udhëkryqin e zgjidhjeve paqësore”, Prishtinë, 1995.
10. Esat Stavileci, “Fjalor Shpjegues i Termave Administrativë”, Botime të veçanta, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Prishtinë, 2010.
11. Esat Stavileci, “Çështja Shqiptare në Udhëkryqin e Zgjidhjeve Paqësore”, Prishtinë 1995.
12. Esat Stavileci “Një Këndvështrim për Pakon e Ahtisaarit”, Prishtinë 2007.
13. Fjalori Konciz i Oxfordit për Politikë”, Edicioni dytë, Oxford University Press 2003.
14. Gazmend Zajmi, “Çështja e Kosovës në kuadër të Çështjes Shqiptare si Sfidë e Madhe dhe Madhore e Kohës dhe Ndaj Kohës”, Prishtinë, Revista “E Drejta” 1/96.
15. Gazmend Zajmi, “Rrjedhat e konfliktësisë shqiptaro- serbe në rrafshin kushtetues të ish Federatës Multinacionale të Jugosllavisë”, Vjetari 1996, Prishtinë, 1996.
16. Gazmend Zajmi, “Dimensionis of the Questions of Kosova in the Balcanes, Prishtinë, 1994.

17. Greg Campbell, "The road to Kosovo", 2000.
18. Gabriel Partos, "Kosova-mënyra të reja për të ndalur një konflikt të vjetër", botuar në librin "Lufta kundër luftës", Tiranë, 2001.
19. KOSOVA - një vështrim monografik", Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë 2011.
20. Kurtesh Saliu, "Lindja, zhvillimi, pozita dhe aspektet e autonomitetit të KSAK në Jugosllavinë Socialiste", Prishtinë, 1984.
21. Luan Omari, "Kushtetuta e Republikës së Kosovës, një Vështrim Krahasues", Tiranë 2009.
22. Luan Omari dhe Dr.Aurela Anastasi "E Drejta Kushtetuese", Tiranë, 2010.
23. Marc Weller, "Shtetësia e kontestuar", KOHA, Prishtinë, mars 2009.
24. Noel Molcolm, "Të drejtat e Kosovës", botuar në librin Lufta kundër luftës, Tiranë, 2001.
25. Noel Molcolm, "Kosovo-a Short History", Macmillan, London 1998
26. Parker, Andrew N., "Decentralization The Way Forward for Rural Development", June 1995. World Bank Policy Research Working Paper. Washington, DC.
27. Osman Ismaili, "Fillet e së Drejtës", Prishtinë, 2011.
28. Post-Conflict Constitution,Drafters' Handbook,Prepared by The Public International Law & Policy Group Paul R. Williams, Executive Director Elizabeth Hahn, Post-Conflict Constitution Project Director Cassandra Tillinghast, Senior Research Associate Emily Nugent, Senior Research Associate January 2007.
29. Qerim Qerimi, "Karakterit dhe Burimet e të Drejtës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut", Revista "E Drejta", nr. 2/2010.
30. Sistemi Kushtetues dhe Sfidat e Tij"-konferencë shkencore kombëtare, boton Universiteti i Tiranës, 2011.
31. Stipe Mesiç, "Si u Shkatërrua Jugosllavia", Prishtinë 2011.
32. Shukri Rrahimi, "Vilajeti i Kosovës", Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i KSAK, Prishtinë, 1989.
33. Visar Morina, The Newly Established Constitutional Court in Post-Status Kosovo: Selected Institutional and Procedural Concerns *Review of Central and East European Law*, Volume 35, Number 2, 2010.
34. Xhezair Zaganjori, Aurela Anastasi, Eralda Qani, "Sistemi i së Drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë", Tiranë 2011.

## Akte kushtetuese dhe ligjore

1. Kushtetuta e KSA të Kosovës e vitit 1974, “Gazeta Zyrtare” e KSAK nr. 4/74/.
2. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e miratuar në Kaçanik, më 7 shtator të vitit 1990.
3. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2008.
4. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 1998.
5. Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, 2001.
6. Amendamentet kushtetuese në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të miratuara në vitin 1991 dhe 1992.
7. “Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjedhjen e Statusit të Kosovës”, shkurt, 2007.
8. Deklarata Kushtetuese e 2 Korrikut 1990, e shpallur në “Gazetën Zyrtare” të KSAK nr. 10-22/90.
9. Deklarata e Pavarësisë së Kosovës, 17.02.2008.
10. Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së.
11. Rezoluta e Konferencës së Bujanit, botuar në librin “Këshilli Popullor i Krahinës Autonome të Kosovës dhe Dukagjinit”.
12. Rezoluta e Kuvendit të Kosovës për Republikën e Kosovës shtet sovran dhe i pavarur, e miratuar pas referendumit popullor më 18 tetor të vitit 1991.
13. Rezoluta e Kuvendit të Kosovës, nr, 04-R-02.





Bujar Bukoshi

## QEVERIA E PËRKOHSHME E KOALICIONIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS (1991) PARA DHE PAS ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE DHE PRESIDENCIALE

### Përmbledhje

Qeveria e Republikës së Kosovës u formua pas disa ngjarjeve të cilat mund të cilësohen si historike. Sidomos pas themelimit të LDK-së dhe partive të tjera, në Kosovë filloi jeta politike plurale.

Pas Referendumit gjithëpopullor Kosova u shpall shtet i pavarur dhe sovran. Si konsekuencë logjike u zgjodh Qeveria e Përkohshme, si shprehje e konsolidimit shtetëror, si për rrethanat e brendshme, ashtu edhe për rrethanat e jashtme, si shprehje e përfundimit të periudhës moniste dhe ndarjes faktike nga Serbia.

Qeveria e Republikës së parë e cila veprroi në mërgim, veprroi në koordinim dhe së bashku me Presidentin Ibrahim Rugova për të kontaktuar dhe për të bindur bashkësinë ndërkombëtare në përkrahje të vendosmërisë të popullit të Kosovës dhe institucioneve të saj për pavarësi. Kosova kështu krijoi një bazë legjislative për funksionimin e shtetit të saj në kushte okupimi. Qeveria ngriti një buxhet të dyzuar nga kontributet e diasporës kosovare dhe të qytetarëve brenda Kosovës. Ajo organizoi dhe financoi arsimin shqip, jetën institucionale dhe luftën për pavarësi, si edhe zyrat përfaqësuese të Kosovës, lobimin dhe informimin. Po ashtu, ajo organizoi Forcat e Armatosura të Republikës së

Kosovës dhe bëri përpjekje të pareshtura për bashkëpunim dhe përkrahje të UÇK-së në luftën për liri.

Bashkëpunimi, njohja e hershme dhe përkrahja e shtetit shqiptar ishte një tepër e rëndësishme si për vënien e kontakteve me shumë shtete dhe organizata ndërkombëtare, ashtu edhe për përkrahje të vazhdueshme nga institucionet që vendosnin për fatin e popujve pas shpërbërjes së ish-Federatës Jugosllave. Roli i SHBA-së, Mbretërisë së Bashkuar, Gjermanisë dhe Austrisë ishte i veçantë dhe vendimtar në tërë këtë periudhë.

Qeveria e Kosovës u themelua si e përkohshme, por rrethanat e detyruan atë të mos e ndërpresë punën, edhe pse u mbajtën zgjedhjet parlamentare në maj të 1992 dhe në mars të vitit 1998, kurse në Konferencën e Rambujesë u arrit një marrëveshje për një qeveri të përbashkët. Qeveria përmbylli punën në Kosovën e lirë, duke i raportuar Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 31 janar të vitit 2000.

*Fjalë çelës:* qeveria, koalicioni, zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale, forcat e armatosura, shtetet perëndimore

## 1. Marrëveshja për themelimin e Qeverisë

Zgjedhjeve të para presidenciale dhe parlamentare i parapriu vullneti politik i subjekteve politike shqiptare për ta themeluar Qeverinë e parë, si marrëveshje plurale ndërmjet tyre. Qeveria kishte një simbolikë të fuqishme të vendosmërisë, jo vetëm për ta kundërshtuar pushtetin okupues serb, por edhe për të ushtruar një mision të caktuar të fillimit të funksionalizimit dhe ushtrimit të qeverisjes në Kosovë. Qeveria, në bashkëpunim të ngushtë me subjektet që vepronin në Kosovë dhe me Kuvendin që e kishte shpallur Kushtetutën në Kaçanik, bëri disa punë dhe veprime imediate, të cilat kishin për objektiv të krijojnë kushtet për vazhdimësinë qeverisëse pas zgjedhjeve të para parlamentare dhe presidenciale.

Propozimi për anëtarë të Qeverisë së Kosovës u bë nga Këshilli Koordinues i Partive Politike Shqiptare<sup>1</sup>, të cilin dr Bujar Bukoshi në

---

<sup>1</sup> Më 12 tetor 1991, Ibrahim Rugova, Kryetar i LDK-së, më njoftoi për propozimin e tij dhe përkrahjen e Këshillit Koordinues të Partive Politike Shqiptare që unë të zgjidhem kryetar i Qeverisë së Përkohshme të Koalicionit të Republikës së Kosovës. Në atë kohë

rolin e mandatarit e prezantoi në mbledhjen e Kuvendit të Republikës së Kosovës më 19 tetor 1991 me ç ‘rast u zgjodh Qeveria dhe Kryetari i saj.

Qeveria përbëhej nga Kryetari i Qeverisë dhe shtatë ministri<sup>2</sup>:

- Ministria e Ekonomisë dhe e Financave;
- Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës;
- Ministria e Drejtësisë
- Ministria e Informimit
- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria e Punëve të Brendshme;
- Ministria e Shëndetësisë, e Punës dhe e Mirëqenies Sociale.

Dr. Bujar Bukoshi u zgjodh Kryetar i Qeverisë dhe ministër i Punëve të Jashtme. Rolin e ministrit të Punëve të Jashtme do ta kryente deri në zgjedhjen e ministrit për këtë sektor. Isa Mustafa, ministër i Ekonomisë dhe Financave; prof. dr. Muhamet Bicaj, ministër i Arsimit, Shkencës dhe Kulturës; Halit Muharemi, Ministër i Drejtësisë; Xhafer Shatri, Ministër i Informimit. Kryeministri së bashku dhe këta ministra u caktuan të vepronin jashtë Kosovës.

Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Punëve të Brendshme dhe Ministri i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale do të vepronin në Kosovë, prandaj emrat e tyre nuk u bënë publike.

Kur, në marrëveshje me Këshillin Koordinues të Partive Politike dhe me Kuvendin e Kosovës, u përcaktua që një pjesë e Qeverisë të vepronin jashtë Kosovës, kishim parasysh kushtet me të cilat mundësohej organizimi më i mirë i punëve të Qeverisë, lëvizja e anëtarëve të saj dhe mundësia më e lehtë për kontakte me shtetet e tjera dhe institucionet ndërkombëtare. Organizimi i jetës së mirëfilltë në Kosovë bëhej edhe përmes institucioneve politike, më vonë edhe përmes atyre shtetërore në nivelet komunale. Ndarja e tillë e punës u tregua efikase dhe vepronte si një tërësi unike edhe në ndërtimin e pushtetit, edhe në koordinimin e aktiviteteve. Nuk ishte synim që partitë politike të humbin subjektivitetin e tyre, por përkundrazi, të zhvillojnë edhe më tutje

---

isha Sekretar i Përgjithshëm i LDK-së, kurse aktivisht ushtroja profesionin e mjekut, pasi kisha specializuar dhe doktoruar në Gjermani.

<sup>2</sup> Vendimi KK Numër 6/91, Prishtinë 22 shtator 1991, Burimi: ASHAK, Akte të Kuvendit të Republikës së Kosovës, 2 Korrik 1990-2 Maj 1992, Prishtinë 2005, fq. 124-131

taktikën e caktuar të tyre, me qëllim të avancimit të çështjes shqiptare. Qeveria e Republikës së Kosovës punën e vet e mbështeti në përcaktimet globale politike të Këshillit Koordinues të Partive Politike në Kosovë mbi zgjedhjen e çështjes shqiptare.

Qeveria e Republikës së Kosovës, e krijuar në tetor të vitit 1991, kishte së paku tri detyra kryesore:

E PARA, ishte veprimtaria diplomatike për sigurimin e mbështetjes për Kosovën e pavarur;

E DYTA, ishte puna me diasporën shqiptare si bazë për financimin e Republikës;

E TRETA, ishin pagesat jetike në Kosovës, sa i përket sistemit të arsimit, shëndetësisë, si edhe institucioneve paralele.

Prioritet ishte të mundësojmë mbajtjen e arsimit shqip, në mënyrë që të mos pësojnë gjeneratat e nxënësve dhe studentëve;

Ishte sigurimi i një buxheti bazë për të mundësuar funksionalitetin e fushave të domosdoshme në Kosovë;

Financimi i rrjetit të zyrave të jashtme të cilat do të ishin urë lidhëse të bashkëpunimit me vendet më të rëndësishme;

Financimi për Informimin, si element kyç për të komunikuar me qytetarët, që ishin në terr të plotë informativ në Kosovë;

Përgatitjet për luftë (e cila kishte filluar në Slloveni, zhvillohej në Kroaci dhe në Bosnjë e Hercegovinë.), e cila vetëm shtyhej, por nuk mund të evitohej edhe në Kosovë.

Formimi i një baze të nomenklaturës ligjore për ta bërë çdo veprim të institucioneve dhe të qytetarëve përgjegjës para ligjeve të Republikës së Kosovës.

## 2. Puna e Qeverisë pa përkufizim kohor

Filluam me shpresë për një periudhë të shkurtër, vepruam 9 vjet. Në takimin e parë konstitues të Qeverisë, të mbajtur në zyrën e degës së LDK-së për Gjermani, në Shtutgart, menjëherë pas zgjedhjes së qeverisë, trajtuam shumë aspekte të organizimit dhe të punëve që na pritnin. Por gjithnjë llogarisnim se periudha e veprimit jashtë Kosovës mund të zgjasë deri në tre muaj, kohë gjatë së cilës do të organizoheshin zgjedhjet në Kosovë, ku do të vepronte qeveria e cila do të dilte nga

këto zgjedhje. Në fakt, shikuar nga këndvështrimi i sotëm, ne nuk ishim të vetëdijshëm për barrën që do ta marrim mbi vete dhe për sfidat që na prisnin. Ndoshta kjo ishte edhe përparësia jonë që na mundësoi të ndër marrim shumë iniciativa dhe të hapim shumë procese, duke mos pasur përvoja dhe njohuri krahasuese, të cilat do të na shtynin të hezitojmë apo të frikësohemi. Në një situatë të tillë, çdo gjë duhej bërë nga e para, prandaj çdo veprim ishte sfidë në vete. Busullën e vetme për orientim e kishim idealin për ndërtimin e shtetit të Kosovës, i cili na jepte fuqinë dhe na orientonte të respektojmë ligjet e vendeve ku vepronim dhe ligjet tona. Zbatimi i rregullave dhe ligjeve që i kishim shpallur ishte vullnet dhe ideal.

Zgjedhjet Parlamentare dhe Presidenciale të 24 maj 1992, ishin një hap konkret i institucionalizimit të Republikës së Kosovës. Nga këto zgjedhje do të dilnin institucionet e para të shtetit të Kosovës, të cilat burojnë nga vullneti dhe përcaktimi popullor. Tjetër është se rrethanat nuk lejuan konstituimin e të gjitha organeve legjislativë dhe ekzekutive në Kosovë pas këtyre zgjedhjeve, sikurse edhe pas atyre që pasuan në mars të vitit 1998. Ishte institucioni i Presidentit të Republikës së Kosovës dhe vetë Presidenti Rugova që mori barrën themelore të drejtimit të vendit dhe qeveria që e drejtoja unë jashtë vendit. Nuk ndodhën ndryshime afatgjate në Qeveri me propozime dhe vendime nga Kosova<sup>3</sup>. As marrëveshja në procesin e Rambujesë nuk solli qeveri të re<sup>4</sup>. Pas arrestimeve në Kosovë të kuadrove që punonin në punët e mbrojtjes dhe të sigurisë (në fund të vitit 1993 dhe gjatë vitit 1994), Qeveria caktoi kolonel Ahmet Krasniqin, ministër të Mbrojtjes dhe z. Jonuz Tërstena, ministër të Punëve të Brendshme.

Armikun më të madh në punën e saj, qeveria e kishte përkohshmerinë. Në fakt, qeveria e kishte atributin e qeverisë së përkohshme, por koha se sa do të jetë ajo e përkohshme, asnjëherë nuk dihej. Kjo ushtronte ndikim thelbësor në mundësinë e afatizimeve të punëve dhe projekteve të saj. Qeveria i raportoi Kuvendit në mbledhjen e dt. 2 maj 1992, për punën e saj për periudhën 19 tetor 1991-30 prill 1992. Në këtë kohë, Qeveria i kishte bërë të gjitha përgatitjet për t'ia dorëzuar punët qeverisë që do ta pasojë pas zgjedhjeve. Në vazhdim do të prezantohen

---

<sup>3</sup> Vlen të theksohet se pas zgjedhjes së Qeverisë (tetor 1991), asaj deri në zgjedhjet e 24 majit 1992 iu bashkëngjitën edhe z. Ramush Tahiri dhe z. Nik Gjeloshi në cilësinë e zëvendësve të kryeministrit. Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Kosovë ishte dr. Adem Limani.

<sup>4</sup> Gjatë Konferencës në Rambuje u arrit pajtimi që të themelohet një qeveri e koalicionit UÇK, LDK dhe subjektet që përfaqësonte Rexhep Qosja.

disa vlerësime nga Raporti që e karakterizojnë rrethanat e themelimit të Qeverisë dhe të punës së saj deri në zgjedhjet e dt. 24 maj 1992.

Në raportin prezantuar Kuvendit<sup>5</sup> thuhet se “Qeveria e Republikës së Kosovës u formua në bazë të vullnetit të shprehur të mbarë popullit në Kosovë, nëpër tubimet e qytetarëve dhe nëpër format e organizimit politik”. Raporti sqaron se “formimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës pasoi pas disa ngjarjeve me rëndësi, të cilat, në bazë të peshës dhe momentit kur ato ndodhën, mund t’i vlerësojmë si historike. Këtu mendohet në formimin e partive politike në Kosovë me të cilat filloi jeta politike plurale, shpalljen, nga ky Kuvend, po në këtë përbërje, të Kosovës Republikë dhe Kushtetutës së saj dhe Referendumin e suksesshëm gjithëpopullor me të cilin Kosova u shpall shtet sovran dhe i pavarur. Me këtë organizim dhe veprim praktik politik është bërë kundërvënie e suksesshme politikës serbe që vazhdimisht synon të zbatohet në Kosovë. U pa e nevojshme që të zgjidhet një Qeveri që do të pasqyronte rrethanat e reja të krijuara dhe frymën pluraliste që filloi në Kosovë, por edhe që do të kishte vazhdimësinë e vijëzimit të frymës së popullit dhe të mbrojtjes së interesave të tij. Zgjedhja e Qeverisë së përkohshme ishte e nevojshme si për rrethanat e brendshme, si shprehje e konsolidimit shtetëror, ashtu edhe për rrethanat e jashtme, si shprehje e frymës pluraliste e demokratike të jetës politike në Kosovë dhe si ndarje faktike me periudhën moniste”.

Për shkak të pamundësisë që të mblidhet Kuvendi, në Qeverinë e Kosovës u bart pjesa më e madhe e kompetencave të vetë Kuvendit, të përcaktuara me Kushtetutë, gjë që ia shtoi më shumë përgjegjësinë Qeverisë për punën e saj.

Detyrat që u parashtruan para Qeverisë kishin të bëjnë me konstituimin autokton shtetëror me institucionet e veta për aq sa lejuan kushtet dhe mundësitë, si pushtet autentik i popullit në Kosovë dhe si kundërpërgjigje ndaj pushtetit serb në Kosovë. Çështja shqiptare, përkatësisht çështja e Kosovës pati një prezantim të suksesshëm në shtetet e Evropës dhe në SHBA. Në të gjitha takimet dhe bisedat, problemi i Kosovës u prezantua drejt dhe u kërkuar që të përkrahet vullneti i popullit për pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës. Që në dhjetor të 1991 Qeveria i paraqiti kërkesë zyrtare Bashkësisë Evropiane në Bruksel, për njohjen e Kosovës si shtet sovran dhe të pavarur. Kjo

---

<sup>5</sup> Raporti i Qeverisë së Përkohshme të Republikës së Kosovës për Punën e Saj në Periudhën 19 Tetor 1991-30 Prill 1992, Mbledhja e Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbajtur më 2 Maj 1992.

kërkesë iu bë edhe shteteve të veçanta evropiane, shtetit të Vatikanit dhe SHBA-së. Në të gjitha bisedat dhe takimet me autoritetet evropiane dhe amerikane u kuptua drejt çështja e jonë dhe iu dha përkrahje opsioneve dhe qasjes paqësore, demokratike për zgjidhjen e çështjes së Kosovës.

Rëndësia e takimeve dhe bashkëpunimit me Shqipërinë kishte peshë të veçantë edhe nga fakti se ishte Shqipëria që e kishte njohur Kosovën shtet sovran dhe të pavarur. Ndërkaq shumica e qeverive me të cilat u arritën kontakte kishin shprehur gatishmërinë që të njohin sovranitetin e Kosovës me krijimin e kushteve që të funksionojë pushteti faktik i saj.

Bindja jonë ishte se njohja e Kosovës, pos që duhet të jetë akt formal, ajo duhet të jetë edhe akt faktik që nënkupton largimin e forcave ushtarake dhe policore serbe dhe regjimit serb, vendosjen e pushtetit autentik të Kosovës, të identifikuar me Kuvendin dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës; që funksionimi faktik i pushtetit të Kosovës të mos përcillet me ndonjë gjakderdhje të mundshme, gjë që shtronte nevojën për punë të e mëtejme të subjekteve politike të Kosovës, por edhe angazhimin e shteteve evropiane dhe SHBA-së.

Qeveria e Republikës së Kosovës me përgjegjësi të plotë përcolli të gjitha rrjedhat dhe ngjarjet aktuale në Kosovë dhe lidhur me Kosovën, reagoi me kohë dhe ndërmori masa të nevojshme brenda mundësive dhe varësisht nga rrethanat, duke i koordinuar punët me institucionet në Kosovë dhe njëkohësisht duke i informuar institucionet përkatëse ndërkombëtare.

Qeveria ishte e interesuar të krijonjë një bazë ligjore për funksionimin e saj dhe të institucioneve në Kosovë. Ministria e Drejtësisë, punoi në hartimin e ligjeve dhe akteve të tjera ligjore për funksionimin dhe organizimin e pushtetit të Republikës së Kosovës. U arrit një bashkëpunim me shërbimet profesionale në Kosovë, me sektorin e legjislacionit dhe të gjyqësisë. U përgatitën: Dekretligji për simbolin shtetëror të Republikës së Kosovës, Dekretligji për pamjen dhe përmbajtjen e vulave të organeve shtetërore, Dekretligji për Qeverinë, Dekretligji për administratën shtetërore republikane, Dekretligji për të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të bashkësive etnike dhe nacionale, Dekretligji për dokumente të udhëtimit të shtetasve të Republikës, Dekretligji për marrëdhënien e punës dhe Dekretligji për organizimin territorial të Republikës së Kosovës dhe vetadministrimin lokal.

Pas mbylljes së shkollave shqipe në të gjitha nivelet e arsimit dhe largimit të mësimdhënësve vazhdoi të organizohet mësimi në gjuhën

shqipe sipas programeve të Republikës së Kosovës, në bazë të kushteve dhe rrethanave të krijuara. U aktivizuan tërë mekanizmat dhe format e ndryshme të veprimit të sistemit arsimor-pedagogjik dhe shkencor në territorin e Republikës së Kosovës. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës arriti ta bëjë konstituimin e të gjitha organeve, të institucioneve shkollore, pedagogjike dhe universitare. Me gjithë pengesat shumë të mëdha nga Serbia, arriti të zhvillohet mësimi në gjuhën shqipe për nxënësit dhe studentët shqiptarë, kryesisht në shtëpi private. Në organizimin e arsimit shqip dhe të shëndetësisë u bashkërendit puna me të gjitha institucionet dhe organizatat përkatëse në Kosovë që mbulonin këto fusha, me komisionet e LDK-së, komisionet e Kuvendit, Lidhjen e Arsimitarëve Shqiptarë, Entin për Botimin e Teksteve dhe Materialit Mësimor, Organizatën Bamirëse “Nënë Tereza”.

Në lëmin e shëndetësisë, gjendja vlerësohej e rëndë. Mjekët kontribuonin në mënyrë individuale, por shumica e tyre ishin larguar nga institucionet ku kishin punuar më parë. U kontaktua me "Mjekët pa kufi", organizatë nga e cila u kërkua ndihma për shëndetësinë kosovare, ndërkaq me Ministrinë e Shëndetësisë të Shqipërisë u arrit marrëveshja për bashkëpunim.

Në fushën e informimit, Qendra e LDK-së për Informim (QIK) vazhdonte me Informatorin ditor, me informata, që brenda ditës shpërndareshin edhe jashtë shtetit, me pjesë të përkthyer në gjuhë angleze dhe që faktikisht në këto kushte kryente funksionin e një agjencie informative të Kosovës. Ministria për informim nxirrte Buletinin për ngjarjet aktuale në Kosovë në tri gjuhë: angleze, frënge dhe gjermane, i cili u shpërndahej institucioneve informative dhe shtetërore ndërkombëtare. Në “Radio Zagreb” po vazhdonte të funksiononte programi dhjetëminutësh informativ në gjuhën shqipe i organizuar nga Qeveria e Kosovës. Në ndërkohë u kryen bisedimet dhe përgatitjet paraprake për projektin televiziv satelitor dyorësh në ditë, përmes Televizioni Shqiptar.

Përmes Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, pas rrënimit të sistemit ekonomik të Kosovës dhe përzënies masive të punëtorëve shqiptarë nga puna, u bënë përpjekje për organizimin e sektorit privat në Kosovë. Qeveria e Kosovës themeloi fondin e saj në të cilin u derdhën mjetet që u mblodhën në Fondin Humanitar Gjithëkombëtar. Në fillim të vitit 1992 u iniciua organizimi i sistemit të ri të grumbullimit dhe sigurimit të mjeteve për financimin e nevojave të Republikës së Kosovës.

Qeveria disa herë vlerësoi gjendjen shumë të rëndë ekonomike në Kosovë, të shkaktuar nga pushteti serb. Në harmoni me këtë u ndërmorën masa për vlerësimin e dëmeve që u shkaktuan Kosovës dhe u shpallën të pavlefshme të gjitha aktet që i nxori Serbia për tjetërsimin e pasurisë së patundshme shoqërore. Me Komisionin për Ekonomi të LDK-së u punua në prerjen e detyrimeve dhe kërkesave reciproke të Kosovës ndaj kreditorëve dhe debitorëve të jashtëm, dhe në përpilimin dhe realizimin e mekanizmave institucionalë për përballimin e skamjes ekonomike dhe hartimin e strategjisë zhvillimore, me pikënisje pavarësinë e plotë në zhvillim, ekonomi të tregut dhe intensifikim i shfrytëzimit të të gjitha resurseve materiale dhe njerëzore në funksion të dinamizimit të zhvillimit.

Përkundër raportimit në Kuvend më 2 maj 1992 dhe zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale, puna e Qeverisë në ekzil vazhdoi edhe 8 vite të tjera. U organizua dhe u konsolidua sistemi i financimit jashtë Kosovës dhe në Kosovë, u themelua “Dardania Bank” në Tiranë, u rrit përkrahja për arsimin në Kosovë, u organizua Programi Satelitor për Kosovën përmes RTV Shqiptar, u mbështet lobimi për Kosovën; u konsolidua Ministria e Mbrojtjes dhe ajo e Punëve të Brendshme dhe u mbështet lufta në Kosovë.

### 3. Buxheti nga ndihmat

Nga prizma e sotme, siç thotë një gazetar dhe publicist i njohur shqiptar është e magjishme të flitet se si u grumbulluan miliona marka e franga për t’u mbajtur në këmbë strukturat paralele në arsim apo shëndetësi, të financohen institucionet akademike apo dhe shtypi, pastaj si financoheshin luftëtarë dhe lobistë, për një dekadë e, që askush nuk mund ta përsëris më.

Qeveria që unë drejtova, e cila veproi në ekzil, dallonte nga qeveritë e vendeve të tjera që vepruan në mërgim. Ne e quanim qeveri, por qeverinë time nuk e kishin njohur asnjë nga vendet, as ato ku ne qëndronim dhe zhvillonim aktivitet, përpos Shqipërisë, e cila na priste dhe na përcillte me protokolle qeveritare. Na ndihmonte përmes diplomatëve të tyre të hapim dyert në shumë organizata ndërkombëtare dhe shtete të veçanta dhe atje ku nuk arrinim ne, ata ishin zë i Kosovës. Qeveria e Kosovës nuk ka pasur ndihma financiare nga asnjë vend dhe nga asnjë organizatë ndërkombëtare, s’ka disponuar me prona qeveritare, as me biznese qeveritare dhe aktivitete ekonomike për të krijuar të

hyra. I tërë aktiviteti qeveritar është bazuar dhe është mbuluar nga një buxhet i krijuar mbi baza të vullnetit, të solidaritetit të shqiptarëve në vendet perëndimore dhe brenda Kosovës. Ne e quanim buxhet shtetëror, kurse vendet në të cilat i grumbullonim mjetet, i cilësonin si ndihma humanitare. Pra një gërshetim i panatyrshëm i ndihmave me natyrën e veprimeve shtetërore.

Fondet e para të grumbullimit të ndihmave financiare janë hapur në Perëndim nga degët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) pas shtrirjes së saj atje, në vitin 1990. Pas fillimit të punës së Qeverisë së Kosovës të gjitha këto fonde u vetëshkrinë dhe shumat e tyre iu dorëzuan Fondit të Qeverisë. Dorëzimi i fondeve ishte edhe një shenjë e besimit të fortë të subjekteve politike për Qeverinë dhe një konfirmim i legjitimitetit të saj.

Vetë qeveria ndoqi një procedurë jo të lehtë për themelimin e fondeve të saj legjitime në Perëndim, kryesisht në Zvicër dhe Gjermani. Problemi ishte se ajo vepronte në një territor të huaj, që nuk njihte Qeverinë e Kosovës dhe grumbullimi i fondeve mund të lejohej vetëm për arsye humanitare. Regjistrimi i këtyre fondeve si fonde legale kishte shumë rëndësi, pasi zhduknin mundësinë e abuzimit me to. Fondi i regjistruar në Gjermani dhe Zvicër kishte mbikëqyrje të rreptë nga autoritetet gjermane dhe zvicerane, asnjë markë apo frang nuk mund të tërhiqej pa e justifikuar destinimin e tyre. Në Gjermani, ndihmat humanitare (Tre për qind nga pagat) që paguheshin “Fond der Republik von Kosova e.V.” ishin të zbritshme nga tatimi. Ishte kjo arsyeja juridike pse autoritetet financiare të Gjermanisë (Finanzamt) mbikëqyrnin Fondin, se bëhej fjalë për mbrojtje nga devijimi eventual i taksave gjermane.

Në arkivin e Qeverisë së Republikës së Kosovës gjenden dy vendime që rregullojnë veprimtarinë e këtyre fondeve. Vendimi Nr. 7/81 “Mbi grumbullimin e mjeteve financiare në Republikën e Kosovës” dhe “Rregullorja mbi shpërndarjen e mjeteve që janë në disponim dhe qeverisje të Republikës së Kosovës” Këto shërbenin vetëm për të krijuar një mjedis administrativ korrekt mbi fondet brenda qeverisë. Përgjegjësinë ligjore mbi to e kanë pasur autoritetet zvicerane, gjermane dhe të vendeve të tjera. Në disa raste, kur ka pasur raportime kundër (“spiunime”), ata i kanë pezulluar dhe pastaj i kanë lejuar përsëri, pasi kanë hetuar gjithçka dhe nuk kanë gjetur abuzime.

Fondi i parë që Qeveria ka hapur jashtë Kosovës, ka qenë ai i Gjenezës (Zvicër), më 20 nëntor 1991. Pastaj u hapën fonde në Gjermani, Austri, Suedi, Itali, Norvegji, Danimarkë, Francë, Holandë,

Belgjikë, Mbretëri e Bashkuar, SHBA, Australi, Finlandë, Slloveni, Luksemburg, Çeki, Kroaci dhe Shqipëri. Raporti i parë financiar iu dorëzua Qeverisë nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave, më 20 shkurt 1993. Raporti përmblihte periudhën 19 tetor 1991 deri më 31 dhjetor 1992, pra vitin e parë buxhetor. Raportet janë prezantuar çdo vit në Qeveri, kurse në vitin 2000 i është prezantuar Kuvendit të Kosovës Raporti i Punës së Qeverisë ku përfshihej në detaje edhe aktiviteti financiar nga viti 1991 deri në shtator të vitit 1999.

Qeveria arriti të harmonizojë përdorimin e mjeteve financiare me ligjet dhe rregullat në vendet perëndimore. Krijua disiplinë dhe rregull financiar, që mundësuan që gjatë periudhës nëntëvjeçare në ekzil të shfrytëzoheshin mjetet që grumbulloheshin, por duke respektuar ligjet e shteteve evropiane, të cilat kërkonin rregull, por edhe ofronin siguri për fondet dhe njerëzit që punonin në fonde. Të gjitha fondet grumbulloheshin përmes sistemit bankar, jo me para në dorë, siç ishte rasti i fondit të LPK-së, “Vendlindja thërret”. Ishte një disiplinë shumë e lartë e menaxhimit të fondeve dhe e raportimit. Gjatë nëntë viteve të veprimit të qeverisë nuk është shënuar asnjë rast i shkeljes së rregullave dhe i keqpërdorimit të mjeteve, me gjithë fushatat e shumta që janë zhvilluar ndaj fondeve dhe përgjegjësve të tyre. Lëshime nuk janë konstatuar as deri më sot, 30 vjet pas themelimit të fondeve.

Në disa raste qeveria ka pasur probleme me qeveritë në Perëndim rreth destinacionit të fondeve. Në verën e vitit 1998, pas vendimit të Grupit të Kontaktit për bllokimin e fondeve të shqiptarëve në Perëndim, qeveria zvicerane njoftoi se do të ngrinte fondin humanitar në Zvicër, gjoja si fond që grumbullon mjete dhe shërben për blerje të armatimit dhe për financim të UÇK-së. Qeveria e Kosovës reagoi përmes Isa Mustafës, ministër i Ekonomisë dhe Financave, duke shpjeguar se fondi që kishte rreth 8.000.000 franga, ishte mbështetje për arsimin shqip në Kosovë dhe se mbyllja e tij do ta rrezikonte arsimin e Kosovës. Përmes Qendrës për Informim në Gjenevë (Ministrisë së Informimit) u angazhuan avokatë për zhbllokimin e fondeve. Pikë e fortë ishte se ai fond vepronte legalisht në Zvicër, sikurse edhe në Gjermani dhe vende e tjera evropiane, si fondacion humanitar. Në këtë pikë, çdo përpjekje e drejtuesve të UÇK-së që këto fonde t’u kalonin atyre ishte jo vetëm e pamundur, por edhe e dënueshme ligjërish.

*Unë si kryeministër vendosa të merrja në telefon Carla del Ponte, atëbotë kryeprokurore e Zvicrës, që më pas u bë e famshme si prokurore e Gjykatës së Krimeve të Luftës në ish-Jugosllavi. I shpjegova asaj se ato para janë për nxënësit e Kosovës dhe nënat që lindnin në shtëpi lindjesh*

*private. “Nuk mund t’i bllokoni” i thashë ashpër. Ajo më reagoi ashpër, por disi u zbut nga fundi. Dy ditë më vonë i liruan ato para...*

Qeveria e Kosovës ka zhvilluar një sistem paralel të financimit të nevojave në Kosovë. Fillimisht është financuar arsimiti shqip, disa nevoja në shëndetësi, organet e zgjedhura në Kosovë, presidenti, bashkëpunëtorët dhe ekipi i tij, Kuvendi, QIK-u. Më vonë, në financim ka zënë peshë përgatitja për luftë dhe përkrahja e luftës për liri dhe pavarësi. Mjetet për luftë janë mbledhur me aksione të veçanta, duke mos cenuar karakterin humanitar të fondeve të Republikës së Kosovës. Qeveria e Kosovës organizoi disa herë fushata solidariteti për mbledhje fondesh. Ato ishin: Aksioni “Ndihma për Pavarësinë e Kosovës”, qershor – gusht 1998; Aksioni “Ndihmë Drenicës”, 6 mars 1998 e në vazhdim; Aksioni për shkollën shqipe, 25 gusht 1994 – 25 shtator 1994; Aksioni “Ndihma për Shqipërinë”, 17 mars 1997 – 15 dhjetor 1997; Janë grumbulluar mjete për Unionin Studentor, Sindikatën e Minatorëve, Shoqatën e ish- të burgosurve politikë. Këto aksione ishin me objektiva të veçanta dhe ndihmat e siguruar dedikoheshin vetëm për qëllimin që ishin mbledhur.

Ndihma për Pavarësinë e Kosovës, që u zhvillua me bono të donacioneve nga bashkatdhetarët u grumbulluan mjete, të cilat u orientuan për luftë. Qeveria e përkrahur nga LDK-ja, PSHDK-ja dhe subjektet e tjera shqiptare në vendet perëndimore themeloi 19 fonde, si fonde humanitare, prej të cilëve më të fuqishmit ishin fondi i Republikës së Kosovës në Gjermani dhe Fondi i Kosovës në Zvicër, të cilat siguruan mbi 80 për qind të kontributeve të grumbulluara. Për të kapërcyer problemet e transferimit të mjeteve në Kosovë, sikurse edhe për të krijuar një pikë referimi për bizneset kosovare për transaksionet e tyre financiare, në marrëveshje që Presidenti Rugova dhe unë e bëmë me Presidentin e Shqipërisë, Sali Berisha, themeluan “Dardania Bank” në Tiranë, e cila luajti një rol të madh, jo vetëm në bartjen e fondeve në Kosovë, por edhe në shërbimet financiare që ua ofroi bizneseve kosovare dhe shqiptare dhe qytetarëve që erdhën në Shqipëri pas deportimeve nga forcat ushtarake e policore serbe. Qeveria organizoi edhe aksione të veçanta të ndihmave, si atë për arsimin, për minatorët, për Shqipërinë. Një punë shumë të dobishme e ka bërë edhe Këshilli Qendror për Financim i Kosovës dhe këshillat komunalë për financim, të cilat me një organizim të mirë grumbullonin mjete në Kosovë dhe shpërndanin mjetet të cilat i pranonin nga Qeveria. Shumicën e fondeve të saj të grumbulluara në Perëndim, Qeveria i shpenzoi nëpërmjet Këshillit Qendror për Financim në Kosovë, përmes të cilit financohej arsimiti fillor, i mesëm dhe universitar, botimi i

teksteve shkollore, institucionet shkencore kërkimore dhe publikimet e tjera të këtyre institucioneve. Puna e institucioneve në Kosovë financohej drejtpërsëdrejti nga Qeveria. Pas përfundimit të punës së Qeverisë (më 31 janar 2000) mjetet e mbetura të pashpenzuara u investuan në Kosovë me vendime të drejtpërdrejta të fondeve nga shtetet perëndimore, të organizuara në Unionin e Fondeve për Rindërtimin e Kosovës (UFORK).

#### 4. Zgjidhja paqësore dhe lufta

Në të gjitha bisedat dhe takimet me qeveritarë dhe autoritete evropiane dhe amerikane në vitet deri në vitin 1995 kur Kosova nuk u bë çështje e Dejtonit, u kuptua drejt çështja e Kosovës dhe iu dha përkrahje qasjes paqësore.

Qeveria e Kosovës, edhe pse vepronte në mërgim, në një distancë fizike dhe nganjëherë edhe të boshllëkut të komunikimit me organet në Kosovë, nuk kishte probleme me qëndrimet politike nga Kosova. Presidenti Ibrahim Rugova ishte përherë konsistent dhe i qartë në pozicionimin e tij për shtet sovran dhe të pavarur, pavarësisht nga rrethanat dhe sfidat me të cilat ballafaqohej. Ishte po ashtu shumë i ndërgjegjshëm dhe vizionar në qëndrimet e tij për të ruajtur popullin nga veprimet aventureske që do të çonin në masakrime masive. Ishte i vetëdijshëm se ndarja nga Serbia nuk është e lehtë, por punonte që Kosova të ketë aleatë që do ta ndihmonin dhe lehtësonin këtë ndarje dhe pavarësimin e Kosovës. Ibrahim Rugova luajti një rol që vetëm ai mund ta bënte për ta ruajtur Kosovën nga goditja e parë fatale që mund të merrte bashkë me shembjen e Jugosllavisë. Orientimi nga Perëndimi dhe rezistenca paqësore përbënin esencën e vizionit për të cilën u përpoqëm, por pa e lënë anash edhe përgatitjen për luftë.

Kosova zgjodhi të punojë për paqe, por punoi edhe për t'iu kundërpërgjigjur luftës, nga dërgimi i njërive të para të vullnetarëve për stërvitur në Shqipëri dhe koordinimi me njësitë e mbrojtjes dhe të Punëve të Brendshme në Kosovë. Pas arrestimit të kuadrove që punonin në punët e mbrojtjes dhe të sigurisë në Kosovë, u organizua puna e Ministrisë së Mbrojtjes dhe asaj të Punëve të Brendshme jashtë Kosovës, me përfshirje të oficerëve të karrierës në suaza të Forcave të Armatosura dhe angazhimi i tyre në luftë së bashku me UÇK-në.

*Pas vendosjes së kontakteve të para me Shqipërinë, nga takimi im me presidentin e Shqipërisë Ramiz Alia, në janar të vitit 1991, si edhe më pas, me emërimin e Ali Aliut si përfaqësues i Zyrës së Kosovës në*

*Tiranë, jo përmes ndonjë marrëveshjeje zyrtare, u vendos për trajnimin e pesëdhjetedy (52) të rinjve nga Kosova në Shkollën e Bashkuar në Tiranë. Grupi që drejtohej nga Sali Çekaj, ishin kryesisht të rinj që kishin dalë në Perëndim. Trajnimi iu kushtua kryesisht njohjes dhe përdorimit të armëve të lehta automatike dhe raketave supi. Ylli Mici, një prej oficerëve shqiptarë që ka trajnuar këtë grup për gjashtë javë, nga tetori deri në mes të nëntorit 1991 shprehej: “Grupi ishte i disiplinuar dhe korrekt. Sali Çekaj ishte përgjegjësi i tyre. Nuk kemi pasur asnjë problem me ta. Pastaj, në pritje të grupit të dytë na erdhi urdhri të mbyllim kursin pasi kishin reaguuar keq disa shtete perëndimore. Asgjë nuk ishte bërë me letra dhe qeveria e mbylli në heshtje kursin”. Më tej Mici shpjegon se tridhjetë e pesë prej tyre u nisën drejt Kosovës në dhjetor të vitit 1991, duke marrë me vete armatime të rënda. Me makina të ushtrisë shqiptare ata janë ndihmuar ta çojnë armatimin deri afër kufirit, pastaj e kanë futur vetë në Kosovë.*

*Pas mbylljes së kursit të trajnimit, më 1992 u hap kampi i Labinotit në Elbasan, fshehur thellë mes maleve, ku dërgoheshin të rinj që i iknin thirrjes për rekrutim në ushtrinë jugosllave. Në maj të vitit 1993 edhe ky kamp u mbyll. Pas vitit 1994, kur një pjesë e Ministrisë së Mbrojtjes të Kosovës u vendos në Tiranë u mundësua marrja në përdorim e një reparti ushtarak ku bëhej stërvitja e dikurshme e studentëve në Mamuras, e cila u kthye në kamp trajnimi dhe qëndrimi për disa ditë nga njësitë e para ushtarake në Ministrinë e Mbrojtjes.*

Ministria e Mbrojtjes e krijuar për të vepruar në Kosovë, planifikoi një shtrirje të bashkëpunëtorëve të saj në territorin e Kosovës, në nivel qendror dhe komunal. Praktikisht u krijua një organizim ushtarak klandestin që përfshinte formacione të vogla në formën e togave me sistem koordinues me njëri-tjetrin në rast të sinjaleve për rezistencë.

Hajzer Hajzeraj ishte Shefi i Shtabit të Mbrojtjes në Kosovë, i cili mbikëqyrte këtë organizim. Por kjo strukturë u dekonspirua dhe në shtator të vitit 1993 kur një numër i madh i tyre u arrestuan nga Serbia<sup>6</sup>.

Pas shkatërrimit të kësaj strukture qeveria i ktheu sytë nga ish-ushtarakët shqiptarë që kishin braktisur ushtrinë jugosllave, kryesisht ata që kishin luftuar në Bosnjë dhe Kroaci dhe që gjendeshin në Perëndim. Kjo strukturë e re e krijuar në vitin 1994, e rigjallëroi strukturën e Ministrisë së Mbrojtjes në krye të së cilës u vendos kolonel Ahmet Krasniqi, një ushtarak i aftë e me përvojë. Në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes së Kosovës kanë qenë angazhuar 228 eprorë ku

---

<sup>6</sup> Në mesin e të arrestuarve dhe të dënuarve ishte edhe Hajzer Hajzeraj, Shef i Shtabit të Mbrojtjes, i cili u dënua me 7,5 vjet burg.

hyjnë ushtarakë të lart dhe mjekë ushtarakë të mobilizuar në luftë. Ministria e Mbrojtjes kishte hartuar një listë të detajuar të të gjithë eprorëve ushtarakë shqiptarë që kishin pranuar të ishin në dispozicion të saj. Ishin rreth 110 eprorë të lartë ushtarakë.

Qeveria krijoi një bazë logjistike në Shqipëri dhe një fond për financimin e saj, logjistike që shërbeu si bazë më vonë për krijimin e Forcat e Armatosura të Kosovës, (FARK) një institucion që komplikoi raportet me UÇK pasi kjo e fundit filloi ta kundërshtojë linjën institucionale të Kosovës. Në Shqipëri funksionuan 5 qendra stërvitore në të cilat u stërvitën shumë ushtarë dhe të cilat ishin vazhdim i praktikës së kompanisë që u trajnua në vitin 1991 në Tiranë.

Sali Çekaj ishte personi kyç që u mor me organizimin në terren të futjes së grupeve në Kosovë. Ai organizoi futjen e materialeve luftarake në Kosovë, organizimin e grupeve të vogla mbështetëse në terren dhe në secilën komunë deri në 25 vetë. Shtigjet e furnizimit ishin planifikuar prej tij, kryesisht vija Bajram Curri, Tropojë, Padesh Kroi i Ujzës deri te piramida nr.2, si dhe një shteg më i mundimshëm, Bjeshka e Dobërdolit, Qafa e Ali Qelës-Zalli i Rupës -Belle.

Si Kryeministër kisha për detyrë të shterë të gjitha mundësitë për ta bashkuar faktorin e luftës në një kulm, sepse kështu do të bëhej më i fortë, më unik dhe më i organizuar. Më 6 mars të vitit 1998 në Bon u organizua një takim me të gjithë përfaqësuesit e subjekteve politike shqiptare që vepronin në Gjermani. Nga takimi rezultoi formimi i grupit emergjent, i cili në marrëveshje me Qeverinë dhe në harmoni me presidentin e Republikës dhe subjektet e tjera politike në Kosovë, do t'i bashkërendiste aktivitetet për të mbështetur Kosovën me të gjitha format që do të kërkohej nga mërgata shqiptare. Me gjithë pajtimin e plotë, të nesërmen u tërhoqën nga marrëveshja LPK-ja dhe grupimet e afërta me ta.

*Në Maj të vitit 1998, u takova me udhëheqësit e UÇK-së në Tiranë. Mbledhja vazhdoi 9 orë. Çështja ime kryesore në takim ishte: Konflikti ka plasur, unë i respektoj njerëzit që luftojnë në terren, tani duhet të bashkohemi politikisht dhe ushtarakisht. U thashë se duhet të bashkojmë gjitha burimet për qëllimin e përbashkët. Iu ofrova financimin, oficerë dhe përkrahje institucionale. Ne duhet të kishim një Shtab Suprem të përbashkët dhe fondet që kishim grumbulluar për këto qëllime, mund t'i vinim në shërbim për luftën e armatosur. U përpoqa t'i bind për 9 orë. Ata më thanë se duhet t'ua dorëzoj atyre paratë dhe e akuzuan rëndë Ibrahim Rugovën. Qëllimi ishte të denigronin rezistencën paqësore dhe ta paraqisnin atë si tradhti. Ishin shumë larg dëshirës për bashkëpunim dhe shumë qartë dëshirës për poshtërim.*

*UÇK-ja kishte komandantë shumë trima në terren dhe ajo që unë u ofroja ishin oficerët e trajnuar nga lufta në Bosnjë dhe Kroaci. Duhej një drejtim profesional i luftës, por me sa dukej shqetësimi i tyre ishte politik. Ata nuk donin t'i jepnin kredibilitet institucioneve të Kosovës duke i përfshirë në luftë. Lufta u duhej si monopol politik. E bëmë edhe takimin tjetër në Tiranë me përfaqësues të UÇK-së më 5 korrik 1998. Këto përpjekje nuk dhanë rezultate që priteshin.*

Pasi e pa të pamundur bashkëpunimin që dëshironte me Shtabin e UÇK-së, qeveria vuri në dispozicion të Ministrisë së Mbrojtjes mjetet financiare që kishte grumbulluar në aksionin “Gjithçka për Pavarësinë e Kosovës”, një pjesë e rëndësishme e të cilave iu dha edhe Shtabit dhe njësive të UÇK-së.

Shumë oficerë profesionistë iu bashkuan luftës. Disa prej tyre si kolonel Tahir Zemaj hynë në Kosovë. U krijuan Brigadat 134, 133, dhe 131 të cilat hynë kryesisht në Rrafshin e Dukagjinit. Të tri brigadat, në krye të të cilëve u vunë eprorë ushtarakë me përvojë dhe u pajisën me armatim dhe uniforma, duke marrë urdhrin nga ministri të hyjnë në Kosovë<sup>7</sup>. Njësitë ushtarake të qeverisë hynë në Kosovë me emblema të UÇK-së për të mos krijuar konfuzion mes qytetarëve për dy ushtri. Mjetet e shpenzuara për nevoja të luftës, qoftë për njësitë e Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës (që luftonin me emblemën e UÇK-së) apo ato që iu dorëzuan shtabit dhe njësive të UÇK-së, kapërcejnë mbi 30 për qind të të gjitha mjeteve të shpenzuara nga Qeveria për 9 vjet.

Një pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së Qeverisë në fushën e mbrojtjes ishte organizimi i operacioneve humanitare dhe mjekëve për t’u përkujdesur për viktimat e luftës dhe të terrorit. Ekipet e Qeverisë së Kosovës përballuan valën e parë të refugjatëve të luftës në Tropojë në Qershor 1998, me gjithë problemet me bandat e Tropojës dhe

---

<sup>7</sup> Eprorët që u vendosën në krye të këtyre brigadave ishin, Rrustem Berisha, Sali Çekaj, Agim Ramadani, Tahir Zemaj, Kemajl Shaqiri, Nazif Ramabaja, Shaban Dragaj, Fadil Hadërgjonaj, Fahrush Thaçi, Sefedin Kuqi, Musa Gjakova, Lumni Surdulli, Esat Ademaj, Faruk Xhemajli, Zymer Luli, Sabahet Tolaj dhe Ismet Qeku. Në dispozicion të këtyre brigadave pasi u futën në Kosovë u vunë edhe edhe ushtarakë dhe profesionistë tjerë si Adem Ukhaxhaj, Skënder Rexhahmetaj, Gani Gjukaj, Shemsedin Qeku, Rrustem Tetaj, Florim Qelaj, Isuf Haklaj, Idriz Elezaj, Rrustem Bruqi, Shaban Avdimetaj, Rrok Berisha etj.

Qendra e dytë stërvitore ishte ajo e Kalimashit, ku u formua Brigada “Skënderbeu” në krye të së cilës u vendos Avdulla Shasivari si komandant brigade, dhe ushtarakët si Enver Rustemi, Fatmir Dushaku, Besnik Osmani, Xhevati Leci, Anton Ndreca dhe Esat Qolaku.

armiqësinë politike të Qeverisë së Tiranës. Qeveria financoi rrjetin e mjekëve në shërbim të luftës, një strukturë me rreth 200 mjekë të gatshëm. Qeveri po ashtu financoi shërimin e të plagosurve rëndë gjatë luftës.

Më 29 mars të vitit 1999 pas vlerësimit të gjendjes në Kosovë, Ministria e Mbrojtjes në pajtim me Qeverinë por edhe me sinjalet e pranuar nga presidenti i Kosovës, Ibrahim Rugova, shpalli mobilizimin e përgjithshëm për luftë dhe urdhëroi që të ndërmerren veprime luftarake të Brigadës 131 dhe 134 për shpërthimin e kufirit Kosovë-Shqipëri. Qeveria i la në dispozicion të luftës të gjitha mjetet e grumbulluara për këtë qëllim. Njësitë e udhëhequra nga Rustem Berisha, Sali Çekaj, Agim Ramadani dhe eprorë të tjerë ushtarakë të caktuar nga Ministria e Mbrojtjes, në disa beteja, e sidomos në Betejën e Koshares mposhtën ushtrinë serbe dhe për herë të parë u thye kufiri Kosovë-Shqipëri<sup>8</sup>.

Një kontribut jashtëzakonisht të madh në organizimin e Forcave të Armatosura i takon kolonel Ahmet Krasniqi<sup>9</sup>, ministër i Mbrojtjes, Hajzer Hajzerajt, Shef i Shtabit të Mbrojtjes Territoriale, deri në burgosjen e tij, Sali Çekajt dhe kolonel Tahir Zemajt<sup>10</sup>. Bashkëpunimi dhe angazhimi i tyre ka qenë shembull i sakrificës për Kosovën.

## 5. Disa takime të rëndësishme ndërkombëtare

Bashkëpunimi me vendet perëndimore dhe me vendet që potencialisht mund ta përkrahnin Kosovën ishte me rëndësi shumë të madhe. Janë shumë takime të realizuara së bashku me Presidentin Ibrahim Rugova, por edhe në rolin e Kryeministrit me personalitete dhe adresa të fuqishme ndërkombëtare.

Disa prej tyre dhe përmbajtjen e takimeve po i theksoj në këtë punim. Duhej të kërkonim sanksione ndaj Federatës së Serbisë dhe të Malit të Zi, të informonim komunitetin ndërkombëtar për përshkallëzimin e dhunës në Kosovë, përjashtimet nga puna, mbylljen e

---

<sup>8</sup> Republika e Kosovës, Qeveria e Republikës, Raport i Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës për Periudhën tetor 1991-dhjetor 1999, Prishtinë, janar 2000.

<sup>9</sup> Kolonel Ahmet Krasniqi, ministër i Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, i lindur në fshatin Zhilivodë të Vushtrisë, u vra tradhtisht më 21 shtator 1998 në Tiranë.

<sup>10</sup> Betejën e Loxhës e drejtoi kolonel Tahir Zemaj, në të cilën, sipas vlerësimeve të ekspertëve ushtarakë, u treguan shkathësi të larta profesionale të strategjisë luftarake, të drejtimit dhe komandimit.

shkollave... Qoftë me shkresa, siç vepruam me Këshillin e Ministrave të Komunitetit Evropian dhe veçmas me ministrin e Jashtëm gjerman Hans Ditrh Gensher, menjëherë pas themelimit të Qeverisë, qoftë në takime të drejtpërdrejta, deri me Kancelarin Helmut Kohl. Takimi i parë në Vjenë më 26 shkurt 1992 dhe takimet që pasuan më vonë me ministrin e Jashtëm të Austrisë, Alois Mock, një mik i madh i Kosovës, na ndihmuan shumë në hapjen e dyerve në Evropë.

Austria ishte e para që hapi dyert. Ministri i Jashtëm i Austrisë, Alois Mock, theu akullin duke më pritur në zyrën e tij në Vjenë më 26 shkurt 1992. Takimin, në të vërtetë, e kishte mundësuar Christine von Kohl, aktivistja e të drejtave të njeriut aq shumë e lidhur me Kosovën. Ky takim më trimëroi.

*Deri në atë moment, këdo që takoja kishte një këshillë: Bëni kujdes, bisedoni me serbët, mos hapni luftë, bëni kërkesa të moderuara, etj. Alois Mock më uli në krah të tij dhe para një tavoline të rrumbullakët më tha: Po të dëgjoj. Ja nisa t'i flas me ato formulat e bëra gati prej këshilltarëve. I thashë që shqiptarët kanë luftuar në vite për barazi me gjithë popujt e tjerë të Jugosllavisë. Tani ky shtet po prishet dhe të gjitha kombet po krijojnë shtetet e tyre. Kështu që edhe ne shqiptarët duhet të krijojmë shtetin tonë. I thashë se situata është e rëndë dhe Kosova është fuçia e barutit e Ballkanit. Mjafton një shkëndijë që aty të ndodh një kasaphanë njerëzore. I thashë se shqiptarët janë të zemëruar që janë nëpërkëmbur dhe përjashtuar nga të gjitha bisedimet për Jugosllavinë. Ia vizatova jetën e vështirë në Kosovë. Se një mijë e gjashtëqind (1600) mjekë dhe 22 mijë mësues ishin ndërkohë të papunë dhe çdo ditë po përjashtoheshin nga puna punëtorët shqiptarë. Alois Mock vuri dorën grusht mbi tavolinë, pasi kishim folur gjatë, dhe më tha se Austria do të vazhdojë të ngrejë çështjen e Kosovës në Konferencën për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë dhe do të jetë përherë e gatshme të mbrojë të drejtat e shqiptarëve atje. Pastaj si përfundoi kjo pjesa zyrtare me zë pak më konfidencial më tha: zoti Bukoshi, më jep fjalën që nuk do të dorëzoheni. Është rrugë e gjatë. Mos u dorëzoni! Kjo ishte një pikë kthese në atë që unë po e përjetoja si një proces i vështirë i hapjes së dyerve.*

Vazhduan takimet në Ankara me kryeministrin Sulejman Demirel. Ishte hera e dytë që vizitoja Ankaranë, por tashmë me kërkesën që Turqia të angazhohej në njohjen e Kosovës. E vetmja gjë që i shkëputa Demirelit ishte “Turqia nuk do ta lërë vetëm Kosovën”. Interesant ishte dhe takimi me kryetarin e Partisë Demokratike të Majtë, ish-kryeministrin Eçevit, si dhe kryetarin e Parlamentit turk,

Hysamedin Xhontyrk. Kjo ishte vizita ime më zyrtarja deri në atë kohë, me një protokoll të plotë shtetëror dhe me një vëmendje nga shtypi.

*Pas Ankarasë, i ftuar nga Senatori Bob Dole dhe Larry Pressler udhëtova për në SHBA. Disa ditë para vizitës, Senatori Bob Dole i ishte drejtuar Senatit Amerikan me një fjalim kushtuar gjendjes së shqiptarëve në Kosovë. Ai kërkoi urgjent miratimin e Rezolutës 207 rreth çështjes së shqiptarëve në Kosovë. Senatori Bob Dole theksonte: “Kjo javë shënon vitin e tretë të gjendjes së jashtëzakonshme të vendosur në Kosovë, ish- krahinë jugosllave, me një popullsi të përbërë nga 90 për qind shqiptarë. Derisa demokracia dhe liria kanë triumfuar në pjesën tjetër të Evropës Lindore, ardhja e lirisë dhe demokracisë në Kosovë është e pasigurt. Kjo është vetëm një shpresë e venitur në zemrat e dy milionë shqiptarëve, që jetojnë atje, në shtetin policor që e krijoi njeriu i dorës së fortë, Slobodan Milosheviç. Për mëse një mijë ditë, shqiptarëve iu është ndaluar e drejta për t’u tubuar dhe për të shprehur mendimin e lirë, për t’u shprehur në rrafshin politik dhe kulturor, për të punuar në paqe, për të bërë jetë normale. Për më se një mijë ditë, shqiptarët po jetojnë me mungesë ushqimi, dhe pa kurrfarë mbrojtjeje shëndetësore. Por më e keqja nga të gjitha, për më se një mijë ditë shqiptarët e Kosovës po jetojnë në gjendje frike dhe terrori absolut.”*

Xhim Xhema, biznesmeni i njohur shqiptaro-amerikan dhe për-krahës i denjë i Kosovës ishte ai që kishte ndërmjetësuar agjendën e takimeve me Senatorin Dole e Pressler. Senatori Dole ishte shumë i informuar për Kosovën. Ndonjëherë më dukej se dinte më shumë se ne. Fjalimi i tij në Senat, një javë më parë, vazhdonte të kishte jehonë të fortë në shtyp dhe në komunitetin shqiptar. Ishte shumë i detajuar me fakte dhe me një panoramë të qartë se çfarë po ndodhte. Më inkurajoi të vazhdonim betejën tonë dhe na siguroi se vëmendja amerikane ndaj Kosovës lidhej me principet e politikës amerikane, ndaj nuk duhet të ndiheshim të braktisur. Ai më tha se SHBA-ja është udhëheqëse e botës së lirë dhe shqiptarët e Kosovës i kanë kthyer sytë nga SHBA-ja për t’i udhëhequr drejt lirisë. Bob Dole më përmendi rezolutën 205, paraqitur nga Senatori D’Amato i Nju Jorkut. Sipas saj:

- SHBA-ja duhet të bënin presion për përfshirje të menjëhershme të përfaqësuesit shqiptar të Kosovës në Konferencën për Paqen të Komunitetit Evropian;

- Të dënonte qeverinë e Serbisë, me rastin e përvjetorit të tretë të vendosjes së Gjendjes së Jashtëzakonshme në Kosovë;

- Të kërkojë nga Kombet e Bashkuara që menjëherë të dërgojë vëzhgues në Kosovë për të mbikëqyrur gjendjen atje;

- Të përkrahë fuqimisht aspiratat e popullit shqiptar në Kosovë për demokraci dhe vetëvendosje.

Po kaq i përzemërt ishte dhe senatori Pressler. Sami Repishti, një nga intelektualët e shquar shqiptarë në shoqëroi në takim me Larry Pressler-in. Repishti ndërkohë ishte angazhuar si konsulent i qeverisë së Kosovës, duke e furnizuar atë me sugjerime historike dhe interpretime të historisë së shqiptarëve në takimet që kryenim. Njohuritë e tij për Kosovën ishin të plota dhe të pandikuara nga kornizat e komunizmit jugosllav dhe atij të Shqipërisë për Kosovën. Ai ishte arratisur nga Shqipëria dhe tashmë jetonte në SHBA.

Vizita në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dukej se ishte një inkurajim i madh. Senatori Pressler kishte paraqitur po ashtu një rezolutë të tijën në Senat rreth Kosovës, ku kërkonte që SHBA-ja të njihte pavarësinë e Kosovës, të sigurohet nga OKB-ja tërheqja e trupave serbe nga Kosova dhe të përfshihet Kosova në rendin e ditës së KSBE-së.

Më duhet të tërheq vëmendjen për takimet e panumërta të bëra për nëntë vjet në ekzil. Takimet e shpeshta i kam bërë bashkë me Presidentin Rugova dhe ato mund të dokumentohen lehtë. Po të flitej për të gjitha takimet, nuk do të mjaftonte një libër. Është fjala për disa nga qindra personalitete politike, kryetarë qeverish, deputetë, ambasadorë, presidentë, kryetarë të organizatave të ndryshme shumë të rëndësishme, takime në OKB, në Pentagon, fjalime në parlamente, vizita në Perëndim, shumë intervista, etj.

Me Presidentin Rugova u pritëm nga Kryetari i Parlamentit Evropian, Egon Klepseh. E njoftuam për përgatitjet për zgjedhjet në Kosovë dhe rrezikun e shpërthimit të konfliktit. Vazhduam në Konferencën e Londrës. Qëndrimet tona i prezantuam edhe para grupit special për Kosovën në Gjenevë në fund të shtatorit 1992, së bashku me akademik Gazmend Zajmin dhe Hivzi Islamin, kryetar i Partisë Fshatare. Plani dhjetëpikësh për Kosovën unifikonte qëndrimet dhe strategjinë që Rugova e thoshte në Londër në tetor të vitit 1992, “Unë kërkoj Kosovën neutrale që të jetë e hapur me Shqipërinë dhe Serbinë...” në takim me ministrin e Jashtëm Douglas Hurd, si dhe në takime me presidentin slloven Kučan dhe presidentin dhe kryeministrin e Shqipërisë, Berisha dhe Meksi. Në Washington Qeveria angazhoi kompaninë amerikane të lobimit “Ruder Finn”, e cila ndihmoi që ta prezantojë planin prej dhjetë pikash të quajtur ndryshe “Karta e të Drejtave të Kosovës”. Situata e krijuar në Washington pas deklaratës së Presidentit Xhorxh Bush, në ditën e Krishtlindjeve, se Shtetet e Bashkuara do të kundërpërgjigjeshin

ushtarakisht, nëse serbët do të fillonin ndonjë konflikt të armatosur në Kosovë, ishte një përkrahje e fuqishme për Kosovën. Kjo deklaratë u përsërit në vitin 1993 edhe nga sekretari i Shtetit, Christopher, pas ardhjes në pushtet të Presidentit Klinton. Isha me Presidentin Rugova në selinë e OKB-së në takim me nënsekretarin për çështje politike për ta njoftuar për gjendjen e rëndë në Kosovë dhe për të shprehur nevojën e pranisë më të madhe ndërkombëtare të OKB-së në Kosovë. Rugova kërkoi që trupat e Kombeve të Bashkuara dhe ato të vendeve të tjera, të autorizuar nga OKB-ja do duhej të vendosen sa më shpejt në Kosovë, për të parandaluar shpërthimin e një konflikti dhe për të mundësuar riinstitucionalizimin e jetës në Kosovë. Të njëjtat preokupime ua shprehëm edhe ndihmës sekretari Amerikan i Shtetit për Evropën dhe Kanadanë, zotin Thomas Niles dhe Komitetit të Kongresit Amerikan për Marrëdhënie me Jashtë. Vlen të veçohet edhe takimi me kryeministrin e Suedisë Karl Bild, në prill të vitit 1993 dhe fjalimi i Rugovës në Parlamentin e Suedisë. Pjesëmarrja në Konferencën e OKB-së në Vjenë në qershor të vitit 1993 dhe takimet diplomatike në Gjermani, Austri, Holandë, Turqi Mbretërinë e Bashkuar dhe Francë, si dhe në Samitin e Budapestit, ku merrte pjesë Presidenti Klinton dhe liderë të tjerë të botës, ku ishim së bashku me Presidentin Ibrahim Rugova të ndihmuar nga diplomatët e Shqipërisë. Diplomatët shqiptarë ishin krahu ynë i djathtë në shumicën e takimeve në organizatat ndërkombëtare. Nga vendet evropiane dhe nga SHBA-ja kërkohet që të përfshihet Kosova në aksionin për planin e paqes, të sigurohet një prezencë ndërkombëtare në Kosovë dhe të vazhdoen sanksionet ekonomike ndaj Serbisë derisa të gjendet zgjidhja për Kosovën. Në Kosovë u rrit pasiguria pas Marrëveshjes së Daytonit, ku Kosova mbeti jashtë vëmendjes ndërkombëtare. Ky ishte fillimi i rënies së besimit të një pjesë e popullatës në rrugën paqësore. I intensifikuam takimet me SHBA-në, Mbretërinë e Bashkuar dhe vende të tjera, sepse ishte rreziku i inkurajimit të Serbisë për ta konsideruar Kosovën pjesë të saj. Rugova në njërën anë dhe kryetari i Qeverisë në anën tjetër punuan shumë për ta frenuar normalizimin e raporteve të disa vendeve evropiane me Serbinë. Porosia ishte se nuk do të ketë paqe të qëndrueshme në Ballkan pa paqe në Kosovë, njëri në Parlamentin Evropian, duke e pranuar Çmimin Saharov, e tjetri në Washington në takim me Richard Hollbruk-un.

Më i rëndësishmi ishte takimi, që me Presidentin Rugova e kishin më 29 maj 1998 me Presidentin Klinton dhe zëvendës-presidentin Al Gore në Shtëpinë e Bardhë. Presidenti Rugova u shpreh për një prani të

shtuar të Shteteve të Bashkuara në Kosovë dhe një mbrojtje më të madhe nga Amerika për popullin e Kosovës.

Në takimet që paraprakisht kisha me udhëheqës të lartë amerikanë dhe institucione amerikane, thuhej se SHBA-ja ka përkrahur politikën paqësore, por se është e qartë se Serbia nuk po tregon vullnet për një zgjidhje të tillë.

Konferenca e Rambujesë e filluar më 7 shkurt 1999 dhe e përfunduar më 18 mars në Paris, hapi rrugën për ndërhyrje ushtarake të NATO-s dhe për çlirimin e Kosovës. Në gjithë këtë proces, politika paqësore dhe lufta e UÇK-së kanë merita të pamohueshme. Qeveria u kthye në Kosovë më 20 qershor të vitit 1999, punoi ngushtë me Presidentin Rugova pas kthimit të tij nga Italia dhe përmbylli punën më 31 janar të vitit 2000, kur të gjitha autorizimet për të qeverisur me Kosovën i mori Misioni i OKB-së në Kosovë.

## Përfundime

- Qeveria e Përkohshme e Koalicionit të Republikës së Kosovës deri në zgjedhjet e para parlamentare, së bashku me Kuvendin që shpalli Kushtetutën në Kaçanik dhe me LDK-në vuri bazat themelore normative dhe financiare të shtetit;

- Qeveria ishte e suksesshme, sidomos në inicimin dhe organizimin e aksioneve të caktuara për të neutralizuar dhe për të bllokuar masat që i ndërmernte Serbia, për ta zbatuar pushtetin e saj në Kosovë;

- Puna e Qeverisë së Kosovës ndikoi në mbajtjen e frymës optimiste në popull, që ishte e nevojshme për organizim dhe për të penguar çfarëdo aktiviteti që do të shkaktonte anarki dhe ndikoi si balancë e forcave politike në Kosovë;

- Qeveria ishte e vendosur dhe konsekuente në realizimin e vullnetit të popullit, ashtu siç ishte deklaruar ai në Referendumin për Kosovën shtet sovran dhe i pavarur;

- Bashkëpunimi i Qeverisë dhe puna me Presidentin Ibrahim Rugova ka qenë e ngushtë me gjithë propagandën për gjoja përçarjet President-Qeveri; konsistenca politike e Ibrahim Rugovës, vizioni i tij perëndimor, kujdesi për të mos rrëshqitur në luftë në fazën e pare të shpërbërjes së Jugosllavisë, ndihmuan që Kosova të fitojë përkrahje ndërkombëtare dhe të përfundojë me liri dhe pavarësi.

## Referencat

- Raporti i Qeverisë së Përkohshme të Republikës së Kosovës për punën e saj në periudhën 19 Tetor 1991-30 Prill 1992, Mbledhja e Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbajtur më 2 Maj 1992
- Republika e Kosovës, Qeveria e Republikës, Raport i Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës për Periudhën tetor 1991-dhjetor 1999, Prishtinë, janar 2000.
- Vendimi KK Numër 6/91, Prishtinë 22 shtator 1991, Burimi: ASHAK, Akte të Kuvendit të Republikës së Kosovës, 2 Korrik 1990-2 Maj 1992, Prishtinë 2005, fq. 124-131
- Dokumente personale dhe shënime.





Valentina Duka

## NJOHJA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS NGA SHTETI SHQIPTAR

### Përmbledhje

Pavarësisht nga tronditjet politike që lidheshin me kapërcimin e madh historik nga diktatura komuniste në demokraci të Shqipërisë së fillimviteve 90 të shekullit të kaluar, si qeveria komuniste e Adil Çarçanit, ashtu edhe qeveritë e tjera që e pasuan në vitet 1991-1992 (kabinetet e Fatos Nanos, Ylli Bufit, Vilson Ahmetit dhe së fundmi Qeveria Meksi), çështjen e Kosovës e kanë pasur në qendër të vëmendjes.

Nëpërmjet kësaj trajtесе modeste do të hidhet dritë mbi disa çështje që lidhen me reflektimet që kanë gjetur në politikën e Tiranës zyrtare ngjarjet e Kosovës të viteve 1990-1992, të cilat çuan në jetësimin e vullnetit të shqiptarëve të Kosovës duke e shpallur këtë të fundit republikë në kuadër të Federatës apo Konfederatës jugosllave. Duke evidentuar qëndrimin mbështetës të qeverive të Shqipërisë ndaj hapave të guximshëm që po bënte elita shqiptare e Kosovës për një status politik të ri, të merituar e dinjitoz të popullit të vet, janë vlerësuar si momente shumë të rëndësishme deklaratat përkatëse të qeverisë shqiptare (10 tetor 1991) dhe Kuvendit Popullor të Shqipërisë (21 tetor 1991) për njohjen e Republikës së Kosovës.

Kumtesa është përgatitur pas një hulumtimi të kujdesshëm të materialeve dokumentare që ruhen në arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, si dhe shtypit të kohës, botimeve të ndryshme, etj.

*Fjalë çelës:* regjimi komunist, Qeveria shqiptare, Republika e Kosovës, Ministria e Jashtme e Shqipërisë

Më 2 korrik 1990, regjimi komunist shqiptar pësoi një tronditje të madhe kur rreth 6 mijë shqiptarë u dyndën në oborret e ambasadave të huaja në Tiranë. Kriza e ambasadave ishte tronditja më e thellë që kishte pësuar shoqëria komuniste shqiptare dhe lëkundjet që ajo shkaktoi, nuk kishte si të mos ndiheshin edhe në rangjet e larta të PPSH-së. Ndërkohë që në Shqipëri zhvilloheshin këto ngjarje, në Jugosllavi kishte nisur procesi i shpërbërjes së saj. Ky proces afektonte pothuajse gjysmën e kombit shqiptar që i ishte lënë padrejtësisht jashtë Shqipërisë që në fillimet e shek. XX.

Pavarësisht nga problemet e brendshme politike në Shqipërinë e asaj kohe, në kapërcimin e madh historik nga komunizmi në demokraci (vitet 1991-1992), si qeveria komuniste shqiptare e Adil Çarçanit fillimisht, qeveria socialiste jetëshkurtër e Fatos Nanos, qeveria e Stabilitetit e Ylli Bufit, qeveria teknike e Vilson Ahmetit dhe së fundi, qeveria e Aleksandër Meksit, e kanë pasur në qendër të vëmendjes çështjen e Kosovës. Për këtë flet edhe fakti që në Arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, gjenden një numër i konsiderueshëm raportesh për situatën në Kosovën e atyre viteve, për veprimtarinë e partive politike kosovare dhe programet e tyre, për diasporën kosovare, për veprimtarinë e intelektualëve kosovarë, për politikën e qeverisë shqiptare në lidhje me çështjen e Kosovës etj. të përgatitura për qeverinë nga funksionarë të ministrisë apo titullarë të përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë në vendet ballkanike dhe evropiane.

Por ndryshe nga kabinetet pasardhëse, edhe pse e mbështeste zgjidhjen e çështjes së Kosovës me rrugë paqësore, qeveria komuniste e Adil Çarçanit që ekzistoi deri në shkurt 1991 ishte e ngurtë në reforma dhe kishte pak hapësira ta mbronte ndërkombëtarisht këtë çështje. Prandaj edhe intelektualët kosovarë, sipas njoftimeve diplomatike të kohës, ishin të shqetësuar për hapat e ngadalshme të Shqipërisë së viteve 90 në drejtim të demokratizimit të vendit. Për këtë arsye, edhe vetë Ibrahim Rugova drejtuesi i LDK-së dhe udhëheqësi i lëvizjes për të drejtat politike të popullit shqiptar në Kosovë, në një intervistë dhënë Zërit të Amerikës më 8 korrik 1990, kërkonte që proceset demokratike në Shqipëri të përshejtoheshin, sepse mendonte se një Shqipëri demokratike mund të kishte më shumë hapësira ndërkombëtare për të mbështetur Kosovën sesa një Shqipëri komuniste.<sup>1</sup>

Sigurisht me hyrjen e Shqipërisë në epokën e tranzicionit demokratik, me pranimin e saj në Këshillin për Siguri dhe Bashkëpunim

---

<sup>1</sup> *Arkivi Historik MEPJ*, 1990, dosja 1145, 10.11.1990. f. 4.

Evropian (KSBE) në qershor 1991, me vizitën e sekretarit amerikan të shtetit James Baker po në qershor 1991, u krijuan kushte favorizuese kombëtare dhe ndërkombëtare që qeveria shqiptare të ngrinte zërin më fort në mbështetje të Kosovës.

Parlamenti i parë pluralist i dalë nga zgjedhjet e 31 marsit 1991, në seancën e 30 prillit, votoi rezolutën e parë për Kosovën.<sup>2</sup> Mes të tjerash, në këtë dokument thuhej:

*“Shovinizmi serbomadn nuk po kufizohet vetëm në shkeljet e rënda e sistematike të të drejtave elementare të shqiptarëve, me burgosjet, deportimet e vrasjet e tyre, por ka marrë revansh në zhdukjen e autonomisë. Ky shovinizëm ka vendosur këto ditë të shkojë më tutje: të bëjë rajonizimin e Kosovës në mënyrë që miti i tij mesjetar të marrë përfundimisht fytyrë reale, duke çuar deri në fund krimin më të shëmtuar kundër njerëzimit, atë të gjenocidit kundër rreth 3 milionë shqiptarëve në trojet e tyre. Mirëpo dihet se populli shqiptar i Kosovës e ka shprehur qartë vullnetin e tij sovran në vendimet e Kuvendit të Kosovës më 2 korrik 1990. Ai me këtë akt nuk kërkon asgjë më shumë nga sa kanë popujt e tjerë sllavë në Jugosllavi.”<sup>3</sup>*

Më 8 korrik 1991 presidenti i fundit komunist shqiptar, Ramiz Alia u dërgoi telegrame presidentit amerikan Bush,<sup>4</sup> kryeministrit anglez Major,<sup>5</sup> presidentit kinez Shangkun,<sup>6</sup> presidentit të Komisionit Evropian Delors.<sup>7</sup> Në këto telegrame me të njëjtin tekst theksohej:

*“Republika e Shqipërisë dhe populli shqiptar ndjekin me vëmendje dhe shqetësim të madh zhvillimin e situatës në Jugosllavi. Ata janë bashkuar tërësisht me përpjekjet që shtetet evropiane dhe Fuqitë e Mëdha po bëjnë për të arritur një zgjidhje paqësore dhe demokratike të krizës në Jugosllavi. Zyrtarisht kemi deklaruar dhe e ritheksojmë edhe një herë kundërshtimin tonë ndaj çdo përdorimi të forcës me bindjen se kjo nuk mund të jetë kurrësi mjet për zgjidhjen e krizës jugosllave. Në të njëjtën kohë ne mbështesim çdo përpjekje për dialog midis të gjitha palëve pa përjashtim, lidhur me të ardhmen e Jugosllavisë, të drejtën për vetëvendosje, respektimin e të drejtave të njeriut, duke u mbështetur në parimet e mishëruara në Aktin Final të Helsinkit, Kartën e Parisit për një Evropë të Re, dokumentet e tjerë të KSBE<sup>-së</sup> dhe Kartës së Kombeve të*

<sup>2</sup> Po aty, 1991, dosja 1606, 30 prill 1991.

<sup>3</sup> Po aty.

<sup>4</sup> Po aty, viti 1991, dosja 1613, f.16-17.

<sup>5</sup> Po aty, f. 12-13.

<sup>6</sup> Po aty, f. 18-19.

<sup>7</sup> Po aty, 22-23.

*Bashkuara...Përballë këtij realiteti, Republika e Shqipërisë nuk mund të heshtë. Ne e ndjejmë të nevojshme të theksojmë rëndësinë që ka në këto momente angazhimi serioz i shteteve pjesëmarrëse në KSBE, i Komunitetit Evropian, i Fuqive të Mëdha dhe i tërë komunitetit ndërkombëtar për të parandaluar këtë konflikt të rrezikshëm që kërcënon paqen dhe sigurimin në shkallë ndërkombëtare.”<sup>8</sup>*

Gjithashtu në takimet ndërkombëtare, bilaterale dhe ato multi-laterale i ishte dhënë mbështetje nga diplomacia shqiptare të drejtës së Kosovës për të marrë pjesë në bisedimet për të ardhmen e Jugosllavisë, për t’i dhënë asaj status të barabartë me kombet e tjera në Jugosllavi, si dhe të drejtës së saj për vetëvendosje. Në raportet e Ministrisë së Jashtme Shqiptare të verës së vitit 1991 bëhej e ditur se udhëheqësit kosovarë ishin ndihmuar që të vendosnin kontakte me vende të tjera si dhe me KSBE-në. Komunitetit Evropian dhe Fuqive të Mëdha u ishte kërkuar angazhim serioz për të parandaluar një konflikt në Kosovë, si dhe për një zgjidhje të drejtë e paqësore të çështjes shqiptare në Jugosllavi.<sup>9</sup>

Çështja mjaft e ndjeshme e njohjes gjithashtu të Republikës së Kosovës nga qeveria shqiptare, u kthye në një diskutim të madh medi- atik dhe politik në Shqipërinë e viteve 90. Informacionet që vinin nga terreni në Kosovë, ku situata po bëhej më e vështirë, e rrisnin presionin mbi institucionet qeveritare shqiptare për njohjen e Republikës së Kosovës. Në këto informacione shpjegohej me hollësi gjendja në Kosovë. Sipas diplomatëve shqiptarë, elitat e reja politike të shqiptarëve të Kosovës po organizoheshin brenda dhe jashtë vendit në mbrojtje të të drejtave të popullsisë kosovare.

Në njërin prej raporteve të përgatitur nga Ministria e Jashtme e Shqipërisë vihej në dukje shprehimisht se *“në kushtet kur popullsia e paarmatosur shqiptare e Kosovës ndodhet përballë masakrimit të mundshëm, udhëheqësit kosovarë dhe partitë politike u kanë bërë thirrje organizatave ndërkombëtare, KSBE-së, parlamenteve të vende- ve evropiane, etj., të shtojnë presionin e tyre për të ndalur terrorin e dhunën serbe në Kosovë; Komunitetit Evropian dhe Këshillit të Minis- trave të Bashkësisë Evropiane u kërkohet të bëjnë gjithçka që në bise- dimet e ardhshme për rregullimin e marrëdhënieve midis popujve të Jugosllavisë të ftohen edhe shqiptarët, të shqyrtohet problemi i Kosovës dhe i shqiptarëve në Jugosllavi në të gjitha dimensionet si vullnet i një*

---

<sup>8</sup> Po aty.

<sup>9</sup> Po aty, dosja, 1606, viti 1991, gusht, f.247-248.

*populli që kërkon të jetë i barabartë me të gjithë popujt e tjerë që jetojnë në këtë vend”.*

Më tej, kërkohej që komuniteti ndërkombëtar të dërgonte vëzhgues në Kosovë për të parandaluar masakrën ndaj popullsisë shqiptare. Theksohej gjithashtu se faktori politik shqiptar përballë tensionimit gjithnjë e më shumë të situatës politike në vend, po bënte hapa pozitivë drejt bashkëpunimit e bashkërendimit të veprimtarisë së tij në shërbim të çështjes së Kosovës. Domethënës në këtë drejtim ishte fakti se më 22 korrik 1991, partitë kryesore të shqiptarëve të Kosovës, LDK-ja, Partia Parlamentare, Partia Fshatare, Partia Kristiane-Demokrate, Partia Socialdemokrate dhe Partia Republikane, krijuan Komitetin e Përbashkët Koordinues me synim përpilimin e një platforme dhe strategjie të përbashkët për realizimin e aspiratave të popullsisë shqiptare. I njëjti dokument vijonte më tej:

*“...janë shtuar kërkesat për konsolidimin e ish-Kuvendit të Kosovës, zgjedhjen e qeverisë së koalicionit dhe formimin e Këshillit të Shpëtimit Kombëtar të Shqiptarëve, i cili do të shërbejë si trup udhëheqës dhe do të organizonte mbrojtjen e armatosur të popullsisë shqiptare. Ndërkohë emigracioni shqiptar po deklarohet i gatshëm që në rast lufte të armatosur të kthehet në Kosovë i organizuar për luftë mbi baza vullnetare. Kështu, më 28 korrik të rinjtë shqiptarë që jetojnë në Belgjikë formuan brigadë vullnetare për mbrojtjen kombëtare, e cila është e gatshme që në çdo moment të nisët në Kosovë për mbrojtjen e trojeve shqiptare.”<sup>10</sup>*

Është e vërtetë se ka pasur dilema të mëdha për njohjen e Republikës së Kosovës nga qeveria shqiptare. Hezitimet për të hedhur një hap të tillë lidheshin me kujdesin për të respektuar të drejtën ndërkombëtare. Sipas zyrtarëve të shtetit shqiptar, për të sqaruar statusin aktual të Kosovës dhe për të dalë me konkluzionet e duhura për qëndrimet politike të qeverisë, duhej të kihej parasysh kronologjia e ngjarjeve në Kosovë, si dhe teoria e praktika ndërkombëtare në fushën e njohjes së shteteve të reja.

Kronologjia e zhvillimeve politike në Kosovën e asaj kohe ishte mjaft interesante. Rëndësia dhe densiteti i ngjarjeve ishte mbresëlënëse. Këto zhvillime janë reflektuar në këtë mënyrë në burimet diplomatike shqiptare të kohës:

*“Në bazë të Kushtetutës së vitit 1974 të RPFJ, Krahuina Autonome e Kosovës njihet si element konstitutiv i Federatës Jugosllave. Kuvendi i*

---

<sup>10</sup> Po aty.

*Serbisë duke tejkeluar kuadrin juridiko-konstitucional federativ e anuloi këtë status me Kushtetutën e re të Serbisë të miratuar në mars të vitit 1989 (e cila u pasua nga një kushtetutë tjetër në tetor 1990), si dhe me ligjet e veçanta për Kosovën të quajtura “ligje për rrethana të posaçme”, të miratuara në qershor të vitit 1990. Më 2 korrik 1990, si reagim ndaj tyre dhe shprehje legjitime e vullnetit të popullit kosovar, Kuvendi i Kosovës shpalli Deklaratën për konstituimin e Kosovës si Republikë brenda federatës apo konfederatës jugosllave. Më 5 korrik 1990 në mënyrë antikushtetuese dhe me shumicë vote, Kuvendi i Serbisë pezulloi dhe shpërndau Kuvendin e Kosovës dhe qeverinë e saj. Më pas, nëpërmjet një veprimtarie sistematike antiligjore, shkatërroi tërë strukturën autonome juridiko-institucionale të Kosovës. Më 7 shtator 1990, në Kaçanik, Kuvendi i Kosovës miratoi dhe shpalli Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në të cilën sanksionohet se “Republika e Kosovës si shtet është anëtare e Bashkësisë së Jugosllavisë” (neni 2).<sup>11</sup>*

Duke iu referuar këtij historiku si dhe të drejtës ndërkombëtare, diplomatët shqiptarë i sugjerorin qeverisë shqiptare në korrik 1991, se nuk mund të bëhet fjalë për njohjen e Republikës së Kosovës nga ana e shteteve të tjera, përfshirë këtu edhe shtetin shqiptar. Një gjë e tillë duhet të bëhej sikurse thuhet edhe në vetë Deklaratën Kushtetuese të Kuvendit të Kosovës të 2 Korrikut 1990 nga shteti jugosllav nëpërmjet Kushtetutës Federative.<sup>12</sup>

Në lidhje me qëndrimin e qeverisë shqiptare diplomatët sugjerorin që “*njohja e Kosovës mund të kalojë nëpërmjet dy fazash njohjes de facto, që është një njohje jo e plotë dhe jopërfundimtare dhe de jure, që është njohje e plotë përfundimtare e që shoqërohet si rregull me vendosjen e marrëdhënieve diplomatike dhe zhvillimin e gjithë anshëm të marrëdhënieve në fusha të ndryshme*”.<sup>13</sup>

Megjithatë, diplomatët shqiptarë rekomandonin që organet shtetërore, shtypi, partitë politike, personalitete të ndryshme politike, mund të afirmonin se shpallja e Republikës së Kosovës, më 2 korrik 1990 dhe Kushtetuta e miratuar në Kaçanik më 7 shtator 1990 janë akte që shprehin vullnetin e popullit shqiptar të Kosovës për t’u organizuar në formën që ai e ka gjykuar më të përshtatshme. Për të përgatitur opinionin brenda e jashtë vendit, termat “Republika e Kosovës”, “Kuvendi

---

<sup>11</sup> *Po aty*, dosja 1606, viti 1991, f. 245.

<sup>12</sup> *Po aty*, dosja 1606, viti 1991, f. 246.

<sup>13</sup> *Po aty*.

i Kosovës”, “Qeveria e Republikës së Kosovës”, mund të përmendeshin në raste të ndryshme.<sup>14</sup>

Por pas referendumit të 26 shtatorit 1991 në Kosovë, ndoshta nga presioni i brendshëm apo nga ndonjë sinjal ndërkombëtarë deri tani i panjohur nga ana jonë, në mënyrë të papritur qeveria e Ylli Bufit, më 10 tetor 1991, ndryshon qëndrim dhe deklaron njohjen e Republikës së Kosovës shtet sovran dhe të pavarur. Në deklaratën e qeverisë shqiptare ndër të tjera, thuhet: “*Qeveria e Republikës së Shqipërisë priti me kënaqësi dhe përshëndet përzemërsisht Rezolutën e Kuvendit të Kosovës me të cilën Kosova shpallet sovranë dhe e pavarur me të drejtë të pjesëmarrjes konstitutive në lidhjen e shteteve dhe republikave sovranë në Jugosllavi. Ky vendim historik është rezultat logjik i përpjekjeve shumëvjeçare të popullit shqiptar në Kosovë për liri, drejtësi dhe barazi. Ai konfirmoi vullnetin e lirë e aspiratat kombëtare të shqiptarëve për të vendosur vetë për fatin e tyre, në përputhje të plotë me dokumentet e pranuar nga KSBE-ja dhe OKB-ja për vetëvendosjen e popujve.*

*Shpallja e Kosovës shtet sovran e i pavarur, vijon më tej deklarata, është një kontribut i rëndësishëm i popullit shqiptar në Kosovë për zgjidhjen paqësore e me mjete demokratike të krizës jugosllave. Ky akt përputhet me proceset pozitive demokratike që kanë përfshirë disa republika në Jugosllavi, i shërben vendosjes së paqes reale e të qëndrueshme në këtë vend dhe stabilitetit e sigurisë në Ballkan dhe Evropë. Duke njohur Republikën e Kosovës shtet sovran e të pavarur, Qeveria e Republikës së Shqipërisë, deklaron se është gati të vendosë marrëdhënie diplomatike me të dhe të japë mbështetjen e nevojshme për konsolidimin e pavarësisë. Ajo shpreh dëshirën e veçantë për zhvillimin e marrëdhënieve vëllazërore midis shqiptarëve që jetojnë në Shqipëri e në Kosovë. Qeveria e Republikës së Shqipërisë ka bindjen se vendet e tjera të KSBE-së e të Komunitetit Ndërkombëtar do të mbështesin shtetin e pavarur të Kosovës, duke e pranuar si partner të barabartë në familjen e shteteve sovranë, bazuar në parimet e lirisë dhe të demokracisë.”<sup>15</sup>*

Pas njohjes nga qeveria shqiptare, edhe Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë miratoi një deklaratë më 21 tetor 1991 ku shprehej për njohjen e Kosovës Republikë.

<sup>14</sup> Po aty.

<sup>15</sup> Po aty. viti 1991, dosja 1601, f. 138.

“Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë, thuhej në deklaratë, u njoh me rezolutën e shpallur nga Komisioni Qendror i Kuvendit të Kosovës, ku shprehet sukcesi i plotë i referendumit për miratimin e rezolutës së këtij kuvendi, nëpërmjet së cilës Republika e Kosovës përcaktohet si shtet sovran dhe i pavarur, mbi bazën e lirisë dhe të barazisë së plotë me të gjithë popujt e tjerë. Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë e quan rezolutën plotësisht të drejtë, legjitime dhe të mbështetur në parimet e dokumenteve themelore demokratike ndërkombëtare siç janë karta e OKB-së, Akti Final i Helsinkit dhe Karta e Parisit. Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë e njeh Republikën e Kosovës, thuhet ndër të tjera në deklaratë, si shtet sovran dhe të pavarur, mbi bazën e lirisë dhe barazisë së plotë me të gjithë popujt e tjerë. Ai njeh, gjithashtu, si legjitime Qeverinë e re të Përkohshme të Republikës së Kosovës nën drejtimin e dr. Bujar Bukoshit. Ai u bën thirrje opinionit demokratik ndërkombëtar dhe shteteve pjesëmarrëse të KSBE-së që të njohin dhe respektojnë vullnetin e ligjshëm të popullit shqiptar të Kosovës. Kjo do të ishte një provë tjetër e angazhimit të tyre të sinqertë e pa paragjykimë për zgjidhjen e drejtë të krizës jugosllave.”<sup>16</sup>

Kjo Deklaratë iu shpërnda të gjitha përfaqësive të huaja në Tiranë. Më 31 tetor 1991, qeveria e Kosovës vendosi “..hapjen e përfaqësive të Republikës së Kosovës në Republikën e Shqipërisë, me seli në Tiranë, pranë Muzeut Kombëtar”. Më 30 nëntor 1991, u hap në Tiranë edhe Zyra e Informacionit e Kosovës. Pas këtyre akteve diplomatike, Qeveria Shqiptare rrit ritmet e forcimit të marrëdhënieve me Kosovën. Viti 1991, nuk ishte vetëm viti i njohjes së Kosovës Republikë, por edhe i përpjekjeve për shtimin e marrëdhënieve tregtare, shkencore intelektuale, kulturore, artistike, turistike, etj., midis Shqipërisë dhe Kosovës.<sup>17</sup> Pas zgjedhjeve të para pluraliste në Kosovë më 24 maj 1992, nga ku doli parlamenti i parë pluralist i saj, Kuvendi i Shqipërisë më 1 qershor 1992, riafirmoi edhe një herë njohjen e Republikës së Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran.<sup>18</sup>

Me ardhjen në pushtet të Partisë Demokratike më 22 mars 1992, Qeveria Meksi bëri përpjekje të mëdha diplomatike për theksimin e domosdoshmërisë së marrjes së masave për parandalimin e shpërthimit të konfliktit në Kosovë, si dhe të domosdoshmërisë së vendosjes dhe vazhdimin të dialogut politik midis përfaqësuesve të ligjshëm të popullit shqiptar dhe autoriteteve në Kosovë për negociimin e një zgjidhjeje paqësore politike të krizës.<sup>19</sup>

---

<sup>16</sup> Gazeta “Zëri i Popullit”, 22 tetor 1991.

<sup>17</sup> Arkivi Historik i MEPJ, viti 1991, dosja 1601, f. 8.

<sup>18</sup> Po aty.

<sup>19</sup> Po aty, viti 1992, dosja 1122.

Veprimtaria diplomatike e qeverisë shqiptare për mbrojtjen e çështjes kombëtare në përgjithësi dhe për problemin e Kosovës në veçanti, u përqendrua në dy drejtime kryesore: a. *në theksimin e domosdoshmërisë së marrjes së masave për parandalimin e shpërthimit të konfliktit në Kosovë*, dhe b. *në theksimin e domosdoshmërisë së vendosjes dhe vazhdimit të dialogut politik midis përfaqësuesve të ligjshëm të popullit shqiptar dhe autoriteteve në Kosovë për negociimin e një zgjidhjeje paqësore politike të krizës.*<sup>20</sup>

Për çështjen e parë, pra, për parandalimin e një konflikti të mundshëm në Kosovë, diplomacia shqiptare në kuadrin e KSBE-së, kishte kontribuar në realizimin dhe konkretizimin e angazhimeve të vendosura në Samitin e Helsinkit. Në përputhje me këto angazhime, ishte arritur që nga data 11 tetor të vendosen në Kosovë misionet afatgjata të KSBE-së. Kjo do të thoshte se ishte realizuar një nga synimet e Tiranës zyrtare për të siguruar praninë ndërkombëtare në Kosovë. Veprimtaria e Misioneve në fjalë zhvillohej në pajtim me mandatin e përcaktuar duke raportuar për çdo incident që ndodhte në vend. Një zhvillim tjetër i rëndësishëm në aspektin e forcimit të monitorimit ndërkombëtar në Kosovë ishte edhe vendimi i marrë për të dërguar pesë anëtarë të Misionit Monitorues të Komunitetit Evropian në misionet afatgjate që ishin vendosur në Kosovë, Sanxhak dhe Vojvodinë.<sup>21</sup>

Ndërsa në kuadrin e NATO-s, sipas burimeve të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, qeveria shqiptare bëri përpjekje të mëdha që kjo organizatë gjithashtu të angazhohej për parandalimin e konfliktit në Kosovë, megjithëse kontaktet me këtë të fundit ishin në fazën e tyre fillestare. Sipas raporteve të diplomatëve shqiptarë, *“gjatë kontakteve të vendosura me këtë organizatë, duke pasur parasysh edhe specifikën e saj si një organizatë ushtarake, është prezantuar për herë të parë problemi i Kosovës, duke bërë demarshet e nevojshme që NATO-ja të angazhohej për parandalimin e konfliktit. Megjithëse kontaktet janë vendosur së fundi dhe janë në fazën e tyre fillestare, nuk ka kaluar pa sjellë rezultatet e veta.”*<sup>22</sup>

1. *NATO-ja ka vendosur të dërgojë trupat e veta detare në ujërat tona territoriale për të bashkëpunuar me forcat tona ushtarake për të mbikëqyrur zbatimin e embargos kundër Jugosllavisë. Këtu mund të shtojmë edhe vizitat e anijeve të një sërë shteteve të NATO-s si SHBA-së, Anglisë etj.*

<sup>20</sup> Po aty.

<sup>21</sup> Po aty.

<sup>22</sup> Po aty.

2. Në dokumentet e miratuara në takimet e nivelit të lartë të NATO-s situatës në Kosovë i është kushtuar një vëmendje e veçantë duke e konsideruar atë si të rrezikshme dhe është vënë në dukje nevoja e marrjes urgjente të masave parandaluese për të evituar shtrirjen e konfliktit në këtë rajon.<sup>23</sup>

Arritje të rëndësishme diplomatike të qeverisë shqiptare për çështjen e Kosovës u shënuan edhe në kuadër të OKB-së. Për herë të parë në mbledhjen e jashtëzakonshme të 29 nëntor-1dhjetorit 1992 të Komisionit për të Drejtat e Njeriut të OKB-së, të dënohej diskriminimi i popullit shqiptar në Kosovë dhe t'i kërkohej Serbisë të ndalonte politikën e spastrimit etnik. *“Theksojmë se pas 40 vjet veprimtarie të diplomacisë së diktaturës së kuqe, në mbrojtje të popujve të Botës së Tretë, thuhej në një dokument arkivor të Ministrisë së Jashtme, kjo rezolutë përfaqëson rastin e parë kur OKB-ja me një dokument zyrtar të saj (jo me fjalimet e kryetarit të delegacionit shqiptar) përmend problemin e Kosovës duke dënuar politikën serbe.”*<sup>24</sup>

Në kuadrin e Konferencës Ndërkombëtare mbi ish-Jugosllavinë, përfaqësuesit shqiptarë kanë zhvilluar një veprimtari aktive në Grupin e Posaçëm për Kosovën. Një moment të rëndësishëm përbën edhe vizita e bashkëkryetarëve të kësaj Konference në Tiranë, me ç'rast pala shqiptare vuri në dukje nevojën e një angazhimi më serioz të Konferencës për bisedimet e filluara në Prishtinë dhe nënvizoi faktin se sanksionet ndërkombëtare kundër Jugosllavisë, megjithëse janë vendosur kryesisht për shkak të situatës në Bosnjë e Hercegovinë, duhet të hiqen vetëm pasi të jetë zgjidhur problemi i Kosovës.<sup>25</sup>

Në fund të kësaj parashprese mund të pohohet pa mëdyshje se vitet 1991-1992 shënojnë një nga segmentet më të ndritura të historisë së luftës së popullit shqiptar dhe elitës politike në Kosovë për të drejtat e tyre politike legjitime dhe të kundërshtimit të vendosur të shtypjes serbe.

Një tjetër përfundim i rëndësishëm që mund të formulohet me këtë rast është edhe fakti se çështja e Kosovës ka qenë vazhdimisht në fokus të vëmendjes dhe interesimit të qarqeve zyrtare dhe politike të Republikës së Shqipërisë.

---

<sup>23</sup> Po aty.

<sup>24</sup> Po aty.

<sup>25</sup> Po aty.



Ksenofon Krisafi

## DEKLARATA KUSHTETUESE E 2 KORRIKUT DHE KUSHTETUTA E KAÇANIKUT NE VËSHTRIMIN JURIDIKO-NDËRKOMBËTAR

### Përmbledhje

Përpjekjet e shqiptarëve të Kosovës për të realizuar të drejtën e tyre për shtet të pavarur dhe sovran kanë nisur që prej kohës kur diplomacia e Fuqive të Mëdha i ndau nga trungu i territoreve amtare dhe i vendosi nën zgjedhën serbe. Serbia, veçanërisht pas gjysmës së dytë të shekullit të kaluar, nuk mund të mbështetej më pa probleme, si dikur, te Traktati i Berlinit i 13 korrikut 1878, as edhe te Vendimi i 22 Marsit 1913 i Konferencës së Ambasadorëve të Londrës, as te Protokollin e Parisit i korrikut 1926, nëpërmjet të cilave uzurpoi territore të shumta shqiptare. Ajo nuk mund të mbështetej as te Rezoluta e Konferencës së Prizrenit, e 10 korrikut 1945, për anulimin e vendimit të Konferencës së Bujanit të 1943, as te ndryshimet e Kushtetutës së Serbisë të 23 marsit 1989, që abroguan Kushtetutën e Kosovës të vitit 1974 dhe suprimuan autonominë e saj. Sepse tashmë përplasjet e shqiptarëve me Beogradin nuk zhvilloheshin më vetëm në frontet e kundërshtimit, rezistencës, manifestimeve dhe grevave me karakter politik, ekonomik, social, etnik etj. Lufta e popullit shqiptar të Kosovës për liri e pavarësi kishte zbritur dhe zhvillohej më e plotë dhe më e fuqishme edhe në terrenin juridik, të cilin pushtuesi serb, me pretekste dhe interpretime spekulative e kishte konsideruar si ekskluzivitet të vetin.

Në këto rrethana, veçanërisht pas Deklaratës së 2 Korrikut 1990 dhe Kushtetutës së Kaçanikut, të shtatorit të atij viti, Kosova ndërmori një varg hapash dhe miratoi në formën e përshtatshme zyrtare një kompleks aktesh juridiko-kushtetuese që guxuan të atakonin dhe të zhvleftësonin veprimet legjislativë të Beogradit.

Nëpërmjet tyre, duke shfrytëzuar dhe interpretuar me shumë mençuri jo vetëm aktet kushtetuese jugosllave dhe serbe, por edhe aktet pertinente të së drejtës ndërkombëtare, ajo mbronte interesat e veta dhe garantonte, për aq sa ishte e mundur, të ardhmen dhe të drejtën e popullit të vet për shtet të pavarur dhe sovran.

Legjitimiteti i pakontestueshëm i Deklaratës së 2 Korrikut, i Kushtetutës së Kaçanikut dhe i të gjitha akteve të tjera që dolën në plotësim ose në zbatim të tyre, veprimtaria e urtë politike e presidentit Rugova, Lufta e UÇK-së dhe shpallja e Pavarësisë më 17 shkurt 2008, do të vulosej përfundimisht nga opinioni konsultativ i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë i 22 Korrikut 2010. Ai sanksionoi nga pikëpamja juridiko-ndërkombëtare se shpallja e Pavarësisë së Kosovës dhe rrjedhimisht të gjitha veprimet dhe aktet e miratuara me atë rast, nuk kishin shkelur të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare.

*Fjalë çelës:* rezoluta, Kosova, Deklarata Kushtetuese, Kushtetuta, e Drejta Ndërkombëtare

Shteti sovran dhe i pavarur i Kosovës, i zyrtarizuar me vendimin e 17 Shkurtit 2008, erdhi në jetë falë luftës së popullit të Kosovës, veprimit të faktorit politik, ndihmës dhe mbështetjes vendimtare të faktorit ndërkombëtar dhe Shqipërisë, por edhe sanksionimit juridik të rezultateve të tyre në aktet kushtetuese e ligjore të miratuara nga institucionet e saj kompetente dhe forumet ndërkombëtare.

Midis akteve kryesore të arsenalit juridik të përdorura për krijimin dhe paraqitjen zyrtare të shtetit të pavarur të Kosovës, vend me rëndësi zë Deklarata Kushtetuese e 2 Korrikut 1990. Ajo u pasua nga Kushtetuta e 7 Shtatorit të vitit 1990, e njohur ndryshe edhe si Kushtetuta e Kaçanikut,<sup>1</sup> e

---

<sup>1</sup> Për mbledhjen e përbashkët të të gjitha dhomave të Kuvendit të KSA të Kosovës, të datës 7 shtator 1990, që u mbajt në Kaçanik dhe ku u miratua Kushtetuta, ishte propozuar ky rend dite:

1. Shqyrtimi i Propozimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për ta miratuar;
2. Shpallja e Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

cila u përgatit në fshehtësi gjatë muajve korrik e gusht të vitit 1990.<sup>2</sup> Miratimi i saj shtoi edhe më tej fondin normativ që sanksiononte legjitimitetin e shtetit të Kosovës. Në bazë të tyre, më 22 shtator 1991, Kuvendi i Kosovës miratoi Rezolutën për Pavarësi dhe Sovranitet.<sup>3</sup> Ishin një sistem aktesh që atakonin dhe zhvleftësonin veprimet legislative antishqiptare të Beogradit. Mbi bazën e tyre, më 26-30 shtator të vitit 1991, u zhvillua referendumi që e shpalli Kosovën shtet sovran dhe të pavarur, sanksionuar me Rezolutën e 19 tetorit 1991, e cila, së bashku edhe me amendamentet në Kushtetutën e saj, të tetorit 1991, konstruktuan juridikisht rrugën për zgjedhjet e lira, shumëpartiake për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe për zgjedhjen e Kryetarit të Republikës, që u mbajtën më 24 maj 1992 dhe sërish pas gjashtë vjetësh, më 22 mars të vitit 1998.<sup>4</sup>

Duke shfrytëzuar dhe interpretuar me mençuri aktet kushtetuese jugosllave dhe serbe si edhe normat e së drejtës ndërkombëtare, Kosova dëshmoi se ishte në gjendje që edhe nëpërmjet veprimeve të rregullta legislative, të mbronte interesat e veta dhe të garantonte, për aq sa ishte e mundur, të drejtën për t'u shkëputur nga ish- Jugosllavia dhe Serbia, duke ndjekur rrugën e vet juridiko-institucionale drejt së ardhmes.

Në një hapësirë të caktuar kohore veprimtaritë juridiko-kushtetuese u zhvilluan paralel me ato për afirmimin ndërkombëtar të çështjes së Kosovës. Një prej tyre ishte politika e urtë e presidentit Ibrahim Rugova,

3. Shqyrtimi i Propozimit të Ligjit Kushtetues për zbatimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për ta miratuar;
4. Shpallja e Ligjit Kushtetues për zbatimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
5. Marrja e Vendimit mbi vazhdimin e punës së Kuvendit të Kosovës, Këshillit Ekzekutiv dhe organeve të tanishme të administratës, deri në zgjedhjen dhe konstituimin e Kuvendit të ri të Republikës së Kosovës;
6. Shqyrtimi i propozimit të Ligjit mbi bashkimin e qytetarëve në parti politike, shoqata dhe forma të tjera të bashkimit, për ta miratuar;
7. Shqyrtimi i Propozimit të Ligjit mbi zgjedhjet, për ta miratuar;
8. Dhënia e pëlqimit për amendamentet kushtetuese për Kushtetutën e RSFJ-së, në bazë të propozimit të KEF-it;
9. Shpallja e zgjedhjeve dhe
10. Aprovimi i Rezolutës për pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës. Marrë nga *Në tridhjetëvjetorin e Kushtetutës së Kaçanikut: Një ngacmim kujtese për parandalim harrese*, Rexhep Rifati, - PROINTEGRA, -07/09/2020.

<sup>2</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e miratuar më 7 shtator 1990 në Kaçanik, u publikua në Revistën “Zëri i rinisë”, më 14 shtator 1990, sepse botimi i gazetës “Rilindja” ishte ndaluar nga Beogradi.

<sup>3</sup> Miranda Vickers (1998), *Between Serb and Albanian: A History of Kosovo*, f. 251.

<sup>4</sup> Arsim Bajrami, Florent Mucaj, - *E drejta kushtetuese*, botim i Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës, të vitit 2012, f. 213-214.

programi politik dhe filozofia e të cilit synonin respektimin e të drejtave të shqiptarëve dhe krijimin e Republikës së Kosovës, si pjesë e Jugosllavisë, në rrugë paqësore, dialogut dhe mbështetjes ndërkombëtare.<sup>5</sup> Tjetra, veçanërisht e rëndësishme, ishte epopeja e lavdishme e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës<sup>6</sup>, ku morën pjesë disa mijëra djem e vajza, burra e gra, shqiptarë nga të dyja anët e kufirit shtetëror, si dhe nga diaspora. Shumë prej tyre u flijuan në altarin e lirisë. Ajo, siç u përmend, pati edhe mbështetjen e fuqishme të faktorit ndërkombëtar.

\*\*\*

Deklarata e pavarësisë së Kosovës dhe Kushtetuta e Kaçanikut ishin ndër sinjalet që paralajmëruan fillimin e shpërbërjes së Federatës Jugosllave. Ato shënuan gjithashtu inaugurimin e procesit të themelimit të shtetit të saj të pavarur dhe njohjes si subjekt i së drejtës ndërkombëtare. “Deklarata Kushtetuese është hapi i parë drejt pavarësisë së Kosovës, që u ndërtua me Lëvizjen paqësore për çlirim, ndërsa kulmoi me luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për t’u realizuar e plotë në 17 Shkurt 2008”, është shprehur Ilaz Ramajli.<sup>7</sup>

Ato erdhën pas rreth një shekulli zhvillimesh gjithë turbulenca politike në Jugosllavi, e cila, e përbërë nga një grumbull popujsh, ishte përfshirë nga konvulsione të fuqishme që po e çonin gradualisht drejt shturjes. Secili prej tyre, i nxitur edhe nga proceset transformuese në “Lindjen komuniste”, po përpiquej të organizohej politikisht brenda kufijve të etnisë së vet për t’u shkëputur prej saj.

Pas rënies së Jugosllavisë, Serbia u përpoq të ruante rolin e vet dominues në atë që mbeti, sidomos në Kosovë. Konsekuente në obsesionin e vet albanofob, shtoi aty numrin e armatave, të dispozitivit luftarak dhe shkoi deri në vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme. Në marsin e 1989, me të ashtuquajturën “kushtetutë të tankeve” vendosi shtetrrethimin ushtarako-politor për likuidimin e çdo gjurme autonomie dhe

---

<sup>5</sup> Xhezair Zaganjori, - *Jurisprudencë dhe praktikë ndërkombëtare*, Shkolla e Magjistraturës, 2012.

<sup>6</sup> Lufta Çlirimtare e Kosovës erdhi si vazhdim dhe shembulltyrë e luftërave që kanë zhvilluar shqiptarët për liri dhe pavarësi. Krahas ndikimit të mendimit teorik, politik e kulturor të Rilindjes, për zgjimin e vetëdijes kombëtare, u ngrit edhe një valë luftërash antiosmane. Veprimi revolucionar i armatosur ishte pjesë e rëndësishme e Lëvizjes kombëtare shqiptare.

<sup>7</sup> Ish- nënkryetari i Kuvendit të Kosovës më 2 Korrik 1990 dhe më vonë kryetari i tij. Në *Ilaz Ramajli, heroi modern i Kaçanikut legjendar! Epoka e re*, 7 Shtator 2022, Intervistë e realizuar nga Metush Zenuni në Kaçanik, më 03.05.2022, dhe botuar ekskluzivisht në portalin *Pashtriku.org*.

shtetshmërie. Asgjësoi subjektivitetin juridiko-kushtetues të përcaktuar me Kushtetutën e vitit 1974,<sup>8</sup> e cila e konsideronte element konstitutiv me të drejtë vetoje, gati të barabartë me gjashtë ish- republikat e Federatës Jugosllave.<sup>9</sup> Suprimoi strukturat institucionale e ligjore ekzistuese, duke mos kursyer Kuvendin, Këshillin Ekzekutiv, sistemin e organeve gjyqësore, fiskale, administrative, si edhe institucionet shkencore, arsimore, kulturore etj. U krijua një vakuum gati i plotë kushtetues dhe administrativ, u shkatërrua struktura institucionale e juridike vendase dhe Kosova u shndërrua në njësi administrative të zakonshme të Serbisë. Perspektivat dukeshin edhe më të zymta. Në kushtet e errësirës ligjore dhe institucionale, njerëzit mendjendritur, “burrat” trima të Kosovës, me shumë mençuri, dolën në konkluzionin se juridikisht ajo ndodhej në kushtet e *Rebus sic stantibus*, që përligjte zgjidhje radikale institucionale dhe juridike për shkak të ndryshimeve rrënjësore të rrethanave. Për rrjedhojë, u mendua fillimisht konstituimi me statusin e Republikës, si anëtare e Federatës Jugosllave.<sup>10</sup> Kjo ndodhi realisht përpara daljes me

---

<sup>8</sup> Për ideimin e përmbajtjes themelore dhe redaktimin e Kushtetutës së Kosovës të vitit 1974, në literaturën juridiko-kushtetuese të Kosovës flitet me respekt dhe me vlerësime pozitive për kontributet e Mahmut Bakallit dhe Kurtesh Salihut.

<sup>9</sup> Neni 338 i Kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Publikuar në “Gazeta zyrtare e KSAK” Nr. 4, 27 shkurt 1974, - Prishtinë, f. 35.

<sup>10</sup> Teksti i plotë i Deklaratës Kushtetuese i botuar në “Fletoren Zyrtare” të KSAK, nr. 21, më 3 korrik 1990:

1. Me këtë Deklaratë shprehet dhe shpallet qëndrimi burimor kushtetues i popullsisë së Kosovës dhe i këtij Kuvendi si *akt i vetëvendosjes politike në kuadër të Jugosllavisë*. 2. Ky kuvend duke e shpallur nga ana e tij dhe në nivel të tij Kosovën si *njësi të barabartë në Jugosllavi*, në bazë të principeve të demokracisë autentike mbi respektimin e vullnetit të njerëzve dhe të kolektiviteteve njerëzore dhe kombëtare, *pret konfirmimin e këtij akti konstitutiv të tij në Kushtetutën e Jugosllavisë* me mbështetje të plotë të opinionit demokratik në Jugosllavi dhe të opinionit ndërkombëtar. 3. Ky Kuvend Kosovën dhe *pozitën e re kushtetuese të saj e konfirmon si bashkësi politiko-kushtetuese dhe pozitë politiko-kushtetuese të përbashkët të qytetarëve dhe nacionalitetëve të barabarta të Kosovës*, ku *shqiptarët si shumicë e popullsisë së Kosovës dhe një ndër popujt më numerikë në Jugosllavi*, si dhe serbët dhe të tjerët në Kosovë *konsiderohen popull-komb dhe jo kombësi (pakicë kombëtare)*. 4. Në ndërkohë, deri në aplikimin definitiv juridik të kësaj Deklarate Kushtetuese, *Kuvendi dhe organet e pushtetit të Kosovës marrëdhëniet e tyre në rëndin kushtetues të Jugosllavisë i mbështesin në Kushtetutën në fuqi të Jugosllavisë dhe jo në amendamentet e Kushtetutës së RS të Serbisë të vitit 1989, me ç’rast bëhet edhe anulimi i vendimit të Kuvendit të Kosovës i datës 23 mars 1989 mbi dhënien e pëlqimit në këto amendamente*. 5. Kuvendi i Kosovës deri në nxjerrjen e Kushtetutës së re të Kosovës tash e tutje do të komunikojë publikisht me këtë emërtim, duke e emërtuar njëkohësisht bashkësinë shoqërore-politike organ i së cilës është, vetëm si Kosovë. Prishtinë, më 2 korrik 1990. Delegatët nënshkruet të Deklaratës.”

vete të disa prej republikave jugosllave, Sllovenisë, Kroacisë, Maqedonisë, Bosnjë e Hercegovinës.<sup>11</sup>

Ideja e statusit të republikës, si anëtare e Federatës Jugosllave, evoluoi shpejt, drejt shkëputjes dhe daljes si shtet i pavarur dhe sovran.<sup>12</sup>

Më 2 korrikun e 1990, 111<sup>13</sup> anëtarët e Kuvendit<sup>14</sup> u mbledhën para deryve të mbyllura të selisë së tij në Prishtinë dhe nën kërcënimin e

<sup>11</sup> Të drejtën e ish-republikave jugosllave për shkëputje Bashkësia Evropiane dhe Komisioni i Arbitrazhit, në kuadër të Konferencës të Paqes për ish-Jugosllavinë, e kanë pranuar në dhjetor të vitit 1991. Ndërkaq Sllovenia dhe Kroacia e kishin shpallur pavarësinë më 25 qershor 1991. Në Bosnjë e Hercegovinë, shumica e banorëve shpallën gjithashtu pavarësinë më 5 prill të vitit 1992, por siç dihet, vuajtjet dhe humbjet e këtij shteti ishin të tmerrshme, sepse pati rreth një milionë të dëbuar dhe rreth 100 mijë të vrarë nga Serbia, i vetmi shtet agresor dhe shkatërrues i paqes dhe stabilitetit në Ballkan. Maqedonia e shpalli pavarësinë pas referendumit të 8 shtatorit 1991, pavarësia e Malit të Zi u zyrtarizua më 21 maj 2006.

<sup>12</sup> Ilaz Ramajli, drejtuesi i mbledhjes së Kuvendit të Kosovës më 7 shtator 1990, në Kaçanik, ku u miratua Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e njohur si Kushtetuta e Kaçanikut, një prej protagonistëve të ngjarjeve të stuhishme të atyre kohëve, shpjegon qartësisht zhvillimet e ndodhura. Ai thotë se më 5 korrik 1990 Kuvendi i Serbisë, miratoi *Ligjin mbi pushimin e punës së Kuvendit të Kosovës dhe Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Kosovës*, në zbatim të të cilit Kuvendi i Serbisë morri të drejtat dhe obligimet e Kuvendit të Kosovës kurse të drejtat dhe obligimet e qeverisë së Kosovës i morri qeveria e Serbisë. U shkarkuan gjithashtu të gjithë funksionarët e Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës, si dhe funksionarët e punonjësit në organet e administratës në Kosovë. Po atë ditë zyrtarët e administratës dhe policisë serbe larguan nga zyrat e tyre të gjithë funksionarët e Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës. Në ditët në vijim u larguan edhe të gjithë të punësuarit në administratën qendrore të Kosovës. Në këtë mënyrë Serbia në mënyrë antikushtetuese mori me dhunë për t'i ushtruar direkt të gjitha funksionet shtetërorë në Kosovë, shkeli Kushtetutën Federative duke prishur raportet kushtetuese dhe duke e privuar Kosovën, si njësi konstitutive e Federatës nga e drejta që të vetëqeverisej. Serbia, pasi kishte suspenduar të gjitha organet legjitime të Kosovës, ndërhyri direkt në të gjitha fushat e jetës në Kosovë duke larguar nga funksionet të gjithë shqiptarët jo vetëm në organet e pushtetit, por edhe në institucionet shëndetësore, arsimore, kulturore, të ndërmarrjeve etj. Nga data 05 Korrik 1990, Serbia realisht e kishte pushtuar me forcë dhe me masa antikushtetuese Kosovën dhe shqiptarëve të Kosovës iu ishte mohuar çdo e drejtë në të gjitha fushat e jetës. *Ilaz Ramajli, heroi modern i Kaçanikut legjendar! Epoka e re*, 7 shtator 2022, Intervistë e realizuar nga Metush Zenuni në Kaçanik, më 03.05.2022, dhe botuar ekskluzivisht në portalin pashtriku.org. Ilaz Ramajli. Prej vitit 1989, kur u abrogua Kushtetuta e vitit 1974, Kosovës iu hoq gjithashtu edhe policia e saj, iu mbyll Radiotelevizioni, gazeta ditore "Rilindja", u larguan nga puna punonjësit shqiptarë, në dhjetor të vitit 1990 u mbyllën shkollat dhe universiteti etj.

<sup>13</sup> Diku thuhet se numri ishte 114 vetë.

<sup>14</sup> Në shkrimet e shtypit kosovar, që autori ka pasur rastin të konsultojë, dalin si protagonistë veçanërisht prof. dr. Kurtesh Saliu, prof. dr. Ejup Statovci, prof. dr. Ismet Salihu, Ilaz Ramajli, Sabri Hamiti, Fatmir Fehmiu, Muharrem Shabani, delegat, lexoi

snajperëve që ndodheshin në ndërtesat përballë, zhvilluan zyrtarisht seancën e punimeve, ku miratuan Deklaratën Kushtetuese, një akt me rëndësi historike. Disa muaj më vonë, më 7 Shtator 1999, në Kaçanik u miratua dhe u shpall Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Aktet e mesipërme përfaqësonin përgjigjen joviolente të shqiptarëve të Kosovës ndaj strukturave qendrore, nëpërmjet mosbindjes civile dhe krijimit të organeve paralele në arsim, shëndetësi, taksa etj, me qëllim përfundimtar shkëputjen dhe daljen si shtet tërësisht i pavarur.

Rruga e zgjedhur dëshmoi jo vetëm trimëri e guxim, por edhe inteligjencë dhe profesionalizëm. Me nivelin e lartë tekniko-profesional të atyre që i përgatitën, me kujdesin shembullor, guximin dhe pjekurinë politike të treguar, deputetët e Kuvendit të Kosovës, si dhe ekipi mbështetës, impresionuan opinionin publik vendas dhe të huaj dhe në njëfarë kuptimi e kapën në befasi Beogradin.

Për misionin dhe rëndësinë e kësaj ngjarjeje me përmasa unike, për aspektet institucionale, juridike dhe vlerat teorike e akademike të akteve të lartpërmendur, studiues të nderuar, brenda dhe jashtë Kosovës, kanë kryer jo pak studime shkencore.<sup>15</sup>

\*\*\*

Zgjidhja e sanksionuar në Deklaratë kishte si bosht qendror strategjik shkëputjen nga zgjedhja serbe, kalimin nga statusi i krahinës autonome në atë të republikës. Ishte një hap taktik mjaft i mençur që shpresoj se në Beograd mund të shihej si më pak i dhimbshëm dhe ndoshta mund ta zbehte disi furinë e reagimit agresiv të tij. Pushtetet e Serbisë ndaj Kosovës, formalisht do të distancoheshin, por shpresoj se

---

Deklaratën, prof. dr. Riza Smaka dhe Halit Muharremi, sekretar i Komisionit Kushtetues të Kuvendit të Kosovës, Riza Alajt, Ilaz Kurteshi, Neshet Zhubi, Ramë Alihajdari, Rexhep Hamiti, të gjithë delegatë në Dhomën Federative të Kuvendit të Jugosllavisë nga Kosova, juristi i ri në atë kohë Arsim Bajrami etj.<sup>14</sup> Midis tyre kishte një numër juristësh të shquar, të cilët me formimin, dijet dhe profesionalizmin e spikatur kontribuan për përgatitjen cilësore të akteve që u miratuan.

<sup>15</sup> Kam pasur rast të njihem me punimet e një pjese prej tyre dhe konkretisht me ato të prof. dr. Kurtesh Salihut, një ndër përpiluesit e deklaratës për Pavarësinë e Kosovës, si dhe i kushtetutës së Kaçanikut, prof. dr. Hazer Susurit, prof. dr. Hajredin Kuçit, prof. dr. Arsim Bajramit, prof. dr. Enver Hasanit, prof. dr. Ejup Statovcit, prof. dr. Ismet Salihut, prof. dr. Riza Smaka, Visar Morina, Mr. Fatmir Fehmiu, Halit Muharremi. Autori i referatit, i vetëdijshëm që lista e pjesëmarrësve dhe kontribuesve në mbledhjen e Kuvendit të 2 Korrikut 1990, sikurse edhe ajo e studiuesve të aspekteve të ndryshme të këtyre dy ngjarjeve të mëdha është e gjatë, kërkon falje dhe mirëkuptim nga ata, emrat dhe kontributet e të cilëve nuk ka pasur mundësi t'i identifikonte në materialet e shfletuara.

ajo mund të përmbahej nga fakti që lidhjet e imponuara forcërisht prej më shumë se një shekulli, do të vazhdonin përsëri, qoftë edhe për shkak të përkatësisë në të njëjtin shtet federal edhe pse jo më si më parë.

Ideja e daljes si republikë kishte si argumente edhe zhvillimet traumatike që u vërtetuan sidomos në dekadën e viteve '80 të shekullit të kaluar dhe që kulmuan me vitin '89, kur Milosheviçi, në shenjë hakmarrjeje ndaj rezistencës dhe reagimeve të Kosovës kundër represionit politik, policor, gjyqësor, administrativ, ekonomik etj. si edhe për protagonizëm ndaj serbëve, ndërmoi hapin ekstrem të suprimimit të statusit të krahinës autonome.<sup>16</sup> “Ne ishim të vetëdijshëm, tha Ilaz Ramajli, se do të ketë një kundërreaksion të Serbisë, pasi që ajo nuk zgjidhte mjete për t’i realizuar qëllimet e veta. Shumë shpejt, më 5 korrik, Kuvendi i Serbisë, me një ligj antikushtetues dhe pa të drejtë, pa bazë kushtetuese, suspendoi Kuvendin dhe e ndali punën e Qeverisë së Kosovës”. E prekur në thelbin e vet ekzistencial politik, kushtetues, juridik, ekonomik etj. kryesisht për motive etnike, ajo kishte me vete gjithë të drejtën, të rivendikonte rikrijimin e institucioneve të suprimuara dhe rikthimin në një nivel edhe më të avancuar të statusit të abroguar.

Kjo zgjidhje duhet të ishte vështirësisht e kontestueshme edhe në rrafshin juridiko-ndërkombëtar, sepse invokonte parimet e rëndësishme të barazisë sovrane, mosdiskriminimit, të drejtën e vetëvendosjes etj. Prandaj shpresohej që përmes rrugës së zgjedhur të sigurohej edhe një përkrahje relative nga segmente të caktuar të faktorit ndërkombëtar.

Deklarata e 2 Korrikut 1990 karakterizohet nga përmbajtja e thellë, qartësia, largpamësia, gjuha e përpunuar dhe teknika juridike e nivelit të lartë, çka konstatohet lehtësisht qoftë edhe me një vështrim të shpejtë vertikalisht. Aty thuhet se “Me këtë deklaratë shprehet dhe shpallet qëndrimi burimor kushtetues i popullsisë së Kosovës dhe i këtij Kuvendi si akt i vetëvendosjes politike në kuadër të Jugosllavisë”. Afirmohej se ajo do të ishte “bashkësi politiko-kushtetuese”, “njësi e barabartë në Jugosllavi”. Marrëdhëniet e Kuvendit dhe organeve të pushtetit të Kosovës në rendin kushtetues të Jugosllavisë mbështeteshin në Kushtetutën në fuqi të Jugosllavisë dhe jo në amendamentet e Kushtetutës së RS të Serbisë të vitit 1989, me ç’rast bëhej edhe anulimi i vendimit të Kuvendit të Kosovës i datës 23 mars 1989.

---

<sup>16</sup> Më 23 mars 1989, Kuvendit të Kosovës, në kundërshtim me vullnetin e qytetarëve, iu imponua ndryshimi i Kushtetutës së vitit 1974, suprimimi i autonomisë së Kosovës në Federatën Jugosllave, duke e lënë Kosovën si njësi të zakonshme administrative të Serbisë. Pas suprimimit të autonomisë Kosova u inondua nga mijëra policë e ushtarë serbë, të cilët do të mbështesnin represionin dhe aparteidin serb ndaj shqiptarëve.

Deklarata është çmuar si akt me rëndësi të shumëfishtë, sepse:

*Së pari*, siç u tha, abrogohej vendimi i Kuvendit të Kosovës, i datës 23 mars 1989 mbi dhënien e pëlqimit të imponuar për amendamentet e Kushtetutës së RS të Serbisë, të vitit 1989.

*Së dyti*, përmbajtja e saj zhvlerësoi Rezolutën e Konferencës së Prizrenit, të 10 korrikut 1945, me të cilën Serbia, kishte abroguar Rezolutën e Bujanit dhe aneksoi Kosovën.

*Së treti*, e përcaktoi atë si njësi të barabartë të Federatës Jugosllave, duke i hapur rrugën miratimit të Kushtetutës së Kaçanikut, e cila më 7 shtator 1990, e shpalli Kosovën Republikë. Statusi i republikës u zgjodh si rruga më e përshtatshme e mundshme ndër të tjera edhe për të realizuar të drejtën e vetëvendosjes deri në shkëputje, të cilën krahinat autonome, Kosova dhe Vojvodina, nuk e gëzonin,<sup>17</sup> kurse republikat po.<sup>18</sup>

*Së katërti*, së bashku me Kushtetutën e Kaçanikut krijuan bazën juridike për organizimin e Referendumit për Pavarësi të vitit 1991, si dhe të zgjedhjeve të para parlamentare dhe presidenciale të Kosovës të vitit 1992, duke përmbyllur aspektet formalo-juridiko-kushtetuese të legjitimitimit të infrastrukturës demokratike të shtetit të pavarur të Kosovës.

*Së pesti*, të dy këto akte krijuan kushtet e nevojshme juridike dhe institucionale për organizimin e Referendumit, më 22 shtator 1991. Rezultati ishte befasues. Morën pjesë 914,802 votues, baras me 99.87 për qind e qytetarëve dhe rreth 90 për qind e tyre votuan pro shpalljes së

---

<sup>17</sup> Kushtetuta e RSFJ-së e vitit 1946 përcakton Kosovën si krahinë autonome dhe si element konstitutiv të federalizimit, e që njëkohësisht gjendej në kuadrin e strukturës kushtetuese të Serbisë. Sipas Arsim Bajrami, *Draftimi i Kushtetutës (Manual për hartuesit e Kushtetutës)*, Universiteti “Fama”, Prishtinë, 2007, p. 239; Kosovës dhe Vojvodinës iu dha një statusi i autonomisë brenda Republikës së Serbisë. Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar, Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për Pavarësi*, Koha, 2009, p.73.

<sup>18</sup> Kushtetuta e RS të Serbisë e vitit 1963, ia mohoi Kosovës elementin konstitutiv të federalizimit, të njohur nga kushtetuta e RSFJ-së e vitit 1946. Kjo ishte arsyeja pse deri në vitin 1974 ato ishin lënë me pozitën e një rajoni, e një qarku të zakonshëm. Edhe Kushtetuta e Republikës Socialiste Federative e Jugosllavisë e vitit 1963, e trajtoi Kosovën sërish me titullin dhe statusin e “Krahinës” autonome. Noel Malcom që është marrë gjerësisht me historinë e saj thotë se ajo përcaktonte që republikat kishin të drejtë të formonin krahinat e tyre autonome me iniciativën e vet. Krahina Autonome e Kosovës dhe ajo e Vojvodinës u themeluan me vendim të Kuvendit të Serbisë. Statusi kushtetues i Kosovës ishte eliminuar tërësisht në nivelin federativ, duke i dhënë kompetenca vetëm në kuadrin e Republikës së Serbisë. Noel Malcom, *Kosova, një histori e shkurtër*, Koha, Prishtinë dhe Shtëpia Botuese e Librit, Tiranë 2001, p.337.

Kosovës shtet i pavarur,<sup>19</sup> pas shpërbërjes së ish-Federatës Jugosllave, proces që kishte filluar. Nisur nga ky rezultat, më 19 tetor 1991, Kuvendi i Kosovës amendoi Kushtetutën e saj dhe shpalli pavarësinë, si sanksionim i vullnetit politik të popullit të vet, e deklaroi Kosovën shtet sovran dhe të pavarur, me emrin Republika e Kosovës.

Hap i rëndësishëm ishte formimi i qeverisë, zhvillimi i zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare, më 24 maj 1992 dhe zgjedhja e Ibrahim Rugovës president i Kosovës. Siç deklaroi në atë kohë Sabri Hamiti, referendumi “vërtetoi e legjitimoi Deklaratën e 2 Korrikut 1990 dhe shpalljen e pavarësisë së 7 Shtatorit 1990”.<sup>20</sup>

*Së gjashti*, me kontributin e çmuar të UÇK-së, gjakun e disa mijëra dëshmorëve të Luftës Çlirimtare të Kosovës dhe përkrahjen e faktorit ndërkombëtar, u krijuan premiset e duhura për shpalljen e pavarësisë së plotë dhe të mirëfilltë të Kosovës.

*Së shtati*, ishte një nga vendimet më të drejta të kohës sepse jo vetëm legjitimonte dëshirën për liri, pavarësi dhe shtet sovran të shqiptarëve të mbetur në Kosovë, por edhe sepse nëse nuk do të ishte vepruar në atë kohë, rreziqe të paparashikuara mund të shfaqeshin. Dalloheshin pa vështirësi shenjat e shpërbërjes së ish-RSFJ-së, e konsideruar gjerësisht si krijesë artificiale. Politika hegjemoniste serbe, ndaj shqiptarëve në Kosovë, Maqedoni, Malin e Zi, Kosovën Lindore etj. kishte kristalizuar format më tipike të veprimeve antishqiptare, me tipare të gjenocidit dhe të spastrimit etnik.

Strategjia e përzgjedhur u realizua në disa etapa. Në secilën prej tyre, siç u vu në dukje më sipër, u manifestuan veprime të mençura, të cilat u paraqitën edhe me aparenca perfekte juridike. Ato, posaçërisht Kushtetuta e Kaçanikut, sanksionuan juridikisht sovranitetin e Kosovës, pavarësinë, tërësinë territoriale dhe pozitën e saj në marrëdhënie me shtetet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare. Përcaktuan kufijtë dhe paprekshmërinë e tyre, gjuhën shqipe si gjuhë zyrtare, shtetshmërinë e Republikës së Kosovës për qytetarët e saj, të drejtat e pakicave kombëtare, të drejtën e strehimit politik, liritë dhe të drejtat e njeriut në përputhje me aktet ndërkombëtare etj.

Aktet e 1990 patën si objektiv minimal vendosjen e shqiptarëve në të njëjtat pozita me popujt e tjerë të ish-Jugosllavisë. Kjo është arsyeja kryesore pse ende nuk bëhej fjalë për daljen si shtet i shkëputur nga ish-

---

<sup>19</sup> Citohet nga Erjonë Popova, - *Kuvendi Kujton Referendumin për Pavarësi të Vitit 1991*, KALLXO.com, 29.9.2016.

<sup>20</sup> Po aty.

Federata Jugosllave. Neni 2 i Kushtetutës stipulonte se Republika e Kosovës, ishte anëtare e Bashkësisë së Jugosllavisë. Në pajtim me parimet e federalizmit klasik, për të mbrojtur të drejtat e ligjshme të popullit të vet, neni 12 shpallte që “Republika e Kosovës ushtron pushtetin shtetëror në *mënyrë sovrane*. Të drejtat sovrane të Republikës së Kosovës, siguria e saj, si dhe rregullimi shoqëror ekonomik e politik janë të mbrojtura me këtë Kushtetutë.” Sipas saj sovraniteti në Republikën e Kosovës buron nga populli dhe i takon popullit. Vullneti i tij është bazë e pushtetit shtetëror (Neni 3); Territori i Republikës së Kosovës është unik, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm. Kufijtë e Republikës mund të ndryshohen vetëm në bazë të vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me vullnetin e shprehur të popullit me të cilin ka të bëjë ndryshimi. (Neni 8). Në mbështetje dhe në mbrojtje të subjektivitetit juridiko-ndërkombëtar, Kushtetuta përcaktonte gjithashtu se “Republika realizon dhe siguron:

a) sovranitetin, pavarësinë dhe tërësinë territoriale të Republikës dhe pozitën ndërkombëtare e marrëdhëniet e Republikës me shtetet e tjera dhe me organizatat e ndryshme ndërkombëtare; b) liritë dhe të drejtat e njeriut e të qytetarit dhe kushtetutshmërinë e ligjshmërinë; c) mbrojtjen dhe sigurinë e qytetarëve dhe mbrojtjen e sistemit të përcaktuar me Kushtetutë etj”(Neni 95). Në nenin 108, i cili bën fjalë për kryesinë e Republikës, përcaktohej se ajo: “a) vendos mbi çështjet nga sfera e mbrojtjes popullore, në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin dhe udhëheq rezistencën popullore në luftë; b) miraton dekrete me fuqi ligjore, në rast të rrezikut të drejtpërdrejtë nga lufta, gjatë kohës së gjendjes së luftës, rrezikimit të pavarësisë nacionale, ose të tërësisë territoriale dhe pamundësisë së funksionimit të rregullt të organeve republikane, në qoftë se Kuvendi i Republikës nuk ka mundësi të mbajë mbledhje; c) me dekrete me fuqi ligjore mund të suprimohen disa dispozita të Kushtetutës që kanë të bëjnë me liritë dhe të drejtat e qytetarëve dhe me organizimin, përbërjen dhe autorizimet e disa organeve republikane; ç) dekretet me fuqi ligjore Kryesia e Republikës ia paraqet Kuvendit të Republikës për verifikim menjëherë posa ai të ketë mundësi të mblidhet; d) përcakton planet dhe masat për mbrojtjen e vendit, jep udhëzime për marrjen e masave për përgatitjen dhe mobilizimin e burimeve dhe forcave të vendit për mbrojtje dhe për koordinimin e planeve dhe të masave të subjekteve të tjera, përcakton ekzistimin e rrezikut të drejtpërdrejt nga lufta, urdhëron mobilizimin e përgjithshëm dhe të pjesërishëm dhe, në qoftë se Kuvendi i Republikës nuk ka mundësi që të mbajë mbledhje, shpall gjendjen e luftës; d) përcakton planin e përdorimit të forcave të armatosura në rast lufte dhe urdhëron përdorimin e forcave të armatosura në paqe; e) vendos mbi çështjet nga sfera e politikës së jashtme

dhe e marrëdhënieve ndërkombëtare në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin;” Ajo është shprehur edhe se “Qytetarët e Republikës së Kosovës gëzojnë të drejtën e shtetësisë së Republikës. Shtetasit e njëjstëve të tjera të bashkësisë së Jugosllavisë gëzojnë liritë dhe të drejtat e përcaktuara me aktin e saj (Neni 9); Në Republikën e Kosovës është në përdorim zyrtar gjuha shqipe dhe shkrimi i saj. Në rajonet e Republikës së Kosovës, ku jetojnë edhe pjesëtarët e nacionaliteteve të tjera, në përdorim të barabartë zyrtar janë edhe gjuha serbokroate e turke dhe shkrimet e tyre, në pajtim me ligjin (Neni 11); Në Republikën e Kosovës është e drejtë e pjesëtarëve të kombeve dhe pakicave kombëtare që të përdorin simbolet e veta. Kushtet dhe mënyra e përdorimit të simboleve të tyre rregullohen me ligj (Neni 22) etj.

Kushtetuta rregullonte gjithashtu një varg çështjesh të tjera, të cilat afirmojnë qartësisht tiparet e subjektivitetit juridiko-ndërkombëtar të Kosovës, brenda kuadrit të Federatës Jugosllave. Fjala vjen neni 73 kishte sanksionuar se “Shtetasi i Republikës së Kosovës në botën e jashtme gëzon mbrojtjen e Republikës së vet. Shtetasi i Republikës së Kosovës nuk mund të zhvishet nga shtetësia, të largohet nga vendi, e as të ekstradohet. Shtetasit të Republikës së Kosovës, i cili nuk gjendet në vend, e i cili disponon një shtetësi tjetër, mundet që vetëm përjashtimisht, në bazë të ligjit, t’i hiqet shtetësia, në qoftë se me punën e vetë u shkakton dëm interesave ndërkombëtare ose interesave të tjera të Republikës së Kosovës ose në qoftë se refuzon të kryejë obligimet qytetare.” Ajo u garantonte të drejtën “e strehimit shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi, të cilët ndiqen për shkak të angazhimit të tyre për pikëpamje dhe lëvizje demokratike, për çlirimin social dhe nacional, për lirinë dhe të drejtat e personalitetit të njeriut ose për lirinë e krijimit shkencor ose artistik” (Neni 74). u

Kushtetuta sanksiononte se Republika e Kosovës ka marrë përsipër t’ua garantojë shtetasve lirinë e shprehjes së përkatësisë kombëtare, lirinë e shprehjes së kulturës kombëtare dhe lirinë e përdorimit të gjuhës e të shkrimit të saj. “Qytetari nuk është i detyruar të deklarohet se cilës përkatësi kombëtare i takon, as të përcaktohet që t’i takojë njërit nga kombet, përkatësisht pakicës kombëtare. Është kundërkushtetuese dhe dënohet çdo propagandim ose zbatim i pabarazisë kombëtare, si dhe çdo mbjellje e urrejtjes dhe e mosdurimit kombëtar, racial ose fetar, mohimi i historisë, kulturës dhe i vlerave të tjera kombëtare” (Neni 75).

Citimi ose komentimi i mësipërm i jo pak dispozitave të Kushtetutës u bë për të treguar cilësinë e lartë të përmbajtjes së saj, mënyrën e kompozimit mjaft racional të shprehur në sistemimin e dispozitave

përkatëse, të grupuara në krerët dhe nënkrerët e duhur, të cilat rezultojnë të redaktuara me frymë moderne, etj. Në këtë vështrim ajo iu bën nder atyre që e ideuan, konceptuan, përgatitën, e redaktuan dhe atyre që patën guximin dhe përgjegjshmërinë për ta miratuar në Kaçanikun e legjendave shqiptare.

\*\*\*

Ngjarjet e verë-vjeshtës së 1990, ishin vazhde e një procesi që kishte nisur me kohë, qysh kurse në kuadrin e konfigurimit territorial, administrativ dhe kushtetues të ish-Jugosllavisë ndaj shqiptarëve, ishin ritheksuar dhe rënduar politikat sistematike kolonizuese dhe asimiluese. Ata ishin shpërndarë artificialisht në tre republika (Serbi, Mal të Zi dhe Maqedoni). Ndryshe nga serbët, kroatët, sllovenët, boshnjakët, malazezët, maqedonasit, etj nuk gëzonin të njëjtat standarde. Nga numri shqiptarët ishin populli i tretë në Jugosllavi, por konsideroheshin kombësi dhe nuk iu njihej e drejta e krijimit të republikës. Si justifikim përmendeshin tri arsye kryesore.

*E para* ata e kishin republikën e tyre përtej kufirit, në Shqipëri. Këta të ish-Jugosllavisë nuk mund të kishin një tjetër republikë shqiptare.<sup>21</sup>

*E dyta*, thuhej se po t'u jepej e drejta e shkëputjes, siç e gëzonin republikat e tjera ish-jugosllave, mund ta shfrytëzonin për të braktisur Federatën, për t'u bashkuar me Shqipërinë.

*E treta*, ishte frika se dhënia e statusit të republikës mund të shkaktonte pakënaqësi te Serbia dhe te serbët që jetonin në Kosovë.<sup>22</sup>

Për sabotimin e mundësisë së kalimit nga statusi i krahinës autonome në atë të republikës, si gjithmonë, nuk mungonin të jepnin "kontributin" e vet edhe të kudondodhurat skalione të para të strategjisë antishqiptare, Kisha edhe Akademia e Shkencave dhe Arteve e Serbisë. Të njohura për kultivimin e frymës antishqiptare, argumentimin e saj teoriko-juridik dhe shpërndarjen në mjediset politike, akademike, publicistike etj.

---

<sup>21</sup> Kur nisi të qarkullonte ideja e dhënies së statusit të krahinës autonome për Kosovën, në qarqet akademike dhe universitare në Tiranë, u përhap një thashethemnajë, sipas së cilës në udhëheqjen federale jugosllave ekzistonte si alternativë mundësia e statusit të Republikës. Thuhej se nismëtar ishte Titoja, i cili e bënte këtë jo vetëm në kuadrin e rritjes së karizmës së tij personale te shqiptarët, që kishin vuajtur në ato kohë shtypjen e egër nacionaliste, që iu faturua pothuajse kryesisht Rankoviçit, por edhe si një sfidë politike ndaj kundërshtarëve të tij, sidomos atyre serbë. Ajo, nëse realisht ishte e vërtetë, nuk u çua më tej. Autori e ka dëgjuar këtë version nga pedagogët e vet që udhëtonin herë pas here në Kosovë për leksione ose veprimtari të tjera.

<sup>22</sup> Iain King dhe Writ Mason, *Paqe me çdo kusht, Si dështoi bota në Kosovë*, Koha, Prishtinë, 2007, f.50

si edhe për bekimin e falangave ushtarako-policore që vrisnin njerëz në Kosovë, u shfaqën në kor për të sulmuar edhe Deklaratën e Pavarësisë dhe Kushtetutën e Kaçanikut. Lanë të kuptohej se nga pikëpamja juridiko-kushtetuese dhe juridiko-ndërkombëtare, ato ishin nul e të paqena. Në një Memorandum ku trajtohej kjo çështje, kërkohej “sigurimi i hegjemonisë serbe mbi Jugosllavinë e ricentralizuar”. Nëse ky qëllim nuk do të realizohej, duhet të kërkohej ”krijimi i një Serbie të Madhe”.<sup>23</sup> Ideatori dhe realizuesi i kësaj platforme u bë Slobodan Milosheviçi, ai që i hodhi popujt e Ballkanit në luftëra të përgjakshme.

Kushtetuta e 1974, i kishte njohur Kosovës një pozitë më shumë se krahina autonome dhe më pak se republika. Kosova dhe Vojvodina kishin edhe legjislacionin krahinor, krahas atij republikan dhe federativ, kishin të drejtën e përfshirjes së kryetarit në procesin e daljes në krye të shtetit federal jugosllav, nëpërmjet sistemit të qarkullimit në mënyrë të barabartë me 6 republikat.<sup>24</sup> Por krahina, siç u theksua më sipër, në dallim nga republika, nuk e kishte të drejtën e vetëvendosjes deri në shkëputje.

Ndryshimi i statusit të Kosovës në vitin 1974, sollu me vete zbehjen formalo-juridike të lidhjes së saj me Republikën e Serbisë.<sup>25</sup> Pas asaj kohe, ndryshe nga më parë, lidhjet kryesore do t’i kishte më shumë me Federatën sesa me Serbinë, një realitet, të cilin kjo e fundit nuk mund ta pranonte me dëshirë. Me këtë status Kosova zgjeroi shumë marrëdhëniet me jashtë, veçanërisht me Shqipërinë. Disa qindra vetë, ndoshta edhe më shumë, profesorë, akademikë, intelektualë, artistë, sportistë, njerëz të sferave të ndryshme të kulturës, etj, nga Shqipëria dhe Kosova, kalonin çdo vit kufijtë shtetërorë dhe merrnin pjesë reciprokisht në veprimtari kërkimore, shkencore, akademike, botuese, artistike, kulturore, sportive etj përkatësisht në Shqipëri e në Kosovë. Ky zhvillim gjeti sanksionimin e vet juridiko-ndërkombëtar edhe në aktet përkatëse zyrtare. Qeveritë e të dy shteteve lidhnin periodikisht marrëveshje të bashkëpunimit në fushat e lartpërmendura dhe, në zbatim të tyre, autoritetet përkatëse në Shqipëri dhe në Kosovë, lidhnin midis tyre protokolle bashkëpunimi. Kjo praktikë shënoi zhvillime të ndjeshme pozitive, sepse hapi dyert dhe mundësitë e

---

<sup>23</sup> Viktor Meier, “*Fundi i Jugosllavisë, goditja në Kosovë*”, “Iliria” Lubjanë 2006, f.66.

<sup>24</sup> Në zbatim të saj, ish - kryetari i Kosovës, Sinan Hasani, nga 15 maji 1986 deri në 15 maj 1987, mbajti postin e presidentit të Jugosllavisë etj.

<sup>25</sup> Esat Stavileci, *Rrugëtimet dhe labirintet e Kosovës dhe të shqiptarëve, Pavarësia e Kosovës-fakt i ligjshëm që nuk mund të zhbëhet*, Gjakovë, 2009, f. 69.

kontakteve dhe të lidhjeve, të cilat deri në atë kohë, ishin gati inekzistente.<sup>26</sup>

Te shqiptarët në të dy anët e kufirit ndërshtetëror u kultivua një klimë normale, krejt ndryshe nga më parë, por që fatkeqësisht, u shoqërua me shqetësime alarmuese në Beograd dhe ndërmarrjen e masa restriktive ndaj Kosovës. Ato morën format e dhunës së hapur në ngjarjet tragjike të 11 marsit 1981, me protestat e studentëve të Universitetit të Prishtinës dhe demonstratën e madhe të 1 prillit, të po atij viti, ku rreth 25,000 pjesëmarrës kërkuan ndryshimin e statusit nga Krahinë Socialiste Autonome e Kosovës brenda Serbisë, në republikë, në kuadër të Jugosllavisë. Forcat speciale vranë 9 veta dhe plagosën mbi 250 të tjerë.

Edhe pse të provokuar deri në ekstrem, shqiptarët e Kosovës reagueshan me kujdes duke qëndruar brenda kuadrit të mjeteve paqësore. Aktet e viteve 1990-1992, që sanksionuan vullnetin e popullit të Kosovës për shtet sovran, ishin veprime legjitime për t'i shpëtuar dhunës së organizuar shtetërore.

*Së pari* ishin reagim paqësor, legjislativ, kundërshtim korrekt i një populli të sulmuar ndaj represionit të hapur, të përgjakshëm, të ndërmarrë nga shteti i vet.

*Së dyti*, u miratuan nga organi kompetent kushtetues i Kosovës, deputetët e Kuvendit, që ishte konstituuar nëpërmjet zgjedhjeve të zhvilluara në vitin 1989;

*Së treti*, mbështeteshin në legjislacionin kushtetues jugosllav;

*Së katërti*, ishin në përputhje me frymën, parimet themelore të së drejtës ndërkombëtare;

*Së pesti*, kishin mjaft pika takimi dhe përngjasime me akte të kësaj natyre të krijimit të shteteve të tjerë në kontinentin evropian dhe në botë.

\*\*\*

Ardhja në jetë e Kosovës nëpërmjet akteve të viteve 1990-1992 dhe 2008, u bë konform parimeve të saj, të cilat përcaktojnë se shtetet e reja krijohen në disa mënyra. Njëra është kurorëzimi me sukses i luftës nacional-çlirimtare të një populli.<sup>27</sup> Mënyra të tjera janë shpërbërja,

<sup>26</sup> Në zbatim të akteve të bashkëpunimit dypalësh, autori ka pasur privilegjin të vizitonte Kosovën, në shkurt-marsin e vitit 1981, për të dhënë leksione në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës.

<sup>27</sup> Kjo ndodhi me Greqinë, më 25 mars 1821, kur shpalli pavarësinë, njohjen zyrtare të së cilës e mori nga Konferenca e Londrës, e vitit 1832. Në këtë rrugë ecën edhe serbët e

copëtimi i një shteti dhe krijimi i disa shteteve mbi rrënojat e tij,<sup>28</sup> bashkimi i disa shteteve në një shtet të vetëm<sup>29</sup> etj.

Ndarja apo shkëputja e shteteve dhe krijimi i shteteve të reja në mënyrat e mësipërme mund të bëhet kundër dëshirës së shtetit ekzistues, me kryengritje apo revolucion, (rasti ish-Jugosllavisë), por edhe me pëlqimin e përbashkët, (rasti i ish-Çekoslllovakisë, ish-BRSS) të shprehur në një traktat ndërkombëtar. Mënyrat e mësipërme të krijimit të shteteve të reja mund të konsiderohen në të njëjtën kohë edhe zhdukje e shteteve, por vetëm në ato raste kur shteti i mëparshëm nuk vazhdon të ekzistojë më as edhe si emër. Në këtë mënyrë u zhdukën Austro-Hungaria, Hindustani, Bashkimi Sovjetik, Jugosllavia etj. Por nuk mund të thuhet e njëjta gjë për Holandën, kur prej saj u shkëput Luksemburgu në vitin 1890, për Pakistanin, kur prej tij u shkëput Bangladeshi në vitin 1971 ose për Sudanin, kur prej tij u shkëput Sudani i Jugut etj.

Me Kosovën u vërtetua rasti i triumfit të luftës nacional-çlirimtare të popullit të saj, që përkoi edhe me procesin e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë.

Deklarimi dhe sanksionimi i daljes së shteteve të reja bëhet nëpërmjet një akti të brendshëm të autoriteteve kompetente të shtetit të porsakrijuar, por edhe me anën e një marrëveshjeje ndërmjet Fuqive të Mëdha ose shteteve të interesuara.<sup>30</sup> Mund të bëhet gjithashtu nëpërmjet

---

malazezët në vitin 1878. E njëjta gjë ngjau gati një shekull më vonë edhe me Shqipërinë, e cila e shpalli pavarësinë me deklaratën e Kuvendit Kombëtar të Vlorës, më 28 nëntor 1912 dhe u njoh shprehimisht nga Konferenca e Ambasadorëve të Londrës, më 29 korrik 1913.

<sup>28</sup> Në vitin 1830 u ndanë dhe dolën si shtete më vete Belgjika dhe Holanda, në vitin 1890, u ndanë Holanda dhe Luksemburgu, në vitin 1919, u shthur unioni real Austro-Hungarez dhe u krijuan dy shtete, Austria dhe Hungaria, në vitin 1947, Hindustani u nda në Indi dhe në Pakistan, në vitin 1971, Pakistani u nda në Pakistan dhe në Bangladesh. Në këtë mënyrë janë krijuar në dekadën e fundit të shekullit të kaluar edhe shtete të tjera në Evropë e në Azi nga shthurja e ish- Bashkimit Sovjetik, ish- Jugosllavisë, ish-Çekoslllovakisë, shkëputja e Timorit Lindor, në vitin 2002, shkëputja e Sudanit të Jugut, nga Sudani, nëpërmjet referendumit të janarit të vitit 2011 etj.

<sup>29</sup> Nëpërmjet proceseve unifikuese u krijuan Italia në 1870, Gjermania po në atë kohë, shteti serbo-kroato-slloven më 1918, i cili më vonë u quajt Jugosllavi, ish- BRSS-ja, më 1922. Në vitin 1964 u krijua Tanzania nga bashkimi i Tanganikës dhe i Zanzibarit, kurse më 31 gusht 1991, u krijua Republika Federale e Gjermanisë nëpërmjet thithjes prej saj të ish- Republikës Demokratike Gjermane.

<sup>30</sup> Kështu ndodhi me traktatin anglo-irlandez të vitit 1921, kur u krijua shteti i Irlandës, me marrëveshjen e Evianit, më 18 mars 1962, e cila i dha fund periudhës 132 vjeçare të luftës së kolonizatorëve francezë ndaj algerianëve dhe njohjes së shtetit algerian nga ana Francës, me marrëveshjen e Parisit të 27 janarit 1973, për përfundimin e luftës në Vietnam etj.

akteve të ndonjë organizate ndërkombëtare, siç u krijua shteti i Izraelit dhe Palestinës, në vitin 1947, nëpërmjet një rezolute të OKB-së.

Miratimi i Pavarësisë së Kosovës u bë me vendimin e Kuvendit të saj, të 17 shkurtit 2008 dhe u shpall zyrtarisht nga kryeministri Hashim Thaçi, duke lexuar para deputetëve të tij Deklaratën e shpalljes së saj shtet i pavarur.

Legjitimiteti i pakontestueshëm i Deklaratës së 2 Korrikut 1990 dhe i të gjithë akteve të tjera që vijuan daljen e tyre, në plotësim ose në zbatim të saj, u kurorezuan me lirinë që i solli Kosovës lufta e UÇK-së dhe me shpalljen e pavarësisë, në shkurtin e 2008.

\*\*\*

Në themel të bazës ligjore të krijimit të shteteve të reja duhet të qëndrojë shprehja e lirë e vullnetit të popujve, e zyrtarizuar juridikisht në parimin e vetëvendosjes.

Në praktikë përmendet si shembull plebishiti 18 gusht 1791, i cili vendosi bashkimin e Comtat Venaissin me Francën. Ai konsiderohet si një nga rastet e para të zbatimit praktik të “të drejtave të popujve për vetëvendosje”.<sup>31</sup> Në këtë mënyrë më vonë erdhën në jetë edhe disa shtete të reja dhe u përcaktuan kufijtë në rajonin e Evropës Qendrore, në 1918-1920. Më 14 dhjetor 1922, popullsia e qytetit të Sopronit dhe e rrethinave të tij, në Hungari, mori pjesë në plebishitin, i cili votoi që të qëndronin në Hungari, të mos bashkoheshin me Austrinë. Në këtë mënyrë u veprua edhe me plebishitin e vitit 1920 që bashkoi veriun e Schleswigut me Danimarkën, atë të vitit 1935 dhe referendumin e 1957 për bashkimin e Saarland me Gjermaninë etj. Ka pasur edhe referendume të falsifikuara për vetëvendosjen, siç ishin ato që bëri Hitleri për krijimin e të ashuquajturit Anchluss, aneksimi nga Rusia i Krimesë pas referendumit të falsifikuar të vitit 2014, pushtimi po prej saj, i zyrtarizuar nëpërmjet referendumeve të falsifikuara të Luhanskut, Doneskut etj në vitin 2022, rajone të Ukrainës etj.

Parimi i vetëvendosjes, që u shfrytëzua edhe nga Kosova, e ka burimin dhe mbështetjen juridiko-ndërkombëtare së paku që në periudhën e iluminizmit, në veçanti në idetë e Zhan Zhak Rusoit.

Ai u propagandua gjerësisht në kohën e revolucionit borgjez francez, më pas nga bolshevikët rusë, ishte pjesë e 14 pikave të Willsonit, u zbeh disi në kohën e Lidhjes së Kombeve, u riafirmua pas Luftës së Dytë

---

<sup>31</sup> *Comtat*, në *Dictionnaire de l'Académie française*, Centre National de Ressources Textuelles et Lexicales - Cnrtl<https://www.cnrtl.fr> Académie, 9 édition.

Botërore dhe u përfshi në nenet 1 dhe 55 të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Paragrafi 2 i nenit 1 të Kartës theksonte se një ndër “qëllimet e Kombeve të Bashkuara..., ishte zhvillimi i marrëdhënieve miqësore midis kombeve, bazuar në respektimin e parimit të të drejtave të barazisë së popujve dhe në të drejtën e tyre për vetëvendosje”.<sup>32</sup>

Më pas, Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së e vitit 1960 mbi dhënien e pavarësisë territoreve dhe popujve kolonialë, e konsideronte të drejtën e vetëvendosjes si parim të konsoliduar i së drejtës zakonore ndërkombëtare dhe si institut të *jus cogens*. Në këtë drejtim kishte ecur edhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Në *Procesin për Timorin Lindor (Portugalia kundër Australisë)*,<sup>33</sup> në vitin 1995, ajo iu përmbajt pikëpamjes se vetëvendosja “është një ndër parimet thelbësore të së drejtës së sotme ndërkombëtare”, ndërsa në çështjen tjetër - *Ekspertiza për murin në territorin palestinez*, (viti 2004) u shpreh se “e drejta e popujve për vetëvendosje është sot një e drejtë *erga omnes*”, e cila zbatohet për të gjithë dhe vlen për të gjithë.<sup>34</sup>

Nuk kishte motiv që edhe zhvillimet që përshkuan horizontin e jetës politike e sociale të shqiptarëve të Kosovës në kërkim të zgjidhjeve të përshtatshme, pas ngjarjeve të bujshme të vitit 1981, të mos trajtoheshin sipas parimeve të së drejtës së popujve për vetëvendosje, përfshirë edhe kërkesën për shtet të pavarur dhe sovran. Kosova, në zbatim të tyre, duke shfrytëzuar me mençuri frymën e akteve kushtetuese jugosllave në fuqi, miratoi në formën e përshtatshme një sistem aktesh juridiko-kushtetuese, për të mbrojtur interesat e veta dhe për të garantuar, për aq sa ishte e mundur, të ardhmen e vet.

Besohej se nëpërmjet interpretimit të parimit të vetëvendosjes në favor të statusit të saj, së paku në anën formale, nuk do të kishte reagime ekstreme nga faktori ndërkombëtar. Nuk llogariteshin aleatët tradicionalë sllavo-ortodoksë të Serbisë, sepse ata, siç dihet, mbështeten te interesat e veta gjeopolitike e gjeostrategjike, pa marrë në konsideratë fate popujsh, vendesh, shtetesh, jetë njerëzore etj. Provë është aleanca e përhershme e Rusisë me Serbinë, e shndërruar në rrezik real jo vetëm për të ardhmen e Kosovës, por edhe për paqen dhe sigurinë në rajonin e Ballkanit.

\*\*\*

---

<sup>32</sup> Karta e Kombeve të Bashkuara dhe Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare, Tiranë 1987, f. 11.

<sup>33</sup> RapGjND, 90.

<sup>34</sup> RapGjND, viti 2004, paragrafi 88.

Deklarata e 2 Korrikut 1990 dhe Kushtetuta e Kaçanikut e 7 Shtatorit 1990, me ndryshimet rrënjësore që sollën në statusin e Kosovës, me sa duket, bënë që kësaj here në Beogradin e ish-Jugosllavisë dhe të Serbisë ta kishin kuptuar që në Kosovë kishin ndryshuar rrënjësisht rrethanat politike, sociale, ekonomike dhe realitetet, se ato ishin ndryshe nga më parë. Fryma e përgjithshme e emancipimit kombëtar të shqiptarëve, dëshira për shkëputje nga zgjedha e huaj, ishin shndërruar në frymëzim dhe inkurajim për një të ardhme shpresëdhënëse, kurse për serbët, pushtues dhe mëkatarë të mëdhenj, në makth të përhershëm. Ata e ndjenin se po i humbnin betejat me shqiptarët edhe në aspektin juridik, që e mendonin ekskluzivitet të pakontestueshëm të vetin. E shihnin që tashmë Kosova kishte një brez politikanësh, por edhe juristësh të talëntuar, që ishin shkolluar në universitete prestigjioze në ish-Jugosllavi, Evropë e SHBA. Formimi i tyre teoriko-juridik iu lejonte të trajtonin me kompetencë probleme të rëndësishme të karakterit juridiko-kushtetues dhe juridiko-ndërkombëtar.<sup>35</sup> Ata do të përballëshin me dinjitet profesional me përpjekjet e autoriteteve serbo-jugosllave për nënshtrim, të cilat i kishin shtuar arsenalit të zakonshëm politik, policor, administrativ, juridik gjyqësor etj edhe reagime të vazhdueshme, sistematike të karakterit gjyqësor. Në sintoni të plotë me institucionet legjislativë dhe aparatit represiv serbo-jugosllav, që vepronte haptas me dhunë, nisën kontestimin e vlefshmërisë juridike të akteve kushtetuese të miratuara nga organet kompetente të Kosovës në gjysmën e dytë të vitit 1990. E çuan çështjen në Gjykatën Kushtetuese të Jugosllavisë, me pretendimin se ishin miratuar në shkëlqje të kushtetutës jugosllave dhe e asaj serbe, si edhe të Deklaratave të Kombeve të Bashkuara të viteve 1960 dhe 1970 për të drejtën e popujve (kombeve) për vetëvendosje. Siç pritej, ajo i gjeti ato të papajftueshme me kushtetutën federale.<sup>36</sup> Arsyetoi se Kosova nuk ishte entitet federal dhe se statusi i saj kushtetues mund të ndryshohej vetëm me ndërhyrje në

<sup>35</sup> Ndër argumentet e kësaj natyre që përmendeshin aso kohe për domosdoshmërinë e afirmimit të saj si pjesë e barabartë e Federatës Jugosllave ishte edhe interpretimi që u bëhej mënyrave të fitimit të territoreve nga ana e shteteve. Theksohej se e drejta ndërkombëtare e kishte përjashtuar me kohë pushtimin, nënshtrimin (*debelimin, debelatio*), si mjet dhe mënyrë të zmadhimit territorial, sepse realizohej nëpërmjet luftës pushtuese. Prej kohësh ajo ishte nxjerrë jashtë ligjit. Formalisht zyrtarizimin do ta bënte Lidhja e Kombeve dhe më pas pakti shumëpalësh Briand-Kellog, i 27 gushtit 1928.

<sup>36</sup> Cour constitutionnelle de Yougoslavie, arrêt du 19 février 1991, II-U-broj 87/90, ëOdluka o ocenjivanju ustavnosti Ustavne deklaracije o Kosovu kao samostalnoj i ravnopravnoj jedinici u okviru federacije (konfederacije) Jugoslavije kao ravnopravnog subjekta sa ostalim jedinicama u federaciji (konfederaciji)ç, Journal officiel de la RFSY, no 37/1991, p. 618, pièce 56 des pièces et documents soumis à l'appui du présent exposé écrit.

kushtetutën federale dhe atë serbe.<sup>37</sup> Sipas vendimit, ripohohej se shqiptarët e Kosovës ishin kombësi (pacticë kombëtare), nuk mund të ushtronin të drejtën e vetëvendosjes dhe nuk mund ta shpallnin Kosovën entitet federal, sepse e drejta për vetëvendosje u takonte ekskluzivisht kombeve të Jugosllavisë, e jo kombësive. Gjykata arsyetonte që, nëse Kosova do të bëhej entitet autonom dhe i barabartë me republikat e tjera të RSFJ-së, kjo do të ndryshonte territorin dhe kufijtë e Serbisë, gjë që sërish përbënte shkelje të kushtetutës së RSFJ-së.<sup>38</sup> Sipas nenit 6 të Kushtetutës serbe të vitit 1990,<sup>39</sup> miratuar me referendum, në të cilin kishin marrë pjesë edhe votuesit nga krahinat autonome të Kosovës dhe Vojvodinës<sup>40</sup>, thoshte Gjykata Kushtetuese, Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë dhe Krahina Autonome e Vojvodinës, ishin thjesht njësi territoriale vetëqeverisëse<sup>41</sup> të Serbisë. Duke pretenduar se aktet në fjalë ishin të papajtueshme me kushtetutën federale, vendosi anulimin e tyre.<sup>42</sup>

\*\*\*

---

<sup>37</sup> Po aty.

<sup>38</sup> Po aty, f. 619.

<sup>39</sup> Ustav Republike Srbije (Constitution de la République de Serbie), Sluzbeni glasnik Republike Srbije (Journal officiel de la République de Serbie), no 1/90. Përkthimi anglisht gjendet në adresën:

<http://unpan1.un.org/intradoc/groups/public/documents/UNTC/UNPAN019071.pdf>.  
Shih edhe Sluzbeni glasnik Republike Srbije ëJournal officiel de la République de Serbieç, no 35/1990; Pour une carte de la RFY (Serbie et Monténégro), voir annexe 2; Ustav Savezne Republike Jugoslavije, ëConstitution de la République fédérale de Yougoslavieç, Sluzbeni list Savezne Republike Jugoslavije ëJournal officiel de la RFYç, no 1/1992 (ci-après dénommée: Constitution de la RFY).

<sup>40</sup> Sluzbeni glasnik Republike Srbije (Journal officiel de la République de Serbie), no 35/1990.

<sup>41</sup> Njësitë - provincat autonome ishin të autorizuara kryesisht për të rregulluar çështjet me interes për qytetarët e tyre në fushat e arsimit, kulturës, përdorimit zyrtar të gjuhëve të pacticave, informacionit, shëndetit dhe mirëqenies sociale, mbrojtjes së fëmijëve, mjedisit dhe planifikimit të qytetit (neni 109/1-3 i Ligjit për krahinat autonome). Ligji mund të zgjerojë juridiksionin krahinor në çështje të tjera (po aty, parag. 3). Autoritetet krahinore ishin të autorizuara të zbatonin rregulloret krahinore dhe mund të zbatonin gjithashtu legjisllacionin serb nëse autoritetet qendrore ua delegonin këtë kompetencë atyre (neni 109/1-4).

<sup>42</sup> Cour constitutionnelle de Yougoslavie, arrêt du 19 février 1991, II-U-broj 87/90, ëOdluka o ocenjivanju ustavnosti Ustavne deklaracije o Kosovu kao samostalnoj i ravnopravnoj jedinici u okviru federacije (konfederacije) Jugoslavije kao ravnopravnog subjekta sa ostalim jedinicama u federaciji (konfederaciji)ç, Journal officiel de la RFSY, no 37/1991, p. 618, pièce 56 des pièces et documents soumis à l'appui du présent exposé écrit.

Çështja do të gjente trajtimin e duhur dhe korrekt nëpërmjet Opinioneve Konsultative të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND), të 22 korrikut 2010. Ajo u investua me rezolutën 63/3, të datës 8 tetor 2008, të Asamblesë së Përgjithshme të OKB, e cila kishte vendosur t'i kërkonte Gjykatës së Hagës që të shqyrtonte dhe të shprehej nëpërmjet një mendimi këshillues për pyetjen nëse: "Shpallja e njëanshme e pavarësisë nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes së Kosovës është në përputhje me të drejtën ndërkombëtare?"

Tridhjetë e tetë prej shteteve anëtare të OKB-së paraqitën deklarata me shkrim. Kosova, e cila gjithashtu dorëzoi mendimin e saj me shkrim, për përgatitjen e tij kishte angazhuar disa nga autorët më të njohur të së drejtës ndërkombëtare. Ata kishin punuar për argumentimin e gjithanshëm juridik të aktit të ndërmarrë në 17 shkurt 2008-shpalljen e njëanshme të pavarësisë.

Pesëmbëdhjetë shtete bënë komente me shkrim mbi deklaratat e shteteve që ishin shprehur në favor të shpalljes së pavarësisë dhe mbi materialin me shkrim të Kosovës.

Në seancat dëgjimore publike, që u mbajtën në Hagë, nga 1 deri më 11 dhjetor 2009, morën pjesë njëzet e tetë shtete së bashku me përfaqësuesit e Kosovës.

Një vend të rëndësishëm zuri Deklarata e paraqitur nga Shqipëria. Nëpërmjet letrës së 14 prillit 2009, të ministrit të saj të punëve të jashtme, drejtuar Presidentit të GJND-së, ajo përcolli materialin në përkrahje të së drejtës së Kosovës për shpalljen e njëanshme të pavarësisë, më 17 shkurt 2008. Ishte përgatitur nga specialistë të spikatur të së drejtës ndërkombëtare, vendas dhe të huaj.

Fillimisht bëhej një historik i koncentruar i ngjarjeve që çuan të 17 Shkurtit 2008. Evokoheshin ato që kishin paraprirë shpërbërjen e dhunshme të Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë, zhvillimet pas vitit 1989 në Kosovë, të cilat, duke suprimuar çdo lloj statusi autonom të saj, përshpejtuan ngjarjet e viteve 1990-1992, marrëveshjet e Rambujesë të shkurt-marsit 1999, ndërhyrjen e forcave të NATO-s, nga 24 marsi deri më 10 qershor 1999, rezolutën 1244, të qershorit 1999 dhe krijimin e UNMIK-ut, negociatat për statusin përfundimtar nën drejtimin e bashkësisë ndërkombëtare, deklarata e pavarësisë e Kosovës e 17 Shkurtit 2008.

Në vijim kalohej në thelbin e çështjes, duke argumentuar se Deklarata e pavarësisë ishte një çështje kombëtare që nuk rregullohej nga e drejta ndërkombëtare. Në mbrojtje të së drejtës së popullit të Kosovës për

shpalljen e njëanshme të pavarësisë, Shqipëria shprehej edhe kundër ndërhyrjes së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, e cila, në këtë rast, kishte vepruar duke tejkaluar përmbajtjen e paragrafit 1 të nenit 12 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, në bazë të së cilit ajo nuk kishte të drejtë t'i drejtohej GJND-së për mendim këshillimor. Prandaj, duke menduar se vendimi i GJND-së, mund të ndikohej nga faktorë ose rrethana të paparashikuara, mund t'i prishte punë Kosovës, i kërkonte Asamblesë së Përgjithshme që, në ushtrim të së drejtës së saj diskrecionare të mos shprehej me mendim këshillimor. Shqipëria deklaronte se objekti i mendimit këshillimor kishte të bënte me një mosmarrëveshje dypalëshe ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe ai nuk do të kontribuonte në ushtrimin e kompetencës së vet nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së.

Pas ballafaqimit të mendimeve pro Kosovës dhe kundër Serbisë dhe anasjelltas, u kristalizua mendimi se shpallja e pavarësisë ishte bërë nga përfaqësues të Kosovës, të zgjedhur lirisht dhe në mënyrë demokratike.

GJND-ja u shpreh se shpallja e njëanshme e pavarësisë së Kosovës “nuk ka shkelur të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare”.

Vendimi i Hagës trajtoi, zgjidhi dhe kapërceu pa pasoja ndërkombëtarisht të dëmshme një situatë të krijuar në hapësirat e ish-Jugosllavisë, daljen e Kosovës si shtet më vete dhe shkëputjen e saj përfundimtare nga Serbia. Ai i dha fund alibisë së shpërndarë nga Beogradi mbi gjoja shkeljen e së drejtës ndërkombëtare nga vendimi i 17 shkurtit të 2008 dhe prodhoi një precedent teorik e juridik duke i dhënë politikës dhe diplomacisë një instrument komod autoritar, që nuk mund të interpretohej abuzivisht. Ai tregoi se Kosova jo vetëm që nuk kishte shkelur të drejtën ndërkombëtare, por përkundrazi kishte respektuar maksimalisht parimet dhe normat bazë të saj.

Vendimi i 22 korrikut i dha doktrinës juridiko-ndërkombëtare lëndë të parë për një aspekt veçanërisht sensitiv, aplikimin e saktë të së drejtës së popujve për vetëvendosje, duke gjetur ekuilibrin e duhur ndërmjet parimit të moscenimit të integritetit territorial të shtetit dhe atij të vetëvendosjes deri në shkëputje.

Tashmë do të ishte i mirëpritur një qëndrim racional dhe realist i Beogradit që nisej nga premisa elementare që shqiptarët e Kosovës kanë të drejtën të jetojnë më vete, të lirë e të pavarur dhe se kjo kauzë e realizuar përmes një kalvari të gjatë mundimesh, në të cilin ata kishin dëshmuar shumë maturi, durim dhe vetëpërmbajtje, meritonte të respektohej edhe nga ata që ua kishin mohuar për më shumë se një shekull.

Vendimi i mbyllte përfundimisht debatet e autoriteteve serbe e jugosllave rreth të drejtës së saj për vetëvendosje deri në shkëputje, të konstatuara, sidomos në shkrime të disa autorëve të së drejtës ndërkombëtare. Ai iu dha përgjigje shteruese në aspektin juridik diskutimeve për të drejtën e shqiptareve të Kosovës për të shpallur shkëputjen nga ish- Jugosllavia dhe Serbia dhe daljen si shtet i pavarur.

Ditën e shpalljes së mendimit konsultativ të GJND-së për ligjshmërinë e pavarësisë së Kosovës, ministri i Jashtëm serb, Vuk Jeremiç, deklaroi se “Serbia nuk e ndryshon qëndrimin e saj dhe nuk do ta njohë kurrë shpalljen e njëanshme të pavarësisë së Kosovës, pavarësisht nga deklarata e ligjshmërisë që u dha sot nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë”.<sup>43</sup> Në të njëjtën linjë ishte edhe qëndrimi i Ruisisë. Ministria e Jashtme ruse, në një komunikatë të publikuar gjithashtu ditën e shpalljes së vendimit të GJND-së, u shpreh se mendimi i dhënë sot nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, GJND, nuk e ndryshon aspak qëndrimin e Ruisisë, që mbetet kundër njohjes së pavarësisë së Kosovës. “Qëndrimi ynë për mosnjohjen e pavarësisë së Kosovës mbetet i pandryshuar”, deklaronte ministria ruse. Me arsyetime të tipit sofist vazhdonte duke thënë se “Është shumë e rëndësishme që Gjykata ka dhënë mendimin e saj vetëm për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës, duke theksuar pikërisht se nuk e shqyrton në tërësi çështjen e të drejtës së Kosovës për ndarje të njëanshme nga Serbia”.<sup>44</sup>

Atë që GJND-ja do ta shpallte më 2010, nismëtarët dhe ideatorët e pavarësisë e kishin interpretuar drejt dhe e kishin realizuar 20 vjet më parë, me mençuri, vendosmëri, largpamësi, atdhetarizëm, elegancë dhe kompetencë profesionale. E kishte realizuar me forcën e armëve UÇK-ja dhe e kishte shpallur Kuvendi më 17 shkurt 2008. U mbyll kështu cikli juridiko-kushtetues dhe juridiko-ndërkombëtar që çoi në krijimin e shtetit të pavarur të Kosovës. Ai u formalizua nëpërmjet shprehjes së lirë të vullnetit të popullit të saj në formën e duhur juridike dhe institucionale, siç u tha më sipër, me tre akte, deklaratën kushtetuese, kushtetutën, referendumin. Akti i fundit ishte shpallja e pavarësisë, ngritja e shtetit real dhe sigurimi i njohjeve nga një numër i konsiderueshëm shtetesh.

\*\*\*

Rruga e Kosovës drejt pavarësisë, aktet e ndërmarra në vitet 1990-1992, përngjasojnë disi me ato çka ndodhën në Shqipëri, 110 vjet më parë. Pavarësia e Shqipërisë së asaj kohe, ku përfshihej doemos edhe Kosova, u

<sup>43</sup> Po aty.

<sup>44</sup> Po aty.

miratua me vendimin e 28 Nëntorit 1912, të Kuvendit Kombëtar të Vlorës për shpalljen e pavarësisë. Në këtë mënyrë u veprua edhe me Deklaratën e 2 korrikut dhe me Kushtetutën e Kaçanikut të shtatorit 1990, në Kosovë.

Më tej përpjekjet për ngritjen e shtetit shqiptar, vazhduan me formulimin dhe përcjelljen e kërkesës për njohje ndërkombëtare të shtetit dhe të qeverisë së përkohshme të Vlorës. Ajo erdhi më 29 korrik 1913, në formën e njohjes kolektive, të vonuar dhe të kushtëzuar, nëpërmjet vendimit të Konferencës së Ambasadorëve, që e përgjysmoi territorin e shtetit të pavarur shqiptar, duke lënë jashtë kufijve të tij gati gjysmën e popullsisë. Ishte pikërisht ajo që la jashtë kufijve Kosovën, treva dhe popullsi shqiptare në Mal të Zi, Maqedoni dhe në Greqi. Ajo zyrtarizoi dhe riafirmoi juridikisht vendimet e Kongresit të Berlinit, 1878. Bashkë me njohjen e pavarësisë, Shqipërisë iu imponuan regjimi i kapitulacioneve dhe statusi i neutralitetit.

Njohja, ishte gjithashtu problematike edhe për Kosovën e fillimviteve '90 të shekullit të kaluar, sikurse edhe për Shqipërinë e 1912-1913. E njohu vetëm Shqipëria, madje edhe ajo në forma të paqarta juridike.

Kurse Kosovën e 2008 e njohën përnjëherësh një numër impresionues shtetesh, ndër të cilët edhe SHBA-ja dhe shumica e anëtarëve të Bashkimit Evropian.

Në Shqipërinë e 1912, në vijim erdhi miratimi i Kanunit të Përtashëm, kushtetutës së parë të shtetit të njohur shqiptar. Në Kosovën e 1990, këtë mision do ta plotësonte Kuvendi i mbledhur në Kaçanik, me Kushtetutën e 7 Shtatorit 1990, e cila për shkak të pushtimit serb u zbatua pjesërisht. Më pas zbatohet Korniza Kushtetuese e bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB dhe e ratifikuar më 2001. Kosova do ta kishte Kushtetutën e saj moderne, të miratuar prej Kuvendit, më 9 prill 2008 dhe të ratifikuar dy ditë më vonë, pas hyrjes së saj në fuqi më 15 qershor 2008.

Kosova e pavarur është sot një realitet i padiskutueshëm dhe i pakthyeshëm. Është një subjekt i mirëfilltë i së drejtës ndërkombëtare, një ndër aktorët më të rinj të skenës botërore, që dëshmon personalitet juridiko-ndërkombëtar të spikatur, të shprehur ndër të tjera edhe në numrin e madh të njohjeve ndërkombëtare, që me siguri do të rritet edhe më shumë, por edhe në politikën e saj paqësore, të fqinjësisë së mirë, bashkëpunimit konstruktiv me fqinjët dhe shtetet e tjera.



Frashër Demaj

## QËNDRIMI I POLITIKËS NDËRKOMBËTARE NDAJ ÇËSHTJES SË KOSOVËS NË FILLIM TË VITEVE '90

### Përmbledhje

Dhuna dhe represioni serb në Kosovë arriti kulmin me veprimet antikushtetuese të Serbisë ndaj Kosovës më 23 mars 1989 në Mbledhjen e Kuvendit të KSA të Kosovës ku u dha pëlqimi për ndryshimin e Kushtetutës, që nënkuptonte suprimimin e autonomisë së Kosovës. Këto veprime i dhanë mundësi Serbisë që më 28 mars të shpallte “krijimin e Serbisë unike”. Këto ngjarje nxitën reagimin e komunitetit ndërkombëtar, sidomos të organizatave që merreshin me liritë dhe të drejtat e njeriut në Evropë dhe SHBA. Si kundërpërgjigje ndaj suprimimit të autonomisë së Kosovës, delegatët e Kuvendit të Kosovës u mbledhën më 2 korrik 1990 dhe miratuan Deklaratën Kushtetuese sipas së cilës Kosova shpallej Republikë.

Më 7 shtator 1990 në Kaçanik delegatët e Kuvendit të Kosovës e miratuan Kushtetutën e Republikës së Kosovës siç njihet ndryshe Kushtetuta e Kaçanikut. Në vazhdimësinë e veprimeve politike, bazuar në Kushtetutën e Kaçanikut, nga 26 deri më 30 shtator të vitit 1991 u organizua Referendumi për Kosovën Shtet i Pavarur dhe Sovran, kurse më 24 maj 1992 u organizuan zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale me të cilat u legjitimua rendi kushtetues dhe demokratik i Kosovës bazuar në Kushtetutën e Kaçanikut. Me votë të drejtpërdrejtë, President

i Republikës së Kosovës u zgjodh dr. Ibrahim Rugova. Këto institucione për popullsinë Kosovës ishin legjitime, por nuk u njohën nga bashkësia ndërkombëtare. Sidoqoftë dr. Ibrahim Rugova u njoh dhe u trajtua si lider i shqiptarëve të Kosovës dhe kjo i dha mundësi që të përfaqësonte Kosovën në politikën ndërkombëtare, të takonte deputetë, senatorë, kongresmenë, ministra, kryeministra, presidentë dhe bartës fronesh të monarkive të cilët i njoftonte me situatën në vend dhe bënte sensibilizimin e çështjes së Kosovës në skenën politike e publike ndërkombëtare. Rugova arriti ta takonte edhe Papa Gjon Palin II në Vatikan nga i cili kishte kërkuar që ta ndihmonte Kosovën dhe popullin e saj për t'u çliruar nga Serbia.

Fushatat diplomatike dhe takimet e niveleve të larta përveçse thyen barrierat e paragjyqimit ndaj Kosovës, hapën edhe perspektivën për zgjidhjen e drejtë të çështjes së saj e cila rezultoi me përcaktimin qytetërimin perëndimor dhe shteteve më të fuqishme të botës për ta ndihmuar popullin kosovar në rrugën e çlirimit dhe ndërtimin e shtetit të Kosovës.

*Fjalë çelës:* Kosova, diplomacia ndërkombëtare, Evropa, SHBA, sensibilizimi dhe ndërkombëtarizimi, Ibrahim Rugova, kongresmenë e senatorë.

Fryma demokratike evropiane shembi diktaturat komuniste, rrëzoi murin e Berlinit (1989), nisi demokratizimin e shteteve duke i dhënë fund simbolikisht edhe Luftës së Ftohtë. Por një nga problemet e ndjeshme ishte dilema për shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë. Në politikën ndërkombëtare artikuloleshin ide pro dhe kundër shpërbërjes së RSFJ-së dhe jo të gjithë ishin të një mendjeje nëse kjo federatë duhej të qëndronte edhe më tutje apo duhet të shpërbëhej. Në disa kryeqytete evropiane dominonte ideja se ky shtet nuk duhet të shpërbëhet sepse një Jugosllavi unike është faktor qëndrueshmërie rajonale meqë kishte shërbyer edhe si tampon zonë midis lindjes dhe perëndimit, kurse të tjerë mendonin se shpërbërja e Jugosllavisë do të krijonte mundësi për demokratizimin e republikave, krahinave dhe popujve që jetonin në federatën e përbashkët. SHBA-ja fillimisht kishte një qëndrim më të balancuar ndaj kësaj çështjeje duke e konsideruar se

menaxhimi i situatës në Jugosllavi ishte detyrë evropiane.<sup>1</sup> Evoluimi i politikës amerikane dhe interesave strategjike të saj u vuri pikë dilemave të ngritura në horizont, kur Shtëpia e Bardhë kërkoi që jo vetëm gjashtë republikat, por edhe dy krahinat të gëzojnë të drejtën e tyre për vetëvendosje dhe organizimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike të bazuara në pluralizmin politik.<sup>2</sup> Ky qëndrim i Uashingtonit nënkuptonte shpërbërjen e Jugosllavisë përmes demokratizimit të brendshëm, ku secili nga subjektet e Federatës Jugosllave të kishte të drejtën e patjetërsueshme përmes vullnetit politik të deklarohet për të ardhmen e vet. Të ndikuara nga qëndrimi amerikan edhe Gjermania dhe Franca, (kjo e fundit me vështirësi F.D) ranë dakord që “Jugosllavia nuk mund të mbahet e bashkuar me forcë”. Ndoshta hezitimi për shpërbërjen e RSFJ-së do të ishte me përmasa më të vogla por ekzistonte rreziku i cenimit të paqes botërore me fillimin e procesit të shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik. Pra shpërbërja e RSFJ-së paraqiste rrezik për paqen ballkanike, kurse dezintegrimi i BRSS-së rrezikonte luftë me përmasa të mëdha. Në këtë situatë SHBA-ja dhe vendet kryesore evropiane, përveç se të brengosura, ishin shumë të kujdesshme në qëndrime sa i takon këtyre dy federatave komuniste.

Që nga viti 1981, Republika e Serbisë, me bekimin e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, përmes pushtetit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës që dominohej në shumicë nga serbët dhe malazezët, vazhdoi me fushatë denigruese, shpifëse dhe akuzuese ndaj shqiptarëve që kërkonin të drejtat e tyre kombëtare. Ardhja e Slobodan Milosheviçit në pushtet në Serbi, rinovoi një agjendë të ringjalljes së nacionalizmit serb dhe forcimit të pozitave të tij politike. Në Serbi u përhap një eufori nacionaliste, e cila ndërkohë arriti deri atje sa serbët me lule e këngë nacionaliste i përcillnin tanket dhe makinat e blinduara drejt luftërave kundër popujve me të cilët kishin jetuar në një shtet të përbashkët.<sup>3</sup> Kësaj shtate i shërbeu edhe Memorandumi i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë (1986) që për fat të keq u shndërrua në instrument në duar të politikës.<sup>4</sup> Edhe shkrimtarët serbë u shndërruan në objekt të manipulimeve të politikës ditore duke ngritur zërin kundër kombeve të tjera, pavarësisht se shkrimtarët do të duhej të

<sup>1</sup> Dario Malnar, *SHBA dhe Kosova*, Prishtinë 2013, f. 100.

<sup>2</sup> Mehmet Elezi, *Kosova midis politikës dhe realpolitikës*, Tiranë 1999, f. 21.

<sup>3</sup> Stefan Karastojanov, *Kosova (një analizë gjeopolitike)*, Shkup 2007, f. 197.

<sup>4</sup> Janusz Bugajski, *Ngritja e Kosovës, artikuj dhe fjalime nga okupimi deri te pavarësia*, Prishtinë 2006, f. 23.

ishin në shërbim të paqes dhe humanizmit.<sup>5</sup> Shoqata e Shkrimtarëve të Serbisë dhe disa udhëheqës të Lidhjes Komuniste në Beograd akuzonin Lidhjen e Shkrimtarëve të Kosovës dhe kryetarin e saj Ibrahim Rugova për nxitje të protestave shqiptare dhe destabilizimit të Kosovës. Në përgjigje të këtyre akuzave Rugova deklaronte: "... nuk ka këtu asnjë nxitje, por kjo që po ndodh është kryengritje e popullit kundër dhunës, për shkak të dhunës sepse populli i Kosovës lufton për të drejtat e tij.<sup>6</sup> Në këtë fushatë luftënxitëse ndaj të tjerëve ishte implikuar edhe Kisha Ortodokse Serbe e cila në vend se të kërkonte paqe midis popujve, "bekonte" vullnetarët serbë dhe i motivonte për luftë. Agresion i hapur i serbëve ndaj shqiptarëve shpërtheu më 24 prill 1986 në tubimin e serbëve në Fushë Kosovë ku ishte prezent Slobodan Milosheviçi. Aty u inskenua një ndërhyrje e policisë ndaj turmave serbe për të krijuar pretekstin se serbët po dhunoheshin nga organet e rendit. Në atë moment, Milosheviçi e ndërpreu mbledhjen që po mbante me përfaqësuesit politikë, doli jashtë dhe iu drejtua turmës me fjalët: "Askush nuk guxon t'ju rrahë". Kurse turma e ngazëllyer me ovacione thërriste emrin e Slobodan Milosheviçit. Ky moment shënon nisjen e ngritjes së hovshme të tij në karrierën politike në Serbi dhe Jugosllavi.<sup>7</sup> Pra Milosheviçi duke shfrytëzuar situatën në Kosovë dhe duke instrumentalizuar serbët lokalë u shndërrua në një lider të pakontestueshëm, me autoritet dhe i gjithëpushtetshëm në Serbi. Mitingjet e tij me tone nacionaliste vazhduan edhe gjatë viteve në vijim, sidomos në përvjetorët e "Betejës së Kosovës".<sup>8</sup> Milosheviçi konsideronte se Kushtetuta e Jugosllavisë e vitit 1974 e ka dobësuar sovranitetin e Serbisë mbi Kosovën dhe Vojvodinën, dhe kjo është bërë me qëllim nga regjimi i Titos për ta dobësuar Serbinë.<sup>9</sup> Dhuna dhe represioni serb në Kosovë shënoi shkallë të lartë të zhvillimit që nga akti antikushtetues i Kuvendit të Republikës së Serbisë i vitit 1989, me të cilin u suprimua autonomia e KSA të Kosovës që ishte e garantuar me Kushtetutën e vitit 1974. Veprimet antikushtetuese i dhanë mundësi Serbisë të shpallte "krijimin e Serbisë unike"

<sup>5</sup> "Veçer", Intervju z Ibrahimom Rugovo, "Naj rečejo, da živim v diktaturi" Maribor 22.4.1989.

<sup>6</sup> "L'Unita", Intervista a Ibrahim Rugova, "Questa è una rivolta popolare, Belgrado non la vuole capire", Roma, 30.3.1989.

<sup>7</sup> Noel Malcolm, *Kosovan jë histori e shkurtër*, Prishtinë 1998, f. 356.

<sup>8</sup> Beteja e Kosovës e vitit 1389, ishte luftë në mes popujve ballkanikë dhe Perandorisë Osmane. Betejën e fitoi P. Osmane, kurse Milosheviçi dhe liderët serbë u munduan ta tjetërsojnë duke e quajtur luftë serbo-osmane dhe e manipuluan skajshëm duke e keqpërdorur politikisht.

<sup>9</sup> Janusz Bugajski, *Ngritja e Kosovës... f. 23.*

që nënkuptonte bashkimin e KSA të Kosovës dhe KSA të Vojvodinës me Republikën e Serbisë. Kosovës më këtë rast iu hoqën shumë të drejta kushtetuese dhe ndër të më të rëndësishmet ishin policia, planifikimi ekonomik, drejtësia, mbrojtja territoriale dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.<sup>10</sup> Në këto rrethana, përderisa në Beograd festohej, në Kosovë shqiptarët po manifestonin indinjatën dhe kundërshtimin e tyre përmes protestave dhe demonstratave. Ndërhyrja brutale e policisë ndikoi që këto protesta të rezultonin me shumë të arrestuar, të marrë në biseda informative, të rrahur dhe të burgosur shqiptarë. Ata trajtoheshin nga policia, sigurimi shtetëror serb dhe instanca të tjera të ndjekjes në mënyrat më çnjerëzore. Qëllimi ishte që të arrestuarit dhe të burgosurit të pranonin se u takonin grupeve të ndryshme ilegale nacionaliste e separatiste që luftonin kundër “shtetit ligjor të Serbisë dhe Jugosllavisë”.<sup>11</sup> Ndaj këtyre veprimeve çnjerëzore dhe antikushtetuese reagoi elita intelektuale e Kosovës që ishte pjesë e forumeve të ndryshme politike e jopolitike dhe opinioni i gjerë publik, i cili u solidarizua dhe përkrahu me forcë shfaqjen e pakënaqësisë qytetare përmes protestave paqësore në të gjitha qytetet e Kosovës. Kurse serbët dhe malazezët e Kosovës në vend të solidarizimit dhe reagimit kundër dhunës u vunë në shërbim të politikës ditore duke përkrahur masat e dhunshme policore ndaj qytetarëve shqiptarë. Lidhur me këto akuza dhe tortura Ibrahim Rugova ishte shprehur se: “këto etiketa nuk e shprehin realitetin, por ishin kualifikime për të justifikuar represionin, sepse ato po mbysin ide, po e mbysin realitetin, po mbysin edhe njerëz fizikisht, por edhe në pikëpamje psikike, sociale...”<sup>12</sup>

Pavarësisht nga dhuna dhe represioni i pashembullt ndaj popullsisë civile, shqiptarët befasuan opinionin ndërkombëtar me sjelljen e tyre qytetëruese. Proklamimi i politikës paqësore me protesta kundër dhunës, realizimi i synimeve politike me dialog dhe kërkesa për demokratizimin e Kosovës krijuan simpati ndaj shqiptarëve në Evropë dhe SHBA. Politika paqësore dhe vlerësimet pozitive ndaj saj çdo ditë e më shumë i legjitimonin kërkesat e shqiptarëve të Kosovës.<sup>13</sup> Elita intelektuale e kishte të qartë se sensibilizimi dhe ndërkombëtarizimi i çështjes

<sup>10</sup> “Der Spiegel”, Interview mit Ibrahim Rugova, “Die serben kommen als Rächer wieder”, nr. 26, Hamburg 1989.

<sup>11</sup> Raportet e KMDLNJ për shkëljen e lirive dhe të drejtave të shqiptarëve nga ana pushtetit të Serbisë dhe Jugosllavisë në Kosovë; KMDLNJ është formuar më 14 dhjetor 1989 nga një grup i veprimtarëve për të drejtat e njeriut në Kosovë.

<sup>12</sup> “Fjala”, Prishtinë më 15 maj 1990.

<sup>13</sup> Oliver Jens Schmit, *Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*, Prishtinë 2012, f. 248.

së Kosovës mund të arrihej vetëm përmes politikës paqësore dhe krijimit të miqve në politikën ndërkombëtare. Targeti i kësaj politike ishte fitimi i përkrahjes nga SHBA-ja, Britania e Madhe, Gjermania, Italia dhe Franca si bartësit kryesorë të politikës ndërkombëtare dhe frymëzues të demokracisë liberale.

Me gjithë kundërvënien paqësore, Serbia vazhdonte me masa agresive dhe shumë të dhunshme ndaj shqiptarëve të arrestuar dhe burgosur. Torturat ishin nga më të ndryshmet duke filluar që nga maltretimet psikike, rrahja në pjesë të ndjeshme të trupit dhe metoda të tjera të torturës.<sup>14</sup> Një formë tjetër e dhunës dhe represionit serb ndaj shqiptarëve ishte edhe helmimi masiv i nxënësve dhe studentëve shqiptarë me helme të luftës në periudhën mars-maj 1990, në klasat dhe shkollat ku ata mbanin mësim<sup>15</sup>. Këto ngjarje nxitën reagimin e komunitetit ndërkombëtar, sidomos të organizatave që merreshin me liritë dhe të drejtat e njeriut në Evropë dhe SHBA. Pas analizave të mostrave të të helmuarve doli se nxënësit shqiptarë ishin helmuar me helme luftime.<sup>16</sup> Ky fakt e tronditi botën demokratike, e cila i gjykoi me forcë këto veprime çnjerëzore të Serbisë, të cilat i konsideroi të papranueshme. Metodot e përdorura nga policia sekrete serbe ngjanin në helmimin dhe mbytjen e hebrenjve në dhomat e gazit në kohën e holokaustit në periudhën e Luftës së Dytë Botërore. Ndërsa Serbia u mundua që rastet e helmimeve t'i proklamonte si aktrim të shqiptarëve.

Protestat, dhunën, helmimet, arrestimet burgosjet dhe veprimet tjera të Serbisë dhe policisë federale të Jugosllavisë, media ndërkombëtare i trajtonte në faqet e para të edicioneve të tyre. Në kanalet kryesore televizive dhe në ballinat e gazetave prestigjioze shfaqeshin çdo ditë pamje nga trajtimet më çnjerëzore që ju bëheshin shqiptarëve nga policia serbe dhe ajo federale duke mos kursyer edhe përdorimin e forcës ushtarake për arritjen e qëllimeve politike në shekullin e civilizimit dhe arritjet kulmore të demokracisë liberale në Evropë dhe SHBA.<sup>17</sup> Opinioni publik dhe politik ndërkombëtar, fillimisht ndjeu dhimbje dhe keqardhje për ngjarjet në Kosovë, dhunën dhe represionin

---

<sup>14</sup> Më gjerësisht, Raportet ditore dhe njoftimet e Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut (KMLDNJ) në Prishtinë.

<sup>15</sup> Frashër Demaj, *Afrim Gjuraj, Jeta dhe vepra*, Prishtinë 2009, f. 62.

<sup>16</sup> Më gjerësisht shih: Bajram Shatri, *Arsimi Shqip në Kosovë 1990-1999*, Shtëpitë Shkolla, sfidat, arritjet dhe aspiratat, Prishtinë 2010; Bajram Shatri, *Arsimi dhe shkollat e mesme në Kosovë në shekullin XX*, Zhvillimi i arsimit në shekullin XX, vëll. 1,2,3,4,5, Prishtinë 2019.

<sup>17</sup> Ksenofon Krisafi, *Lufta e Kosovës në labirintet diplomatike*, Tiranë 2018, f. 110.

serb dhe jugosllav ndaj shqiptarëve të Kosovës. Por ndërkohë këto ndjenja u kthyen në simpati, solidaritet dhe përkrahje ndaj një populli i cili dhunës po i përgjigjej me protesta e demonstrata paqësore. Simpatia e pakursyer kolektive, mbështetja dhe solidarizimi i komunitetit ndërkombëtar në qarqet politike, diplomatike, mediale krijuan një lloj përgjegjësie ndërkombëtare sa i takon sensibilizimit dhe ndërkombëtarizimit të çështjes së Kosovës, fillimisht si shkelje e lirive dhe të drejtave të njeriut e më vonë si shkelje e të drejtave të një populli i cili po kërkonte liri dhe pavarësi nga një shtet federal që ushtronte dhunë ndaj tyre dhe i cili po shpërbëhej me hapa të shpejtë. Mirëpo kishte edhe shefa shtetesh dhe kryeministra të vendeve perëndimore që e shihnin Kosovën si çështje të brendshme të Serbisë dhe tërhiqnin vëmendjen se statusi i Kosovës duhet të mbetet krahinë autonome dhe jo republikë me të drejtë shkëputje.<sup>18</sup>

Mirëpo pavarësisht nga zërat skeptikë që vinin nga politika ndërkombëtare, në shenjë të kundërpërgjigjes ndaj suprimimit të autonomisë së Kosovës, delegatët e Kuvendit të Kosovës u mblodhën më 2 korrik 1990 për të mbajtur seancë plenare. Kuvendi i Kosovës ishte i rrethuar me pjesëtarë të policisë dhe sigurimit shtetëror të Serbisë dhe Jugosllavisë.<sup>19</sup> Delegatët shqiptarë nuk u lejuan të futeshin në ambientet e Kuvendit për të ushtruar të drejtën e tyre dhe obligimet kushtetuese. Për këtë arsye ishin të shtrënguar që në hyrje të Kuvendit të Kosovës të miratojnë Deklaratën Kushtetuese, sipas së cilës Kosova shpallej Republikë në kuadër të Federatës apo Konfederatës së Jugosllavisë, varësisht për cilën nga këto variante do të vendosnin subjektet kushtetuese të Jugosllavisë (Sllovenia, Kroacia, Bosnjë e Hercegovina, Mali i Zi, Serbia, Kosova, Vojvodina dhe Maqedonia)<sup>20</sup>. Kuvendi i Kosovës me këtë akt legjitim dhe legal në kuadër të strukturës së federalizmit multinacional të Federatës Jugosllave vendosi barazinë politiko-juridike të Kosovës me njësitë e tjera të RSFJ-së.<sup>21</sup> Si kundërveprim ndaj shpalljes së Deklaratës Kushtetuese më 5 korrik, Kuvendi i Serbisë suprimoi Kuvendin e Kosovës, Këshillin Ekzekutiv, institucionet administrative e gjyqësore, mbylli Radiotelevizionin e Prishtinës, ndaloi gazetën “Rilindja”, të vetmen në gjuhën shqipe dhe ndërmori masa të

<sup>18</sup> Oliver Jens Schmit, *Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike...* f. 252.

<sup>19</sup> Jusuf Bajraktari, “*Dimensionit historik i pavarësisë së Kosovës*” botuar në Pavarësia e Kosovës dhe sfidat e shtetndërtimit, ASHAK, Prishtinë 2019, f. 15.

<sup>20</sup> Arkivi i Institutit të Historisë-Prishtinë, më tej AIHP, Shih: Deklarata Kushtetuese e 2 Korrikut 1990.

<sup>21</sup> Arsim Bajrami, Florent Muçaj, *E Drejta Kushtetuese*, Prishtinë 2018, f. 215.

tjera të dhunshme kudo nëpër institucione publike. Shqiptarët nuk ndaluan as pas këtyre veprimeve të dhunshme sepse kërkohet që të ndërmerreshin hapa të tjerë për harmonizimin legjislativ në përputhje me statusin e ri politik të Kosovës. Për këto veprime të Serbisë u njoftuan ambasadat e shteteve të huaja në Beograd dhe u ndërmor një fushatë sensibilizuese për të vënë në dijeni faktorin ndërkombëtar për shkeljet kushtetuese që po bënte Serbia me rastin e dhunimit të së drejtës së Kosovës që ia garantonte Kushtetuta e Jugosllavisë.

Një vijimësi të veprimeve politike pas shpalljes së Republikës së Kosovës, më 7 shtator 1990 në Kaçanik delegatët e Kuvendit të Kosovës, pa u hetuar nga policia serbe u tubuan në qytezën e Kaçanikut dhe miratuan Kushtetutën e Republikës së Kosovës siç njihet ndryshe Kushtetuta e Kaçanikut<sup>22</sup>. Kaçaniku u zgjodh si vendtakim i delegatëve kosovarë për shkak se konsiderohej vend më i sigurt dhe larg syve të sigurimit shtetëror dhe policisë serbe. Delegatët udhëtuan privatisht duke ndjekur rrugë të ndryshme lokale deri në Kaçanik. Në këtë mbledhje delegatët e të tri dhomave aprovuan edhe dokumentet përcjellëse dhe nxorën Ligjin mbi zgjedhjet, si dhe disa vendime të rëndësishme politike.

Bazuar në Kushtetutën e Kaçanikut, nga 26 deri më 30 shtator të vitit 1991 u organizua referendumi për Kosovën shtet i pavarur dhe Sovran. Mbi 99% të zgjedhësve nga 87% të trupit elektoral që përveç shqiptarëve morën pjesë edhe qytetarë nga komunitete e tjera etnike si boshnjak, turq e komunitet RAE<sup>23</sup>, u deklaruan për Kosovën shtet sovran dhe i pavarur. Ky referendum u finalizua me shumë sukses jo vetëm për shkak të rezultateve absolute pozitive, por edhe për faktin se nuk u arrit të pengohej nga policia serbe pavarësisht se në disa raste i kishin rënë në gjurmë dhe kishin konfiskuar kuti të mbushura me fletëdeklarime dhe kishin arrestuar përgjegjësit nëpër vende të votimit. Rezultatet e referendumit dhe informatat e plota për mbarëvajtjen dhe pengesat nga policia serbe që kishte pasur në këtë proces u bënë publike. Me këto rezultate u njoftua edhe bashkësia ndërkombëtare, qarqet politike dhe jopolitike, si dhe organizatat që merreshin me liritë dhe të drejtat e njeriut. Pa u mbushur një vit nga referendumi, më 24 maj 1992, në pajtim me Kushtetutën e Kaçanikut dhe amendamentet kushtetuese që buronin nga kjo Kushtetutë, u organizuan zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale me të cilat synohej të legjitimohej rendi

<sup>22</sup> AIHP, Kushtetuta e Republikës së Kosovës e miratuar më 7 shtator në Kaçanik.

<sup>23</sup> Komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian-RAE u konsolidua dhe mori këtë emër pas luftës së vitit 1999.

kushtetues dhe demokratik në Republikën e Kosovës<sup>24</sup>. Shumicën absolute i fitoi Lidhja Demokratike e Kosovës, por ulëse fituan edhe disa parti të tjera, si Partia Fshatare e Kosovës, Partia Socialdemokrate, Partia Parlamentare e Kosovës, Partia Shqiptare Demokristiane, Partia e Boshnjakëve (SDA), Partia turke etj. Mbi bazën e rezultateve zgjedhore u konstituua Parlamenti i Republikës së Kosovës, u zgjodh Qeveria e Kosovës e drejtuar nga dr. Bujar Bukoshi, kurse president i Republikës së Kosovës u zgjodh dr. Ibrahim Rugova. Këto institucione për popullsinë Kosovës ishin legjitime, por nuk u njohën nga bashkësia ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe shpalljen e Republikës së Kosovës<sup>25</sup>. I vetmi shtet që njohu këto akte politiko-juridike ishte Republika e Shqipërisë në qershor të vitit 1991 në Mbledhjen e Kuvendit Popullor. Si rrjedhojë e seancës së Kuvendit Qeveria e Shqipërisë mbështeti referendumin për pavarësi të Kosovës dhe njohu e mbështeti Qeverinë e Kosovës me kryeministër Bujar Bukoshin.<sup>26</sup> As serbët lokalë nuk morën pjesë dhe nuk i pranuan rezultatet e zgjedhjeve dhe autoritetin e institucioneve të Republikës së Kosovës. Ata i quajtën këto institucione si paralele dhe ilegale në raport me pushtetin e Serbisë në Kosovë. Sidoqoftë dr. Ibrahim Rugova u njoh dhe u trajtua si lider i shqiptarëve të Kosovës, dhe kjo i dha mundësi që të përfaqësonte Kosovën brenda dhe në politikën ndërkombëtare, të takonte deputetë, senatorë, kongresmenë, ministra, kryeministra, presidentë dhe bartës fronesh të monarkive të cilët i njoftonte me situatën në vend dhe bënte sensibilizimin e çështjes së Kosovës në skenën politike e publike ndërkombëtare.<sup>27</sup> Përveç liderëve botërorë dhe bartësve të funksioneve shtetërore, Rugova arriti ta takonte edhe Papa Gjon Pali II në Vatikan nga i cili kishte kërkuar që ta ndihmonte Kosovën dhe popullin e saj për t'u çliruar nga Serbia. Përfaqësuesit e Kosovës pavarësisht nga vullneti dhe pretendimet të tyre, nuk arrinin gjithmonë që të kenë mirëkuptim për kauzën e tyre. Shpeshherë në qarqet ndërkombëtare, kryesisht ruse dhe proserbe e jugosllave, Kosova krahasohej padrejtësisht me disa zona të krizës në botë duke u konsideruar si “rast universal”. Megjithatë Kosova për shumë arsye historike, politike, demografike, gjeografike dhe

<sup>24</sup> Këto zgjedhje Serbia i konsideronte ilegale dhe paralele kurse shqiptarët i konsideronin si zgjedhje legjitime në bazë të të cilave krijuan institucionet e pavarura kosovare.

<sup>25</sup> Arkivi i Kosovës-Agjencioni Shtetëror i Arkivave të Republikës së Kosovës, më tej (AK) Referendumi për Kosovën Shtet i Pavarur dhe Sovran 26-30 shtator të vitit 1991.

<sup>26</sup> Mero Baze, *Shqipëria dhe lufta në Kosovë*, Tiranë 1998, f. 28

<sup>27</sup> Më gjerësisht: Munish Hyseni, *Kështu foli Rugova* (Intervista 1990-2005), Prishtinë 2019.

juridiko-kushtetuese ishte rast “Sui Generis” dhe kërkonte trajtim adekuat të bazuar në këto argumente.<sup>28</sup>

Sfidat për sensibilizimin dhe ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës dhe sigurimin e përkrahjes për pavarësinë e saj ishin nga më të ndryshmet.<sup>29</sup> Situatën e vështirësonte edhe më shumë fushata intensive e diplomacisë serbe kundër çështjes së Kosovës, meqë autoriteti i Jugosllavisë në marrëdhëniet ndërkombëtare ishte në nivel shumë të lartë. Antishqiptarizmi serb më së shumti gjente terren të “vendet e treta”, të cilat për arsye të mospasjes së informacioneve të duhura e të drejta dhe për shkak të autoritetit të RSFJ-së në “Lëvizjen e të Painkuadruarve”, problemin e Kosovës e quanin si problem të brendshëm të Serbisë dhe Jugosllavisë. Vështirësitë të shumta vinin edhe nga paradigma e krijuar nga tri momente definuese: e para, sepse bashkësia ndërkombëtare fillimisht ishte kundër zhbërjes së ish-Jugosllavisë, sepse druhej nga shpërthimi i konflikteve të armatosura dhe krijimi i precedentit, pra përpiqej me çdo kusht ta ruante atë; e dyta, çështja e Kosovës shihej e reduktuar në çështjen e të drejtave të njeriut, pra pa të drejtë për subjektivitet të pavarur dhe e treta, sepse në perceptimet e hershme ndërkombëtare Kosova shihej si çështje e brendshme e Serbisë<sup>30</sup>. Pra ishte shumë e vështirë të thyhen kornizat e ngurta të tabusë dhe paragjyqimit, si dhe shpërthimi i marginave të hekurta serbe dhe jugosllave që ishin pengesat më të fuqishme të depërtimit të së vërtetës për Kosovën dhe shqiptarët në një kohë kur potencialet e vetme ndihmuese në diplomacinë prokosovare ishin kapacitetet e kufizuara të Republikës së Shqipërisë, përmes Ministrisë së Jashtme e ambasadave dhe miqtë jo të shumtë që kishte krijuar Kosova për një kohë të shkurtër.

Në këto rrethana të vështira por të bindur në filozofinë paqësore, me sensibilizimin dhe ndërkombëtarizimin e çështjes, pretendohesh shtimi gradual i përkrahjes ndërkombëtare, krijimi i miqësisë së ngushtë me SHBA-në, vënia e kontakteve të përhershme me kryeqendrat e Evropës dhe me vendet më të zhvilluara në botë<sup>31</sup>.

Sensibilizimit dhe ndërkombëtarizimit të problemit të Kosovës i kontribuan edhe aktivitetet e asociacioneve shqiptaro-amerikane që funksiononin në Uashington, New York dhe shtete të tjera amerikane,

---

<sup>28</sup> Më gjerësisht: Dr. Islam Lauka, *Kosovo a Universal case or Sui generis*, Tiranë 2007.

<sup>29</sup> Jusuf Bajraktari, “*Dimensioni historik i Pavarësisë së Kosovës...*” f. 16

<sup>30</sup> Edita Tahiri, *Diplomacia e Kosovës në periudhën e okupimit*, Kumtesë e lexuar në Simpoziumin shkencor “Çlirimi i Kosovës”, mbajtur më 12 qershor 2009 në Prishtinë, f. 7.

<sup>31</sup> Po aty.

si dhe aktiviteti i shqiptarëve në qytete të rëndësishme të Evropës Perëndimore, si në Berlin, Londër, Paris, Romë, Bruksel, Vjenë, Gjenevë, Bernë, Amsterdam etj. Rritja e nivelit të njohjes së çështjes së Kosovës në Washington D.C ishte pjesë e strategjisë së gjithmbarshme kosovare për ndërkombëtarizimin e kësaj çështjeje në qeveritë dhe parlamentet e shumë vendeve.<sup>32</sup> Mërgata shqiptare organizoi në Evropën Perëndimore dhe në SHBA protesta masive në shërbim të sensibilizimit të kauzës kosovare dhe denoncimit të dhunës dhe terrorit serb e jugosllav ndaj shqiptarëve që kërkonin liri e pavarësi. Shpresa të mëdha për përkrahje në Kongres, Senat dhe Departamentin e Shtetit kishte shfaqur Ibrahim Rugova, i cili mendonte se demokracitë perëndimore, në veçanti SHBA-ja do t'i kuptojnë drejt synimet e kosovarëve për çlirim nga Serbia dhe krijimin e shtetit demokratik. Gjithashtu ai ishte i bindur që "gandizmi" kosovar çdo ditë e më shumë po krijon simpati për mënyrën e rezistencës aktive dhe padëgjueshmërisë qytetare të shprehur përmes demonstratave dhe protestave paqësore, sado që manifestuesve paqësorë, Serbia i përgjigjej me dhunë policore. Si rezultat këtyre aktiviteteve në maj 1990 kongresmeni Tom Lantosh dhe Joe Dioguardi udhëhoqën një delegacion amerikan për vizitë në Kosovë. Ata shpërthyen kundër Milosheviçit duke e cilësuar atë tiran modern dhe armik të demokracisë në Jugosllavi. Tom Lantosh me cilësitë e tij prej diplomati shfaqti tone admirimi dhe përkrahje për politikën shqiptare dhe aspiratat e kosovarëve, kurse Dioguardi u pozicionua hapur në favor të shqiptarëve dhe kauzës së tyre kombëtare. Ai në takim me Ibrahim Rugovën dhe përfaqësuesit e partive politike në Kosovë shfaqti hapur përkrahjen e rezervë ndaj kauzës kosovare duke theksuar se "kosovarët kanë miq në Amerikë dhe udhëheqës të mirë si dr. Rugova në Kosovë". Mirëpo fjalitë Dioguardit që e tmerruan më së shumti regjimin e Beogradit ishin citimi i vargjeve të Nolit "Mbahu nënë mos ke frikë se i ke djemtë në Amerikë" dhe "Rroftë Kosova".<sup>33</sup> Për qëndrimet e tij pro Kosovës në korrik 1990 Dioguardit zyrtarisht iu ndalua nga ana e regjimit të Milosheviçit hyrja në Jugosllavi, me motivacionin: për "akte armiqësore ndaj shtetit".<sup>34</sup>

<sup>32</sup> David L. Phillips, *Çlirimi i Kosovës*, Diplomacia Këmbëngulëse dhe ndërhyrja e SHBA-së, Tetovë 2015, f. 83.

<sup>33</sup> Adnan Merovci, Fakte (Emission dokumentar), *Vizita e kongresistëve Tom Llantosh dhe Xho Diogardi në Kosovë*, 1990, Pjesa 1, 6 dhjetor 2021.

<sup>34</sup> Albanian American Civil League, <http://www.aacl.com/our-25-year-history>, shikuar më 03.02.2018.

Më 29 gusht të vitit 1990 me kërkesën e Ligës Qytetare shqiptaro-amerikane, Bob Dole dhe gjashtë senatorë të tjerë të SHBA-së vizitojnë Prishtinën, duke parë nga afër brutalitetin e Milosheviçit dhe gjendjen e popullatës shqiptare që po vuante nga represioni shtetëror dhe masat e dhunshme të instaluar nga Serbia.”<sup>35</sup> Delegacioni amerikan i kryesuar nga Doll, në përbërjen e vet kishte senatorët Xhon Varner, Alfons D’Amato, Xhek Gorn, Don Nikëlls, Stiv Sims dhe Keni Mak të shoqëruar nga ambasadori i SHBA-së në Beograd Uoren Zimmerman.<sup>36</sup> Në Prishtinë ata u priten nga delegacioni shqiptar i kryesuar nga Ibrahim Rugova dhe përfaqësues të tjerë të partive politike shqiptare, sindikatave të pavarura, të Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, gazetarë, përfaqësues nga shoqëria civile etj. Në mesin e emrave më të njohur ishin: Fehmi Agani, Adem Demaçi, Rexhep Qosja, Hivzi Islami, Idriz Ajeti, Veton Surroi, Luljeta Pula, Shkëlzen Maliqi, Gazmend Pula, Bujar Bukoshi, Ramadan Kelmendi, Agim Hyseni, Avni Spahiu, Blerim Shala etj. Delegacionit amerikan iu ofruan argumente të mjaftueshme që faktin shkeljet kushtetuese të Serbisë me rastin e suprimimit të autonomisë dhe institucioneve të tjera të Kosovës dhe dhunën e represionit serb ndaj shqiptarëve, protestues paqësorë, që kërkonin të drejtat e tyre. Këto të vërteta u përcollën me dokumentacion përkatës dhe fotografi si dëshmi për senatorët amerikanë, Stejt Departamentin dhe presidentin e SHBA-së. Nga ana tjetër ata u takuan edhe me të dërguarit e Serbisë që kryesoheshin nga nënkryetari i qeverisë së Serbisë Momqillo Trajkoviç, Radoslav Zllatanoviç, përfaqësues i “Këshillit për të vërtetën për Kosovën”, Mirko Çupiç, nënkryetar i “Këshillit”, Atanasije Jevtiç përfaqësues i Patrikanës së Pejës dhe përfaqësues të tjerë politikë serbë.<sup>37</sup> Takimi me përfaqësuesit serbë ishte shumë i acaruar, meqë serbët përveç shovinizmit antishqiptar nuk kishin ofruar asnjë argument që fliste për ndonjë agresion konkret të shqiptarëve ndaj serbëve. Zhgënjimin e tyre e përjetuan edhe senatorët amerikanë, të cilët në takim por edhe në konferenca të shtypit denoncuan shkeljen e lirive dhe të drejtave qytetare të shumicës së shqiptarëve nga pakica serbe përmes pushtetit të dhunshëm serb në Kosovë.<sup>38</sup>

---

<sup>35</sup> Howard Clark, *Civil Resistance in Kosovo*, London 2000, f. 89.

<sup>36</sup> Adnan Merovci, Fakte (Emission dokumentar) *Vizita historike e delegacionit amerikan në krye me senatorin Bob Doll, 1990*, Pjesa 1, 21 dhjetor 2021.

<sup>37</sup> Adnan Merovci, Fakte (Emission dokumentar) *Vizita historike e delegacionit amerikan në krye me senatorin Bob Doll, 1990*, Pjesa 1, 21 dhjetor 2021

<sup>38</sup> Po aty.

Diogardi, Robert Doll dhe senatorë e kongresmenë të tjerë merrnin pjesë edhe në tubimet përkrahëse të komunitetit shqiptaro-amerikan në SHBA. Ata mbanin kontakte të vazhdueshme me lobin shqiptar në SHBA që identifikohesh me emra si Xhim Xhema, Bruno Selimaj, Harry Bajraktari, etj. Më 25 shtator, Rugova ndërmoi një udhëtim drejt SHBA-së me shpresë të takonte kongresmenë, senatorë dhe funksionarë të tjerë të Departamentit të Shtetit për t'i njoftuar me situatën e fundit në Kosovë dhe për të kërkuar përkrahjen e tyre. Në Washington ai takoi Bob Dollin, Joseph Biden dhe senatorë të tjerë të cilët u njoftuan për helmimin masiv të nxënësve shqiptarë në shkollat e Kosovës dhe për dhunën e policisë serbe ndaj qytetarëve shqiptarë.<sup>39</sup> Takimet e shumta dhanë rezultate konkrete sa i takon ridimensionimit dhe trajtimit të çështjes së Kosovës, nga një problem i Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, në një çështje me bazë nacionale e një populli të robëruar, i cili kërkonte zgjidhje demokratike duke respektuar parimin e vetëvendosjes. Këtij konstatimi i jepte shpresë edhe Janusz Bugajski, një personalitet i shquar i jetës publike amerikane i cili kishte krijuar eksperiencë solide me rastin e qëndrimit të tij në Jugosllavi. Bugajski ishte përfshirë në vitin 1990 kur shkoi në Serbi si pjesëtar i një misioni vëzhgues të zgjedhjeve, të organizuar nga Instituti Ndërkombëtar Republikan, mirëpo meqë shqiptarët nuk morën pjesë në zgjedhjet serbe ai qëndroi në Prishtinë ku takoi personalitete të jetës politike dhe publike. Duke njohur rrethanat konkrete në terren ai konstatonte se “Kosova nuk ishte vetëm një çështje e të drejtave të njeriut, ajo ishte çështje e sovranitetit dhe e vetëpërcaktimit”.<sup>40</sup>

Lëvizja për pavarësi e viteve 1990, e udhëhequr nga dr. Ibrahim Rugova ishte një projekt madhor kombëtar shqiptar që rezultoi nga fuqia mendore e elitës intelektuale e politike shqiptare si kundërpërgjigje ndaj okupimit të Kosovës nga Serbia. Rugova deklaronte se është optimist racional, pra ai nuk mbërthehej nga optimizmi i tepruar dhe nuk ekzagjeronte rezultatet e takimeve të tij dhe delegacioneve kosovare me diplomatë të rëndësishëm të rangut të lartë ndërkombëtar.<sup>41</sup> Koncepti i tij bazohej në demokracinë perëndimore dhe vlerat e saj duke besuar se “Kosova nuk mund të jetë oazë e pushtuar në detin e Evropës

<sup>39</sup> David L. Phillips, *Çlirimi i Kosovës...* f. 85.

<sup>40</sup> Po aty f. 87.

<sup>41</sup> “Kosovarja”, Prishtinë, qershor 1990, Intervistë me dr. Ibrahim Rugova, kryetar i LDK-së.

Demokratike” dhe “... durimi i ka kufijtë e vet dhe ai do të na shpie drejt fitores...” deklarohej Rugova në paraqitjet e tij publike.<sup>42</sup>

Pra, ai në diskursin e tij politik e mbështeste politikën paqësore dhe dialogun si mjet për zgjidhjen e çështjes, mirëpo nuk e përjashtonte asnjëherë rrezikun dhe domosdonë e mobilizimit të shqiptarëve në rast lufte me Serbinë. Politika rugoviane shpeshherë është quajtur si politikë qyqare nga qarqe të ndryshme politike sidomos jashtë Kosovës, të cilat i takonin krahut marksist-leninist, por, në të vërtetë, shumica prej tyre ishin entuziastë që situatën në Kosovë e përjetonin me emocion duke mos e njohur realitetin, domosdoshmërinë për ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës, fuqinë dhe pafuqinë në rast kryengritje dhe rrethanat ekzistuese në vend. Politikën e tij paqësore, Rugova e arsyetonte me faktin se: “Nuk më duhet Kosova pa shqiptarë“, kurse sinjalet prej “radikali” i dërgonte përmes konceptit të traditës që “duhet mbrojtur pragu i shtëpisë“. Pra ai nuk e përjashtonte faktin që Kosova një ditë duhet të luftojë për lirinë e saj, por ai synonte që para luftës me armë duhet fituar lufta diplomatike. Në këtë rast historia i dha të drejtë konceptit rugovian, sepse fuqia më e madhe ushtarake në historinë e njerëzimit u vu në mbrojtje të kosovarëve duke bombarduar një shtet sovran siç ishte Serbia dhe “RFJ”, dhe kjo ndodhi si rezultat i ndërkombëtarizimit të problemit të Kosovës dhe krijimit të miqve ndërkombëtarë pa anashkaluar këtu edhe rolin vendimtar të luftës çlirimtare të shqiptarëve.

Okupimi klasik serb jo vetëm që nuk arriti t’i gjunjëzojë shqiptarët, por përkundrazi ripërtëriu fuqinë dhe mobilizoi potencialet e tyre për organizimin e lëvizjes për liri, pavarësi dhe demokraci<sup>43</sup>. Lidhja Demokratike e Kosovës kishte hartuar edhe projektin rezervë përveç dy opsioneve të më hershme politike (federatë apo konfederatë), ku përfshihej opsioni i bashkimit kombëtar si një zgjidhje e natyrshme që mund të bëhej e mundur në rast të hapjes së çështjes së kufijve në Ballkan.<sup>44</sup> Madje në vitin 1991-1992 kishte filluar edhe përgatitje për vetëmbrojtje. Për këtë qëllim në tetor të vitit 1991, bazuar në një marrëveshje gjentelmene në mes të presidentit të Republikës së Shqipërisë Ramiz Alia

---

<sup>42</sup> “Zëri i Rinisë”, Prishtinë, 11 gusht 1990, Intervistë me dr. Ibrahim Rugova, kryetar i LDK-së.

<sup>43</sup> Edita Tahiri, *Diplomacia e Kosovës në periudhën e okupimit...*, f. 7.

<sup>44</sup> AIHP, QIK (Qendra Informativ e Kosovës), Shih “Deklarata politike e Këshillit Koordinues të Partive Politike Shqiptare në Jugosllavi” e miratuar më 12 tetor 1991, Albanian Democratic Movement in Former Yugoslavia, Documents: 1990-1993, Kosova Information Center, Prishtina 1993, 21-23.

dhe dr. Ibrahim Rugovës kishin shkuar në Shqipëri për stërvitje ushtarake dy grupe rekrutësh të udhëhequr nga Sali Çekaj ku bënë pjesë edhe Adem Jashari, Zahir Pajaziti dhe personalitete të tjera që më vonë dolën të jenë bartës të luftës për liri e pavarësi. Shumica nga këta vullnetarë nga Kosova, Maqedonia dhe mërgata udhëtuan në Shqipëri përmes kanaleve të sigurta duke ndjekur rrugët nga Shkupi e Prishtina drejt Zvicrës për të kaluar pastaj në Trieste dhe prej andej në Durrës dhe direkt në kampin e ushtrimeve ushtarake në Surrel të Tiranës.<sup>45</sup>

Stërvitja e rekrutëve nuk u arrit të mbahej e fshehtë meqë, disa kryeqytete evropiane kishin ushtruar presion ndaj qeverisë shqiptare për mbylljen e kampeve të stërvitjes së rekrutëve nga Kosova, kurse ambasada “jugosllave” dhe ajo ruse i kishin dërguar nota diplomatike qeverisë shqiptare ku e akuzonin se po stërviste “terroristë” për të sulmuar një vend fqinj.<sup>46</sup>

Në vitin 1992 u organizuan nëpër fshatra dhe qytete, roje nate dhe rekrutime grupesh të gatshme për rezistencë të armatosur në rast se Serbia do të tentonte të hapte front të drejtpërdrejtë me shqiptarët. Mirëpo si shkak pasojë e dekonspirimit, shumë drejtues, oficerë ushtarakë dhe policorë shqiptarë u arrestuan, burgosën dhe u dënuan me shumë vjet burg nga ana e Serbisë. Në rrethanat e shtimit të represionit serb, Rugova i druhej përhapjes së luftës nga Kroacia dhe Bosnjë e Hercegovina dhe duke pasur parasysh se Kosova ishte e papërgatitur për luftë, ai në pamundësi ishte i detyruar të ndiqte kursin paqësor. Megjithatë ai në një nga deklaratimet e tij publike shprehej: “... ne jemi këtu, do të qëndrojmë, duam dhe mund të mbrohemi...”.<sup>47</sup> Pra Rugova nuk ishte pacifist me çdo kusht, por politikën paqësore e shihte si mundësi të vetme për të avancuar çështjen e Kosovës në diplomacinë ndërkombëtare. Ai gjithashtu ishte i bindur që nëse radikalizohej diskursi politik i komunikimit me ndërkombëtarët do të humbte simpatinë e krijuar për kursin e filluar të politikës paqësore dhe dialogut për arritjen e qëllimeve politike. Në këto qëndrime politike ai mentorohet edhe nga politika e jashtme e SHBA-së, e cila përkrahte zgjidhje politike përmes negociatave.

Për sa i takon zgjidhjes me negociata të çështjes së Kosovës, shqiptarët kishin ideuar një platformë që përmbante dy parime kryesore: që negociatat të jenë të ndërmjetësuar nga një palë e tretë

<sup>45</sup> Marin Mema, Gjurme Shqiptare, (emision dokumentar) *Stërvitja në Shqipëri e grupeve të para ku mori jetë UÇK-ja 1991*, transmetuar më 19 nëntor 2022.

<sup>46</sup> Frashër Demaj, “Stërvitjet ushtarake në Shqipëri dhe hyrja e rekrutëve të armatosur në Kosovë nën drejtimin e Sali Çekajt”. Kumtesë e mbajtur në Pejë, 2.12.2021.

<sup>47</sup> “Zëri”, Prishtinë, 1 prill 1992, Intervistë me dr. Ibrahim Rugova.

ndërkombëtare me fuqi garantuese, duke kërkuar rolin udhëheqës të SHBA-së në bashkëpunim me BE-në; dhe që negociatat të zhvillohen mbi parimin e mosprejudikimit të statusit final të Kosovës. Përkrahje u kërkuar po ashtu për implementimin e diplomacisë preventive, përkatësisht për vendosjen e forcave të NATO-s që do të siguronin paqen, do të parandalonte një luftë me përmasa shkatërruese dhe të shmangte spastrimin etnik të shqiptarëve. Mirëpo për shkak të ligjeve ndërkombëtare ishte shumë e vështirë, pothuajse paimagjinueshme që Serbia të pranonte në mënyrë paqësore hyrjen trupave të NATO-s në Kosovë për të ruajtur paqen dhe stabilitetin meqë ajo e konsideronte Kosovën si pjesë të sovranitetit shtetëror të Serbisë. Shqiptarët e shihnin te SHBA-ja partnerin e fuqishëm i cili historikisht i kishte ndihmuar popujt e shtetet në nevojë. Këtë e simbolizonte edhe shembulli i presidentit Wudrou Wilson në përkrahje të shqiptarëve pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, në Konferencën e Paqes së Versajës (1919). Kurse politika serbe mbështetej në përkrahjen politike e diplomatike të Rusisë për shkak të marrëdhënieve historike midis tyre dhe interesave të përbashkëta rajonale. Politikës ruse i duhej një Serbi e fortë në Ballkan që përmes saj të fuqizonte pozitat e veta strategjike, duke i mbyllur rrugët e ndikimit të SHBA-së dhe Evropës Perëndimore. Dhe pikërisht Kosova u gjet si terren dhe kufi gjeografik i ndeshjes së interesave amerikane dhe atyre ruse.

Në vitet 1990-1993, simpatia perëndimore e krijuar për rezistencën aktive paqësore në Kosovë nuk u shndërrua në mbështetje konkrete dhe të fuqishme politiko-diplomatike që mund ta zgjidhte këtë çështje. Diplomacia perëndimore mendohej t'i menaxhonte pritjet e shoqërisë kosovare, duke miratuar disa rezoluta ndërkombëtare dhe qëndrime që e dënonin dhunën e regjimit serb në Kosovë, por pa diskutuar për statusin final të Kosovës. Zhgënjimi i parë i kosovarëve ndodhi me rastin e mbajtjes së Konferencës së Paqes për Jugosllavinë në Hagë më 27 gusht 1991, ku u ftuan përfaqësuesit e republikave jugosllave, por jo edhe Kosova dhe Vojvodina, pavarësisht se sipas Kushtetutës së Jugosllavisë ishin element konstitutiv i kësaj Federate. Kosova nuk u përfshi as në projektplanet e paqes për Jugosllavinë. Konferenca themeloi Misionin e Komunitetit Evropian të Monitorimit dhe Komisionin e Arbitrazhit, i njohur ndryshe si Komisioni Badinter për të negociuar zgjidhjet e mundshme në kuadrin e shpërbërjes së Jugosllavisë.<sup>48</sup>

---

<sup>48</sup> Enika Abazi, "Çështja e Kosovës dhe diplomacia ndërkombëtare (1991-1999): një konflikti i parashikueshëm", Studime Historike 3-4, Tiranë 2013, f. 192.

Në dy konferencat vijuese ndërkombëtare në vitet '90 u dëshmuar qartë se rezistenca paqësore për arritjen e qëllimeve politike po rezultonte si një pritje naive dhe e stërzgatur. E para ishte Konferenca e Londrës, e cila u përjetua si fyerje dhe injorim nga ana e popullit të Kosovës, kurse e dyta ishte Konferenca e Dejtonit. Në vitin 1992 kishte shpresa se Kosova do të ftohej në Konferencën për Jugosllavinë, e cila do të mbahej në Londër, në muajin gusht.<sup>49</sup> Këto shpresa u bënë realitet në momentin kur u ftua dr. Ibrahim Rugova, që në atë kohë ishte zgjedhur kryetar i Kosovës.<sup>50</sup> Mirëpo ftesa ishte me hile, sepse delegacioni i Kosovës nuk mori pjesë aktivisht në punimet e konferencës, meqë nuk ishte i ftuar i barabartë me të tjerët. Për delegacionin e Kosovës ishte organizuar një dhomë e veçantë, e emëruar si "sallë dëgjimi" (*salla d'ecoute*).<sup>51</sup> Megjithatë delegacioni kosovar kishte rastin të bisedonte herë pas here me Lordin Karrington (Peter Alexander Ruper Carrington, 6th baron Carrington) që ishte udhëheqës i Konferencës së Londrës dhe me diplomatë të tjerë.<sup>52</sup> Për këtë arsye skeptikët dhe kundërshtarët politikë e kishin "këshilluar" Rugovën që të mos merrte pjesë në këtë Konferencë ku Kosova nuk po trajtohej me dinjitet dhe nuk ishte pjesëmarrëse aktive e Konferencës. Megjithatë presidenti Rugova vendosi që pavarësisht nga kritikrat, skepticizmi dhe statusi i të ftuarit, të merrte pjesë në një takim të rëndësishëm ndërkombëtar ku ishte e fokusuar e gjithë politika dhe diplomacia botërore. Ai në një nga intervistat e tij deklaronte: "Ne e pranuam ftesën më shumë për kooperim. Unë e kam thënë edhe publikisht se nuk jemi të kënaqur me statusin, por marrë në përgjithësi nuk mund të jemi të pakënaqur".<sup>53</sup> Rugova më tej vlerësoi se Konferenca e Londrës për shqiptarët ishte një hap përpara, ndërsa formimi i Grupit të posaçëm për Kosovën në Gjenevë është edhe një sukses i radhës në projektin kosovar për sensibilizimin dhe ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës. Edhe vizita e Sajrus Vensit dhe lordit Oven në Kosovë kanë rëndësi të veçantë,

<sup>49</sup> Më gjerësisht shih: Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar: Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*, Prishtinë 2009, f. 93-127.

<sup>50</sup> Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar: Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*, Prishtinë 2009, f. 103.

<sup>51</sup> *Po aty*, f. 104.

<sup>52</sup> <https://www.britannica.com/biography/Peter-Carrington-6th-Baron-Carrington-of-Upton>; <https://www.theguardian.com/politics/2018/jul/10/peter-carrington-lord-carrington-obituary>, hulumtuar me 3 maj 2022.

<sup>53</sup> "Zëri", Prishtinë, 26 shtator 1992, Intervistë me presidentin e Republikës së Kosovës dr. Ibrahim Rugova.

sepse pavarësisht nga qëndrimet e tyre, kjo vizitë u dha si lajm në mediet më prestigjioze botërore që nënkuptonte se në Kosovë ka një konflikt në mes popullsisë shumicë që po përpiqej për liri dhe demokraci dhe pushtetit të instaluar serb që ushtronte dhunë ndaj shqiptarëve. Ne do të kërkojmë që shqiptarët të kenë të drejtë plebishitare që të deklarohen për vetëvendosje, por do të bëjmë çmos që edhe më tej t'i shpëtojmë luftës shprehej Rugova më 6 nëntor të vitit 1992.<sup>54</sup> Shqiptarët duhet të qëndrojnë dhe të rezistojnë në rrugën që kanë zgjedhur, sepse çështja e Kosovës do të zgjidhet përmes një procesi që mund të jetë i gjatë dhe i mundimshëm.<sup>55</sup>

Pavarësisht nga mungesa e trajtimit të barabartë, politika kosovare po e fuste gradualisht në agjenda ndërkombëtare çështjen e Kosovës, po rriste simpatinë perëndimore dhe përkrahjen ndaj saj, po krijohte bindjen absolute se çështja e Kosovës ishte një problem që nuk mund të neglizhohej gjatë dhe kërkonte zgjidhje të shpejtë e substanciale.<sup>56</sup> Në të kundërtën, Kosova do të ishte bombë e kurdisur e cila në rast lufte rrezikonte të përfshinte edhe Shqipërinë e Maqedoninë, por mund të ndizte edhe konfliktet historike të vazhdueshme në mes të Turqisë dhe Greqisë. Prandaj diplomacia ndërkombëtare duke qenë e vetëdijshme për këtë situatë eksplozive, Kosovës i jepte shpresa, por pa e futur në agjenda të trajtimit të thelbit të çështjes së saj që ishte kërkesa për pavarësi nga Serbia.

Moment përcaktues që e sfidoi me sukses marginalizimin dhe i hapi rrugë ndërkombëtarizimit dhe trajtimit të çështjes së Kosovës si një problem ndërkombëtar ishte dalja e Presidenti *George H. W. Bush* me qëndrimin e “vijës së kuqe” për Kosovën në fund të vitit 1992.<sup>57</sup> Presidenti Bush në kujtimet e tij theksonte se, përherë ditën e niste me informimin nga CIA lidhur me ngjarjet në botë me “President’s Daily Brief” që ishte një përmbledhje me shkrim e raporteve dhe analizave të shërbimit të inteligjencës amerikane. Nga raportet e CIA-s shihet se

---

<sup>54</sup> “Bujku”, Prishtinë, 6 nëntor 1992, “*Qëndrojmë në opsionin tonë për Kosovën e pavarur dhe neutrale*”, Intervistë e presidentit të Kosovës dr. Ibrahim Rugova.

<sup>55</sup> “Bujku”, Prishtinë, 27 shtator 1993, *Organizimi ynë kërkon një reformim të brendshëm*, intervistë e presidentit dr. Ibrahim Rugova.

<sup>56</sup> Beqir Meta, “*Konteksti ndërkombëtar i rezistencës paqësore të shqiptarëve të Kosovës i udhëhequr nga Presidenti Rugova në vitet 90*”, botuar në Pavarësia e Kosovës dhe sfidat e shtetndërtimit, ASHAK, Prishtinë 2019, f. 29.

<sup>57</sup> AIHP, QIK (Qendra Informative e Kosovës), Shih “Deklarata politike e Këshillit Koordinues të Partive Politike Shqiptare në Jugosllavi” e miratuar më 12 tetor, 1991, Albanian Democratic Movement in Former Yugoslavia, Documents: 1990-1993, Kosova Information Center, Prishtina 1993, 21-23.

presidenti Bush ishte marrë edhe me zhvillimet në Kosovë, meqë sipas inteligjencës amerikane, Kosova ishte një potencial serioz që mund të shndërrohej në konfliktin e parë në RSFJ dhe përhapjen e shpejtë të luftës në Ballkanin Juglindor.<sup>58</sup> Ky qëndrim i presidentit amerikan u njoh edhe si “Kërcënim i Krishtlindjeve” që ishte vërejtja më serioze ndaj Serbisë dhe Jugosllavisë në rast të përshkallëzimit të dhunës në Kosovë. Disa muaj më vonë, Sekretari i Shtetit i Administratës Klinton, Warren Christopher, deklaroi se SHBA-ja është e shqetësuar, nëse dhuna serbe zgjerohet drejt Kosovës, ajo do të përfshinte në konflikt vende të tjera të rajonit si Shqipërinë, Greqinë dhe Turqinë. SHBA-ja është e bindur se duhet të parandalojnë zgjerimin e konfliktit që do të përfshinte aleatët tanë të NATO-s dhe të çonte pjesë të gjera të Evropës në luftë dhe ndoshta, siç ka ndodhur më parë, kjo do të eskalonte në një luftë botërore.<sup>59</sup> Christopher aludonte në “Atentatin e Sarajevës” (më 1914) nga i cili mori shkas fillimi i Luftës së Parë Botërore.

Sidoqoftë një mbështetje e tillë e fuqishme amerikane hapi perspektiva të mëdha sa i takon sensibilizimit dhe ndërkombëtarizimit të çështjes së Kosovës. Mirëpo pavarësisht paralajmërimeve amerikane, Serbia nuk pushoi së ushtruari dhunë, vrasje, arrestime, burgosje dhe trajtime tjera çnjerëzore ndaj shqiptarëve, e bindur gjithmonë se përkrahja ruse ndaj politikës serbe do të ishte ngadhënjyese në raport me përkrahjen e zbehtë të SHBA-së dhe Evropës Perëndimore ndaj shqiptarëve të Kosovës. Slobodan Milosheviçi pretendonte se diskursi politik e kërcënues i SHBA-së në raport me Serbinë më tepër ishte për “konsum të brendshëm” dhe manifestim të fuqisë amerikane e më pak rrezik potencial për Serbinë, sepse sipas tij nuk kishte asnjë mundësi që SHBA-ja të niste luftë për shkak të Kosovës.

Nga janari i vitit 1993 u krijua një klimë e re në marrëdhëniet ndërkombëtare. Deklarimet e presidentit amerikan Bush ndikuan në avancimin e pozicionit ndërkombëtar të Kosovës sepse filluan takime të shpeshta me personalitetet të rëndësishme të politikës ndërkombëtare, me pjesëmarrje në konferenca e forume të ndryshme dhe në të njëjtën kohë me negociatat për çështjet e veçanta në kuadër të Konferencës së Gjenevës. Ndër takimet më të rëndësishme të nivelit të lartë të udhëhequr nga Presidenti Rugova ishin: në SHBA me sekretarët e

<sup>58</sup> Dario Malnar, SHBA dhe Kosova... f. 101.

<sup>59</sup> Stephen Engelberg, *Weighing Strikes in Bosnia, US Warns of Wider War*, The New York Times, 25 prill 1993; Mark Danner, “Endgame in Kosovo: Ethnic Cleansing and American Amnesia”, në botimin: *Kosovo: Contending Voices on Balkan Interventions*, Edited by William Joseph Buckley, f. 69.

shtetit, *Warren Christopher* dhe *Madeleine Albright*; në Gjermani me ministrin e Jashtëm *Klaus Kinkel*; në Britaninë e Madhe me ministrat e Jashtëm *Douglas Hurd* dhe *Malcolm Rifkind*; në Francë me ministrin e Jashtëm *Hubert Vedrine*; në Austri me ministrin e Jashtëm *Wolfgang Schüssel*, në Itali me ministrin e Jashtëm *Lamberto Dini*; në Spanjë me ministrin e Jashtëm *Javier Solana* etj<sup>60</sup>. Takime të rëndësishme të delegacioneve kosovare u zhvilluan edhe në nivele të tjera përfaqësuese të institucioneve të përbashkëta evropiane me të gjithë kryesuesit e radhës së BE-së, Komisararin politik *Hans van den Broek*, kryetarin e Komisionit Evropian *Jacques Santer*, me kryesuesin e radhës së OSBE-së *Flavio Cotti*<sup>61</sup>, e takime të tjera, të cilat në formën dhe përmbajtjen e tyre treguan interesin e Kosovës për ndërkombëtarizimin e çështjes së tyre dhe interesimin e përfaqësuesve evropian për t'u njoftuar drejtpërdrejt nga përfaqësuesit e popullit të Kosovës me situatën në terren dhe me kërkesat e tyre politike. Duke marrë shkas nga zhvillimi i ngjarjeve të tensionuara në Kosovë dhe kërkesat politike të shqiptarëve, Kosova u bë temë në lajme dhe edicione të veçanta televizive në Euro-news, ZDF, RTL, CNN, BBC, Rai Uno, Voice of America, Deutsche Welle, dhe medime të shkruara si: *Herald Tribune*, *Washington Post*, *New York Times*, *Tageszeitung*, *Frankfurter Allgemeine Zeitung*, *Le Parisien*, *Liberation*, *Der Spiegel*, *Le Figaro*, *Corriere della Sera* etj.

Bartësit e politikës paqësore nuk e fshihnin optimizmin e tyre pas takimeve me diplomatët amerikanë dhe evropianë dhe premtimeve të tyre për zgjidhjen e njëjës kosovare pa e përmendur statusin final. Rugova këmbëngulte që në këto takime të mirëkuptohej kërkesa e shqiptarëve që problemi i Kosovës të zgjidhej në përputhje me referendumin për pavarësi dhe orientimet për krijimin e një shoqërie moderne në mënyrë që brezave të rinj t'u lihen sa më pak çështje të pazgjidhura.<sup>62</sup>

Presidenti i Kosovës ishte shprehur me tone optimiste edhe nga takimet në Kongres dhe Senatën amerikanë në vitin 1994, të organizuara nga lobi shqiptaro-amerikan, i cili kishte rolin kryesor në aranzhimin e takimeve të delegacioneve kosovare me përfaqësuesit e politikës dhe diplomacisë amerikane. Ai deklaronte se vizita në SHBA ishte vizita më e suksesshme, sepse u zhvilluan takime të rëndësishme me zyrtarët më të lartë të administratës së presidentit Klinton. Për herë të parë

---

<sup>60</sup> Edita Tahiri, *Diplomacia e Kosovës në periudhën e okupimit*, Kumtesë e lexuar në Simpoziumin shkencor "Çlirimi i Kosovës", mbajtur më 12 qershor 2009 në Prishtinë.

<sup>61</sup> Po aty f. 17.

<sup>62</sup> "Bota e re", Prishtinë, 18 maj 1994, "Me politikë pragmatike drejt realizimit të pavarësisë", intervistë e presidentit dr. Ibrahim Rugova.

bisedat ishin të hapura miqësore dhe të përzemërta. Edhe këtë herë u rikonfirmua se kërcënimet e Presidentit Bush dhe ai i Presidentit Klinton janë garancë se SHBA-ja janë të gatshme të bëjnë çmos për ta ndaluar konfliktin në Kosovë dhe të intervenojnë nëse Serbia tenton të bëjë luftë të hapur kundër Kosovës. Me përmendjen dhe falënderimet drejtuar presidentëve Bush dhe Klinton Kosova tregonte respekt për të dy krahët e politikës amerikane. Gjithashtu kongresmenët e senatorët demokratë e republikan lobonin në Kongres e Senat dhe ishin zotuar që edhe më tej të përkrahin çështjen e Kosovës dhe zgjidhjen definitive në përputhje me interesat e popullit të saj.<sup>63</sup>

Në gjysmën e parë të vitit 1995, Kosova sërish ishte në qendër të vëmendjes në agjendat ndërkombëtare të institucioneve dhe organizatave politike e diplomatike. Rugova deklaronte se:” ne si shtet duhet të kemi sa më shumë kontakte, të bëjmë sa më shumë miq, të jemi krenarë për përkatësinë tonë kombëtare, të krijojmë mundësi për brezin e ri të cilin unë e quaj brezi i Republikës dhe ta inkuadrojmë shtetin tonë në proceset integruese shqiptare, ballkanike dhe evropiane”.<sup>64</sup>

Me gjithë situatën dhe tonet optimiste, Kosova nuk u ftua në Konferencën e Dejtonit ku më 21 nëntor 1995 në bazën ushtarake amerikane “Wright Peterson” në Ohajo u arrit marrëveshja për ndarjen e Bosnjës e Hercegovinës në 51 për qind në territorin e Federatës së Bosnjës e Hercegovinës dhe 49 për qind të territorit në Republika Srpska.<sup>65</sup> Dejtoni zbehu kursin politik paqësor të ndjekur nga kosovarët dhe nxiti qarqet radikale në Kosovë dhe jashtë saj që të proklamnin luftën e armatosur si të vetmen alternativë për çlirimin e Kosovës.

Mungesa e ftesës në konferencë dhe fakti se në Dejton nuk u bë fjalë për çështjen e Kosovës u interpretua në mënyra të ndryshme në Prishtinë dhe Beograd si dhe nga vëzhguesit politikë dhe nga zyrtarët e vendeve të ndryshme evropiane.<sup>66</sup> Opinioni publik dhe politik ndërkombëtar u nda në dysh. Disa mendonin se mosftesa e Kosovës në

<sup>63</sup> “Koha”, Prishtinë, 29 dhjetor 1994, “Zgjidhja premtuese-Administrimi Civil” intervistë e presidentit dr. Ibrahim Rugova.

<sup>64</sup> “Zëri”, Prishtinë, 13 maj 1995, “Bashkësia ndërkombëtare po punon intensivisht për fillimin e bisedimeve për Kosovën”, intervistë e presidentit dr. Ibrahim Rugova.

<sup>65</sup> www.zeriamerikes.com, “Marrëveshja e Dejtonit, vështrim retrospektiv nga aktorët kryesorë”. Hulumtuar më 10 janar 2018.

<sup>66</sup> Muhamedin Kullashi, “Evoluimi i opinionit publik ndërkombëtar rreth pavarësisë së Kosovës” botuar në Pavarësia e Kosovës dhe sfidat e shtetndërtimit, ASHAK, Prishtinë 2019, f. 62.

Dejton ishte indiferencë totale ndaj kësaj çështjeje dhe politikës paqesore e cila dukej e parrezikshme për cenimin e paqes dhe stabilitetit rajonal. Kurse të tjerë mendonin se diplomacia ndërkombëtare e kishte fokusuar gjithë energjinë e vet në zgjidhjen e çështjes së Bosnjë e Hercegovinës, sepse lufta e pamëshirshme e kishte shkatërruar këtë vend dhe pas mbylljes së krizës atje do t'i vinte radha për trajtim Kosovës. Edhe në Serbi pati reagime. Disa qarqe politike mungesën e Kosovës në Dejton e konsideruan si provë të tezës së lansuar serbe se Kosova është “çështje e brendshme e Jugosllavisë” dhe se shqiptarët duhet ta braktisnin shpresën për ndërkombëtarizimin e këtij problemi.<sup>67</sup> Kurse skeptikët mendonin se nuk do të ketë trajtim serioz të çështjes së Kosovës pa filluar lufta kundër Serbisë. Kjo luftë do të rrezikonte paqen dhe stabilitetin rajonal të Evropës Juglindore dhe atëherë diplomacia ndërkombëtare do ta trajtonte me urgjencë dhe në plotni problemin e Kosovës dhe t'i merrte parasysh kërkesat e shqiptarëve.

Për Konferencën e Dejtonit ishte deklaruar edhe presidenti Rugova i cili pavarësisht nga mospajtimet për mostrajtimin e problemit të Kosovës, ishte treguar i matur dhe optimist me qëllim të mosshfaqjes së papajtueshmërisë dhe luhatjes së përkrahjes ndërkombëtare të çështjes kosovare. Optimizmi i tij ishte i bazuar edhe në marrëdhëniet e veçanta me SHBA-në, përkrahjen amerikane për Kosovën dhe arsye të tjera që nuk duhej të bëheshin publike. Ai më 28 nëntor 1995 deklaronte se Marrëveshja e Dejtonit do të reflektonte në mënyrë pozitive. Qëllimi i parë i Dejtonit ishte që të ndërpritet lufta në Bosnjë e pastaj të gjenden zgjidhje për të gjitha problemet në Jugosllavi e Ballkan. “Kam të drejtë të jem optimist si president i Kosovës dhe si qytetar i saj. Optimizmin e mbështes të përkrahja e miqve të Kosovës, sepse ata flasin gjithkund me simpati dhe tone pozitive për kauzën tonë” vlerësonte Rugova.<sup>68</sup> Pra, ai ishte i bindur se qëndrimi i bashkësisë ndërkombëtare kishte shënuar ngritje cilësore dhe në procesin e sensibilizimit dhe ndërkombëtarizimit, Kosova kishte krijuar miq dhe kishte fituar përkrahje e cila shtohet gjithnjë e më shumë, si rezultat i këmbënguljes në synimet e popullit të Kosovës dhe kursit paqësor për zgjidhjen e problemit me dialog dhe me ndërmjetësimin ndërkombëtar.

---

<sup>67</sup> Po aty f. 63

<sup>68</sup> “Bujku”, Prishtinë, 28 nëntor 1995, “*Të koncentrohemi të gjithë në çështjen e Kosovës*” intervistë e presidentit dr. Ibrahim Rugova.

## Përfundimi

Rezistenca paqësore e shqiptarëve të Kosovës si zgjedhje pothuajse e pa alternativë në rrugëtimin ndërkombëtar të Kosovës për një periudhë relativisht të shkurtër arriti rezultate të rëndësishme duke shpërthyer margjinat e propagandës serbe dhe jugosllave, duke ndërkombëtarizuar Kosovën nga një problem i lirive dhe të drejtave të njeriut dhe zgjidhje brenda juridiksionit dhe sistemit politik të Serbisë dhe RFJ-së në një “çështje që kërkon zgjidhje ndërkombëtare” përfshirë këtu edhe statusin e saj përfundimtar.

Ajo e diskreditoi përfundimisht Serbinë dhe shovinizmin serb duke argumentuar se janë shkelësit e të drejtave qytetare e kombëtare të popujve të tjerë, shkaktar të luftërave në Slloveni, Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë dhe pretendues të pushtimit të territoreve të huaja në emër të ruajtjes së Jugosllavisë, e cila tashmë ishte shpërbërë dhe nuk kishte asnjë gjasë të rikthimit të idesë së “jugosllavizmit” as te popujt sllavë.

Prandaj sensibilizimi i çështjes së Kosovës në qeveritë, parlamentet dhe opinionin publik të vendeve më të fuqishme të Evropës dhe SHBA-së krijoi një situatë të favorshme në rrugëtimin e mëtutjeshëm të Kosovës sepse pa ndërkombëtarizimin e kauzës dhe krijimin e miqve ishte e vështirë të imagjinohej ndonjë zgjidhje politike në përputhje me interesat e popullit të Kosovës. Pra, pavarësisht nga këndvështrimet pro dhe kontra sa u takon rëndësisë së sensibilizimit dhe ndërkombëtarizimit të çështjes së Kosovës në periudhën mes viteve 1990-1996, përfundimisht konstatohet se rezistenca paqësore e shqiptarëve arriti rezultate të konsiderueshme si në planin e brendshëm duke krijuar institucione të pavarura në arsim, shëndetësi etj., po ashtu edhe në atë ndërkombëtar duke arritur që në analizat ndërkombëtare Kosova të konsiderohet si faktor i stabilitetit ose i destabilizimit të rajonit të Ballkanit, në rast të mostrajtitimit të përgjegjshëm nga ana e faktorit ndërkombëtar.





Fehmi Rexhepi

## THEMELIMI DHE FUNKSIONIMI I INSTITUCIONEVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS (1990 – 2000)

### Përmbledhje

Rrethanat e krijuara në fund të viteve 80, kur pushteti serb angazhohej për suprimimin e asaj autonomie të brishtë që kishte Kosova në Federatën Jugosllave, në një anë si dhe përpjekjet shekullore të forcave politike shqiptare për t'u çliruar një herë e përgjithmonë nga sundimi serbo-jugosllav në anën tjetër, sollën si rezultat ngjarjet që shënojnë një etapë të re të historisë sonë që emërues të përbashkët ka krijimin e institucioneve të pavarura të Republikës së Kosovës, me të cilën fillon dhe zhvillohet më tej shtetësia e saj.

Pas miratimit të Deklaratës Kushtetuese (2. VII. 1990) dhe Kushtetutës së Kaçanikut (7. IX. 1990), u siguria baza kushtetuese-juridike për ngritjen e institucioneve të pavarura shtetërore të Republikës së Kosovës. Referendumi për Kosovën shtet i pavarur dhe sovran (26-30 shtator 1991) dhe zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale (24 maj 1992) krijuan parakushte për ngritjen dhe funksionimin e institucioneve të pavarura të Republikës së Kosovës. Me këtë rast nuk mund të mos përmendim edhe faktin se këtyre akteve madhore iu kishte pri një Deklaratë e ASHAK-ut (qershor 1990), duke shprehur kështu gatishmërinë e saj për të dhënë ndihmesë në hartimin e dokumenteve për pozitën e re kushtetuese të Kosovës.

Kështu gjatë gjithë dekadës së fundit të shekullit XX Kuvendi i Republikës funksionoi përmes grupeve dhe komisioneve parlamentare. Presidenca e Kosovës që udhëhiqej nga dr. Ibrahim Rugova gjithashtu koordinonte dhe bashkërendonte veprimet e të gjitha segmenteve të Republikës. Qeveria e Republikës që udhëhiqej nga dr. Bujar Bukoshi, veprimtarinë kryesisht e zhvilloi në emigracion. Të gjithë ministrat jetuan në ekzil deri në qershor të vitit 1999, i vetmi ministër që nuk e lëshoi Kosovën ishte dr. Adem Limani – ministër i Shëndetësisë, Punës dhe i Politikës Sociale.

Për ngritjen dhe funksionimin e institucioneve të Republikës së Kosovës, sipas kushtetutës së Kaçanikut, gjatë periudhës 1990-2000, u derdh shumë mund, dije, djersë, e shumë gjak. Pushteti i këtyre institucioneve, edhe pse pa segmentin e forcës, funksionoi si një mekanizëm i vullnetit të popullit duke sfiduar kështu pushtetin okupues serb.

*Fjalë çelës:* Kosova, Deklarata kushtetuese, institucionet e pavarura, qeveria, parlamenti

## Rrethanat që i paraprinë themelimit dhe pavarësimin të institucioneve të Republikës së Kosovës

Zanafilla e ngritjes së institucioneve të pavarura të Republikës së Kosovës padyshim duhet kërkuar në rrethanat e krijuara në fund të viteve 80 të shekullit të kaluar. Kjo kohë karakterizohet me prirjet e pushtetit serb për ta shuar me çdo kusht edhe atë autonomi të brishtë që kishte siguruar me shumë mund Kosova në Federatën Jugosllave në bazë të Kushtetutës së vitit 1974 në një anë dhe në anën tjetër në përpjekjet shekullore të popullit shqiptar për ta avancuar këtë autonomi deri në pavarësi të plotë dhe njëherësh për të krijuar parakushte për t'u çliruar njëherë e përgjithmonë nga sundimi serb.

Siç është e ditur mirë, një pjesë e madhe e udhëheqjes politike dhe shtetërore në Kosovë që nga viti 1981 e deri më 1989 ishte vetëm një instrument në duart e politikës serbe, e cila filloi t'i realizonte një nga një synimet për krijimin e Serbisë së Madhe që mbështetej në programin nacional serb. Me këtë rast nuk mund të mos ceket edhe fakti se udhëheqja politike dhe shtetërore serbe që mbështetej në ideologjinë

shoviniste serbomadhe kishte edhe përkrahjen e rezervë të Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve, Shoqatës së Shkrimtarëve të Serbisë dhe të Kishës Ortodokse Serbe.

Në këto rrethana të reja udhëheqja politike e Kosovës me shumë vonesë, filloi t'i kuptonte përpjekjet dhe synimet serbe për suprimimin e autonomisë së Kosovës. Por, inteligjenca dhe populli kishin hetuar me kohë këto synime antishqiptare. Kjo vërtetohet më së miri në diskutimet për ndryshimet kushtetuese në Kosovë, ku morën pjesë mbi 400 mijë veta. Punëtorët, fshatarët dhe inteligjenca shqiptare, jo vetëm që u deklaruan kundër propozimeve për ndryshime të Kushtetutës që i impononte Serbia, por ata kërkonin me vendosmëri jo vetëm ruajtjen, por edhe forcimin dhe avancimin e autonomisë së Kosovës.<sup>1</sup> Ky qëndrim mbështetet edhe nga lëvizja e fuqishme gjithëpopullore e nëntorit 1988, ku u shquan minatorët e Trepçës. Revolta e tyre arriti kulmin më aktin e paparë ndonjëherë në histori, kur u vetëngujuan 1300 minatorë në zgafellet e minierës prej 19 deri 28 shkurt 1989. Ata paraqitën kërkesat prej dhjetë pikash, ndër të cilat edhe atë për ruajtjen e parimeve themelore të Kushtetutës së vitit 1974, si dhe kërkesën për shqyrtimin e çështjes së shqiptarëve të Kosovës dhe viseve të tjera etnike në ish-Jugosllavi në Këshillin e Sigurimit të OKB-së.<sup>2</sup> Vlen të theksohet se kjo është kërkesa e parë publike e emituar edhe në mjetet e informimit publikë të kohës për sensibilizimin dhe për zgjidhjen e problemit shqiptar dhe të Kosovës në ish-Jugosllavi. Me kërkesat e minatorëve u solidarizuan studentët e Universitetit të Prishtinës, si dhe mbarë populli shqiptar i Kosovës dhe më gjerë. Për mbrojtjen dhe për avancimin e autonomisë së Kosovës, në mars të vitit 1989 u angazhuan edhe 215 intelektualë me Apelin e njohur drejtuar opinionit jugosllav dhe Kuvendit të Serbisë.<sup>3</sup>

Mirëpo, me gjithë rrethanat e krijuara, si dhe të një disponimi të përgjithshëm për ndryshime pozitive në Kosovë, në kreun shtetëror dhe politik të Jugosllavisë nuk kishte gatishmëri për të zgjedhur mirë dhe drejt kërkesat e arsyeshme të popullit shqiptar. Kështu, Kryesia e Jugosllavisë e frikësuar nga qëndresa dhe vendosmëria e shqiptarëve, si dhe nga ndërkombëtarizimi i kësaj çështjeje për të gjuhëzuar shqiptarët vendosi të zbatonte edhe një herë në Kosovë administrimin ushtarak si në vitin 1945, kur Kosova u riokupua nga ana e Jugosllavisë.

<sup>1</sup> *Historia e Shqipërisë dhe e Shqiptarëve*, Prizren, 2001, f. 384.

<sup>2</sup> Po aty.

<sup>3</sup> Zekeria Cana, *Apeli i 215 intelektualëve shqiptarë*, Rilindja, Prishtinë, 2001, f. 126.

Në këto rrethana më 23 mars 1989, në Prishtinë u mbajt mbledhja e Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, ndërtesa e të cilit ishte rrethuar që më parë me tanke, ushtri dhe polici speciale. Në këtë mbledhje u dha "pëlqimi" për ndryshimin e kushtetutës, që do të thotë u suprimua autonomia e Kosovës. Miratimi i amendamenteve u bë nën presion dhe në masa të jashtëzakonshme. Në mesin e delegatëve të Kuvendit të Kosovës të cilët votuan kundër ish-in: Melihate Tërmkollli, Shkëlzen Gusia, Ukë Bytyçi, Sadik Zuka, Valbona Rraci, Agim Kastrati, Riza Lluka, Mehdi Uka, Remzi Hasani, Bajram Bytyçi etj..<sup>4</sup> Për fat të keq, siç po shihet ish-in vetëm 10 delegatë, gjegjësisht sipas disa të dhënave të tjera 13 delegatë të Kuvendit të Kosovës, të cilët patën guximin të kundërshtojnë ndryshimet dhe që votuan kundër ndryshimeve kushtetuese. Sipas një fotografie të ruajtur shihen edhe delegatët Avdi Berisha, Ejup Qorri dhe Hysen Shabani me gishtërinj të ngritur kundër.<sup>5</sup>

Në rrethanat e gjendjes së jashtëzakonshme organet e pushtetit organizuan një aksion masiv policor, gjatë të cilit brenda një nate u izoluan 254 intelektualë dhe kuadro udhëheqëse shqiptare, të cilët u torturuan në mënyrën më brutale për tre muaj në burgjet serbe.<sup>6</sup>

Pasi dështuan të gjitha përpjekjet e forcave politike e institucionale të shqiptarëve për ruajtjen dhe avancimin e autonomisë së Kosovës, atëherë në skenë u paraqitën forcat e reja politike dhe intelektuale që kishin qenë opozitë e sistemit ekzistues. Ato do ta marrin fatin e popullit në duar dhe kështu do të kalojnë në fazën tjetër që është faza e ngritjes dhe e ndërtimit të institucioneve të pavarura të Republikës së Kosovës. Zanafillën e kësaj veprimtarie e gjejmë në fillet e zhvillimit të pluralizmit politik në Kosovë, përkatësisht ajo merr hov menjëherë pas themelimit të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) më 23 dhjetor 1989. Kështu LDK-ja do të jetë partia e parë politike shqiptare legale në trojet tona pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, në krye të së cilës u zgjodh dr. Ibrahim Rugova.

Atë që ne mund ta quajmë nismë të mbarë të ngritjes së institucioneve të pavarura të Republikës së Kosovës padyshim janë: Deklarata Kushtetuese e Kuvendit të Kosovës (2. VII. 1990); Kushtetuta e

---

<sup>4</sup> Zekeria Cana, Apeli.,f. 266; Nikë Gjelogshi, Kosova në udhëkryq' 89, Velar, 1997, f.98. Ai shënon vetëm emrat e 7 delegatëve që votuan kundër e këta ish-in: Ukë Bytyqi, Melihate Tërmkollli, Sadik Zukaj, Riza Lluka, Bajram Bytyçi, Valbona Rraci e Mehdi Uka.

<sup>5</sup> Zekeria Cana, Apeli., f. 266.

<sup>6</sup> *Historia e Shqiptarisë dhe e shqiptarëve*, Prizren, 2001, f. 384.

Kaçanikut (7. IX. 1990); Referendumi për Kosovën Shtet Sovran dhe i Pavarur (26-30 shtator 1991) dhe zgjedhjet e para parlamentare dhe presidenciale (24 maj 1992).<sup>7</sup>

Këtyre akteve madhore padyshim iu kishte prirë Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (ASHAK), e cila më 15 qershor të vitit 1990 me një Deklaratë të veçantë iu drejtua Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Kuvendit të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe Kuvendit të Republikës Socialiste të Serbisë, duke shprehur kështu gatishmërinë për të dhënë ndihmesën e vet në hartimin e dokumenteve për pozitën e re kushtetuese të Kosovës. Në Deklaratë pos të tjerash thuhej: "Serbia në Kushtetutën e re synon degradimin e qenies dhe pozitës kushtetuese të KSA të Kosovës, e që ai degradim është në kundërshtim me parimet themelore të Kushtetutës së Federatës (nenet 2 e 4)". Serbia me propozimet e dhëna lidhur me krahinat autonome shkel edhe Kushtetutën e vet, sipas së cilës në pikën 2 të amendamentit 47 ishte precizuar se "me ndryshimin e Kushtetutës së Serbisë nuk mund të ndryshohen pozita, të drejtat dhe detyrat Krahinës Autonome të përcaktuar me Kushtetutën e RSFJ-së".<sup>8</sup>

Me anën e kësaj Deklarate, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës e ftonte Kuvendin e Kosovës që të anulonte vendimin e 23 marsit 1989 për dhënien e pëlqimit në Amendamentet e Kushtetutës së Serbisë dhe të shpallte Deklaratën Kushtetuese mbi pozitën e re kushtetuese të Kosovës në kuadër të Federatës-Konfederatës Jugosllave. Gjithashtu në shenjë përkrahjeje të kësaj Deklarate shumë intelektualë, institucione dhe kuvende komunale të Kosovës kërkuan nga delegatët e Kuvendit të Kosovës që ta ligjësonin sa më parë vullnetin e popullit e ky vullnet ishte as më shumë as më pak se pavarësimi i Kosovës nga Serbia dhe Jugosllavia dhe çlirimi nga pushteti serb njëherë e përgjithmonë.

## Pavarësimi dhe funksionalizimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Institucioni i parë i Republikës së Kosovës padyshim ishte Kuvendi i cili pas miratimit të Deklaratës Kushtetuese (2 Korrik 1990)

<sup>7</sup> Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Akte të Kuvendit të Republikës së Kosovës 2 Korrik 1990-2 maj 1992, Prishtinë, 2005.

<sup>8</sup> Nikë Gjeloshi, *Kosova...*, f. 129, 130.

Kosovën e shpallte njësi të pavarur në Federatën – Konfederatën e ardhshme Jugosllave. Me miratimin e Deklaratës Kushtetuese të Kuvendit të Kosovës fillon etapa e krijimit dhe e institucionalizimit të institucioneve të pavarura në Kosovë. Të gjitha institucionet e pavarura të Kosovës më pas do të mbështeten në këtë Deklaratë. Ndërsa pas miratimit të Kushtetutës së Kosovës më 7 shtator 1990, edhe pse në kushte të jashtëzakonshme, ajo paraqet aktin më madhor juridik me të cilin u mbyll faza fillestare e formësimit të shtetit të Kosovës që po lindte e po krijohej në dekadën e fundit të shekullit XX.

Me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përveç lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të qytetarit të njohur në shoqëritë më të civilizuara demokratike, garantohej edhe barazia e minoriteteve në raport me popullsinë shumicë në të gjitha fushat. Ndonëse kjo Kushtetutë u miratua dhe u shpall në kushte të jashtëzakonshme të pushtimit serb, ajo paraqet aktin më të lartë juridik për funksionalizimin e institucioneve të pavarura të shtetit të Kosovës.

Në bazë të Kapitullit VII të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, organet republikane ishin: Kuvendi i Republikës, Kryesia e Republikës, Qeveria e Republikës, Gjyqet dhe Prokuroritë Publike, Banka Popullore dhe Gjyqi Kushtetues i Kosovës.<sup>9</sup> Kështu, gjatë gjithë viteve 90 Kosova në rrugën e ngritjes dhe të funksionimit të institucioneve të pavarura të saj u mbështet në këtë Kushtetutë, e cila më pas u plotësua edhe me amendamente të veçanta.

Sipas nenit 89, të Kushtetutës së miratuar në Kaçanik, kuvendet komunale obligoheshin, që statutet e kuvendeve komunale t'i harmonizonin me këtë Kushtetutë. Me këtë rast, nuk mund të mos përmendim angazhimin e Shoqatës së Pavarur të Juristëve të Kosovës dega në Deçan, së cilës i printe Sali Çekaj. Juristët e Deçanit të prirë nga Sali Çekaj ishin të parët dhe të vetmit në Kosovë që hartuan dhe harmonizuan Statutin e komunës së Deçanit sipas dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Me gjithë rrezikun permanent, hartuesit e statutit të komunës, për as një moment, nuk u zbrapsën nga qëllimi që të harmonizonin atë me Kushtetutën e Republikës. Ata Statutin e hartuan prej 10 tetorit 1990 deri më 5 nëntor 1990. Ata bënë të pamundshmen për ta zbatuar këtë Statut në praktikë në komunën e tyre.

Me që puna e tyre ishte publike, organet e ndjekjes të pushtetit serb iu ranë në gjurmë dhe iniciatorët dhe hartuesit e Statutit i burgosën

---

<sup>9</sup> Shih Kapitullin VII, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenet 96, 128.

dhe i gjithë grupi u dënua me 20 vjet burg.<sup>10</sup> Kështu, juristët Isat Mushkolaj, Xhevdet Lataj, Zeqir Ramosaj, Pashë Kuqi, Isa Demukaj, Njazi Hylaj dhe Rustem Bruqi, u arrestuan nga 6-8 nëntori 1990, dhe dënohen me burg shumëvjeçar. Vetëm Sali Çekaj, arrin t'i shpëtojë arrestimit duke u arratisur jashtë vendit në çastet e fundit.<sup>11</sup>

Një hap më tej në ngritjen e institucioneve të pavarura të Kosovës padyshim është Referendumi si akti më i lartë i shprehjes së vullnetit të popullit. Kështu mbështetur në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, më 26-30 shtator 1991, u organizua Referendumi për Kosovën Shtet i Pavarur dhe Sovran. Vendimin për shpalljen e Referendimit në Republikën e Kosovës e kishte marrë Kuvendi i Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 22 shtator 1991.<sup>12</sup>

Edhe pse ky Referendum u organizua në kushte të pushtimit klasik dhe të represionit policor serb, ai ishte plotësisht legjitim dhe i suksesshëm. Sipas Komisionit të Kuvendit për zbatimin e Referendimit nga 1.051.357 votues sa ishte numri i përgjithshëm i qytetarëve me të drejtë vote, 914.802 votues ose 87.01% morën pjesë në votime. Prej tyre për Kosovën sovranë votuan 913,705 veta apo 99.87 %. Kundër votuan 164 veta, ndërsa të pavlefshme ishin 933 fletëvotime.<sup>13</sup>

Rezultatet e Referendimit dëshmuar se shumica absolute e popullit të Kosovës dëshironte të jetojë në Republikën e Kosovës, shtet i pavarur dhe sovran.

Menjëherë pas Referendimit Kuvendi i Republikës së Kosovës, që udhëhiqej nga Iljaz Ramajli, në marrëveshje me Këshillin Koordinues të Partive Politike në Kosovë që udhëhiqej nga Kryetari Lidhjes Demokratike të Kosovës dr. Ibrahim Rugova, zgjodhi Qeverinë e Përkohshme të Koalicionit (19 tetor 1991) me kryetar dr. Buiar Bukoshin. Qeveria e Përkohshme e koalicionit e Republikës së Kosovës përbëhej nga kryetari, nënkryetari dhe 11 anëtarë, të cilët i zgjodhi Kuvendi i Republikës së Kosovës me propozim të mandatarit të Qeverisë në marrëveshje me Këshillin Koordinues të Partive Politike në Kosovë.<sup>14</sup> Më 1991 u themelua edhe Qendra për Informim e Kosovës-QIK-u, e

<sup>10</sup> Selim Lokaj-Shkodran Imeraj, *Fillimi i jetësimit të Kushtetutës së Kaçanikut në komunën e Deçanit*, Focus. Prishtinë, 2008, f. 29, 41.

<sup>11</sup> Shih më gjerësisht: Selim Lokaj- Shkodran Imeraj, *Fillimi i jetësimit*.

<sup>12</sup> ASHAK, Akte të Kuvendit të Republikës së Kosovës 2 korrik 1990 - 2 maj 1992 Prishtinë, 2005, f. 99.

<sup>13</sup> Po aty, f. 111; *Historia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve*, Prizren, 2001, f. 330.

<sup>14</sup> ASHAK, Akte..., f. 121.

cila do të luajë me shumë sukses rolin e agjencisë shtetërore informative të Kosovës.

Kuvendi i Republikës së Kosovës gjithashtu shpalli zgjedhjet e para shumëpartiake parlamentare dhe presidenciale që u mbajtën më 24 maj 1992. Në këto zgjedhje ku morën pjesë partitë politike shqiptare, boshnjake dhe turke u zgjodhën 115 deputetë të Kuvendit të Kosovës, kurse me vota të drejtpërdrejta u zgjodh dr. Ibrahim Rugova -kryetar i Republikës së Kosovës.<sup>15</sup> Shumicën absolute të deputetëve në parlament i fituan kandidatët e Lidhjes Demokratike të Kosovës që udhëhiqej nga dr. Ibrahim Rugova. Më 26. VI. 1992, në lokalet e LDK-së u vendos selia e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Edhe pse Kuvendi i Republikës së Kosovës, i dalë nga zgjedhjet e 24 majit 1992 tentoi disa herë të mblidhej, ai u pengua nga policia serbe dhe nuk u lejua të mblidhej asnjëherë. Për shkak se Kosova gjendej në rrethana të rënda të okupimit klasik, Kuvendi u funksionalizua përmes grupeve parlamentare, komisioneve parlamentare dhe trupave punues, të cilat kryenin obligimet që dëlnin nga fushëveprimi i tyre në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Me këtë rast nuk mund të mos potencohet fakti se njëri ndër komisionet parlamentare më aktive i Kuvendit të Kosovës ishte Komisioni për Arsim, Shkencë e Kulturë, i cili kryente punët legjislativë në fushën e vet të përgjegjësisë, ndërsa Lidhja e Arsimtarëve Shqiptarë "Naim Frashëri" në krye të së cilës ishte Rexhep Osmani, i kryente punët ekzekutive në Kosovë në marrëveshje me ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e cila gjendej në ekzil. Në rrethana shumë të vështira të okupimit klasik, njëri nga segmentet më të organizuar që funksiononte në kuadër të institucioneve të pavarura të Republikës së Kosovës, s'ka dyshim se ishte arsimit. Institucionet shtetërore të arsimit të Republikës së Kosovës e organizuan dhe funksionalizuan arsimin shqip plotësisht të pavarur të Republikës së Kosovës.

I tërë financimi për nevojat e arsimit të rinisë shqiptare në Kosovë përballohej nga kontributi vullnetar i qytetarëve të Kosovës që organizohej përmes Këshillit për Financim dhe nga fondi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i cili grumbullohej nga kontributi solidar i të gjithë shqiptarëve të Kosovës dhe i atyre që punonin në botën e jashtme, ku përfshiheshin dhe kontribuonin edhe shqiptarët e viseve të tjera, si nga Maqedonia, Kosova Lindore dhe nga Mali i Zi.

---

<sup>15</sup> *Historia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve, Prizren, 2001, f. 387.*

Është me rëndësi të potencohet fakti se gjatë gjithë periudhës në fjalë, shumica dërmuese e institucioneve të pavarura që funksiononin në Kosovë në komunikim, por edhe në ftesa e dokumente zyrtare përdornin vulën dhe emblemën e Republikës së Kosovës. Në këtë aspekt prijnë institucionet shkollore dhe shkencore që funksiononin nën përkujdesjen e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Kulturës. Ato, dëftesat, diplomat dhe dokumentet zyrtare i lëshonin me logon dhe vulën e Republikës së Kosovës. Dokumentet zyrtare të lëshuara nga institucione pavarura të Republikës së Kosovës njiheshin dhe pranoheshin edhe nga institucionet simotra në botën e jashtme. Kështu, p.sh. nxënësit dhe studentët shqiptarë, me logon e Republikës së Kosovës, regjistroheshin pa ndonjë vështirësi në shkollat fillore apo të mesme, si dhe në universitetet e shteteve të Evropës dhe më gjerë.

Periodha pas zgjedhjeve të vitit 1992 shënon ngritjen e mëtejme dhe funksionimin e institucioneve të pavarura në Kosovë, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë komunal. Periodha prej vitit 1992 deri më 1997 ishte periodha e ngritjes, e ndërtimit dhe e funksionalizimit të plotë të institucioneve të pavarura të Republikës së Kosovës. Gjatë kësaj periudhe u vazhdua puna e institucioneve qendrore dhe komunale në arsim, shkencë, kulturë, sport, informim, shëndetësi, fushën e mbrojtjes dhe të vetëmbrojtjes etj.

Politika dhe strategjia shtetërore e institucioneve të Republikës së Kosovës që udhëhiqej nga Presidenti Rugova e sensibilizoi dhe e internacionalizoi çështjen shqiptare dhe atë të Kosovës në arenën ndërkombëtare si një çështje të rëndësishme që kërkonte zgjidhje të shpejtë.<sup>16</sup>

Kuvendi i Republikës së Kosovës gjithashtu organizoi edhe zgjedhjet e dyta parlamentare dhe presidenciale më 22 mars 1998. Qëllimi kryesor i organizimit të këtyre zgjedhjeve padyshim ishte rikonfirmimi i vendosmërisë së popullit të Kosovës për pavarësi në një anë, si dhe për të treguar vendosmëri në qëndresën kundër pushtetit okupues serb në anën tjetër. Në këtë kohë krahas institucionalizimit dhe internacionalizimit të çështjes së Kosovës kishte shpërthyer dhe po merrte përmasa gjithnjë e më të mëdha edhe Lufta Çlirimtare që të tri këta komponentë së bashku synonin çlirimin përfundimtar nga vargonjtë e robërisë serbe.<sup>17</sup>

---

<sup>16</sup> *Historia e Shqipërisë dhe shqiptarëve*, Prizren, 2001, f. 387.

<sup>17</sup> Po aty, f. 387,388.

Edhe në këto zgjedhje shumicën e deputetëve i fitoi LDK-ja, ndërsa Kryetar i Republikës së Kosovës u rizgjodh dr. Ibrahim Rugova. Mbledhja konstitutive e legjislaturës së dytë të Kuvendit të Republikës së Kosovës u mbajt më 15.7.1998 në të cilën me vota të fshehta kryetar i Kuvendit u zgjodh Akademik Idriz Ajeti,<sup>18</sup> ndërsa nënkryetarë u zgjodhën, Iljaz Kurteshi, përfaqësues i Partisë Social Demokrate të Kosovës dhe Gjergj Dedaj përfaqësues i Partisë Liberale të Kosovës, kurse Sekretar i Kuvendit të Republikës u zgjodh dr. Fatmir Sejdiu.

## Funksionimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës

Qeveria e Përkohshme e Republikës së Kosovës e zgjedhur më 19 tetor 1991, ishte qeveri e koalicionit që udhëhiqej nga dr. Bujar Bukoshi, i cili me vendim të Kuvendit do të udhëhiqte edhe Ministrinë e Punëve të Jashtme përderisa ky i fundit ta emëronte ministrin e resorit.<sup>19</sup>

Kabineti qeveritar i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i udhëhequr nga dr. Bujar Bukoshi, kishte këtë përbërje:

- Dr. Bujar Bukoshi - Kryeministër dhe ministër i Punëve të Jashtme;
- Muhamet Bicaj - Ministër i Arsimit, i Shkencës dhe i Kulturës;
- Isa Mustafa – Ministër i Ekonomisë dhe i Financave;
- Halit Muharremi - Ministër i Drejtësisë;
- NN.- Ministër i Shëndetësisë, i Punës dhe i Politikës Sociale,;
- Xhafer Shatri - Ministër i Informimit;
- Numan Baliqi - Ministër pa Portofol;
- N.N. - Ministër i Mbrojtjes;
- N.N. - Ministër i Punëve të Brendshme.<sup>20</sup>

Për shkak të ndjeshmërisë dhe për shkak të sigurisë dhe të rrezikshmërisë së anëtarëve të Kabinetit Qeveritar në aktet e vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për 3 ministri: atë të Mbrojtjes, të Punëve të Brendshme dhe të Shëndetësisë, Punës dhe Politikës Sociale, u shënuan vetëm me shkronjat N.N. Në fakt, ministër i Mbrojtjes u emërua Nikë Gjeloshi, ndërsa ministër i Punëve të

---

<sup>18</sup> Po aty, f. 388.

<sup>19</sup> ASHAK, Akte. f. 143.

<sup>20</sup> Po aty, f. 124, 138.

Brendshme u emërua Ramush Tahiri, që të dy të propozuar nga Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës.<sup>21</sup>

Ndërsa ministër i Shëndetësisë i Punës dhe i Politikës Sociale, u emërua dr. Adem Limani, përfaqësues i Partisë Fshatare të Kosovës, i cili jo vetëm që nuk u largua nga Kosova, por vepronte publikisht pa e fshehur për asnjë moment funksionin që kishte në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Kështu vetëm në mars të vitit 1998, Qeveria e Republikës së Kosovës do të dalë publikisht edhe me kolonel Ahmet Krasniqin – ministër i Mbrojtjes dhe Jonuz Tërstenën - ministër i Punëve të Brendshme.<sup>22</sup> Ministri i Mbrojtjes i Qeverisë së Republikës së Kosovës kolonel Ahmet Krasniqi organizoi dhe i funksionalizoi Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës (FARK) si forcë ushtarake e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që kreu aksione të shumta luftarake kundër ushtrisë dhe policisë serbe gjatë viteve 1998-1999.

Në këto kushte e rrethana shumë të vështira, pjesa më e madhe e kabinetit qeveritar të Republikës së Kosovës tërë veprimtarinë e vet do të jetë e detyruar ta zhvillojë në emigracion. Kryeministri me disa ministra për 6 muaj do të qëndrojnë në Slloveni, më pas kaloi në Gjermani, prej nga do të drejtojnë edhe resorët e tjerë, Ministrinë e Informimit në Zvicër, ndërsa nga Tirana do ta drejtojnë Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës; Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Mbrojtjes.

Derisa të gjithë ministrat e Qeverisë së Republikës së Kosovës u larguan dhe jetuan në ekzil deri në qershor të vitit 1999, i vetmi ministër i Republikës së Kosovës që nuk e lëshoi Kosovën ishte dr. Adem Limani, ministër i Shëndetësisë, i Punës dhe i Politikës Sociale që ishte përfaqësues i Partisë Fshatare të Kosovës.

Gjatë qëndrimit në Gjermani, Qeveria e Republikës së Kosovës i koordinonte punët me veprimtarët dhe institucionet në Kosovë me qëllim të përballimit sa më të lehtë të vështirësive që paraqiteshin në jetën e përditshme të qytetarëve si pasojë e okupimit serb. Në këtë kuadër ajo më 7 shkurt 1992 me një vendim të veçantë themeloi Këshillin Qendror për Financim të Kosovës me qëllim të udhëheqjes dhe mbikëqyrjes së aktivitetit për grumbullimin, shpërndarjen dhe kontrollin e mjeteve financiare të këshillave komunalë. Këshilli

<sup>21</sup> Jusuf Buxhovi, *Kthesa historike 2*, Prishtinë 2009, f. 93.

<sup>22</sup> *Historia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve*, Prizren 2001, f. 429; ASHAK, Aktet. 124, 138.

Qendror për Financim i përgjigjej drejtpërdrejt Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave dhe Ministrisë për Shëndetësi dhe Punë Sociale.<sup>23</sup>

Qeveria e Republikës së Kosovës përkatësisht Ministria e Ekonomisë dhe e Financave për të përbulluar gjendjen e rëndë ekonomiko-sociale që dominonte në Kosovë themeloi Fondin e Republikës së Kosovës apo fondi i tre përqindëshit, i cili grumbullohej kryesisht nga të ardhurat e të punësuarve shqiptarë në botën e jashtme. Ky fond u bë burimi kryesor i mbajtjes dhe i sigurimit të ekzistencës ekonomike në Kosovë.<sup>24</sup> Mjete të këtij fondi me nikoqirllëk do të shfrytëzohen për financimin e Qeverisë, Parlamentit, Presidencës dhe institucioneve të tjera, por edhe të mbajtjes së arsimit, shëndetësisë, kulturës, shkencës, informimit si dhe emergjencës dhe solidaritetit social për familjet e shumta në nevojë.<sup>25</sup> Mjetet mbaheshin në banka në Gjermani, në Zvicër dhe më vonë edhe në “Dardania Bank” në Tiranë.

Një hap më tej në institucionalizimin e shpërndarjes së mjeteve financiare Qeveria e Republikës së Kosovës, do ta bëjë më 16 mars 1992, kur në mbështetje të propozimit të Këshillit Qendror të LDK-së do t’i emërojë anëtarët e Këshillit Qendror për Financim me seli në Prishtinë.<sup>26</sup>

Kryetar i Këshillit Qendror u emërua Mehmet Hajrizi, ndërsa Mustaf Blakaj, Ismail Kastrati, Muharrem Ibrahim, Ali Gagica, Skënder Dyla, Destan Halimi, Shyqëri Obërtinca dhe Bajram Shatri anëtarë<sup>27</sup>

Këshilli Qendror për Financim më pas themeloi edhe Këshillat Komunalë për Financim, të cilët me sukses kryen grumbullimin dhe shpërndarjen e mjeteve financiare për të gjithë të punësuarit në institucionet e Republikës së Kosovës deri në çlirimin e vendit përkatësisht deri në janar të vitit 2000 kur pushoi së funksionuari në bazë të një vendimi të përfaqësuesit special të Kombeve të Bashkuara z. Bernard Kushner. Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës dr. Bujar Bukoshi para se ta dorëzojë postin në një mbledhje të Kuvendit i

---

<sup>23</sup> Grup Autorësh, *Këshilli Qendror për Financim i Kosovës*, Shtëpia Botuese “Libri Shkollor”, Prishtinë 2007, f. 27, 28.

<sup>24</sup> ASHAK, Aktet., f. 199.

<sup>25</sup> Po aty, f. 197.

<sup>26</sup> Jusuf Buxhovi, *Kthesa Historike 2*, f.61

<sup>27</sup> Grup autorësh, *Këshilli Qendror për Financim i Kosovës*, Shtëpia Botuese “Libri Shkollor”, Prishtinë 2007, f. 28.

paraqiti atij raportin për punën e Qeverisë së Republikës i cili u miratua nga deputetët e parlamentit në një seancë plenare më 31 janar 2000.<sup>28</sup>

Në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Qeveria e Republikës së Kosovës kishte ngritë edhe zyrat e Republikës së Kosovës të cilat funksiononin në Tiranë, Gjenevë, Stamboll, Bruksel etj.

Krahas Këshillit Qendror për Financim, që nga viti 1992 e tutje në nivel qendror dhe komunal u ngritën dhe funksionuan edhe Këshilli për Emergjencë, Këshilli për Arsim, Këshilli për Informim, Këshilli për Shëndetësi, Këshilli për Kulturë e Sport etj.

## Themelimi dhe funksionalizimi i Presidencës së Republikës së Kosovës

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës të miratuar më 7 Shtator 1990 në Kaçanik, përkatësisht në bazë të Amendamentit IV të kësaj Kushtetute ku flitet për zgjedhjen e kryetarit të Republikës, Kosova ishte Republikë Presidenciale. Presidenti zgjidhej me votim të drejtpërdrejtë nga populli i Kosovës me vota të fshehta në pajtim me Ligjin.<sup>29</sup>

Institucioni i Presidentit të Republikës së Kosovës ishte shtyllë e shtetit të Kosovës i cili u ngrit dhe zhvilloi veprimtarinë e vet si institucion më i lartë reprezentues i Republikës së Kosovës. Presidenca u funksionalizua menjëherë pas zgjedhjeve parlamentare e presidenciale të 24 majit 1992. President i Kosovës me vota të drejtpërdrejta më 24 maj 1992 u zgjodh kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës dr. Ibrahim Rugova. Më 26. V. 1992, vetëm 2 ditë pas zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale, në lokalet e Lidhjes së Shkrimtarëve përkatësisht në lokalet e Lidhjes Demokratike të Kosovës u vendos Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës. Zyra kryesore e presidentit ishte në lokalet e LDK-së, ndërsa rezidenca kryesore në fillim në një shtëpi private në Kodrën e Diellit dhe më pas në lagjen Velania të Prishtinës.

Presidenti koordinonte dhe bashkërendonte veprimet e të gjitha segmenteve të Republikës së Kosovës, përfaqësonte vullnetin e popullit të Republikës së Kosovës në kontakte zyrtare si dhe kryente punë të tjera të parapara me Kushtetutën e Kosovës.

<sup>28</sup> ASHAK, Aktet..., f. 156.

<sup>29</sup> Presidenti Rugova, Botim i Presidencës së Kosovës, Prishtinë 2007, f. 263.

Në kabinetin e tij Presidenti kishte këshilltarët për çështje të veçanta të cilët kryenin punë dhe detyra të caktuara edhe pse në kushte e rrethana shumë të vështira. Numri i këshilltarëve të Presidentit dhe resorët që mbulonin ndryshonte varësisht nga nevojat dhe rrethanat e veprimit. Shpalljet, vendimet apo urdhëresat, presidenti i shpallte përmes konferencave për shtyp dhe përmes Qendrës për Informim të Kosovës. Qendrën për Informim të Kosovës e udhëhiqnin njerëzit më të afërm të Presidentit gjegjësisht këshilltarët e tij: si Xhemajl Mustafa, Enver Maloku etj..

Presidenca e Kosovës në bazë të kompetencave ligjore ka miratuar dhe ka zbatuar edhe Rregullore të veçanta si p.sh. Rregulloren mbi dekoratat, urdhrat dhe titujt e nderit që i jep presidenti i Kosovës, ku përkrahjet edhe procedura e dhënies së tyre. Njëra ndër dekoratat më të vjetra që ka ndarë presidenti i Republikës së Kosovës dr. Ibrahim Rugova është Dekorata "Qytetar Nderi i Kosovës", e cila u jepet qytetarëve të Kosovës dhe të huaj si dhe shtetasve me origjinë nga Kosova, që me veprat e tyre lartësojnë dhe nderojnë kombin tonë. Dekorata është e punuar në ar, kurse është themeluar nga presidenti i Republikës së Kosovës më 27 nëntor 1996, kur i është dhënë "Nënë Terezës".<sup>30</sup>

Një dekoratë tjetër po kaq e vjetër është Dekorata "Crystalla Dardanica", e cila u jepet qytetarëve të Kosovës e të huaj që kontribuojnë për Kosovën. Kjo dekoratë simbolizon pasuritë, bukuritë dhe lashtësinë e Kosovës në kuptim të miqësisë. Dekorata u themelua nga presidenti i Republikës së Kosovës më 1996 dhe u është dhënë disa personaliteteve të huaja.<sup>31</sup>

Presidenti në bazë të kompetencave që i jepte Kushtetuta e Republikës së Kosovës shpallte ditët e festave, por shpallte edhe ditë zie me rastin e fatkeqësive të ndryshme, sidomos pas masakrave të cilat i kryenin forcat militare e policore serbe mbi popullsinë civile. Me këtë rast nuk mund të mos përmendet edhe shpallja e 2 ditë zie në tërë Kosovën në shenjë proteste kundër represionit dhe vrasjeve jo vetëm të familjes Jashari në Prekaz, si dhe të masakrave të popullsisë civile në Llaushë por edhe kundër represionit dhe masakrave ndaj popullsisë civile anekënd Kosovës.<sup>32</sup> Kjo njëherësh ishte edhe një demonstrim dhe një përkrahje e presidentit dhe e popullit të Kosovës për heroizmin dhe

---

<sup>30</sup> Po aty, f. 173.

<sup>31</sup> Po aty.

<sup>32</sup> Po aty, f. 258.

sakrificën madhore të Adem Jasharit dhe të familjes së tij, si dhe të popullsisë civile në Kosovë. Këto 2 ditë zie u respektuan me përpikëri nga i tërë populli i Kosovës.

## Presidenti Rugova përcakton simbolet e shtetit

Presidenti i Republikës së Kosovës dr. Ibrahim Rugova si institucion kishte dhe përdori edhe simbolet e shtetit si: vulën, stemën, flamurin e himnin, të cilat jo vetëm që respektoheshin nga qytetarët e Kosovës, por ata me to edhe krenoheshin sepse ishin mishëruar për një kohë shumë të gjatë. Vula, stema, flamuri dhe himni përdorëshin sipas protokollit të shtetit në të gjitha manifestimet zyrtare që organizonte presidenti si gjatë okupimit, ashtu edhe pas çlirimit të vendit më 1999.

Këngën kushttrim që e zgjodhi presidenti i Kosovës për himn të Republikës së Kosovës ishte "Kur ka ra kushtrimi në Kosovë" që ishte një këngë që e këndonin kryengritësit shqiptarë në luftërat kundër ushtrisë osmane gjatë dekadës së parë të shekulli XX e që këndohej e këndohet deri në ditët e sotme në raste të caktuara për të mobilizuar të rinjtë dhe popullin në Luftën Çlirimtare kundër pushtuesve të huaj.

Flamuri i Kosovës, përdoret nga presidenti i Kosovës që nga viti 1992, përkatësisht menjëherë pas mbajtjes së Referendumit për Pavarësi (26-30 shtator 1991) dhe pas zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare të Republikës së Kosovës (24 maj 1992). Populli i Kosovës ka filluar ta quajë "Flamuri i Dardanisë" më emrin antik të Kosovës.<sup>33</sup>

Me kërkesën e Presidentit të Kosovës dr. Ibrahim Rugova në Prishtinë më 31 janar 2000 mbahet mbledhja e pestë plenare e Kuvendit e Republikës së Kosovës, në të cilën, mes të tjerash u shqyrtua Raporti i punës i Qeverisë së Republikës së Kosovës për periudhën 1991-2000. Presidenti i Republikës dr. Ibrahim Rugova, u drejtohet deputetëve të Kuvendit me një fjalë rasti. Ai pos të tjerash tha së "çështje me rëndësi të veçantë dhe që hap perspektivën është formimi i strukturave të përbashkëta me UNMIK-un. Ne e bëmë këtë hap me qëllim që Kosova dhe UNMIK-u të jenë më efikas në ndërtimin e institucional, ekonomik e social të vendit tonë. Këto struktura të përbashkëta do të funksionojnë deri në zgjedhjet e reja nacionale e lokale në Kosovë".<sup>34</sup> Kështu pas 10

<sup>33</sup> Po aty, f. 166.

<sup>34</sup> Po aty, f. 263.

vite të ngritjes dhe të funksionimit të institucioneve të pavarura të Republikës së Kosovës data 31 janar i vitit 2000 padyshim shënon edhe fundin e ekzistimit dhe të funksionimit zyrtar të tyre.

Presidenti Rugova, përcaktoi flamurin, stemën dhe himnin e Republikës së Kosovës si simbole të shtetit. Presidenti Rugova, do të përdorë këto simbole edhe pas vitit 2000, përkatësisht pas zgjedhjes President i Kosovës pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2001 dhe 2004. Këto simbole të shtetësisë së Kosovës ai ua la trashëgim pasardhësve të tij në Presidencën e Kosovës. Këto simbole vazhduan të përdoren si simbole shteti edhe pas rishpalljes së Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 në marrëveshje me faktorin vendimmarrës ndërkombëtar.

### Institucionet e Republikës së Kosovës ishin institucione legale dhe legjitime e jo institucione paralele

Institucionet e pavarura të Republikës së Kosovës ishin institucione legale dhe legjitime e jo institucione paralele apo pushtet paralel siç i dëgjojmë shpeshherë të quhen jo vetëm nga ndërkombëtarët, por edhe nga vetë shqiptarët. Një emërtim i tillë besojmë se vjen për shkak të mosdijes apo të mosinformimit të situatës dhe të kushteve specifike në të cilat funksionuan këto institucione apo edhe të moskuptimit të nocionit pushtet paralel, institucion paralel.

Institucione paralele quheshin nga ana e pushtetit okupues serb, krejt kjo bëhej me qëllim të inkriminimit të shqiptarëve dhe të institucioneve të tyre, në mënyrë që kështu të krijonin alibi para opinionit ndërkombëtar për t'i luftuar ato dhe për t'i dënua bartësit e tyre që nënkupton shqiptarët. Nocioni institucion paralel apo pushtet paralel me qëllim apo pa qëllim filloi të përdoret edhe nga ndërkombëtarët sidomos pas vendosjes së Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë - UNMIK-ut, në qershor të vitit 1999. Ndërkombëtarët institucionet e pavarura të Republikës së Kosovës në dokumentet e tyre i quajtën institucione paralele në raport me organet pushtuese serbe, sepse UNMIK-u, në mbështetje të Rezolutës 1244 të Kombeve të Bashkuara njihnte si institucione legale e legjitime vetëm institucionet-organet e pushtetit okupues serb të vendosura në Kosovë pas heqjes së autonomisë së Kosovës më 1989. Për fat të keq UNMIK-u komunikon edhe sot e gjithë ditën me këto institucione serbe. Konsiderojmë se institucione paralele mund të quhen vetëm organet e dhunshme serbe që u vendosën në Kosovë që nga suprimimi i autonomisë së Kosovës më

1989, e jo institucionet e popullit të Kosovës që u krijuan në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe me vendim të veçantë të Kuvendit të Kosovës që ishte i zgjedhur me votën e lirë të popullit.

Për fat të keq edhe shumë të huaj sidomos autorë, diplomatë e politikanë që janë marrë dhe merren me çështjen e shqiptarëve dhe të Kosovës nën ndikimin e propagandës serbe në një anë dhe duke mos qenë të informuar drejt apo duke mos njohur dhe duke mos e kuptuar formën dhe mënyrën e ngritjes dhe të funksionimit të këtyre institucioneve në anën tjetër do t'i quajnë institucione paralele. Me këtë rast është e nevojshme të theksohet se nuk mund të amnistohet as faktori shqiptar, si ai politik e shtetëror por as ai intelektual e shkencor, ngase nuk kanë bërë pothuajse as përpjekje minimale për t'iu kundërvënë makinerisë propagandistike serbe në një anë dhe për t'ua sqaruar me argumente përfaqësuesve ndërkombëtarë në anën tjetër.

Shumica e autorëve të huaj në shkrimet e tyre si para vitit 1999 ashtu edhe pas çlirimit të Kosovës, institucionet e pavarura të Republikës së Kosovës i quajnë institucione paralele. Por, edhe më shumë dhemb fakti kur edhe vetë autorët shqiptarë në mesin e të cilëve ka edhe njohës të mirë të kësaj çështjeje dhe të rrethanave të Kosovës e që në shkrimet apo paraqitjet e tyre publike me apo pa qëllim institucionet e pavarura të Republikës së Kosovës i quajnë institucione apo pushtet paralel.<sup>35</sup>

Institucionet e Republikës së Kosovës ishin legale dhe legjitime sepse që në zanafillën e tyre nga miratimi i Deklaratës Kushtetuese më 2. VII. 1990 dhe miratimi i Kushtetutës së Kaçanikut më 7 Shtator 1990 e deri në janar të vitit 2000 kur pushuan së funksionuari ato jo vetëm që përfaqësonin e mbrojnë interesat e shumicës absolute të popullsisë së Kosovës, por edhe janë përkrahur e janë mbrojtur nga vetë populli. Njëherësh duhet theksuar se institucionet që kanë përfaqësuar interesat e mbi 90 për qind të popullsisë së Kosovës nuk mund të quhen institucione paralele edhe për faktin se ato funksiononin në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Kosovës. Ndërsa në anën tjetër në këtë periudhë në Kosovë nuk kishte institucione të formuara nga pushteti serb, pra s'kishte as Kuvend as President as Qeveri, përveç organeve të dhunshme, forcave ushtarake, policore e paramilitare të

---

<sup>35</sup> Më këtë rast nuk mund të pajtohem më shkrimet e Jusuf Buxhovit, i cili në dy librat e tij: *Kthesa historike I-Vitet e Gjermanisë dhe epoka e LDK-së dhe II – Shteti Paralel dhe rezistenca e Kosovës*, të botuara nga Shtëpia Botuese "Faik Konica" 2009, tërë veprimtarinë e institucioneve të Republikës së Kosovës, pa përjashtim gjatë viteve 1990 e deri më 2000, i quan institucione të pushtetit paralel.

cilat funksiononin në bazë të ligjit të forcës duke përdorur vetëm dhunë deri në gjenocid ndaj popullsisë shumicë shqiptare.



Rexhep Osmani

## GJENDJA, PROBLEMET DHE ZHVILLIMET E ARSIMIT NË KOSOVË

### Përmbledhje

Në hyrje të kësaj teme do të pasqyrohet një tablo e shkurtër për zhvillimet në arsim dhe konteksti politiko-shoqërorë i këtyre zhvillimeve. Tema qendrore do të karakterizohet me gjendjen, problemet dhe zhvillimet në arsim që përfshijnë periudhën 1989-1999 nga këto aspekte:

Reforma në arsim në RSFJ; Koncepti unitarist i zhvillimeve në arsim; Ndryshimet ligjore pas suprimimit të Kushtetutës 1974 dhe heqjes së autonomisë; Miratimi i iniciativave të Serbisë për nxjerrjen e ligjeve unike, me marrëveshje, për veprimtari shoqërore (arsimi, shkencë, kultura) për zbatim në tërë territorin e Republikës; Programi Jugosllav për fushën e arsimit; Bërthamat e përbashkëta programore jugosllave; Përfshirja e Bërthamës programore jugosllave në programet mësimore të lëndëve me rëndësi të veçantë kombëtare dhe pasojat e tyre; Spastrimi i përmbajtjeve programore nga programet dhe tekstet shkollë; Mësimi dygjuhësor dhe paralelet e përziera; Zbatimi i mësimi të gjuhëve joamtare nga klasa I e shkollës fillore etj. Miratimin i Projektligjit për pensionimin e parakohshëm të arsimtarëve; Dhënia e pëlqimit Kuvendit të Serbisë për nxjerrjen e nëntë ligjeve unike për veprimtari shoqërore, duke përfshirë edhe Ligjin mbi Pleqësinë e

Arsimit.; Ndarja e nxënësve në ndërresa sipas përkatësisë etnike; Helmimi i nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme; Dëbimi i studentëve nga konviktet e Qendrës së Studentëve; Diferencimi ideopolitik si proces sadist politik kundër inteligjencës shqiptare në institucionet arsimore dhe shkencore. Masat e Serbisë për shkatërrimin e sistemit të arsimit parauniversitar dhe universitar të Kosovës. Shkëputja e sistemit të arsimit të Kosovës nga Serbia dhe krijimi i sistemit të pavarur të arsimit; Uzurpimi i lokaleve shkollore dhe universitare dhe hapësirave të tyre; Roli i Lidhjes së Arsimitarëve Shqiptarë "Naim Frashëri" për pavarësimin e sistemit të arsimit. Bisedat me Serbinë lidhur me lirin e lokaleve shkollore dhe universitare, bashkëpunim i Kosovës me Shqipërinë, etj.

*Fjalët kyçe:* diferencimi ideopolitik, reformat, arsimit, programet, sistemi i pavarur, Lidhja e Arsimitarëve Shqiptarë

Para dhe pas suprimimit të Kushtetutës së vitit 1974 dhe heqjes së autonomisë më 1989, në vitet 80, Komiteti (Sekretariati) për Arsim, Shkencë dhe Kulturë mori disa vendime të dëmshme për sistemin e arsimit të Kosovës, të cilat patën pasoja të rënda për shkollat me mësim në gjuhën shqipe dhe për institucionet arsimore, shkencore dhe të kulturës, në fund të shekullit të kaluar:

- *Dëbimi i autorëve nga Shqipëria nga planprogramet mësimore (I. Kada-renë, D. Agollin etj.)*
- *Mënjanimi i autorëve të teksteve për arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë.*
- *Spastrimi i përmbajtjeve programore nga programet dhe tekstet shkollore (1981-1988);*
- *Pranimi i bërthamave të përbashkëta;*
- *Mësimi dygjuhësor dhe paralelet e përziera;*
- *Zbatimi i mësimin të gjuhëve joamtare nga klasa I e shkollës fillore etj. (25 gusht 1987);*
- *Miratimi i Projektligjit për pensionimin e parakohshëm të arsimtarëve etj. (28 janar 1988);*
- *Miratimi i iniciativave të Serbisë për nxjerrjen e ligjeve unike me marrëveshje për veprimtari shoqërore (arsimi, shkenca, kultura) për zbatim në tërë territorin e Republikës (19 shtator 1989);*
- *Dhënia e pëlqimit Kuvendit të Serbisë për nxjerrjen e 9 ligjeve unike për veprimtari shoqërore duke përfshirë edhe Ligjin mbi Pleqësinë e Arsimit. (23 janar 1990);*

- *Ndarja e nxënësve në ndërresa sipas përkatësisë etnike (8 mars 1990);*
- *Helmimi i nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme 20 mars 1990 e tutje;*
- *Dëbimi i studentëve nga konviktet e Qendrës së Studentëve (16 mars 1990).*

Pleqësia e Arsimit e Kosovës ka marrë shumë vendime lidhur me miratimin e planprogrameve mësimore, lejimin e përdorimit të teksteve shkollore, e tjera, të cilat dalin nga dokumentet e ndryshme politike federative, republikane, krahinore dhe Programi jugosllav siç janë: miratimi i bërthamave të përbashkëta programore jugosllave, fillimi i mësimin të gjuhës serbokroate si gjuhë joamtare nga kl. I e shkollës fillore, formimi i paraleleve të përziera me mësim dygjuhësor, spastrimi i programeve dhe teksteve mësimore të ngarkuara me “nacional-romanizëm,” eliminimi i shumë autorëve me vlera krijuese të mirëfillta. Pleqësia e Arsimit ishte shndërruar në një shërbyes të regjimit të Beogradit për heqjen e të drejtave të Kosovës në fushën e arsimit.

Në periudhën kohore 1981-1990, Serbia kishte shtrirë kontrollin e saj të plotë në të gjitha institucionet e arsimit. Enti Pedagogjik ishte shndërruar në një njësi të Entit Republikan të Serbisë për përkthimin e planprogrameve mësimore dhe të dokumenteve të tjera arsimore që dilnin nga platformat politike të LKJ-së, të projekteve dhe të marrëveshjeve që zëvendësonin infrastrukturën ligjore dhe kushtetuese të KSA të Kosovës. Enti Republikan i Serbisë u dërgon materiale për diskutim publik edhe në institucionet arsimore të KSA të Kosovës. Komiteti Krahinor i Arsimit, Shkencës dhe i Kulturës, Pleqësia e Arsimit e Kosovës dhe Enti ishin të varura verbërisht në sendërtimin e detyrave që dilnin nga Përfundimet e Plenumit IX të KQ të LKJ-së dhe të Programit Jugosllave në fushën e arsimit, nga pika 64- 86 siç janë: pranimi i bërthamave të përbashkëta, pranimi i programeve për gjuhë dhe letërsi shqipe, histori dhe kulturë muzikore me mësim në gjuhën shqipe në RSS, RSM, RSZM dhe në KSA të Kosovës. Kuvendi i Republikës së Serbisë më 23 tetor 1990, nxjerrë vendim për vendosjen e masave të përkohshme në Entin e “KA të Kosovës. Më 1.11.1990 u dhanë vendimet për largimin nga puna e të gjithë punëtorëve në shërbimin arsimor-pedagogjik në KSA të Kosovës. Mirëpo, për suprimimin e Entit, Këshilli Ekzekutiv i Serbisë kishte përgatitur projektligjin në të cilin parashihet se dy entet në Prishtinë dhe në Novi- Sad do të jenë paralele të Entit Republikan. Ministri i Arsimit i Serbisë nxjerr Aktvendim për bartjen e pasurisë së Entit të “KA të Kosovës dhe Metohisë” në Ministrinë e Arsimit nga dita 16 mars 1992 dhe ngritjen e Komisionit për pranim-dorëzimin e pronës së Entit.

## Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore

ETMM ka pasur bashkëpunim edhe me botuesit jashtë Kosovës, kryesisht me Serbinë. Nisma për tekste të përbashkëta me Serbinë fillon më 22 nëntor 1981 kur u nënshkrua marrëveshja shoqërore për bashkëpunim shkencor-pedagogjik dhe bashkëpunim botues ndërmjet Entit Republikan të RS të Serbisë dhe ETMM. Pra, shumë gjenerata kanë mësuar nga tekstet e përkthyer të autorëve të cilët kanë shkruar në gjuhën joamtare të nxënësve shqiptarë. Pas miratimit të bërthamave dhe pas miratimit të ligjeve unike për një arsim më 1990, u krijua një sistem i pabarazisë nacionale dhe i marrëdhënieve koloniale në Kosovë.

Për vitin 1988 ka pasur reduktime të planit botues. Shumë tituj ishin paraparë botime të përbashkëta me Serbinë dhe Vojvodinën. Më 17 nëntor 1988, në Prishtinë është mbajtur mbledhja e përbashkët e përfaqësuesve të ETMM të KSA të Kosovës, RSS, RSMZ dhe të RSM. Tema e këtij takimi ishte hartimi i teksteve të përbashkëta të gjuhës dhe të letërsisë shqipe për tri republikat dhe KSA të Kosovës. Me gjithë debatin polemizues dhe mospajtimeve të përfaqësuesve profesionistë të redaktorëve të ETMM-së të Kosovës u vendos të shpallet konkursi për tekste të përbashkëta për librat e leximit për shkollën fillore. Në katalogun e ETMM-së të Serbisë për vitin shkollor 1990/91 për shkollat fillore të RSS-së jepet edhe pasqyra e teksteve të përkthyer edhe për KSA të Kosovës. Në bazë të Ligjit serb mbi marrëdhëniet e punës në rrethana të veçanta janë përjashtuar 42 punëtorë. Organi i dhunshëm i ETMM përmes Sekretariatit për Arsim, Kulturë dhe Shkencë i propozon Kuvendit të Serbisë dhe pas disa procedurave “ETMM të transformohet në paralele të Entit të Beogradit për Botimin e Teksteve”

## Reforma e sistemit të arsimit dhe edukimit në RSFJ

Enti Republikan për Përparimin e Arsimit dhe Edukimit të Serbisë hartoi një raport për gjendjen, problemet dhe politikat e arsimit në RSFJ. Kjo ishte një nismë e Serbisë për t'i filluar ndryshimet sistemore dhe politikat arsimore, ngase ajo nuk ishte e kënaqur me shumësinë e sistemeve nacionale arsimore në republika dhe në krahina. Serbia synonte një sistem unik jugosllav që ta kontrollonte nga Beogradi. Për angazhimet e Serbisë për një sistem uniform shtetëror në Jugosllavi, dr.

Jovan Deretiç, shkrimtar dhe historian i letërsisë, thotë: *“Mendoj se duhet të synojmë një sistem unik arsimor jugosllav, ngase gjendja e tashme kur secila republikë dhe krahinë kanë sistemin e tyre, programet e tyre, po nxisin shumë vështirësi dhe objektivisht po sjellin dezintegrimin e sistemit dhe po shkatërrojnë unitetin e bashkësisë jugosllave. Republikat dhe krahinat në mënyrë të pavarur përcaktojnë sistemet e tyre arsimore dhe çka tjetër, por kjo mënyrë e pavarur, pikërisht, pa tjetër do të thotë edhe ndryshe nga të tjerët. A do të jetë, ndoshta, e rrezikuar pavarësia jonë kur do të kishim marrëveshje, të kërkojmë zgjidhje të përbashkët, të gjithë së bashku të ndërtojmë **modelin jugosllav të sistemit të arsimit**. Koncepti unitarist serb, në vitet dhe në punën e mëtejshme, do të zhvillohej në të gjitha republikat dhe krahinat. Për këtë qëllim janë sajuar bërthamat e përbashkëta programore jugosllave që mbarësojnë një uniformizëm shtetëror në arsim. Në mars të vitit 1981, kuvendet e republikave socialiste dhe të krahinave socialiste kanë miratuar Marrëveshjen për bazat e përbashkëta të sistemit të edukimit dhe arsimit në RSFJ. Me këtë Marrëveshje, pos të tjerash, kërkohet të harmonizohen përmbajtjet e planeve dhe programeve të edukimit dhe të arsimit për të gjitha nivelet e sistemit të arsimor. Me marrëveshje, në nenin 15, thuhet: *“kuvendet e republikave përkatësisht të krahinave marrin për obligim që në afatin prej dy vjetësh të nisnin zbatimin e planprogrameve të reja në pajtim me këtë Marrëveshje, më së voni në vitin shkollor 1982/ 83.”* Është koha kur përmes marrëveshjeve, duke shfrytëzuar servilitetin e krerëve politikë dhe të institucioneve përkatëse të Kosovës, Serbia anashkalonte infrastrukturën ligjore në fusha të ndryshme sistimore, për të ecur drejt kapjes së Kushtetutës së Kosovës më 1989. Tezat e ngritura në Raportin për gjendjen, problemet dhe politikat e arsimit në RSFJ hapën rrugën e rishikimit edhe të përmbajtjeve të planprogrameve dhe të teksteve mësimore. Diskutimet për njësimin e standardeve të sistemit të arsimit dhe të përmbajtjeve programore në nivel të RSFJ-së fillojnë në mars të vitit 1979. Grupi i punës për edukimin parashkollor në mbledhjen e parë të mbajtur më 19 mars 1979, në Beograd, diskutoi për një marrëveshje mbi përpilimin e bërthamës së përbashkët programore për edukimin dhe arsimin parashkollor. Këtu zë fill gjeneza e bërthamës së përbashkët programore mësimore jugosllave edhe për nivelet e tjera të arsimit dhe edukimit. Konferenca e përhershme e enteve për përparimin e edukimit dhe arsimit në RSFJ, nga mesi i vitit 1979 ngriti Grupin.*

## *Pranimi i bërthamave të përbashkëta*

Bërthamat e përbashkëta programore për edukimin dhe arsimin parashkollor, arsimin fillor dhe të përgjithshëm janë shqyrtuar dhe pranuar në qershor dhe tetor të vitit 1983 në Komisionin ndërrepublikano-krahinor për reformë si standard i marrëveshjes së përbashkët të arsimit të përgjithshëm dhe u rekomandohet organeve kompetente të republikave dhe të krahinave që në pajtim me kompetencat e tyre t'i përfshijnë në programet parashkollore, në programet e arsimit fillor dhe të mesëm të orientuar. Pavarësisht nga harmonizimet mbetën edhe disa çështje të hapura, për të cilat pati mospajtime. Sllovenia nuk u pajtua lidhur me propozimin e bërthamës për gjuhën amtare dhe të edukatës muzikore duke theksuar se bërthama duhet të jetë dokument i karakterit të përgjithshëm, pa konkretizimin e përmbajtjeve të përbashkëta dhe caktimin e tyre sipas klasave. KSA e Kosovës kishte kërkuar që në bërthama duhet të përfshihen autorët nga letërsia përkatësisht kompozitorët, të cilët kanë jetuar dhe krijuar jashtë RSFJ-së.

## Kontesti politiko-shoqëror

Pas ngjarjeve të pranverës së vitit 1981, por edhe më parë, Serbia duke shfrytëzuar funksionarë partiakë të LKJ-së dhe drejtues të institucioneve arsimore në Kosovë, luajalë të regjimit të Beogradit, në dy dhjetëvjetshat e fundit të shekullit të kaluar, përgatiti parakushtet për shpërbërjen e rendit kushtetues të KSA të Kosovës, e cila do t'i shërbente kauzës gjenocidale serbe për spastrimin etnik dhe rikolonizimin e Kosovës. Këshilli Federativ për Ruajtjen e Rendit Kushtetues, ngjarjet e pranverës së vitit 1981, më 11 mars dhe më 1 e 2 prill, i vlerësoi si "akt kundërrevolucionar nga pozicioni i nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar me qëllim të cenimit të integritetit dhe tërësisë së RSFJ-së etj. Këtë vlerësim e miratuan edhe Kryesia e RSFJ-së dhe Kryesia e KQ e LKJ-së. Dy Kryesitë e Jugosllavisë, në mbledhjen e përbashkët të mbajtur më 1 prill 1981 vlerësuan se në Kosovë është krijuar gjendje krize. Kryesia e RSFJ-së urdhëroi që më 1 dhe 2 prill, në KSA të Kosovës, të dërgohen njësitë speciale të milicisë nga Sekretariati Federativ për Punë të Brendshme nga të gjitha republikat dhe KSA e Vojvodinës. Në Kosovë "zbarkuan" rreth 3500 milicë. U sollën edhe njësi të APJ-së, rreth dy divizione. Po ashtu ngjarjet e marsit dhe të prillit të viti 1981

nga Kryesia e KQ e LKJ-së u vlerësuan si “veprimtari armiqësore dhe kundërrevolucionare me elemente të kryengritjes. Nacionalizmi dhe irredentizmi shqiptar ishte baza e kundërrevolucionit.” Këto vlerësime u përkrahën edhe nga të dy kryesitë e LK të Serbisë dhe të Kosovës, të cilat hapën rrugën e goditjes çnjerëzore dhe të ushtrimit të terrorit shtetëror ndaj rinisë studentore dhe shkollore të Kosovës. Universiteti i Prishtinës u etiketua si “qendër” e nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar.

Kryesia e RSFJ-së dhe Kryesia e KQ e LKJ-së, në mbledhjen më 5 mars 1986, sajoi një material për situatën aktuale politike në KSA të Kosovës.

Dy kryesitë përcaktuan edhe masat që duhen të merren në fushën edukativo-arsimore, të shkencës dhe të kulturës duke obliguar organet kompetente krahinore të arsimit dhe të KK të LK të Kosovës, që deri në fund të qershorit të hartojnë programe të reja të punës edukativo-arsimore, të cilat do të bëheshin të obliguara t’i zbatojnë të gjithë arsimtarët në të gjitha shkollat. Në këto programe vend të veçantë i duhet dhënë edukimit në frymën e patriotizmit socialist jugosllav dhe forcimit të vëllazërim-bashkimit të të gjitha kombeve dhe kombësive, të cilët jetojnë në KSA të Kosovës dhe më gjerë. Për kryerjen e punëve të tilla, që nënkupton dhe “krijimin e bazës ligjore për ndërmarrjen e masave. Në pajtim më këtë të shqyrtohet edhe mundësia e pensionimit në mënyrë administrative të atyre arsimtarëve të cilët nuk janë të gatshëm t’i pranojnë detyrat të cilat qëndrojnë para shkollimit në Kosovë. Në mbështetje të qëndrimeve të të dy kryesive të RSFJ-së “që deri në fund të qershorit, të hartojnë programe të reja të punës edukativo-arsimore, organet e LKJ-së të Kosovës krijuan platformën për mënjanimin e të gjitha shkaqeve që sollën “indoktrinimin” e një numri të rinjsh me ideologji të huaj për LKJ-në.

### *Spastrimi i programeve dhe teksteve mësimore*

Detyra e parë e tyre ishte të analizohen, të vlerësohen, të plotësohen dhe të përsosen planprogramet mësimore, tekstet shkollore në të gjitha nivelet e arsimit. Në mënyrë kritike u evidencuan tekstet dhe mjetet mësimore, të cilat u morën nga Shqipëria. Universiteti i Prishtinës vlerësoi tekstet dhe literaturën, e cila përdorej në fakultete dhe në shkolla të larta dhe disa sosh i mënjanoi nga përdorimi, duke përfshirë edhe tekste themelore nga fusha e gjuhës, letërsisë dhe e

historisë. Në dokumentin e cituar të Kryesisë së KK të LKJ-së është marrë një vendim skandaloz që të hartohen planprogramet mësimore të gjuhës dhe letërsisë shqipe për paralelet me mësim në gjuhën shqipe për RSS, RSM, RSMZ dhe KSAK. Po ashtu burokracia puthadorë komuniste shqiptare e mbështetur edhe nga Beogradi mënjanoi nga përdorimi edhe disa doracakë të autorëve, të cilët ishin larguar nga procesi edukativo-arsimor në Universitet. U hoqën nga përdorimi tekstet e figurave të shquara të dijes, kulturës dhe të shkencës shqiptare. Është fjala për Ali Hadrin, Gazmend Zajmin, Fehmi Aganin, Mark Krasniqin etj, tekstet e të cilëve u hoqën nga përdorimi në shkollat e KSA të Kosovës. Po ashtu nga tekstet shkollore u hoqën të gjitha krijimet letrare të Ismail Kadaresë, Dritëro Agollit të cilët u akuzuan se kanë kritikuar Jugosllavinë dhe kanë përkrahur nacionalizmin dhe irredentizmin shqiptar në Kosovë. Nga tekstet shkollore janë hequr edhe krijimet e disa autorëve kosovarë të cilët, sipas politikës së Beogradit, kanë rënë në konflikt me LK të Jugosllavisë. Nga planprogramet për shkollën fillore nga klasa I-VIII u hoqën 35 përmbajtje, kurse nga planprogrami i shkollës së mesme u hoqën 13 sosh. Raportet koloniale me shqiptarët, si popull josllav u bënë më të mprehta. Në praktikën e robërimit të popujve janë shënuar modele të larmishme për shtypjen e tyre. Ndër format më trishtuese dhe prekëse përmenden përdhosjet e vlerave shpirtërore dhe veprimet për zhdukjen e gjuhës së një kombi. Pra, sunduesit serbë synonin pushtimin e fundit-“kalanë e gjuhës”- gjuhën si përçues i kulturës dhe i dijes kombëtare dhe asaj universale. Pikërisht për këtë arsye, strukturat Beogradit bashkëpunuan edhe me udhëheqësit luajalë në Kosovë.

### *Përfshirja e bërthamat e përbashkëta në planprogramet mësimore*

Bërthamat e përbashkëta programore ishin një projekt i planifikuar i politikës serbe për të mundësuar një uniformizëm shtetëror në arsim. Grupet punuese, përmes komisioneve, në emër të bashkëjetesës jugosllave, kishin sajuar dokumentin me plot elemente të mospajtimeve dhe të imponimeve etj. Sllovenët vërejtën se bërthamat ofronin modelin e unitarizmit shtetëror në arsim dhe kërkuan që kjo çështje të mbetet në kompetencën e republikave dhe e krahinave.

Në vitin 1983, në Kosovë, diskutimi për bërthamat e përbashkëta zhvillohej në qarqe të ngushta partiake dhe brenda grupit punues për

harmonizimin e qëndrimeve. Lidhur me bërthamat e përbashkëta të gjuhës dhe të letërsisë shqipe më 8 tetor 1983, në Rilindje, u botua reagimi me titull "Gjuha amtare dhe letërsia kombëtare duan trajtim të drejtë" të autorëve Nazmi Rrahmani, letrar dhe prof. dr. Rexhep Ismaili, gjuhëtar. Në 6 faqet e artikullit në fjalë kundërshtohet me argumente profesionale dhe shkencore përfshirja e bërthamës së përbashkët programore në Programin e gjuhës dhe të letërsisë shqipe: "Në shkollat në gjuhën shqipe duhet të mbetet e paprekur lënda e gjuhës dhe letërsisë amtare, si lëndë themelore për formimin e drejtë të brezave, pa prekur autenticitetin dhe individualitetin kulturor. Mësimi i gjuhës madje duhet të forcohet edhe më shumë për shkak të mundësive të mëdha të interferencave që imponon bilinguizmi. Letërsia kombëtare duhet të mësohet në vëllimin e plotë dhe nëpër të gjitha etapat e saj duke respektuar historinë e saj specifike që nga shkrimet e para e deri në ditët e sotme, pa kufizime. Për këtë është i nevojshëm një fond më i madh orësh. Kjo letërsi nuk mund të ndahet nga gjuha"

Pleqësia e Arsimit e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 dhjetor 1983, miratoi bërthamat e përbashkëta programore jugosllave për 15 lëndë mësimore të edukimit dhe të arsimit fillor dhe për ato të bazave të përbashkëta të AMO të përgatitura nga grupet e përbashkëta të punës së Entit Krahinor për Përparimin e Edukimit dhe Arsimit në bashkëpunim me Entin Republikan të Serbisë dhe KSA të Vojvodinës. Shumica e planprogrameve janë përgatitur së pari në gjuhën serbo-kroate dhe pastaj janë përkthyer në gjuhën shqipe dhe turke. Bërthama e përbashkët programore për gjuhën dhe letërsinë shqipe dhe kulturën muzikore nuk u miratuan, ngase nuk ishin harmonizuar qëndrimet për një përfaqësim adekuat për të cilin kishin kërkuar ekspertët.<sup>1</sup>

Institucionet e arsimit të Serbisë, hap pas hapi, pushtojnë sistemin e arsimit të KSA të Kosovës. Në janar të vitit 1985, Enti Republikan për Përparimin e Edukimit dhe Arsimit, i dërgon Entit Krahinor për Përparimin e Edukimit dhe Arsimit Projektin e përcjelljes së realizimit të qëllimeve shoqërore në edukimin dhe arsimin fillor për periudhën 1985-1989. Ky Projekt është nisur nga koncepti i planit dhe programi të përbashkët i punës edukativo-arsimore i bazuar në përcaktimet dhe qëndrimet e shprehura në Marrëveshjen e republikave socialiste dhe krahinave autonome socialiste për bazat e përbashkëta të sistemit të edukimit dhe arsimit; në bërthamat e përbashkëta programore për edukimin dhe arsimin fillor; në drejtimit e zhvillimit të mëtejshëm të

<sup>1</sup> Rilindja, Prishtinë, 28 dhjetor 1983

edukimit dhe arsimit fillor dhe Ligjit të edukimit dhe arsimit fillor<sup>2</sup> “Pleqësia e Arsimit e RS e Serbisë këtë material prej 7 faqesh e miraton më 31 maj dhe 26 qershor 1984. Pleqësia e Arsimit e Kosovës ka vendosur që për zbatimin e këtij dokumenti të fillohet nga viti shkollor 1985/86. Enti Krahinor i Përparimit të Arsimit dhe të Edukimit këtë material e ka pranuar më 4 shkurt 1985.

### *Miratimi i Programit të gjuhës dhe letërsisë shqipe dhe kulturës muzikore*

Në bazë të përfundimeve të Komisionit ndërrepublikan e ndër-krahinor për reformën e edukimit dhe të arsimit në RSFJ, më 27 dhe më 28 shkurt 1986, në Beograd, është mbajtur mbledhja e Grupit punues për hartimin e propozimit të bërthamave të përbashkëta programore të gjuhës amtare dhe të letërsisë për edukimin dhe arsimin fillor dhe për arsimin e mesëm të orientuar, si dhe lidhur me aktivitetet e ardhshme të këshilltarëve të gjuhës amtare dhe të letërsisë. Grupi punues i KSA i Kosovës paraqiti dokumentin: “Vërejtjet, propozimet dhe sugjerimet e KSA të Kosovës lidhur me bërthamat e përbashkëta programore të gjuhës amtare dhe të letërsisë”. Për grupin e Kosovës veçanërisht ishte i papranueshëm qëndrimi që letërsia kombëtare shqiptare të përfaqësohet vetëm me veprat e autorëve që kanë krijuar pas vitit 1945. Në këtë mbledhje nuk janë harmonizuar qëndrimet përkitazi me çështjet parimore dhe konkrete.<sup>3</sup>

Lidhur me përfshirjen e bërthamave të përbashkëta programore të gjuhës dhe letërsisë shqipe janë zhvilluar debate të gjithanshme, të rënda dhe të ndjekura me mospajtime dhe trysni të shumta, fillimisht nga Beogradi e më vonë edhe nga Prishtina. Në një bisedë të zhvilluar në KQ të LK të Serbisë rreth zbatimit të Konkluzioneve të Plenumit IX të KQ të LKJ për Kosovën në fushën e arsimit të mbajtur më 21 gusht 1987, Sekretari ekzekutiv i KK të LK të Kosovës, Milan Kërnjeviç thekson: “*organet profesionale arsimore të Krahinës po e pengojnë*

---

<sup>2</sup> Enti Republikan për Përparimin e Arsimit dhe të Edukimit: Projekti për përcjelljen qëllimeve shoqërore për arsimin dhe edukimin fillor në periudhën 1985-1989, Nr. 101/2. Beograd, më 28. I. 1985

<sup>3</sup> Anëtarët e grupit punues: Informatë nga mbledhja e grupit punues ndërrepublikan-ndër-krahinor për hartimin e propozimit të bërthamave të përbashkëta programore të gjuhës amtare dhe të letërsisë, Prishtinë, më 6 mars 1986.

harmonizimin tash e 4 vjet, dhe kjo nuk do të tolerohet më.”<sup>4</sup> Ai nga Beogradi dërgoi një mesazh kërcënues për të padëgjueshmit: *”Për në fillim të javës së ardhshme<sup>5</sup> është caktuar të mbahet tubimi i kryetarëve të komiteteve për arsim të RSS, RS, RSM të RSMZ dhe të Kosovës për t’u marrë vesh kështu për programin kontestues të gjuhës dhe të letërsisë shqiptare. Pas kësaj nuk do të ketë falje për ata që nuk e kryejnë pjesën e vet të punës. Më 25 gusht 1987, në Gërmi, strukturat politike dhe shtetërore të Kosovës u pajtuan me ato të RSS, RSM, RSMZ që bërthamat e përbashkëta programore jugosllave në tërësi të përfshihen në programin e gjuhës dhe të letërsisë shqipe për arsimin fillor dhe të mesëm.*

Në takimin e këshilltarëve, më 29 gusht 1987, në Prishtinë, përfaqësuesi i Kosovës në mënyrë ultimative kundërshtoi përfshirjen e bërthamat e përbashkëta jugosllave në programin e gjuhës dhe të letërsisë shqipe. Enti Krahinor për Përparimin e Arsimit dhe Edukimit, më 3 shtator 1987, u pajtua që bërthama e përbashkëta programore jugosllave të përfshihen në Programin e gjuhës dhe të letërsisë shqipe. Pleqësia e Arsimit e Kosovës dhe Entit Pedagogjik, me gjithë reagimet e shumta të Grupit punues profesional të Kosovës, të Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës e cila vlerësoi se: *”Përfshirja e bërthamave të përbashkëta programore do të thotë përfundimisht dëbim i gjuhës dhe letërsisë, si dhe i literaturës shqiptare nga shkollat shqipe.”*<sup>6</sup> Degës e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, Instituti Albanologjik, Shoqata e Arsimtarëve të Gjuhës Shqipe miratuan përfshirjen e bërthamave të përbashkëta programore në planet dhe programet e gjuhës dhe letërsisë shqipe.

Plani dhe programi i Kulturës muzikore për arsimin fillor ishte një dokument pedagogjik i një pune të gjatë, mospajtimesh të grupeve punuese profesionale pranë enteve pedagogjike për përparimin e arsimit dhe të edukimit të RS të Serbisë, të RS të Malit të Zi, RS të Maqedonisë dhe të KSA të Kosovës. Sipas vlerësimit të Pleqësisë së Arsimit,

<sup>4</sup> Biseda në KQ të LKS: “Vazhdohet puna për harmonizimin e planprogrameve mësimore” Rilindja, 22. VIII. 1987 (Tanjug)

<sup>5</sup> Shënim zyrtar nga Mbledhja e kryetarëve të komiteteve të arsimit, sekretarëve ekzekutivë të kryesive të LK të RSS, RSM, RSMZ dhe KSAK, mbajtur më 25. VIII. 1987, në Gërmi.

<sup>6</sup> Vlerësimi i SHSHK-së lidhur më “Planin dhe programin e përbashkët mësimor të gjuhës dhe letërsisë shqipe për arsimimin dhe edukimin e mesëm” drejtuar institucioneve shtetërore, politike dhe arsimore të Kosovës, Nr. 25 Prishtinë, 21 mars 1988 të nënshkruar nga dr. Ibrahim Rugova, kryetar, Arkivi shtetëror i Kosovës Fondi: Enti Krahinor për Përparimin e Arsimit dhe Edukimit. (i parregulluar)

Programi i kulturës muzikore “*është hartuar në bazë të qëndrimeve të harmonizuara të tri republikave dhe KSA të Kosovës dhe u është dedikuar nxënësve me mësim në gjuhën shqipe dhe për nga përmbajtja e siguron mundësinë e përvetësimit adekuat të njohurive nga lëmi i kulturës muzikore në shkallën përkatëse të arsimit*”.<sup>7</sup> Sipas arsyeshmërisë së këtij formulimi të Pleqësisë së Arsimit të Kosovës për të miratuar planprograme nën tryshinë e qarqeve unitariste serbe për një arsim uniform vërehet qartë se organet politike dhe arsimore të Kosovës kishin humbur mëvetësinë e tyre, jo vetëm politike, arsimore, kulturore por edhe identitetin autonom të Kosovës në kundërshtim me Kushtetutën e saj. Ato punonin me përkushtim për përmbushjen e obligimeve dhe detyrave që dilnin nga pika 64-81 e Programit jugosllav për parandalimin e shpërnguljes së serbëve dhe të malazezëve nga Kosova dhe kthimin e gjithë atyre që dëshirojnë të jetojnë dhe të punojnë në Kosovë.<sup>8</sup>

### *Programi jugosllav<sup>9</sup> për lëmin e arsimit, shkencës dhe të kulturës*

Mbledhja e dhomës së republikave dhe krahinave e Kuvendit të RSFJ-së, më 29 janar 1987, miratoi iniciativën e Kuvendit të Republikës së Serbisë për hartimin e *Programit jugosllav*... Në këtë program diskriminues për institucionet e Kosovës në lëmin e arsimit, shkencës dhe të kulturës, shtrohen këto obligime dhe detyra: në mjediset e përziera nacionale, të motivohet mësimi i gjuhës së “mjedisit shoqëror”: gjuha serbokroate dhe gjuha shqipe si gjuhë joamtare duhet të përfshihen nga klasa e parë e shkollës fillore dhe të shtohet fondi javor i orëve; është e nevojshme që gradualisht të futet mësimi dygjuhësor për të gjitha lëndët e rëndësishme në të gjitha shkollat e Kosovës; në arsimin e mesëm të orientuar; në vendet ku nuk ka pasur mësim në gjuhën serbokroate të organizohet mësimi me paralele të profesioneve

---

<sup>7</sup> Raporti i punës së Pleqësisë së Arsimit për vitin 1989, Prishtinë, janar 1990 f.3. Arkivi i Kosovës, Fondi: Sekretariati Krahinor i Arsimit.

<sup>8</sup> Programi jugosllav... pika 64-81

<sup>9</sup> Programi jugosllav-masat dhe aktivitetet për ndalimin e shpërnguljes së serbëve dhe të malazezëve nga Kosova, kthimin e shpejtë të atyre që e kanë lëshuar dhe ardhjen e gjithë atyre që dëshirojnë të punojnë dhe të jetojnë në Kosovë. Kuvendi i RFSJ-së miratoi Programin Jugosllav më 17 dhjetor 1987, u dekretua më Nr. 9-6/87-045, kurse u shpall në Fletoren Zyrtare të RFSJ-së më 8 janar 1988. Arkivi Shtetëror i Kosovës, Fondi: Enti Krahinor i Përpimit të Arsimit dhe Edukimit

të caktuara nga shkalla e parë deri në klasën e pestë përgatitjes profesionale; në shkollat e larta dhe në fakultete pjesëtarëve të serbëve dhe malazezëve t'u mundësohet arritja e arsimit të lartë dhe me dhënien e bursave dhe të kredive t'u sigurohen kushte të barabarta për studime; të përgatitet dhe urgjentisht të miratohet programi i gjuhës shqipe si gjuhë amtare dhe programi i edukatës muzikore për shkollën fillore dhe të mesme me mësim në gjuhën shqipe për territorin e RS të Maqedonisë, RS të Malit të zi, RS të Serbisë dhe të KSA të Kosovës dhe të fillojë zbatimi i tyre në pajtim me planet dhe programet e përbashkëta të punës edukative-arsimore; organet dhe organizatat arsimore të Republikës të nxisin bashkëpunimin me shkollat e KSA të Kosovës përmes aktiviteteve të larmishme të përbashkëta; botuesit e teksteve dhe të librave të tjerë shkollorë në KSA të Kosovës, KSA të Vojvodinës dhe të RS të Serbisë duhet që në bazë të planeve dhe programeve të përbashkëta të botojnë një numër sa më të madh tekstesh të përbashkëta për të gjitha nivelet e arsimit, në veçanti për arsimin fillor dhe të mesëm të orientuar; të zgjerohet bashkëpunimi ndëruniversitar në Bashkësinë e Universiteteve të Jugosllavisë dhe të Serbisë, bashkëpunimi ndërmjet fakulteteve të ngjashme për njësimin e planeve dhe programeve mësimore dhe të regjimit të shkollimit lidhur me zbatimin e kriterëve të dakorduara, kriteret dhe planet për regjistrimin e studentëve duke pasur parasysh format e veçanta të bashkëpunimit që duhen të zhvillohen me Universitetin e Prishtinës; me qëllim të pengimit të rritjes së mëtejme të kuadrit tepricë në KSA të Kosovës, KSA të Vojvodinës dhe të RS të Serbisë dhe për këtë duhet të nënshkruhet marrëveshja shoqërore përkatëse; midis programeve arsimore dhe profileve studimore më së paku deri në vitin 2000; për forcimin kadrovik dhe bashkëpunimin e universiteteve të RS të Serbisë dhe universiteteve e tjera të RSFJ-së me Universitetin e Prishtinës, duhet të konkretizohen programet e bashkëpunimit ndëruniversitar dhe midis fakulteteve, veçmas në angazhimin e arsimtarëve nga universitetet e tjera në Universitetin e Prishtinës, si dhe nga Universiteti i Prishtinës në universitetet e tjera; të përgatiten programet për nevojat kadrovike për shtrirjen e ndihmës Kosovës në lëmin e arsimit dhe edukimit nga të gjitha republikat dhe KSA e Vojvodinës; të shfrytëzohen përvojat përkatëse mbi mësimin dygjuhësor në vend, të përcaktohen programe për dhënien e bursave dhe kreditimin e kuadrove nga viset e tjera të vendit të cilët do të shkollohen në Universitetin e Prishtinës, si dhe studentët nga KSA të Kosovës në shkollat e larta, në fakultete dhe universitete të KSA të Vojvodinës, në RS të Serbisë dhe në republikat e tjera. Organet e RS të Serbisë, RS të Maqedonisë, RS të Malit të Zi dhe të KSA të Kosovës, kompetente për çështje të arsimit

dhe të kulturës duhet që bashkërisht t'i përcjellin dhe t'i analizojnë planet, programet dhe tekstat e arsimit fillor dhe të arsimit të mesëm të orientuar dhe për çdo vit të vlerësojnë se si po realizohen qëllimet shoqërore të edukimit. Posaçërisht duhet të organizohen hulumtime të përbashkëta për grupin e lëndëve shoqërore më qëllim që të konstatohet se sa janë zotëruar dhe përvetësuar përmbajtjet programore në të cilat ndërtohet vëllazërimi e bashkimi, patriotizmi socialist jugosllav; organet kompetente në RS të Serbisë dhe të krahinave autonome duhet t'i shikojnë mundësitë që të nisin unifikimin zgjidhjeve normative-ligjore dhe akte të rëndësishme për programet arsimore.<sup>10</sup>

### *Mësimi i gjuhëve joamtare*

Në planprogramet mësimore, në ish- Jugosllavi, në cilësinë e gjuhëve joamtare, ose si gjuhë të mjedisit shoqëror, mësoheshin 10 gjuhë. Statusi i gjuhës joamtare nuk ishte i njëjtë në të gjitha republikat dhe krahinat. Ato diku kanë pasur statusin e lëndës mësimore të obligueshme, diku statusin fakultativ. Edhe përfaqësimi i tyre nuk ishte i njëjtë. Në mungesë të Ligjit mbi barazinë e gjuhëve dhe të shkrimeve në KSA të Kosovës, deri në vitin shkollor 1967/68, serbokroatishtja si gjuhë joamtare ishte lëndë e obligueshme në paralelet me mësim në gjuhën shqipe dhe turke, duke filluar nga klasa e tretë e shkollës fillore nga 3-4 orë në javë. Në Programin jugosllav parashihen që gjuha serbokroate dhe gjuha shqipe<sup>11</sup> si gjuhë joamtare duhen të hyjnë të mësohen nga klasa I e shkollës fillore në mënyrë që t'u mundësohet fëmijëve të tyre dhe rinisë t'i përvetësojnë gjuhët "e mjedisit shoqëror" dhe që do të mund ta përdorin me sukses në komunikimin midis tyre. Me dispozitat e reja ligjore, mësimi i gjuhëve joamtare në KSA të Kosovës, do të ndryshojë thelbësisht. Gjuha shqipe, si gjuhë joamtare, është eliminuar dhe nuk do të figurojë në strukturën e planit dhe të programit mësimor, ndërsa gjuha serbokroate do të jetë lëndë mësimore e obligueshme për pjesëtarët e kombeve dhe të kombësive të tjera. Në nenin 15, paragrafi 4: thuhet: "Kur puna edukativo-arsimore realizohet në gjuhën e kombeve ose të kombësive, nxënësit e përvetësojnë planin

<sup>10</sup> Thekse kryesore nga Programi jugosllav... për arsimin, shkencën dhe kulturën

<sup>11</sup> Kuvendi i RSFJ: Programi jugosllav për pengimin e shpërnguljes së serbëve dhe të malazezëve nga Kosova dhe kthimin e gjithë atyre që dëshirojnë të punojnë dhe të jetojnë në Kosovë, pika 65, Beograd, 29 janar 1987

dhe programin e gjuhës serbokroate”.<sup>12</sup> Kjo lëndë mori karakteri politik. Vendimi i Pleqësisë së Arsimit të Kosovës që mësimi i gjuhëve joamtare të fillojë nga klasa e parë e shkollës fillore, në vitin shkollor 1987-1988, pa kurrfarë përgatitjesh mësimore, ishte një akt skandaloz arsimor.

### *Mësimi dygjuhësor në paralelet e përziera*

Zhvillimi i konceptit unitarist integral i idesë së jugosllavizimit ishte bërë temë në organet më të larta politike e shtetërore të RSFJ-së. Integrimi i identitetit kulturor dhe gjuhësor i kombësive joslave duhet të ndodhë shkallë-shkallë. Shkolla zgjidhet mjedis i përshtatshëm për formimin e brezit të ri me idenë e jugosllavizimit. Për këtë qëllim *“Kryesia e KQ të LKJ-së, në bashkëpunim me Kryesinë e KQ të LKS dhe të KK të LKK do të sigurojnë angazhimin e komunistëve në organet përkatëse arsimore dhe të enteve të teksteve që me kohë dhe në mënyrë cilësore t’i përgatisin programet, tekstet, literaturën dhe të gjitha përparësitë organizative dhe materiale që në mënyrë sa më efikase të futet mësimi dygjuhësor në Kosovë. Kryesia e KQ e LKJ-së kërkonte që të informohet rregullisht për realizimin e këtyre detyrave. Afati u caktua nëntori i vitit 1987*<sup>13</sup>.

Kryesia e Komitetit Krahinor ka mbështetur Projektin ideor mbi shqyrtimin e mundësive dhe të arsyeshmërisë së aplikimit të mëimit dygjuhësor dhe të paraleleve të përziera.<sup>14</sup> Ky qëndrim politik i Kryesisë së KK të LKK-së ka qenë shtysë për përfshirjen e mëimit dygjuhësor dhe të paraleleve të përziera në bazë të Programit jugosllav në të cilin thuhet:” Është e nevojshme që gradualisht të futet mësimi dygjuhësor për të gjitha lëndët e rëndësishme në të gjitha shkollat në KSA të Kosovës, duke shfrytëzuar në këtë rast përvojat përkatëse në vend” Në ERPEA pati edhe mendime të tjera në favor të pamundësisë së organizimit të mëimit dygjuhësor. Mirëpo, Komiteti Republikan i

<sup>12</sup> “Shkëndija”, Prishtinë, më 1 prill 1990

<sup>13</sup> Kryesia e KQ LKJ: 05 Nr. Tepër sekret Beograd, më 21 korrik 1987

<sup>14</sup> KK LKK - Kryesia (për përdorim të brendshëm): Informata mbi aktivitetet e organeve dhe organizatave arsimore për realizimin e detyrave nga Konkluzionet e Kryesisë të RSFJ-së dhe të Kryesisë së KQ të LKJ-së më vështrim të veçantë për planet e programet mësimore dhe tekstet shkollore, f. 5 Prishtinë, tetor 1986. Arkivi i Kosovës, Fondi: Sekretariati i Arsimit, i Shkencës dhe i Kulturës.

Arsimit i Serbisë ishte në favor të zbatimit të mësimin të obligueshëm të gjuhëve të kombeve në RS të Serbisë edhe në Kosovë, pra të gjuhës serbokroate, prej shkollës fillore deri në fakultet. Ky parim mund të vlejë edhe për mësimin dygjuhësor. Sipas Komitetit të Arsimit të Serbisë, për mësimin dygjuhësor më shumë nevojë edhe mundësi ka në arsimin e mesëm dhe të lartë. Lëndët e shkencave shoqërore për nxënësit dhe studentët e kombësive do të mësoheshin në gjuhën amtare, kurse lëndët e shkencave natyrore dhe profesionale do të mësoheshin në gjuhën serbokroate.<sup>15</sup>

Kryesia e KK e LKK po ashtu mbështeti mundësinë e formimit të paraleleve të përziera dhe thekson se është përgatitur projekti ideor mbi shqyrtimin e mundësive dhe të arsyeshmërisë së aplikimit të mësimin dygjuhësor në paralelet e përziera. Për mundësinë e aplikimit të këtij projekti diskriminues për arsimin shqip në Kosovë flet edhe Kryetari i Komitetit për Arsim, Shkencë dhe Kulturë ku thotë: “Në kuadër të masave që dalin nga Konkluzionet e dy Kryesive është parashtruar edhe mundësia e aplikimit të organizimit të mësimin në paralelet e përziera. Edhe për këtë formë të organizimit të mësimin është formuar grupi punues në nivel të Republikës Socialiste të Serbisë (përfaqësuesit e RS të Serbisë, të KSA të Vojvodinës dhe të KSA të Kosovës), grup ky që ka për detyrë që brenda pesë muajsh të analizojë dhe të vlerësojë mundësitë e organizimit të kësaj forme të punës edukativo-arsimore.”<sup>16</sup>

Pleqësia e Arsimit e Kosovës, më 16 dhjetor 1987, shqyrtoi materialin për “Arsyeshmërinë e formimit të paraleleve të përziera dhe zbatimin e mësimin dygjuhësor”<sup>17</sup>. Anëtarët e Pleqësisë së Kosovës, u shprehën: “*Formimi i paraleleve të përziera është një nismë e mirë dhe formë e re jo vetëm për mësimin e gjuhëve joamtare, por edhe për afrimin në mes veti, për forcimin e vëllazërim-bashkimit dhe të bashkëjetesës.*”<sup>18</sup> Pleqësisë së Arsimit iu ofruan tri modele për formimin e paraleleve të përziera me mësim dygjuhësor. Sipas modelit të dytë parashihej që mësimi dygjuhësor në paralelet e përziera të organizohet në disa lëndë mësimore: edukatë fizike e shëndetësore, kulturë muzikore, art figurativ, bazat e teknikës dhe puna prodhuese, si dhe

---

<sup>15</sup> Rilindja, 14. XII. 1987, (Tanjug)

<sup>16</sup> Ejup Hamiti: Rilindja, e shtunë, 19. VIII. 1986

<sup>17</sup> Pleqësia e Arsimit e Kosovës 02 Numër: 612-1983/87, Prishtinë, 29. XII. 1987, pranuar nga Enti 03.nr. 709 më 30. XII. 87. Arkivi shtetëror i Kosovës, Fondi: Enti për Përpërimin e Arsimit dhe Edukimit.

<sup>18</sup> Procesverbali i Pleqësisë së Arsimit f. 3 më 16.12.1987, Prishtinë, 1987, Arkivi i Kosovës, Fondi: Enti Krahinor i Përpërimin të Arsimit dhe Edukimit.

ushtrimet e nxënësve. Mësimi dygjuhësor në paralelet e përziera për herë të parë në Kosovë filloi të zbatohet në vitin shkollor 1987/88. Kjo ishte një ndërhyrje e politikës diskriminuese serbe në shkollën shqipe<sup>19</sup>. EKPEA në Planin dhe programin vjetor të punës, për vitin 1988, përveç detyrave të tjera që dalin nga programi operativ jugosllav, planifikonte “do të bëhen përgatitjet dhe do të merren aktivitete konkrete në gjurmimin e mundësive për aplikimin e mësimin dygjuhësor në paralelet e përziera.”<sup>20</sup> Materialin për paralelet e përziera me mësim dygjuhësor e përgatitën grupet punuese të enteve pedagogjike të RS të Serbisë dhe të KSA të Kosovës<sup>21</sup>. Kjo ishte një përpjekje për t’i kthyer praktikën mësimore të mësimin në dy gjuhë të viteve ’50 dhe 60. Në favor të këtyre praktikave shkruan edhe ak. Jashar Rexhepagiq<sup>22</sup>. Në vitin 1992 Serbia ka nxjerrë Ligjin e ri mbi shkollën fillore në të cilin parasheh mësimin dy gjuhësor (Shih nenin 4 dhe 5).<sup>23</sup>

### *Projektligjit për pensionimin e parakohshëm të arsimtarëve*

Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të KSA të Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 28 janar 1988 nën drejtimin e Rexhep Gashit, nënkryetar miratoi Projektligjin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të punëtorëve në lëmin e arsimit dhe ia dërgoi Kuvendit Krahinor për procedurë të mëtejme<sup>24</sup>. Miratimi i Projektligjit për pensionimin e parakohshëm të arsimtarëve ishte një vendim që pasqyronte kurorën e veprimeve dhe të akteve më diskriminuese që nxori KE i Kosovës kundër arsimtarëve shqiptare dhe sistemit të arsimit shqip në Kosovë. Projektligji në fjalë

<sup>19</sup> (\*Shkresa ë Pleqësisë së Arsimit dërguar Entit Krahinor për Përparimin e Arsimit dhe Edukimit 02 Nr. 612-983/87, Prishtinë, 29. XII. 1987.

<sup>20</sup> Plani dhe Programi Vjetor i Punës së Entit për Vitin 1988, Prishtinë, shkurt 1988

<sup>21</sup> Enti Krahinor i Përparimit të Arsimit dhe Edukimit, Materiali “Arsyet dhe Mundësitë për formimin e paraleleve të përziera për zbatimin e mësimin dygjuhësor” Prishtinë, gusht 1987. Arkivi i Kosovës, Fondi: Enti i Përparimit të Arsimit dhe të Edukimit.

<sup>22</sup> Jashar Rexhepagiq: Vleftha pedagogjike e mësimin në dy gjuhë”, Përparimi f. 671 (Qëllimi i mësim në dy gjuhë del nga anketa nr. 5 kur nxënësi përgjigjet: “Unë dua të mësojë këtu sepse mësojmë gjuhën serbokroate se jemi të gjithë bashkë për arsye se ne të gjithë jemi jugosllavë”

<sup>23</sup> Dekreti mbi shpalljen e Ligjit për shkollën fillore, të cilin e ka miratuar Kuvendi Popullor i Republikës së Serbisë në Sesionin e dytë të jashtëzakonshëm më 1992, mbajtur më 22 korrik 1992. PB numër 223, Beograd, 22 korrik 1992.

<sup>24</sup> Mbledhja e Këshillit Ekzekutiv: “Shpejtohet diferencimi në arsim “ Rilindja, E premtë, 29.I.1988, f. 1

ishte produkt i kërkesave të regjimit shtypës të Beogradit për të hapur portën e zbatimit të Programit jugosllav për Kosovën në fushën e arsimit e që kishte për qëllim ricolonizimin e Kosovës. Projektligj ishte në kundërshtim të plotë me disa ligje sistemore, të cilët rregullojnë fushën e arsimit dhe të edukimit. Në arsyetimin për nxjerrjen e këtij ligji përcaktohet ky qëllim kryesor: *“Me nxjerrjen e këtij ligji do të krijohen kushtet që edhe në këtë bazë, nga veprimtaria e arsimit, si veprimtari me interes dhe rëndësi të veçantë shoqërore, të largohen të gjitha ato kuadro që me punën e tyre, me veprimtarinë ideo-politike dhe me sjelljet e gjithmbarshme nuk kontribuojnë në mënyrë efikase e të plotë në realizimin e detyrave dhe të qëllimeve të arsimit dhe të edukimit socialist”*.<sup>25</sup> Pra, *“Ligji do t’i japë ndihmesë të vendosur diferencimit ideo-politik dhe në punë mes kuadrove në arsim, veçanërisht kur është fjala për të gjithë ata, që me punë dhe sjelljet e tyre kanë ndikuar në indoktrinimin e të rinjve, kanë shkaktuar dhe po shkaktajnë urrejtje dhe zemërngushtësi kombëtare, mosmarrëveshje ndërnacionale që me sjelljen e tyre po e çrregullojnë barazinë kombëtare, bashkimin e vëllazërimit e pjesëtarëve të kombeve dhe të kombësive, të cilët jetojnë dhe punojnë në Krahinë,”*<sup>26</sup> Sipas këtij vlerësimi të KE, kërkohen arsimtarë për ta përcuar idenë për një arsimim shtetëror jugosllav, që do të shpjerë drejt serbizimit të shkollave shqipe në Kosovë. Ky ligj do të diskriminonte vetëm arsimtarët shqiptarë të Kosovës. Në disa institucione profesionale nuk është dhënë mendimi pozitiv.<sup>27</sup> Kuvendi i KSA të Kosovës, në mbledhjet e ndara të Dhomës së Punës së Bashkuar dhe Dhomës së komunave të mbajtura më 28 shkurt 1988, shqyrtuan dhe përkrahën Projektligjin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të punëtorëve të në organizatat e punës së bashkuar në lëmin e arsimit duke nxjerrë një Konkluzion me të cilin përcaktohet Projektligji si bazë për hartimin e Projektligjit dhe të jepet në diskutim publik deri më 26 prill 1988. Pas kërkesave të minatorëve të Trepçës që edhe Projektligji për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të punëtorëve në lëmin e arsimit të tërhiqet propozuesi në heshtje hoqi dorë nga ky Ligj.

---

<sup>25</sup> Brestovci Behlul: Diskutimi në Mbledhjen e Komitetit Krahinor për Arsim, Shkencë, dhe Kulturë.

<sup>26</sup> Mbledhja e Këshillit Ekzekutiv: “Shpejtohet diferencimi në arsim “ Rilindja, f 3, E premte, 29.I.1988

<sup>27</sup> Brestovci: Behlul: Po aty f.4

## *Iniciativat e Serbisë për nxjerrjen e ligjeve unike*

Kuvendi i RS të Serbisë, në dhjetor të vitit 1983, kishte filluar nismën e parë për nxjerrjen e ligjeve në arsim duke i dorëzuar Kuvendit të KSA të Kosovës, konkluzionin lidhur me fillimin e iniciativës që, me marrëveshje, të nxirret Ligji unik mbi arsimin dhe edukimin e mesëm të orientuar për tërë territorin e Republikës. Propozimi i Serbisë për ligjet unike është mbështetur në nenin 301 të Kushtetutës së RS të Serbisë. Kuvendi i KSA i Kosovës përkatësisht delegatët e Dhomës së Punës së Bashkuar u njoftuan me Konkluzionin e iniciativës së Serbisë. Mirëpo, duke u bazuar në nenin 283 të Kushtetutës së KSA të Kosovës, u propozua që më e arsyeshme është të përfillen format e bashkëpunimit dhe të marrëveshjeve për afrim më të madh edhe në këtë sferë.<sup>28</sup> Serbia, në mbështetje të marrëveshjeve dhe të formave të tjera, kishte shtrirë sundimin e saj në fushën e arsimit dhe edukimit dhe hap pas hapi kufizonte dhe ngushtonte të drejtat e Kosovës në fushën e arsimit, por jo vetëm në fushën e arsimit. Në emër të afrimit, bashkëjetesës, vëllazërim-bashkimit, që nga viti 1980, Serbia po përgatitej për ta goditur autonominë e Kosovës dhe suprimimin e Kushtetutës së vitit 1974, të cilën e realizoi në rrethana dramatike me shumicën e delegatëve të Kuvendit të Kosovës, më 23 mars 1989.<sup>29</sup>

Pas suprimimit të autonomisë së KSA të Kosovës, Serbia iu kthye përsëri iniciativave të mëhershme për ligje unike, me marrëveshje në fushën e arsimit, shkencës, kulturës dhe të shëndetësisë për tërë territorin e Republikës. Në mbledhjen e jashtëzakonshme të Komitetit Krahinor, për Arsim, Shkencë e Kulturë,<sup>30</sup> në përbërje të zgjeruar, të cilën e kryesoi Stanisha Markoviç, kryetar, mbajtur më 18 e 19.9.1989, ku ishin të pranishëm edhe disa anëtarë shqiptarë, u diskutuan iniciativat e Serbisë për nxjerrjen e ligjeve unike, me marrëveshje, për rregullimin e çështjeve dhe marrëdhënieve në fushën e arsimit dhe

---

<sup>28</sup> Rilindja, 14 dhjetor 1983

<sup>29</sup> Vendimi mbi dhënien e pëlqimit për tekstin e amendamenteve IX deri XLIX për Kushtetutën e Republikës Socialiste të Serbisë, 01 Nr. 010-4/89, Prishtinë, më 23 mars 1989. Arkivi I Kosovës, Fondi: Kuvendi i KSAK.

<sup>30</sup> Procesverbal nga Mbledhja e jashtëzakonshme në përbërje të zgjeruar e Komitetit Krahinor për Arsim, Shkencë dhe Kulturë, më 18 dhe 19 shtator 1989, f. 9.10 duke filluar në ora 13.45 në Bibliotekën e Kuvendit (Zapisnik sa vanredne sednice u proširenom sastavu Pokroainskog komitetu za obrazovanje, nauku i kulturu u Prištini, održane 18. i 19.1989 god. f.9.10., sa početkom u 13.45 časova u Biblioteci Skupštine.

edukimit fillor, arsimet dhe edukimit të mesëm, arsimet të lartë, arsimet superior dhe të lëmenjve të tjerë të veprimtarive shoqërore. Iniciativat e Serbisë për nxjerrjen e ligjeve unike në arsim, u përkrahën nga ak. Jashar Rexhepagiq, Riza Brada, Nezir Prokshi dhe Jordan Keciq. Në këtë mbledhje u propozua të formohet një *Këshilli koordinues që ta përcjellin rrjedhën e diskutimit publik për ligjet e arsimet fillor dhe të mesëm. Kryetar i Këshillit koordinues u zgjodh ak. Jashar Rexhepagiq,*

## Arsimi 1990-1998

### *Miratimi i ligjeve unike në Kuvendin e Serbisë*

Sekretariati Krahinor për Arsim, Shkencë dhe Kulturë<sup>31</sup>, “*në bashkëpunim me organet e tjera në Krahinë dhe në Serbi ka punuar për përgatitjen e dispozitave të reja ligjore nga lëmi i arsimet, shkencës dhe kulturës dhe në bazë të Amendamentit XXXIII, pika 11, të Kushtetutës së RS të Serbisë, të cilat do të zbatohen në tërë territorin e Republikës, janë përgatitur propozimet e ligjeve për veprimtarinë shoqërore.*”<sup>32</sup> Raporti për rezultatet e diskutimit publik nuk u është shpërndarë fare delegatëve të Kuvendit të KSA të Kosovës, sepse diskutimi publik nuk është zhvilluar ose rezultatet e tij nuk kanë qenë të favorshme për Sekretariatit për Arsim, Shkencë e Kulturë si propozues. Lidhur me këtë Muhamet Bicaj thotë: “*Me rastin e ndryshimeve kushtetuese dhe të shumë ligjeve, popullit iu premtua se të gjithë do të fitojnë dhe të gjithë do të jenë të barabartë. Këtë e kemi thënë të gjithë, unë kam qenë njëri prej kuadrove të tillë, i cili zastupio na terenu jam angazhuar me korrektësi... dhe planprogramet e tilla për ne nuk janë as për diskutim publik sa që nuk kemi guxuar të paraqitemi në diskutim publik*”<sup>33</sup> Mbledhja III e Dhomës së punës së bashkuar të Kuvendit të KSA të Kosovës, më 23 janar 1990 miratoi Ligjet mbi veprimtaritë shoqërore të RS të Serbisë, të cilat duhet të vlenin edhe për KSA të Kosovës edhe pse disa delegatë dhanë vërejtje serioze lidhur me projektligjet. Sekretari i Sekretarit Krahinor për Arsim, Shkencë dhe Kulturë pasi dha sqarime e tjera foli edhe lidhur me

---

<sup>31</sup> Sekretariati Krahinor i Arsimet, Shkencës dhe i Kulturës deri në nxjerrjen e Ligjit mbi organizimin e administratës krahinorë (Gazeta Zyrtare e KSAK”), Nr. 34/89), ka punuar si Komitet Krahinor i Arsimet, Shkencës dhe Kulturës.

<sup>32</sup> Sekretariati Krahinor i Arsimet dhe i Kulturës: Raporti mbi punën e Sekretariatit Krahinor të Arsimet të Kulturës, Prishtinë, mars 1990

<sup>33</sup> Magnetogrami nga Mbledhja e përbashkët e Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të RS të Serbisë dhe Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të KSA të Kosovës (f.39,40,41), mbajtur më 9 qershor 1990 në Prishtinë

Projektligjin për Pleqësinë e Arsimit të Serbisë, i cili i njoftoi delegatët se: “*KE i KSA të Kosovës dhe KE i RS të Serbisë, në Beograd, jemi pajtuar që miratimi i planeve dhe programeve mësimore, përcaktimi i kushteve të pajisjes e të mjeteve për realizimin e këtij programi, si dhe lejimi i teksteve mësimore për arsimin fillor dhe të mesëm, të jenë në kompetencën e Pleqësisë së Arsimit të Serbisë.*”<sup>34</sup> Më 25 janar 1990 delegatët e tri dhomave të Kuvendit të RS të Serbisë shqyrtuan dhe miratuan ligjet unike për veprimtarinë shoqërore, të cilët do të zbatoheshin në tërë territorin e Republikës. Të gjitha amendamentet e Kuvendit të KSA të Kosovës u refuzuan.

Kështu, miratimi i ligjeve dhe i dispozitave të tjera sipas amendamentit XXXIII, pika 11 në Kushtetutën e RS të Serbisë, do të zbatoheshin në mënyrë unike në tërë territorin e Republikës, si: Ligji për arsimin dhe edukimin fillor; Ligji për arsimin dhe edukimin e mesëm; Ligji për shkollat e larta; Ligji për Universitetin, Ligji për Pleqësinë e Arsimit, Ligji për të mirat e kulturës, Ligji për veprimtarinë bibliotekare; Ligji për kulturë fizike; Ligji për veprimtarinë shkencore-kërkimore. Miratimi i këtyre ligjeve shkaktoi indinjatë dhe pakënaqësi në tërë Kosovën, në veçanti tek opinioni arsimor e kulturor. Serbia, pas miratimit të ligjeve unike pretendoi t’i zbatojë në tërë territorin e saj duke kërkuar që organet arsimore të Kosovës të angazhohen në procesin e diskutimit publik për projektet e planeve dhe të programeve edukativo-arsimore për shkollën fillore dhe për arsimimin e mesëm. Enti Krahinor i Përparimit e Edukimit dhe të Arsimit, në prill të vitit 1990 nga Enti Republikan i Arsimit në Beograd i mori projektet e planeve dhe të programeve për gjimnaze, kurse në gjysmën e parë në muajin maj programit të punës edukativo-arsimore për shkollën fillore.

### *KE i Kosovës për realizimin e detyrave nga Programi jugosllav për fushën e arsimit, shkencës dhe të kulturës.*<sup>35</sup>

Këshilli Ekzekutiv i KSA të Kosovës më 1 mars 1990 shqyrtoi dhe miratoi Raportin për realizimin e detyrave nga Programi jugosllav

<sup>34</sup> Dr. Skënder Skënderi: Si veproi Kuvendi i Republikës së Kosovës, Vëllimi I-4.12.1989-7.9.1990, Prishtinë, 2016

<sup>35</sup> Programi jugosllav për parandalimin e shpërnguljes së serbëve dhe të malazezëve nga Kosova dhe kthimin sa më të shpejt të të gjithë atyre që dëshirojnë të punojnë dhe të jetojnë në Kosovë; Arkivi i Kosovës, Fondi: Sekretariati Krahinor i Arsimit, Shkencës dhe i Kulturës.

për periudhën tetor-dhjetor 1989.<sup>36</sup> Në Raportin e KE thuhet se institucionet parashkollore, aty ku ka ekzistuar mundësia kanë formuar grupet e përziera; është aplikuar mësimi i gjuhës serbokroate si gjuhë joamtare nga klasa I e shkollës fillore; në disa mjedise ka filluar zbatimi eksperimental i mësimiit dygjuhësor dhe formimi i paraleleve të përziera; janë siguruar kushtet për regjistrimin e të gjithë nxënësve të kombit serb dhe malazez në të gjitha degët për të cilat organizohet mësimi në KSA të Kosovës. Për vitin shkollor 1989/90, sipas planit të regjistrimit, në arsimin e mesëm të orientuar janë paraparë të regjistruhen 32 793 nxënës dhe pikërisht: në gjuhën shqipe 21050 nxënës, në gjuhën serbokroate 11419 nxënës, në gjuhën turke 224 nxënës. Një plan i tillë është hartuar në bazë të Programit jugosllav për Kosovën me qëllim të regjistrimit pa pengesa të gjithë të kthyerve dhe të atyre që dëshirojnë të jetojnë dhe të punojnë në Kosovë. Nga numri i përgjithshëm që kanë kryer klasën VIII të shkollës fillore, në vitin shkollor 1989/90 nuk janë regjistruar 8 658 nxënës. Prej tyre 8505 në gjuhën shqipe.<sup>37</sup> Është miratuar programi i përbashkët i gjuhës shqipe si gjuhë amtare dhe programi i kulturës muzikore për shkollat fillore dhe të mesme me mësim në gjuhën shqipe për territorin e RS të Maqedonisë, RS të Malit të Zi dhe RS të Serbisë. Në vitin shkollor 1989/90, në shkollat fillore dhe të mesme po zbatohen një numër i teksteve të përbashkëta, të cilat janë hartuar në bashkëpunim me shtëpitë botuese në RS të Serbisë e më gjerë në Jugosllavi. Kujdes i veçantë i është kushtuar regjistrimit të studentëve nga mjediset e tjera në fakultetet dhe në shkollat e larta të Universitetit të Prishtinës. Po ashtu janë angazhuar 140 kuadro mësimore- shkencore për punë në UP, të ardhur nga mjediset e tjera të Jugosllavisë në kuadër të bashkëpunimit ndëruniversitar. Ka filluar realizimi konkret i detyrave për dhënien e bursave dhe të kredive për vendosjen e organizuar të studentëve nga qendrat e tjera universitare të vendit në Qendrën e Studentëve në Prishtinë. Janë vlerësuar veçmas përmbajtjet e lëndëve të shkencave shoqërore. EKPAE duke shqyrtuar realizimin e detyrave nga Mbledhja e 16 -të e KQ të LKJ vlerësojnë se Enti ka kryer punë të mirë rreth planprogrameve mësimore dhe konstatojnë se kanë bërë punë të madhe

---

<sup>36</sup> Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të Kosovës: Raporti KE të KSA të Kosovës për Kuvendin e Kosovës, Nr.9-328/90, Prishtinë, më 14. III. 1990. Arkivi i Kosovës. Fondi: Sekretariati i Arsimit, Shkencës dhe i Kulturës

<sup>37</sup> Komiteti Krahinor i Arsimit, Shkencës dhe i Kulturës: Shkresa 01 Nr.06-1688/89, f.1 dhe 2, Prishtinë më 16. X. 89 lidhur më Shkresën e Kuvendit nr. 06-5-12/89, më 14. XI. 189 në pyetjen e delegatit Hazir Obrazhda, Arkivi i Kosovës Fondi: Esat Kamberi

rreth përfshirjes së mësimi të gjuhës joamtare prej klasës I të shkollës fillore. Kemi hartuar edhe analizën rreth mësimi dy gjuhësor.<sup>38</sup>

Institucionet arsimore të KSA të Kosovës ishin shndërruar në reparte të regjimit të Beogradit dhe të vartësve të tyre politikë shqiptarë në Kosovë duke pranuar dhe zbatuar verbërisht çdo iniciativë dhe kërkesë që vinte nga Beogradi përmes dokumenteve partiake apo shtetërore duke përfshirë edhe Programin jugosllav për parandalimin e shpërnguljes së serbëve dhe të malazezëve nga Kosova, kthimin më të shpejt të atyre që dëshirojnë të jetojnë dhe të punojnë në Kosovë që ishte një projekt i dizajnuar antishqiptar për shkatërrimin e jetës institucionale ekonomiko- shoqërore, arsimore, kulturore, shkencore e shëndetësore të shqiptarëve në Kosovë.

### *Ndarja e nxënësve në shkolla sipas përkatësisë kombëtare*

Ndasitë etnike në shkolla dhe fakultete (konvikte) ishin një akt politik i shëmtuar, diskriminues dhe antipedagogjik kundër nxënësve dhe studentëve shqiptarë i përgatitur nga vetë Qeveria e Serbisë duke inskenuar "pakënaqësinë" e nxënësve serbë e malazezë dhe të prindërve të tyre. Këshilli Ekzekutiv KSA i Kosovës miratoi vendimin "që të ndërpritet mësimi në një numër shkollash të mesme në territorin e Prishtinës për shtatë ditë dhe brenda kësaj kohe u obliguan organet kompetente komunale dhe drejtoritë e shkollave të gjejnë mundësi për vazhdimin normal të vitit shkollor".<sup>39</sup> Më 8 mars 1990, kryetarët e këshillave ekzekutivë të komunave në KSA të Kosovës morën një telegram<sup>40</sup> me të cilin kërkohet që nxënësve me mësim në gjuhën serbokroate t'u sigurohet vijimi i mësimi në ndërresën e parë. "Është e nevojshme që organet e shkollave menjëherë nxënësve me mësim në gjuhën serbokroate t'u sigurohet vijimi në ndërresën e parë derisa të zgjasin rrethanat e jashtëzakonshme."<sup>41</sup> Po ashtu, Këshilli Ekzekutiv i

<sup>38</sup> Procesverbali nga Mbledhja e OTHLK e E K P A E, f.3, më 13 shtator 1988

<sup>39</sup> Këshillit Ekzekutiv i Kuvendit të KSAK të Kosovës: Përfundimet: Nr.06-610/H90, Prishtinë më 16. III. 1990. Arkivi Shtetëror i Kosovës Fondi: Sekretariati i Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (i parregulluar)

<sup>40</sup> Sekretari Krahinor për Arsim, Shkencë dhe Kulturë: Nr.92/90, Prishtinë 8.3.1990 Kuvendi i Komunës – Kryetarit të Këshillit Ekzekutiv Prishtinë, Telegram Nr. 91, datë: 5.mars 1990, Sekretar dr. Muhamet Bicaj.

<sup>41</sup> Përmbytja e telegramit në orgjinal: "Potrbno je da organi škola odmah obezbede učenicima sa nastavom na srpskohrvatskom jeziku pohadžanje nastave u prvoy smeni dok traju vanredne okolnosti."

KSA të Kosovës në të njëjtën mbledhje mori vendim për mbylljen e Qendrës së Studentëve duke kërkuar nga organet e Qendrës që studentët të largohen nga konviktet më së largu deri më 16 mars 1990. Dëbimi studentëve shqiptarë nga konviktet për një kohë të “caktuar” ishte i njëjti skenar mashtrues me qëllim të ndasisë në baza etnike të sigurimit të strehimit të studentëve serbë dhe malazezë në Konviktin nr. 5. Më 9 mars 1990 autoritetet e Beogradit që ishin të angazhuar drejtpërdrejt për destabilizimin e gjendjes në Kosovë mbyllën Konviktin nr.5 me ndihmën e politikës shërbyese të Kosovës, të cilat në një anë bënë thirrje për stabilizimin e procesit, ndërsa në anën tjetër zbatonin vendimet despotike dhe antishqiptare të Qeverisë së Beogradit. Studentë dhe profesorë protestuan, por nuk morën përgjigje. Studentët formuan shtabin për strehimin e tyre. Qytetarët e Prishtinës pranuan studentët në shtëpitë ose në banesat e tyre. Kundër ndasive kombëtare dhe segregacionit të nxënësve dhe të studentëve, LDK-ja vlerësoi se “segregacioni është një veprim i dëmshëm për marrëdhëniet ndërnacionale dhe nxënësit shqiptarë”<sup>42</sup>

### *Helmimi i nxënësve, vepër kriminale*

Politika zyrtare e Serbisë, në harkun kohor 1981-1999, riktheu praktikat kriminale serbe për dëbimin e shqiptarëve nga Kosova të sajuara në platformat e fshehta të Vaso Çubrilloviçit për shfarosjen e etnisë shqiptare nga trojet e veta dhe në Programin jugosllav për ndalimin e shpërnguljes së serbëve dhe të malazezëve nga Kosova dhe kthimin e gjithë atyre që dëshirojnë të punojnë dhe të jetojnë në Kosovë. Pranvera e vitit 1990 shënon rikthimin e këtyre projekteve.

Helmimi i 7421 nxënësve shqiptarë në shkollat e Kosovës paraqet kulmin e një regjimi tiranik antishqiptar. Në historikun e përdorimit të substancave kimike për të helmuar një rini shkollore që mëson në shkollat e veta, në vendin e vet nuk është shënuar asnjëherë dhe askund. Helmimi i nxënësve shqiptarë pati jehonë ndërkombëtare. Në muajin qershor të vitit 1990, në Zagreb u mbajt simpoziumi me emër: “Kosova, sfidë e ndërgjegjes njerëzore”<sup>43</sup>. Në këtë tubim shkencor, toksikologu dhe biokimisti kroat Franjo Pllavishi publikoi substancën kimike

---

<sup>42</sup> Dr. Ibrahim Rugova: Konferencë për shtyp në Lidhjen Demokratikë të Kosovës, Prishtinë, më 9 mars 1990.

<sup>43</sup> Franjo Pllavilishic: Simpoziumi “Kosova sfidë e ndërgjegjes njerëzore” Zagreb, qershor 1990

“Dimetil phosphditionat” e izoluar në mostrat e urinës të helmuarit e Kosovës. Ndërsa mjeku francez Benedeti kishte deklaruar: “Në Kosovë pati helmime. Në Kosovë, gjatë pranverës, me qëllim, janë helmuar mbi 7000 nxënës shqiptarë me gaz deri tani të paidentifikuar”. Sipas tij “ky krim është bërë nga agjentët e Beogradit, me siguri nga agjentët ushtarakë”. Autorët e helmimit të nxënësve shqiptarë, në mjedise të ndryshme shkollore, duhet të kenë qenë profesionistë ose persona të trajnuar për të hedhur substancat kimike helmuese në sasi dozash për efekte të dëshiruara, në mënyrë të përpiktë dhe në zona hapësinore të sakta shkollore ”Mjekët shqiptarë me gjithë kaosin e krijuar patën sukses të regjistronjë të gjitha simptomat e helmimeve.”<sup>44</sup>

Kryesia e KK të LK dhe Komitetit MPP dhe VMSH të Prishtinës mbajti një takim urgjent. Kryesia konkludoi “*që sa më parë në opinion të dilet me të vërtetën mbi kinse helmimin dhe të zbulohen organizatorët e kësaj veprimtarie armiqësore dhe të merren në përgjegjësi.*”<sup>45</sup> Një vlerësim të njëjtë dha edhe ministri Shëndetësisë i Serbisë Vlada Petroniç”. Në aspektin e “helmimit masovik” që ka ndodhur në Kosovë, ne kemi pasur raportet e dy komisioneve në nivel federativ...në qoftë se duam ta qetësojmë situatën atëherë të mos i përmendim më helmimet”.

Pleqësia e Arsimit e RS e Serbisë në mbledhjen e mbajtur më 28 qershor 1990 në bazë të Ligjit për arsimin dhe edukimin fillor miratoi “Rregulloren e planit dhe programit mësimor të arsimit dhe edukimit fillor.” Me operacionalizimin e ligjeve të reja, Serbia ia kishte hequr Kosovës të gjitha të drejtat në fushën e arsimit, të cilat i kishte me Kushtetutën e vitit 1974. Ligji i për arsimin dhe edukimin fillor dhe të gjitha ligjet e tjera parashiheshin të zbatohen në mënyrë unike në tërë territorin e Serbisë. Po ashtu Serbia kishte miratuar edhe “Rregullore për planin e arsimit dhe të edukimit për gjimnaze dhe programin e arsimit për vitin I. “Kushtetuta dhe ligjet e Serbisë” unike” ia morën të drejtën themelore Kosovës për miratimin dhe nxjerrjen e dokumenteve kryesore të arsimit: miratimin e planeve dhe programeve mësimore, të teksteve shkollore dhe të mjeteve mësimore.

Mirëpo, më 24 gusht 1990, Pleqësia e Arsimit e Kosovës në bazë të “Vendimit të Dhomës së Punës së Bashkuar më 28 maj 1990, e cila refuzoi të gjitha insistimet e RS të Serbisë për aplikimin e ligjeve dhe të

<sup>44</sup> Joran Vaseniusi: Sëmundja mistike (për helmimet 1990) Botues: Shota, Gislaved-Sudi)

<sup>45</sup> Ekstrakt nga Procesverbal i Mbledhjes së 17-të të përbashkët të KK të LK dhe Komitetit për MPP dhe VMSH të komunës së Prishtinës mbajtur më 21. 3.1990, në ora 15:00, Arkivi ndërkomunal i Prishtinës: Fondi Komiteti Komunal i LK të Prishtinës (i parregulluar)

planprogrameve mësimore unike,” në frymën e ndryshimeve të reja politike dhe nën tryshninë e opinionit arsimor, miratoi planprogramet mësimore për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, me gjithë tentimet e kryetarit dhe të anëtarëve serbë të Pleqësisë, që të pengojnë këtë proces me arsyetimin se kjo e drejtë tani i takon Pleqësisë së Arsimit të Serbisë. Në mbledhje u tha se Kuvendi i Kosovës, më 2 korrik 1990, ka shpallur Deklaratën e Kushtetuese për Kosovën dhe për të gjitha çështjet dhe vendimet që kanë të bëjnë me arsimin e Kosovës, do të miratohen nga institucionet përkatëse të Kosovës dhe kurrë në Beograd.

### Masat e Serbisë për shkatërrimin e sistemit të arsimit të Kosovës

Viti shkollor 1990/91 shënon përballjen e drejtpërdrejtë institucionale ndërmjet Serbisë dhe Kosovës. Serbia synonte për zbatimin e ligjeve të arsimit në tërë territorin e RS të Serbisë duke përfshirë Kosovën dhe Vojvodinën. Kosova bllokoi zbatimin e ligjeve dhe të planprogrameve mësimore unike të Serbisë në institucionet arsimore dhe në shkollat shqipe në KSA të Kosovës. Sekretari i Sekretariatit Republikan për Arsim, Shkencë dhe Kulturë Fizike, Danilo Zh. Markoviç, më 14.9.1990 vlerësoi se për stabilizimin e gjendjes së arsimit në “KA të Kosovës dhe Metohisë” me urgjencë duhet të zgjidhen këto probleme: përkthimi dhe shpërndarja e programeve mësimore për klasën I dhe klasën V të shkollës fillore dhe për klasën I të shkollës së mesme në gjuhën shqipe, shtypja dhe dorëzimi i librit të klasës i shkollave fillore dhe të mesme dhe të insistohet që të ndërrohen programet “ilegale” që i përdorin shqiptarët; ndërmarrja e masave ligjore për rregullimin e gjendjes në Entin Krahinor dhe në entet komunale pedagogjike-arsimore, në organet komunale të administratës, në sekretariate dhe në organet e veprimtarisë shoqërore, në shërbimin e Inspektoratit Krahinor të Arsimit dhe në Rektoratin e Universitetit të Prishtinës. Drejtori i Entit Republikan dhe Sekretari Republikan dhe ai Krahinor për Arsim, Shkencë dhe Kulturë të rikonstruojnë shërbimin krahinor pedagogjik-arsimor dhe Enti ekzistues të përfshihet në Entin Republikan. Të hapet procedura për vendosjen e masave të përkohshme në Rektorat në shërbimin administrativ-profesional. Këshilli Ekzekutiv i RS të propozojë shkakimin e të gjithë sekretarëve komunalë të veprimtarive shoqërore në KA të Kosovës dhe Metohisë, të cilët nuk i pranojnë ligjet dhe programet e Republikës së Serbisë, si dhe organet e inspektoratit arsimor.

Sekretari Republikan për Arsim, Shkencë dhe Kulturë Fizike, prof. dr. Danilo Zh. Markoviç, pas Mbledhjes së Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Serbisë të mbajtur më 8 dhe 11 shtator 1990 ka urdhëruar që të gjitha organet dhe organizatat në fushën e arsimit të njoftohen me masat të cilat janë paraparë për stabilizimin e gjendjes në Kosovë. Për sanimin e gjendjes së krijuar në arsimin e Kosovës dhe për realizimin e detyrave programore, Serbia ndërmori këto veprime sunduese: përfshirjen e planprogrameve serbe në shkollat fillore dhe të mesme; realizimin e kontrollit dhe mbikëqyrjes inspektuese dhe pedagogjike; rekonstrukcionin kadrovik të inspektoratit dhe enteve pedagogjike-arsimore, krahinore dhe komunale; formimin e fondeve krahinore për arsimin fillor, të mesëm dhe arsimin universitar dhe standardit të nxënësve e të studentëve; në kryerjen e funksionit të Sekretariatit Krahinor për Arsim, Shkencë e Kulturë, posaçërisht në veprimtarinë normative dhe zbatimin e ligjit. Për zbatimin e këtyre aktiviteteve dhe të masave u ngarkuan të gjitha institucionet republikane të arsimit të Serbisë. Sekretariati Krahinor për Arsim, Shkencë dhe Kulturë që ishte shndërruar në një seksion të Sekretariatit Republikan për Arsim dhe Kulturë të Serbisë që e drejtonte prof. dr. Stanoje Dogangjiç ndërmori një varg masash për të kontrolluar procesin mësimor. Ai konstatoi se puna edukativo-arsimore në shkollat në gjuhën shqipe në Kosovë”po zhvillohet sipas planeve dhe programeve mësimore jozyrtare” perkatësisht planeve dhe programeve të cilat më 24 gusht 1990 i ka miratuar Pleqësia e Arsimit e Kosovës, kurse Enti Krahinor për Përparimin e Arsimit dhe Edukimit i Kosovës, pa autorizime, ua ka dërguar shkollave. Planet dhe programet mësimore të Kosovës ishin dërguar në shkolla në kundërshtim me dispozitave ligjore të organeve të Serbisë. Planet dhe programet mësimore, të cilat i kishte miratuar Serbia, ishin shpallur në Buletinin Zyrtar të Pleqësisë së Arsimit të RS të Serbisë nr: 4 më 14 gusht 1990. Përveç kësaj, Sekretariati Krahinor për Arsim serb kishte filluar procedura për vërtetimin e përgjegjësisë të të gjithë personave, të cilët kanë keqpërdorur autorizimet zyrtare. Po ashtu Stanoje Doganjiç kërcënohej se do të merren masa për anulimin e dëftesave, të cilat arrihen sipas planeve dhe programeve jo zyrtare. “Sekretarët e veprimtarive shoqërore, drejtorët e enteve pedagogjike komunale dhe inspektorët komunalë obligohen që të marrin të gjitha masat për ta zbatuar këtë urdhëresë, kurse për moszbatimin e saj do të përcaktohet përgjegjësia e tyre zyrtare. Serbia mori një varg masash politike, administrative, legjislativë, gjyqësore etj, për t’i shpërbërë strukturat e organeve arsimore në Kosovë. Megjithatë, Serbia nuk pati

sukses t'i zbatojë planprogramet e miratuara nga Pleqësia e Arsimit e Serbisë në territorin e KSA të Kosovës.

## Masa drastike për rrënimin e Universitetit të Prishtinës

Më 25 janar 1990, Kuvendi i RS të Serbisë e miratoi edhe Ligjin mbi Universitetin. Me këtë Ligj Serbia "legalizoi" sundimin e vet dhe mori të gjitha të drejtat autonome universitare edhe në arsimin e lartë në KSA të Kosovës. E drejta që krahinat të japin mendimin paraprak për çështjet dhe marrëdhëniet në harmonizimin e politikave zhvillimore të arsimit të lartë dhe përcaktimin e rrjetit të universiteteve dhe të fakulteteve në Republikë etj. ishte një mashtrim tinëzar i Serbisë sa për të kryer anën formale të diskutimit publik, ngase me rastin e miratimit të ligjeve për veprimtari shoqërore edhe për ligjin e arsimit të lartë, Kuvendi i Serbisë i refuzoi të gjitha amendamentet e propozuara të Kuvendit të KSA të Kosovës. Me këtë praktikisht u krijua baza "juridike" serbe e rrënimin të Universitetit të Prishtinës. Rektorin e Universitetit dhe prorektorët, në këtë kohë të goditjes së rëndë për Universitetin dhe një numër i konsiderueshëm i arsimtarëve i kishte rënduar heshtja, indiferentizmi, oportunitizmi, të cilët nuk iu kundërvunë politikës antishqiptare, vlerësimeve partiake, procesit sadist të diferencimit ideo-politik, i cili në vazhdimësi dëbonte inteligjencën elitare nga Universiteti i Prishtinës. Kuvendi i Serbisë vendosi masa të dhunshme në Universitetin e Prishtinës më 27 qershor 1991. Serbia së pari, më 7 gusht 1990, me masa të dhunshme kishte goditur Fakultetin e Mjekësisë dhe institucionet përkatëse të tij. Masat e dhunshme u ndoqën me një varg vendimesh të turpshme: ndërrime të udhëheqjes, përjashtime të stafit akademik, të punëtorëve administrativë, duke përfshirë Sekretarin e Përgjithshëm të Universitetit të Prishtinës dhe në të gjitha njësitë akademike; heqje mbishkrimesh në gjuhën shqipe, vendosje të administratës serbe me alfabetin cirilik etj. Kështu, Universiteti i Prishtinës u serbizua edhe pse "nëpër fakultete dhe shkolla të larta vazhdonin "të punonin" rreth 200 arsimtarë dhe bashkëpunëtorë shqiptarë. Nga Universiteti i Prishtinës u përjashtuan 862 arsimtarë dhe punëtorë e tjerë. Prej tyre 770 arsimtarë. Këtu praktikisht bie perdjja e mbylljes së Universitetit të Prishtinës për shqiptarët, por këtu formësohet mendimi për përgatitjet e punës së pavarur akademike në Universitetin e Prishtinës me mësim në gjuhën shqipe. Shoqata e Arsimtarëve Universitarë dhe Punëtorëve Shkencorë më 26 shkurt 1990 organizoi për

herë të parë një tubim masiv protestues ku u shtruan 24 kërkesa, duke kërkuar së pari heqjen e gjendjes së jashtëzakonshme. Tubimin e kryesuan: prof.dr. Ejup Statovci, prof.dr. Eshref Ademi dhe prof.dr. Idriz Ajeti. Shoqata organizoi edhe dy takime të rëndësishme për gjendjen e rëndë në Universitetin e Prishtinës. Në korrik të vitit 1991 një delegacion të Universitetit të Prishtinës e pranoi Kryetari i Kryesisë të Jugosllavisë z. Stipe Mesiç.

Lidhja e Arsimitarëve Shqiptarë "Naim Frashëri" inkurajoi frymën e rezistencës masive kundër planeve dhe projekteve diskriminuese serbe ndaj arsimit shqiptar në Kosovë. Ajo mori përgjegjësinë historike për organizimin e procesit mësimor me mësim në gjuhën shqip në territorin e KSA të Kosovës, në rrethana dhe në kushte të një pushtimi të egër serb. Kryesia e Lidhjes së Arsimitarëve Shqiptarë "Naim Frashëri" pati rolin ministror, duke ndërmarrë hapa të rëndësishëm për organizimin dhe funksionimin e sistemit të pavarur të arsimit të Kosovës dhe duke u ballafaquar me masat dhe aktivitetet shtypëse dhe represive të organeve sunduese dhe ndjekëse të Serbisë. Konferenca Evropiane e Organizatës Botërore e Arsimitarëve në takimin e Gjenevës prej 19-22 tetor 1991, miratoi një Rezolutë të favorshme për arsimin në Kosovë. Sistemi i pavarur i arsimit u bë shtyllë e rëndësishme në procesin e pavarësisë së Kosovës. Në luftën e fundit për çlirimin e Kosovës (1998-1999) u vranë 278 arsimtarë

Dëbimi i nxënësve dhe i studentëve shqiptarë nga lokalet dhe hapësirat shkollore dhe universitare dhe ndërprerja e të gjitha aktiviteteve mësimore dhe studimore nga 1 shtatori i vitit 1991, ishin akte të shtypjes dhe të terrorit shtetëror serb, ishte një goditje e rëndë për dijen dhe të ardhmen e rinisë shkollore dhe studentore të Kosovës. Lidhja e Arsimitarëve Shqiptarë "Naim Frashëri" në strukturat e saj kishte njohës të mirë të arsimit dhe këshilltarë pedagogjikë. Mësimi në shtëpitë-shkolla filloi më 20 janar 1992. Për ta penguar organizimin e procesit mësimor në shtëpi dhe në lokale private, më 31 janar 1992, në fshatin Uçë të Istogut ndodhi një krim i rëndë. Policia serbe vrau tre prindër të cilët u përpoqën t'i mbronin fëmijët. Policia tentoi t'i shoqërojë nxënësit në polici, të cilët ishin nisur në mësim. *Organizimi i mësimin në shtëpi-shkollë jo vetëm që ruajti kontinuitetin e arsimit shqip, por u shndërrua në një besim gjithëpërfshirës që ringjalli shpresën e popullit shqiptar për jetë, punë dhe rezistencë aktive kundër arrogancës dhe brutalitetit të një shteti totalitar fashist siç është Serbia. Kjo periudhë e punës dhe e veprimit të shkollës shqipe mbajti të ndezur vizionin e mëvetësisë, me*

*kohë, u shndërrua në një nga zhvillimet më unike dhe më të ndritshme të historisë së arsimit shqiptar në Kosovë.”*

### *Uzurpimi i lokaleve shkollore me refugjatë dhe kolonë serbë*

Ministria e Arsimit e Serbisë kishte ngritur një Shtab për konstatimin e kapaciteteve hapësinore të institucionet arsimore: në çerdhe, në shkollat fillore, në shkollat e mesme dhe në konvikte të nxënësve dhe të studentëve, në të gjitha komunat e Kosovës, për të sjellë dhe për të vendosur refugjatë dhe kolonë serbë në Kosovë. Materiali ishte përgatitur nga bisedat e drejtpërdrejta me përgjegjësit e komunave. Qeveria serbe i kishte uzurpuar dhe kishte vendosur kolonë serbë: *“në lokalet shkollore ishin vendosur 1258; në konvikte të nxënësve të shkollave të mesme dhe të konvikteve të studentëve 1127; në Qendrën e Studentëve të Prishtinës janë vendosur 3000” të refugjatë dhe 536 studentë të ardhur nga Republika e Krajinës Serbe.* Shtabi ka konstatuar se për vendosjen e refugjatëve kolonë, nxënës e tjerë, në ndërtesat e shkollave, mund të sigurohen 489 dhoma mësimi. *“Të gjitha shkollat fillore dhe të mesme në territorin e Kosovës dhe të Metohisë mundën, përveç numrit ekzistues të nxënësve, të pranojnë edhe rreth 10.000 nxënës në shkollat fillore dhe 12.000 nxënës në shkollat e mesme, aty ku mësimi zhvillohet në gjuhën serbe.* Po ashtu në dokumentin e përmendur është shtruar nevoja e personelit mësimor për shkollat fillore dhe të mesme në gjuhën serbe; për shkollat fillore 97 arsimtarë dhe 143 profesorë për shkollat e mesme. Në një dokument shtesë është dhënë një pasqyrë e kapaciteteve të lira për regjistrimin e nxënësve në shkollat e mesme në territorin e Kosovës. Sipas të dhënave në 24 komuna të Kosovës dhe të Metohisë mund të regjistrohen edhe 6950 nxënës të shkollave të mesme me mësim në gjuhën serbokroate.

### *Dokumentacioni shkollor-pedagogjik*

Në fund të vitit shkollor 1991/1992 u përgatit dokumentacioni shkollor. Më këtë rast ata konfiskuan dëftesa, diploma, vula të shkollave, libreza nxënësish dhe dokumente të shumta administrative. Shumica prej atyre që ishin marrë në biseda nga inspektorët serbë mbajtën qëndrim korrektë. Pranuan se me vetëdije kanë nënshkruar dëftesat dhe

diplomat të ciliat mbanin siglën “Republika e Kosovës”si dhe i kanë nënshkruar e vulosur ato. Disa prej drejtorëve të shkollave u maltretuan fizikisht, disa u dënuan me burg, ndërsa Haki Pavataj, drejtori i Shkollës fillore “Bajram Curri”në Strellc të Epërm të Deçanit ndërroi jetë nga torturat e policisë serbe dhe sigurimit shtetëror serb më 21 korrik 1992”.

### *Puna e pavarur në Universitetin e Prishtinës 1991-1998*

Pas masave të njëpasnjëshme të dhunshme, që ndërmori Serbia kundër arsimit fillor dhe të mesëm si dhe ndaj institucioneve të tjera të arsimit, në segmente të ndryshme të tij, ajo synonte të ”zbarkojë” arsenalin e saj për ta shkatërruar arsimin e lartë përkatësisht Universitetin e Prishtinës. Së pari, goditi Fakultetin e Mjekësisë.

Shoqata e Arsimitarëve Universitarë dhe e Punëtorëve Shkencorë, kryetar i së cilës ishte prof. dr. Eshref Ademaj, profesor me integritet dhe guxim së bashku me prof. dr. Ejup Statovcin duke u bashkuar edhe Destan Halimi sekretar i përgjithshëm, bënë të gjitha përgatitjet e nevojshme për organizimin e studimeve në Universitetin e Prishtinës, me mësim në gjuhën shqipe, në rrethana dhe në kushte të jashtëzakonshme. Më 26 nëntor 1991 u mbajt Mbledhja e Kuvendit të Universitetit të Prishtinës, i cili vendosi që të organizohet mësimi në gjuhën shqipe jashtë lokaleve publike, të cilat ishin të uzurpuara nga administrata dhe policia serbe. Universiteti i Prishtinës bashkëpunonte me Universitetin e Tiranës. Në vitin shkollor 1991/92, në vitin e krizës, studimet i vijonin 19 622 studentë:15 826 të rregullt dhe 3 796 me korrespondencë. Në këtë vit u diplomuan 1122 studentë. Universiteti bëri ndryshime të rëndësishme në strukturën e planeve dhe në përmbajtjen e programeve mësimore dhe zëvendësime me disa lëndë të reja.

Pati bashkëpunime edhe me disa universitete të huaja. Unioni i studentëve dha kontribut të çmueshëm duke u përfshirë në veprimtarinë e gjithanshme studentore. Unioni i Pavarur i Studentëve me protestat e vitit 1987 edhe më tutje e ndërkombëtarizoi çështjen e Kosovës dhe luftën e Ushtrisë Çlirimtare (1998/1999). Në këtë luftë u vranë 322 studentë dhe 10 arsimtarë. Veprimtaria mësimore shkencore dhe artistike e Universitetit të Prishtinës vazhdon deri më 21 mars 1999. “Nga viti shkollor 1991/92 deri në vitin 1998/99, në kushte të vështira diplomuan 8.758 studentë.

## *Diferencimi ideopolitik proces sadist politik për spastrimin e inteligjencës shqiptare (Gazmend Zajmi)*

*Diferencimi ideopolitik u zhvillua në të gjitha institucionet e arsimit. "Pa kurrfarë kompromisi duhet të mënjanojen nga procesi mësimor të gjithë ata që janë të papërshtatshëm. Nga detyra u larguan të gjithë ata që kishin kontribuar për zhvillimet pozitive në Kosovë, në veçanti, për themelimin dhe ngritjen e institucioneve të rëndësishme të arsimit, të shkencës dhe të kulturës, në vitet shtatëdhjetë në KSA të Kosovës. Vala e diferencimeve politike përfshiu të gjithë autoritetet në institucionet e arsimit, të shkencës dhe të kulturës, si dhe komunat e Kosovës. Prosesi i diferencimit ideo-politik ishte një formë e moderuar e sundimit serb për të shkaktuar përçarje dhe përplasje midis shqiptarëve duke i kundërvënë njërin kundër tjetrit, individin kundër grupit dhe anasjelltas. Në këtë proces politik janë goditur politikanë, akademikë, historianë, profesorë, arsimtarë, mësues, studentë, nxënës, etj. Diferencimi ideo-politik në institucionet arsimore u përdor për "verifikimin e cilësive të dyshimta" moralopolitike të kuadrit mësimor, për largimin e tyre nga procesi mësimor në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë, si dhe në parandalimin e punësimit të atyre që punën edukativo-arsimore mund ta shfrytëzojnë" për indoktrinimin e nxënësve e studentëve me ideologji nga pozitat e nacionalizmit dhe separatizmit shqiptar ose që kanë pasur sjellje oportune dhe u janë kundërvënë aksioneve të forcave progresive për stabilizimin e gjendjes politike e të sigurisë në Krahinë" Lidhja e komunistëve kishte sajuar platforma dhe dokumente për të thelluar procesin sadist antishqiptar të diferencimit në të gjitha nivelet e arsimit, në shkollat, në institucionet e arsimit, por në veçanti në Universitetin e Prishtinës.*

### *Diferencimi ideopolitik në Universitetin e Prishtinës*

Nga viti 1981 deri në vitin 1989 nga procesi mësimor i Universitetit të Prishtinës u larguan 18 mësimdhënës e bashkëpunëtorë universitarë. Viti 1982 shënon fushatën e ndjekjes së kuadrove të shquara dhe të inteligjencës shqiptare. Kryesia e Komitetit Komunal e LK të Prishtinës dhe Kryesia e Konferencës Aksionale të Universiteti

të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 17.2.1982 shqyrtoi dhe miratoi vlerësimet e Grupit të Përbashkët të punës për gjendjen politike dhe propozimin e masave të mëtejshme për kapërcimin e gjendjes në Universitetin e Kosovës. U shqiptuan këto masa: nga LK u përjashtuan 3 profesorë, me vërejtje të fundit 5, me vërejtje 5, u larguan nga vendet udhëheqëse 3, nga procesi mësimor u larguan 6.: prof. Ukshin Hoti, prof. Muhamet Tërnavë, prof. Shaqir Shaqiri, Shemsi Reçica, Ruzhdi Sefa asistentë dhe Halil Alidemaj, referent. Nga procesi mësimor propozohet të largohet dr. Ali Hadri, ndërsa rekomandohet shqyrtimi i papërshtatshmërisë së dr. Mark Krasniqit etj. Në procesin e diferencimit ideopolitik që nga demonstratat “armiqësore” janë marrë masa edhe kundër studentëve anëtarë të LK-së. Kryesia e Komitetit Komunal e LK të Prishtinës në mbledhjen e mbajtur më 22.8.1984 “*duke u mbështetur në analizat dhe konstatimet e dy kryesive të KK të LK dhe të Konferencës Universitare mori vendim që prof. Gazmend Zajmit dhe prof. Fehmi Aganit t’u shqiptohen masa ideopolitike: përjashtim nga LKJ.*”

Komiteti për MPP dhe VMSH i komunës së Prishtinës mbledhjen e mbajtur më 24. VI. 1985 shqyrtoi dhe miratoi “Kriteret për verifikimin e përshtatshmërisë moralopolitike të studentëve për regjistrim në studime, vendosje në konvikte të studentëve, si dhe mënyrën e përcjelljes së punës dhe të sjelljes së nxënësve dhe të studentëve nga ana e shkollave, fakulteteve, komiteteve komunale të LK dhe të subjekteve të tjera, të nënshkruar nga Kolë Shiroka. Me kriteret e përcaktuara në këtë dokument që mban peshën e turpit politik dhe njerëzor prej vitit shkollor 1981/82 deri 1989/90, nuk arritën të regjistrohen 2076 studentë kandidatë, që komunat e ndryshme të Kosovës ua ndaluan të regjistrohen në fakultete dhe në shkollat e larta të Universitetit. Komiteti i MPP dhe i VMSH i Universitetit dhe Rektori kanë zbatuar me përpikëri këto kritere që shkëlqin rëndë konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Kryesia e Komitetit Komunal të Prishtinës më 19.6.1989 përjashtoi nga LKJ 42 profesorë dhe punëtorë shkencorë të Universitetit të Prishtinës. Në institucionet e shkencës dhe të kulturës nga LKJ u përjashtua 12 punëtorë shkencorë.

### *Diferencimi i nënshkruesve të Apelit 215*

Apeli i 215 punëtorëve shkencorë dhe kulturorë për mbrojtjen institucionale dhe afirmimin e pozitës kushtetuese të Kosovës në bazat

e parimit të Kushtetutës së RSFJ-së dërguar Kuvendit të Serbisë dhe opinionit publik më 21 shkurt 1989 u bë shkak për të zhvilluar një valë të egër të diferencimeve politike kundër nënshkruesve të Apelit. Kryesia e Komitetit Komunal e Lidhjes së Komunistëve të Prishtinës vlerësoi apelin; “ *Fjala është për një pamflet politik të llojit të vet i paramenduar për nxitjen dhe përhapjen e rezistencës ndaj zbatimit të politikës së LKJ, ndaj ndryshimeve të Kushtetutës së RS të Serbisë, si dhe kundër qëndrimeve dhe konkluzave të organeve më të larta partiake në nivel të Kosovës, Serbisë dhe Jugosllavisë. Në mesin e nënshkruesve të tij janë gjendur edhe ata që pas vitit 1981 janë përjashtuar nga LKJ për shkak të veprimtarisë nga pozitat e nacionalizmit dhe separatizmit shqiptar. U dënuan 50 intelektualë shqiptarë, nënshkrues të Apelit 215.*

### *Bashkëpunimi i KSA të Kosovës me RPS të Shqipërisë*

Bashkëpunimi kulturor, arsimor dhe shkencor midis institucioneve të KSA të Kosovës me ato të RPS të Shqipërisë është zhvilluar në vazhdimësi që nga viti 1968. Ky bashkëpunim ka shënuar rritje të vazhdueshme në fushën e arsimit, kulturës, shkencës dhe të kulturës fizike. Kjo shtroi nevojën e lidhjes së marrëveshjeve dhe të protokolleve të bashkëpunimit të ndërsjellë. Sekretariati Krahinor për Marrëdhënie me Botën e Jashtme në kuadër të përgatitjeve për nënshkrimin e Programit të bashkëpunimit kulturor-arsimor në mes të RSFJ-së dhe RSP të Shqipërisë për vitin 1972/73, më 26 nëntor 1971, përcaktoi propozimet themelore të KSA të Kosovës për bashkëpunim me RP të Shqipërisë. Këshilli Ekzekutiv i KSA të Kosovës, Sekretariati Krahinor për Marrëdhënie me Botën e Jashtme kishin përgatitur dokumentin: “Propozimet e KSA të Kosovës për bashkëpunim kulturor-arsimor me RP të Shqipërisë”. Në dokument bëhet fjalë për frymën dhe rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve me të cilin do të rregulloheshin shumë çështje të marrëdhënieve të ndërsjella ndërshtetërore në fushën e arsimit, shkencës dhe kulturës.



Haqif Mulliqi

## PËRNPJEKJET PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONALIZIMIN E PARLAMENTIT TË KOSOVËS TË VITIT 1992

### Përmbledhje

Qëllimi i këtij punimi ka të bëjë me zgjedhjet dhe funksionimin e Parlamentit të parë shumëpartiak të Republikës së Kosovës, të organizuara më 24 maj të vitit 1992, me ç'rast, populli i Kosovës, për herë të parë e përdori të drejtën e votës për të zgjedhur udhëheqësit legjitim. Në fakt, synimi ynë do të krijojë kontekste mbi idenë e institucionalizimit të parlamentarizmit në Kosovë, të cilit i paraprinë një numër i konsiderueshëm i takimeve të brendshme të liderëve kryesorë të asaj kohë në vend, takime këto që krijuan një unitet që vendin e shpuri deri te zgjedhjet historike të Republikës së Kosovës, të cilat e legjitimuan udhëheqjen vendore. Një pjesë e veçantë në këtë punim do t'u kushtohet edhe mënyrave të organizimit të këtij parlamenti, Komisioneve parlamentare, me theks të dy përpjekjeve serioze të konstituimit të tij (në vitin 1996), nga një grup i deputetëve, që mund të konsiderohet si një përgjigje ndaj qëndrimit të Bashkësisë Ndërkombëtare ndaj Kosovës në Konferencën e Dejtonit, si dhe moment i domosdoshëm që çështja e Kosovës të ecte nëpër disa binarë të tjerë politikë juridikë dhe diplomatikë.

*Fjalët kyçe:* zgjedhjet, Konferenca e Dejtonit, lufta, konstituimi i Parlamentit, etj.

## PROVOKIMET E PUSHTETIT KLERO-NACIONALIST SERB, VRASJET E NJERËZVE, ARRESTIMET DHE TORTURA MASIVE

Analistë të ndryshëm, komentatorë, ekspertë të çështjeve të sigurisë, etj., në fillimet e viteve 90 të shekullit të kaluar, besonin se lufta që do ta shpartallonte Jugosllavinë, përfundimisht, mund të fillonte pikërisht në Kosovë, ngase situata e nderë këtu, dhuna dhe terrori serb, e kishin sjellë vendin para një erupsioni të pandalshëm. Bile ishte një numër i konsiderueshëm i autorëve, sidomos shqiptarë, që, atëbotë, madje, e kishin paraparë mundësinë e një spastrimin etnik, të thuash biblik, të shqiptarëve nga trojet e tyre, në kontekstin e një konflikti të mundshëm ndërmjet Kosovës dhe Serbinë e që, në fakt, nuk do të ishte asgjë tjetër veç përsëritje e historisë tragjike. Në këtë periudhë, në Kosovë kanë ndodhur provokime të hapura nga pushteti kleronacionalist serb, duke përfshirë këtu edhe vrasjet e njerëzve, arrestimet dhe tortura masive, si dhe helmimin e nxënësve që ndodhën gjatë marsit dhe prillit të vitit 1990.

Një nga arsyt kryesore, pse lufta e paralajmëruar nuk filloi në Kosovë, qëndronte në faktin se ajo, në një proces të përshpejtuar, nisi në pjesët e tjera të Jugosllavisë (në Slloveni, në Kroaci e më pas edhe në Bosnjë e Hercegovinë)<sup>1</sup>. Në të vërtetë, deri në vitin 1995, Milosheviçi ishte i preokupuar me luftërat në Kroaci dhe në Bosnjë, ngase Kosovën e konsideronte si një rast më lehtë të menaxhueshëm, ndërsa në dy republikat e përmendura, duhej mbrojtur e ashtuquajtura “çështje serbe” dhe duheshin trafikuar, qartë, kufijtë e rinj të gogolit të quajtur: “Serbi e Madhe”, që ishte pjesë e projekteve serbe që nga “Naçertanja” e Illija Vujiç Garashanini<sup>2</sup> e deri te Memorandumi i

---

<sup>1</sup> Tahiri, Ramush, intervistë në: *Kosova në ruletin ndërkombëtar*, Haxhiu Baton dhe Mulliqi, Haqif, botoi Zëri, Prishtinë, 1993, f. 118.

<sup>2</sup> Është një dokument i politikës së jashtme të Serbisë, i shkruar në vitin 1844, i mbajtur për një kohë të gjatë si sekreti më i rreptë shtetëror që pasqyronte, në masë të madhe, aspiratat dhe ndjenjat e militariste dhe hegjemoniste serbe, pas pavarësisht të Serbisë. Serbia, asokohe ende vetëm një principatë autonome në një marrëdhënie vasale me Perandorinë Osmane, tregoi se pavarësisht kësaj, ajo ka ambicie të fuqishme politike, ekspansioniste. Ilija Garashanin, edhe pse në atë moment në postin e ministrit të Punëve të Brendshme, hartoi një strategji të politikës së jashtme dhe tregoi rrugën që “duhet” të ndjekë Serbia nëse dëshiron të rifitojë “lavdinë e mëparshme”.

Garashanin e kupton se Serbia, e reduktuar atëherë në një zonë disi më të gjerë se ish-sanxhaku i Smederevës (në gjuhën e folur Pashallëku i Beogradit), si e tillë nuk ka të

Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Serbisë të vitit 1986<sup>3</sup> i cili po e sinjalizonte atë që po pritej të ndodhte në ish-shtetin e sllavëve të jugut ku, me të padrejtë, u ndodhën edhe shqiptarët.

Më 2 korrik 1990, tri ditë para shpërndarjes së Kuvendit të Kosovës, 114 nga 123 deputetët shqiptarë të Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës u tubuan në shkallët e ndërtesës së tyre, e cila ishte e mbyllur për ta nga policia serbe, që ta marrin një vendim tejet të rëndësishëm për gjithë procesin e asaj që ndodhi dhe që u zhvillua, më pas, në vend. Ky numër prej 114 burrash dhe grash, ishte i mjaftueshëm për një kuorum, dhe ata, me atë rast, pavarësisht nga rrethanat e krijuara, e miratuan një dokument të rëndësishëm, të cilën e quajtën **Deklaratë Kushtetuese**, e cila shqiptarëve ua jepte statusin e kombit në Jugosllavi, me të drejtë për konstituimin e republikës së tyre.

Më 7 shtator, po këta deputetë u tubuan (ilegalisht) në qytezën jugore të Kosovës, në Kaçanik, ku e shpallën ligjin kushtetues për Republikën e Kosovës, përfshirë këtu edhe dispozitat për një asamble të re dhe kryesi të zgjedhur.

Mund të konstatohet këtu se, pas kësaj, qëllimi kryesor politik i LDK-së, në këtë kohë, si organizata, absolutisht më e fuqishme në vend, ishte, sendërtimi i idesë së pavarësisë së Kosovës. Shi për këtë Lidhja Demokratike e Kosovës, në bashkëpunim me parti të tjera në Këshillin

---

ardhme dhe se duhet të hyjë në një aleancë me kombet e tjera që e rrethojnë. Synimi i politikës së saj të jashtme duhet të jetë aspirata për “tribashkimin” e popullit serb. Garashanin e mbështet vizionin e tij në historinë serbe dhe të “drejtën” e popullit serb për të jetuar në një shtet. Në fakt ky projekt i Garashaninit ishte një paralajmërim i Serbisë për shumë ngjarje që do të ndodhnin më pas, në aspektin e pushtimit të territoreve të huaja dhe politikat shfarosëse që i zbatoi Serbia, për më shumë se një shekull, në veçanti kundër popullit shqiptar.

<sup>3</sup> Memorandumi i Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve, i njohur thjesht si Memorandumi SANU (serbisht: "Меморандум САНУ"), ishte një draftdokument i hartuar nga një komision 16 anëtarësh i Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve (serbisht: "Srpska akademija nauka i umetnosti - SANU") në vitet 1985-1986. Pjesë të draftit rrodhën dhe u publikuan nga e përditshmja serbe: "Veçernje novosti", në shtator të vitit 1986. Memorandumi tërhoqi menjëherë vëmendjen e publikut në ish-Jugosllavi, pasi u bënte jehonë pikëpamjeve kontraverse mbi gjendjen e vendit dhe kërkonte riorganizim thelbësor të shtetit. Preokupimi kryesor i memorandumit ishte që decentralizimi po e çonte Jugosllavinë drejt shpërbërjes dhe që struktura kushtetuese e Jugosllavisë i diskriminonte serbët. Memorandumi pretendonte se zhvillimi i Serbisë u dëmtua nga mbështetja që u jepej pjesëve të tjera të Jugosllavisë. Ai u dënua zyrtarisht në vitin 1986 nga qeveria e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe qeveria e Republikës Socialiste të Serbisë për nxitje të nacionalizmit. Disa e konsiderojnë publikimin e tij si një moment kyç në shpërbërjen e Jugosllavisë dhe një kontribues për luftërat jugosllave.

Koordinues të Partive Politike (KKPP) dhe Kuvendin (në ekzil), në shtator të vitit 1991 e organizoi referendumin për Pavarësinë e Kosovës. Ky referendum përveç që në njëfarë forme i dha legjitimitet qëllimeve të LDK-së, dhe partive të tjera: Partisë Fshatare të Kosovës, Partisë Parlamentare të Kosovës, Partisë Demokristiane, etj., duke e vënë në spikamë vullnetin e pakontestueshëm të popullit shqiptar për bërjen e Kosovës shtet të pavarur dhe sovran.

## ZGJEDHJET E PARA SHUMËPARTIAKE TË VITIT 1992

Nga votuesit e regjistruar, 89% morën pjesë në votim, ku prej tyre 99% ishin në favor për pavarësi. Referendumi u mbajt brenda 26 dhe 30 shtator të vitit 1991, pra, katër ditë pas miratimit të Rezolutës për Pavarësi dhe Sovranitet të Kosovës nga ana e Kuvendit. Kuvendi u mbledh më 19 tetor 1991 me ç'rast e shpalli pavarësinë e Kosovës dhe mandatoi Kushtetutën e Kaçanikut për të pasqyruar votën popullore për pavarësi.

Deri në vitin 1992, në Kosovë ishte krijuar një situatë kontradiktore politike ku në një anë ishte regjimi serb me ide nacionaliste të vendosur për të mohuar, plotësisht, vullnetin politik të shqiptarëve, duke mos u kursyer edhe në përdorimin të forcës ushtarake dhe policore, dhe, në anën tjetër kishim të bënim me një organizim popullor të shqiptarëve të brumosur fuqishëm, me ide të qarta për pavarësi, më çfarë regjimi serb afishohej qartë - si jolegjitim dhe si autoritet kolonial që përdorte represion të dhunshëm në vend.

Siç dihet, vetëm disa muaj më pas, në Kosovë, u mbajtën zgjedhjet e para shumëpartiake për zgjedhjen e Kryetarit të Kosovës dhe zgjedhjen e Kuvendit të Kosovës. Në mbledhjen e mbajtur më 2 maj të vitit 1992, Kuvendi i Kosovës (i vitit 1989) i shpalli zgjedhjet shumëpartiake, në të cilat partitë politike do të angazhoheshin, jo për rivalitete mes tyre, por të gjitha së bashku, për vendosjen e pushtetit të Kosovës, të pluripartizmit demokratik, në vend të pushtetit të Serbisë, të okupimit e imponimit.

Zgjedhjeve u paraprinë shumë takime të përfaqësuesve të partive më kryesore të Kosovës, si pjesë e Këshillit Koordinues të Partive Politike në vend. Kushtetuta e Kaçanikut kishte përcaktuar numrin e deputetëve me 143 vende në parlament.

Raporti i Komisionit Qendror për Zgjedhjet në Kosovë thekson se ato do të mbaheshin sipas sistemit të kombinuar zgjedhor, dhe në vazhdim konstatonte:

*Nga së paku 130 vende për Parlament, 100 janë zgjedhur përmes votimit të drejtpërdrejtë, pra, në bazë të sistemit të shumicës, ndërsa 30 vende janë zgjedhur përmes sistemit proporcional.*

Lidhur me zgjedhjet që do mbahen më 24 maj të vitit 1992, e përditshmja e vetme, atëbotë, prishtinase, *Bujku* në ballinë e gazetës të datës 23 maj, me mbititullin *Programi i dr. Ibrahim Rugovës, kandidat për kryetar të Republikës së Kosovës* si dhe me kryetitullin *Kosova – Shtet i Lirë dhe i Pavarur*<sup>4</sup>

Ndërsa, në raportin e Informatorit (buletin i përditshëm i Qendrës për Informim të Kosovës) të datës 22 maj 1992, shkruan: *Në konferencën e djeshme për shtyp të Lidhjes Demokratike të Kosovës, dr. Ibrahim Rugova, i vetmi kandidat për kryetar të Republikës së Kosovës, në pika të shkurtra, paraqiti para gazetarëve programin e vet si kandidat për kryetar të Republikës së Kosovës*<sup>5</sup>.

I. Rugova: *Si kryetar i Republikës së Kosovës, tha dr. Ibrahim Rugova, do të përpiqem ta zbatoj programin e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe të partive politike shqiptare në Kosovë, do të përpiqem të zbatoj edhe programin e të gjitha partive të tjera politike në Kosovë, si dhe të të gjithë qytetarëve të Kosovës, që Kosova të jetë republikë e pavarur e neutrale dhe që të vendosim institucionet demokratike dhe pushtetin demokratik në Kosovë, punë kjo që do të shkojë në të mirë të shumicës shqiptare, të serbëve, të myslimanëve dhe të turqve dhe që Kosova të jetë shtet i hapur dhe i lirë në këtë rajon dhe në Evropë*<sup>6</sup>.

Këto zgjedhje, tha Rugova, i cilësoi edhe si një hap para në politikën dhe rezistencën tonë paqësore për të realizuar të drejtat tona demokratike.”

## NUMRI MBRESËLËNËS I VOTUESVE

Në ditën e zgjedhjeve, vendvotimet u hapën prej orës 7 deri në 19. Ndërsa, për t’u zgjedhur kandiduan 511 kandidatë nga 22 parti politike, si dhe grupe shoqërore e etnike në vend. Ndërsa, kandidaturë

<sup>4</sup> *Bujku*, Prishtinë, 23 maj 1992.

<sup>5</sup> *Informatori*, Qendra për informim e Kosovës, Prishtinë 22 maj 1992.

<sup>6</sup> Po aty.

e vetme për president ishte ajo e liderit të konfirmuar të shqiptarëve, Ibrahim Rugova. Rugova, në fakt, e përfaqësonte jo vetëm vullnetin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, por, mund të thuhet, edhe të shumicës së partive të tjera politike pjesëmarrëse në zgjedhje, përfshirë këtu edhe Partinë Parlamentare, të cilën nga viti 1996 do ta drejtonte Adem Demaçi.

Sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, regjistrin zgjedhor të Kosovës e përbënin 853.432 votues, prej të cilëve 762.257 kanë dalë në vendvotime, pra 89.32 për qind të votuesve të regjistruar. Nuk kanë dalë në votime 80.791 votues, ndërsa 10.384 fletëvotime ishin të pavlefshme<sup>7</sup>.

Në zgjedhjet e drejtpërdrejta kandidatët e Lidhjes Demokratike të Kosovës fituan 574.755 vota, që do të thotë 76.44 për qind; kandidatët e Partisë Parlamentare të Kosovës morën 36.594 vota, ose 4.86 për qind; kandidatët e Partisë Fshatare të Kosovës 23.682 vota, ose 3.15 për qind; kandidatët e Partisë Shqiptare Demokristiane 23.303 vota ose 3.10 për qind; kandidatët e pavarur (jopartiakë) fituan 24.702 vota ose 3.29 për qind. Subjektet e tjera zgjedhore që morën pjesë në këto votime fituan më pak se 1.87 për qind të votave, andaj ata nuk fituan të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen proporcionale të vendeve në Parlament<sup>8</sup>.

Pasqyra e vendeve në Parlament ishte si vijon: Lidhja Demokratike e Kosovës 96 deputetë, Partia Parlamentare e Kosovës 13 deputetë, Partia Fshatare e Kosovës 7 deputetë, Partia Shqiptare Demokristiane 7 deputetë, Kandidatët e Pavarur 2 deputetë<sup>9</sup>.

Në thirrjen e këtij Parlamenti të Republikës së Kosovës mbetën 14 vende të zbrazëta, të cilat, sipas përqindjes së popullsisë së Kosovës, dhe shpërndarjes proporcionale të vendeve në Parlament, u takonin pjesëtarëve të etnitetit serb dhe malazez.

Zgjedhjet për Kryetarin e Kosovës janë mbajtur edhe jashtë, në vendet ku shqiptarët nga Kosova jetonin dhe vepronin. Në Kosovë për dr. Ibrahim Rugovën për Kryetar të Kosovës votuan 762.257 votues, (fletëvotime të pavlefshme dhe “kundër” ishin 3.812), ndërsa jashtë

---

<sup>7</sup> *Informatori*, Qendra për Informim e Kosovës, 23 maj 1992.

<sup>8</sup> Hajrullahu, Arben, *Paqja afatgjate në Ballkanin Perëndimor përmes integrimit në BE*, Fondacioni-Konrad-Adenauer, Kosovë, Prishtinë, 2007, f. 79.

<sup>9</sup> Mulliqi, Haqif, *Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve në Kosovë, sipas Komisionit Qendror Zgjedhor, “Zëri”*, Prishtinë, f. 6-7.

Kosovës votuan 105.300 votues. Gjithsej 867.557 votuan për Kryetarin e Republikës së Kosovës<sup>10</sup>.

Në disa vendvotime policia serbe ndërhyri për të ndërprerë procesin zgjedhor. Në dy sosh u konfiskuan një pjesë e materialit zgjedhor.

Zgjedhjet u mbikëqyrën nga 8 grupe vëzhguesish nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga shtetet evropiane. Këto zgjedhje i përcollën 82 ekipe, të akredituara, gazetarësh apo të agjencive të lajmeve nga mbarë bota<sup>11</sup>.

### DELEGACIONI I KONGRESIT AMERIKAN I MREKULLUAR NGA MJESHTËRIA E SHQIPTARËVE PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE

Kosova, në fakt, ishte vendi i fundit në Evropë ku janë mbajtur zgjedhjet shumëpartiake, në të cilat populli i saj, katërçipërisht, e dëshmoi përcaktimin e tij për liri dhe demokraci, përfundonte Raporti i Komisionit Qendror për Zgjedhjet Shumëpartiake Presidenciale dhe Parlamentare në Republikën e Kosovës, i prezantuar në Prishtinë më 15 qershor 1992<sup>12</sup>.

Nga ana e tyre, vëzhguesit e huaj në një konferencë shtypi të mbajtur në shtëpinë e Shoqatës së Shkrimtarëve në Prishtinë, deklaruan përshtypjet e tyre rreth zgjedhjeve të 24 majit në Kosovë. Dr. Majkëll van Vajt Prag, sekretar i përgjithshëm i UNPO-s (Organizata e Kombeve të Papërfaqësuar në OKB) vlerësoi se *zgjedhjet ishin organizuar në mënyrë korrekte dhe me rregullsi*. Ai tha se, gjatë këtyre vëzhgimeve nuk ka hasur në ndonjë parregullsi, derisa veçanërisht e ka impresionuar organizimi i vendvotimeve rezervë.

Delegacioni i Fondacionit të Kongresit Amerikan për të Drejtat e Njeriut, i përbërë nga Konrad Hubers, Pol Berens, Çarls Braun, Debora Xehkobs, Rom Pameir, Maks Primorac, Karl Roads dhe Kevin Tin, theksoi se ishte madhështore pjesëmarrja e votuesve dhe dëshira e tyre për të shfaqur vullnetin politik përmes votimit<sup>13</sup>.

<sup>10</sup> Po aty.

<sup>11</sup> E përditshmja *Bujku*, Prishtinë, 25 maj 1992.

<sup>12</sup> <https://gazetadielli.com/kosova-para-30-viteve-24-maj-1992-zgjedhjet-e-para-pluraliste-dr-ibrahim-rugova-president-republike/>

<sup>13</sup> Po aty.

Konrad Hubers, që i printe Delegacionit të Fondacionit të Kongresit Amerikan për të Drejtat e Njeriut, vlerësoi se këto zgjedhje janë një moment historik për Kosovën<sup>14</sup>.

Debora Xehkobs tha se katër anëtarët e delegacionit amerikan, që vizituan Pejën, kanë fituar një përvojë të shkëlqyer nga vëzhgimi i këtyre zgjedhjeve.

*U mrekulluam nga mjeshtëria e shqiptarëve për organizimin e zgjedhjeve<sup>15</sup>, u shpreh ajo.*

Një anëtar tjetër i këtij delegacioni theksoi se ajo që na interesoi dhe mahniti ishte vetorganizimi i njerëzve.

*Çdo gjë u bë në mënyrë vullnetare, duke u nisur nga shërbimet dhe punët që janë bërë këtu, e deri te njerëzit që kanë organizuar zgjedhjet në çdo pjesë të Kosovës, theksoi ai.*

Ndërsa, Konrad Hubers, që i printe Delegacionit të Fondacionit të Kongresit Amerikan për të Drejtat e Njeriut, zgjedhjet në fjalë i konsideroi një moment historik për Kosovën<sup>16</sup>.

Vlerësimet e vëzhguesve dhe gazetarëve nga bota ishin se zgjedhjet ishin të mira, të rregullta dhe fer.

## PËRPIEKJET PËR KONSTITUIM TË PARLAMENTIT

Parlamenti i ri i Kosovës tentoi të konstituohej, për herë të parë, më 23 korrik të vitit 1992 ashtu siç e përcaktonte Kushtetuta e Kosovës, por kjo gjë pengua nga forca të shumta policore të armatosura rëndë që e kishin vënë, atë ditë, Prishtinën në një shtetrrëhim të hekurt rreth Medresesë së Prishtinës ku planifikohej mbledhja e parë e Parlamentit të Republikës së Kosovës. Me këtë rast, pesë deputetë të Kosovës u arrestuan dhe u dënuan me burgim me dy muaj, për, siç u tha, *aktivitet armiqësor kundër territorit të Republikës së Serbisë dhe cenimin e kushtetutës së saj.*

Kësaj dite, ministri serb i Jurisprudencës u kërcënua hapur, me këtë rast, në “adresë” të subjekteve politike shqiptare, duke u shprehur se, çfarëdo tentative për konstituimin e Parlamentit të Republikës së

---

<sup>14</sup> Po aty.

<sup>15</sup> Po aty.

<sup>16</sup> <https://gazetadielli.com/kosova-para-30-viteve-24-maj-1992-zgjedhjet-e-para-pluraliste-dr-ibrahim-rugova-president-republike/>

Kosovës do të sanksionohej, me dënim të rëndë pre 1 e deri më 15 vjet burg për pjesëmarrësit në një tubim të tillë.

Mirëpo, kritikë të ndryshëm e kanë goditur veprimtarinë e këtij parlamenti në kohën e administrimit të dhunshëm të Kosovës nga ana e Beogradit, por në parim dhe deri diku në praktikë analistët dhe studiuesit kanë zbuluar atë që është thelbësore, se ai, vazhdoi ta shprehte, vullnetin politik dhe juridik të qytetarëve të Kosovës në formë të pranueshme juridike për arritjen e formimit të shtetit sovran e të pavarur.

Profesori i shkencave juridike në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare i Universitetit të Kölnit në Gjermani, **Georg Brunner**, i cili është dhe një nga personalitetet më të spikatur të shkencës ndërkombëtare në këtë fushë, në Evropë, në punimin e tij me titull Nga barra e trashëgimisë historike: *Kosova - perspektivat e ardhshme*, periudhën pas viteve 1990 e quajti si *periudhë të sundimit të dyfishtë të Kosovës; nga njëra anë të sundimit të dhunshëm të Serbisë dhe nga ana tjetër të sundimit të institucioneve paralele të promovuara nga shqiptarët*<sup>17</sup>. Brunner e konsideron të justifikuar nga pikëpamja e së drejtës ndërkombëtare një shprehje të tillë të vullnetit të shqiptarëve në Kosovë për vetëvendosje. Ai, madje, në lidhje me këtë shkruan se: *Në pikëpamjen e organizimit shtetëror u zhvillua sistemi i shkollave, i shëndetësisë, i taksave dhe shtypit, që nuk mundën të evitohej nga ana e administratës qendrore serbe*<sup>18</sup>.

Mendojmë se kjo, në fakt, e përbën qasjen thelbësore të shprehjes së aftësisë shtetformuese të qytetarëve të Kosovës. Nga ana tjetër, presidenti i Kosovës, dr. Rugova, si dhe qeveria në ekzil e udhëhequr nga Bujar Bukoshi, tashmë, ishin pranuar si partnerë të rëndësishëm nga bashkësia ndërkombëtare. Ndonëse në protokollin e veprimtarive ndërkombëtare Rugova emërtohej si “lideri i shqiptarëve të Kosovës“, ai pritej në Shtëpinë e Bardhë dhe Departamentin e Shtetit të ShBA-së, në Paris, në Berlin, Londër, Romë, Athinë, Bruksel, Sofje, Ankara e gjetkë nga liderët e shteteve e të qeverive me protokollin e pritjeve për kryetarë shtetesh.

Lidhur me zgjedhjet dhe të asaj që shkaktuan ato, Jens Reuter shkruan se: *Shteti paralel ia doli që deri në fillim të vitit 1996 të zbatojë*

<sup>17</sup> [https://www.academia.edu/36654875/Von\\_der\\_Last\\_des\\_historischen\\_Erbes\\_Kosovo\\_Kosova\\_Zukunftsperspektiven\\_nach\\_der](https://www.academia.edu/36654875/Von_der_Last_des_historischen_Erbes_Kosovo_Kosova_Zukunftsperspektiven_nach_der)

<sup>18</sup> Po aty.

*politikën e rezistencës paqësore*<sup>19</sup>, kohë kur fillon edhe radikalizimi i jetës politike në Kosovë, si pasojë e mosvëmendjes që i kushtoi bashkësia ndërkombëtare në Dejton (Ohajo) Kosovës si dhe masave represive të qeverisë serbe të Milosheviçit që tashmë kishin arritur kulmin.

Pas Dejtonit, për fat të keq, BE-ja oportuniste, e njohu edhe formalisht Republikën Federale të Jugosllavisë (RFJ), duke e përfshirë edhe Kosovën në përbërjen e saj, ndërsa, Gjermania madje mori qëndrim absurd dhe radikal që të riatdhesonte rreth 120.000 shqiptarë të Kosovës që kishin kërkuar strehim dhe siguri në atë vend. Sipas kryetarit të Qeverisë së Kosovës në ekzil, dr. Bujar Bukoshit - *kjo ishte një tronditje. Ne nuk e prisnim këtë, për të shtuar se bëhej fjalë për një gabim fatal*<sup>20</sup>, do të përfundonte kryeministri.

Duke qenë se situata politike në Kosovë kishte degjeneruar shumë dhe se mesazhi i keq i Konferencës së Dejtonit se pushtimet e luftës, vrasjet dhe krimet e papara, madje, mund të legjitimoheshin në një forum të lartë ndërkombëtar (p.sh. Republika Sërpska u krijua dhe u aprovua mbi gjenocidin serb mbi boshnjakët), në Kosovë i vunë në lëvizje grupet e caktuara të armatosura, të cilat nisën të ndërmerren aksione të ndryshme kundër forcave policore dhe ushtarake serbe.

Duke e vërejtur këtë gjë dhe këto shenja se situata mund të radikalizohej dhe të dilte, krejtësisht, jashtë çdo kontrolli, një grup deputetësh të Parlamentit të Republikës së Kosovës, në shtator të vitit 1996 fillon të mendojnë se, realisht, me konstituimin e Parlamentit të Republikës së Kosovës dhe të funksionalizimit të tij, gjërat mund të viheshin në një kontroll të besueshëm politik në Prishtinë.

Ç' është e vërteta, kërkesa për ta konstituuar Parlamentin kishte në mënyrë të vazhdueshme. Këtë, në veçanti e kërkonin partitë më të vogla politike në vend, duke i përfshirë këtu edhe ato që përfaqësoheshin në parlament, por, gjithashtu edhe degë dhe nëndegë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e cila, siç u theksua sa herë kishte numrin më të madh të deputetëve të zgjedhur. Konstituimin parlamentit e kërkuan edhe individë dhe grupe të ndryshme formale dhe joformale. Mirëpo, për një kohë të gjatë, mbi të gjitha ato kërkesa u kalua heshurazi. Ndërsa, në vitin 1994 u “gjet një zgjidhje alternative” për ta

---

<sup>19</sup> Reuter, Jens, *Der Kosovo Konflikt: Ursachen, Verlauf, Perspektiven by (2001-01-01)*, Wieser Verlag, 2001, f. 37.

<sup>20</sup> <https://gazetadielli.com/kosova-para-30-viteve-24-maj-1992-zgjedhjet-e-para-pluraliste-dr-ibrahim-rugova-president-republike/>

funksionalizuar institucionin më të lartë ligjvënës të Kosovës përmes formimit të Komisioneve parlamentare që ishte diçka për të cilën askush nuk e dinte se si do të mund të funksiononte. Është fjala për komisione, të cilat, edhe sipas rregullores së përkohshme të punës së Parlamentit të Republikës së Kosovës, kishin kompetenca vetëm propozuese, por jo edhe ligjvënëse. Ndaj në vend, mendimet lidhur me këtë formë të “funksionimit” të Parlamentit u ndanë në dysh.

Pastaj, erdhi edhe 24 maji i vitit 1996, që do të thotë dita kur, praktikisht, kësaj përbërjeje parlamentare po i skadonte mandati. Mirëpo, presidenti i Republikës, dr. Ibrahim Rugova e krijoi një “zgjidhje solomoneske”, do të thoshim, duke ua vazhduar mandatin deputetëve të kësaj thirrjeje parlamentare edhe për një vit. Nuk do mend se edhe ky vendim i dr. Rugovës zgjoi mjaft reagime, paçka se ishte arritur një marrëveshje nominale ndërmjet subjekteve politike, parlamentare, që, gjatë këtij viti (shtesë) të mandatit të deputetëve të bëhej gjithë çfarë ishte e mundshme për ta konstituuar Parlamentin Republikan.

Ndërkohë u shënuan edhe disa iniciativa për konstituim të parlamentit. Njëra prej tyre doli nga një angazhim i zonjës, Luljeta Pula, atëbotë, kryetare e njërit krah të Partisë Social Demokratike të Kosovës (e cila e kishte një deputet të kontestuar nga LDK-ja, në Parlament), që të mblidhej një numër i domosdoshëm i nënshkrimeve të deputetëve që të thirrej mbledhja konstitutive e organit më të lartë juridik të shtetit të Kosovës, pa të cilin, praktikisht as nuk mund të bëhej fjalë për institucionalizimin e jetës këtu. Si bartës i kësaj nisme u afishua edhe Selatin Novosella, mirëpo, e tëra kjo përfundoi me një listë që ia kishte dalë të mblidhë një numër shumë të vogël dhe të papërfillshëm nënshkrimesh.

Pas kësaj doli dhe një nismë tjetër, shumë më serioze nga akademikët: Hivzi Islami dhe Jusuf Bajraktari të cilëve iu bashkëngjijt edhe autori i këtij punimi, si deputet i Republikës, duke iniciuar një veprimtari për bashkimin e deputeteve të Kosovës në realizimin idesë për konstituim të Parlamentit. Rreth kësaj nisme u tubuan shumë deputet të Parlamentit të Kosovës, madje nga radhët e të gjitha subjekteve politike që participonin në Parlament, dhe, duke u mbështetur në Amendamentin II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nga kryetari i Republikës kërkohet mbajtja e mbledhjes konstitutive të Parlamentit.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, numri më i vogël i deputetëve për ta sendërtuar këtë qëllim duhej të ishte tridhjetë.

Kërkesa që u nënshkrua nga tridhjetë e një deputetë, iu dërgua presidentit Rugova më 11 shtator 1996: pesëmbëdhjetë nga Lidhja Demokratike e Kosovës; gjashtë nga Partia Fshatare e Kosovës; pesë nga Partia Parlamentare e Kosovës; katër nga Partia Shqiptare Demokratiane dhe një nga Partia Socialdemokrate e Kosovës.

## KËRKESA PUBLIKE E DEPUTETËVE PËR KONSTITUIM TË PARLAMENTIT TË REPUBLIKËS

Më poshtë do t'ua sjellim përmbajtjen e plotë të kësaj kërkesë të publikuar në revistën zëri më 19 tetor të vitit 1996 me titull:

Presidentit të Republikës së Kosovës dr. Ibrahim Rugova

I nderuari zoti President

Duke qenë thellësisht të bindur se vlimet shoqërore dhe politike në hapësirën kombëtare dhe ndërkombëtare në përcaktimin e zgjidhjeve politike e kushtetuese të rajoneve e pjesëve të tyre dhe për faktin se Kosova është një ndër pikat në neuralgjike të krizës në Ballkan, e cila qe sa kohë kërkon zgjidhje, e ndiejmë për detyrë që, si institucion kompetent, t'ju drejtohem me këtë kërkesë.

Është fakt i mirënjohur se gjendjen e rëndë okupuese populli i Kosovës me sakrificat të mëdha e përballoi me dinjitet. Po ashtu e përballoi edhe shtypjen e egër të pushtetit policor dhe ushtarak serb, duke manifestuar zëshëm kërkesat për liri, pavarësi dhe demokraci. Këto kërkesa të drejta e legjitime që rrjedhin nga korpusi i të drejtave më elementare njerëzore e kombëtare u manifestuan në mënyrën më qytetëruese e plebishitare me miratimin e Deklaratës së Pavarësisë të 2 Korrikut 1990; me Referendumin e Shtatorit 1991 dhe me zgjedhjet shumëpartiake e presidenciale të majit të vitit 1992.

Pikërisht, me ato zgjedhje populli i Kosovës me mirëbesim dhe bindje të palëkundur, nëpërmjet votës së lirë, zgjodhi përfaqësuesit e vet dhe juve si president i Republikës së Kosovës, me shpresë se me punën, angazhimin dhe aktivitetin politik do të jetësohen dokumentet për pavarësinë e saj.

Të bindur, thellësisht, se neve që na u dha besimi në zgjedhjet e vitit 1992 e kemi për obligim kushtetues, politik dhe kombëtar të bëjmë hapa konkret për jetësimin e vullnetit të popullit dhe për krijimin e

institucioneve që dalin nga ai vullnet në mënyrë që, para popullit tonë dhe institucioneve ndërkombëtare të dalim të ndërgjegjshëm dhe me dinjitet të plotë.

Duke u mbështetur në vendimin tuaj për zgjatjen njëvjeçare të mandatit të legjislacionit të dalë nga zgjedhjet e vitit 1992, detyrave dhe obligimeve që dalin nga kushtetuta e Republikës së Kosovës, si dhe në vlerësimin tuaj se “Kushtetuta – (është) bazë për organizimin shtetëror dhe shoqëror të Kosovës” (Bujku, dt. 9 shtator 1996), ne të poshtëshënuarit, deputetë nga partitë e ndryshme politike, në bazë të Amendamentit II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kërkojmë mbajtjen e mbledhjes Konstitutive të Parlamentit të Republikës së Kosovës. Kjo do të jetë edhe më e domosdoshme në prag të dialogut të mundshëm shqiptaro-serb.

Konsiderojmë se kjo mbledhje duhet të mbahet brenda 15 ditësh me këtë

Rend dite:

1. Konstituimi i Parlamentit të Republikës së Kosovës;
2. Zgjedhja e organeve të Parlamentit të Republikës së Kosovës;
3. Betimi i Presidentit para Parlamentit dhe
4. Të ndryshme

Jemi të bindur se konstituimi i Parlamentit të Republikës së Kosovës dhe organeve legjitime që dalin nga ai do të kontribuojë për eliminimin e shumë kundërthënive, paqartësive dhe hutive të brendshme kombëtare në momentin e pikërishtëm, por edhe do të afirmojë, fuqimisht, brenda dhe jashtë përcaktimin tonë të vendosur për jetësimin e pavarësisë së Republikës së Kosovës si alternativë e vetme për liri dhe barazi të popullit tonë, si dhe do të krijojë parakushte reale për paqe e prosperitet në Ballkan.

Me respekt:

1. Dr. Jusuf Bajraktari – nënkryetar i Partisë Fshatare të Kosovës (PFK)
2. Akademik Besim Bokshi – kryetar i Partisë Social Demokrate të Kosovës (PSDK)
3. Dr. Fehmi Rexhepi – drejtor i Institutit të Historisë (LDK)
4. Dr. Adem Limani – ministër në Qeverinë e Përkohshme të Republikës së Kosovës (PFK)
5. Dr. Hivzi Islami – kryetar i Partisë Fshatare të Kosovës (PFK)
6. Haqif Mulliqi – publicist dhe gazetar i “Zërit”(PPK)
7. Mr. Haki Shatri - ekonomist (LDK)
8. Selatin Ismaili – gjeodet (PFK)
9. Burhan Kavaja – kryetar i Komisionit për Industri dhe Energjetikë në Parlamentin e Kosovës (PPK)
10. Aziz Pacolli – mësimdhënës në Shkollën e Lartë Teknike në Ferizaj (PPK)
11. Shukri Fetahu – ligjërues në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë (PFK)
12. Ali Lajçi – njëri prej udhëheqësve të Lëvizjes Studentore të vitit 1981 (LDK)
13. Zijadin Gashi – kryetar i Këshillit të Arsimit të Prishtinës (LDK)
14. Ruzhdi Shabani – bujk (PFK)
- 15 – Vehbi Beqiri – jurist (PPK)
16. Musli Bajraktari – dekan i Fakultetit të Makinerisë Prishtinë (LDK)
17. Jonuz Salihaj – drejtor i Qendrës Shkollore Teknike në Prishtinë (PPK)
18. Sanie Selimi – ekonomiste (PSHDK)
19. Ahmet Hasi – jurist (LDK)
20. Veli Bytyçi – zëvendëskryeredaktor në “BUJKU”(PSHDK)
21. Agron Dida – profesor universitar (LDK)
22. Fadil Hysaj – dekan i Fakultetit të Arteve Prishtinë (LDK)
23. Ismail Gashi – kryetar i Këshillit të Arsimit Lipjan (LDK)
24. Mazllum Kumnova – drejtor i Entit Pedagogjik të Kosovës (LDK)
25. Ferat Hajzeraj – kryetar i Këshillit të arsimit në Istog (LDK)
26. Fadil Çitaku – inxhinier (LDK)
27. Jakup Krasniqi – kryetar i Këshillit të Arsimit Glllogoc (LDK)
28. Augustin Bisaku – pensionist (PSHDK)
29. Mon Dajaku – mjek (PSHDK)
30. Safet Ademaj – inxhinier (LDK)
31. Sali Bajra – kryetar i Komisionit Parlamentar për Financa (LDK)



Teki Kurti

## QËNDRIMI I MINISTRISË SË MBROJTJES NDAJ GRUPEVE TË PARA TË REKRUTËVE KOSOVARË NË PËRGATITJET USHTARAKE NË SHQIPËRI MË 1991

### Përmbledhje

Shqipëria në vitet 90 të shek. XX ishte në fazën e fundit të rënies së sistemit komunist, por interesimi dhe vëmendja e liderit të partisë-shtet Ramiz Alia ishte përqendruar që krahas ruajtjes së stabilitetit gjatë ndryshimit të sistemit në vend, Kosova të ndihmohej me çdo kusht.

Në situatën e krijuar në Jugosllavinë e kohës ishte momenti historik i papërsëritshëm që edhe Kosova të ngrihej në luftë dhe të kërkonte të drejtat e veta, njëlloj si kombet e tjera.

Nga shqyrtimi i dokumenteve del se besimi popullor në kauzën e Kosovës ishte i gjallë te brezi i luftëtarëve, të cilët e shtrinë aktivitetin e tyre kudo në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni. Në dokumentet arkivore në Shqipëri nuk gjenden vendime apo urdhëresa të drejtpërdrejta të institucioneve ushtarake që flasin për mbështetjen ushtarake të Shqipërisë ndaj Kosovës, por nga dëshmitë e drejtpërdrejta të ushtarakëve të intervistuar apo të kontaktuar del se Shqipëria ka kontribuar me gjithçka të mundshme për të stërvitur ushtarakisht grupet e para të rekrutëve kosovarë me qëllim që të fillonin luftën çlirimtare në Kosovë.

Sipas dëshmimeve grupet e para të luftëtarëve të UÇK-së, në Shqipëri kanë ardhur në tremujorin e fundit të vitit 1991. Në mesin e këtyre rekrutëve ishin edhe personalitete të shquara bartës të luftës në Kosovë si: Adem Jashari, Sali Çeku, Zahir Pajazitit etj.

Ushtarakët shqiptarë i përgatitën me njohuri mbi armët e këmbësorisë, si dhe zhvilluan përgatitje taktike. Shqipëria u bë baza kryesore e UÇK-së dhe e luftës së Kosovës.

Kështu Shqipëria në shtator 1990 e ngriti çështjen e Kosovës për vetëvendosje në OKB. Në korrik 1991 ajo iu drejtua zyrtarëve të lartë të KSBE-së dhe kryetarëve të shteteve anëtare të përhershme të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Në tetor 1991 Shqipëria njeh zyrtarisht Republikën e Kosovës si shtet sovran e të pavarur.

*Fjalë çelës:* Shqipëria, Kosova, rekrutët, Ministria e Mbrojtjes, oficerët shqiptarë, Adem Jashari, Sali Çeku, Zahir Pajazitit.

Me gjithë ndryshimet që po ndodhnin në Shqipëri në vitet e para të rënies së sistemit komunist, vëmendja ndaj Kosovës ishte një nga prioritetet e partisë-shtet. Kështu vëmendja e liderit të kohës Ramiz Alia ishte përqendruar që krahas ruajtjes së stabilitet në vend, për shkak të ndryshimit të sistemit politik, në cilësinë e Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dha porosi që djemtë e Kosovës të ndihmoheshin në çdo drejtim.<sup>1</sup>

Situata e krijuar në Jugosllavi, pas miratimit të ligjit për pezullimin e punës së Kryesisë së Krahinës Autonome të Kosovës dhe shkarkimit të Riza Sapunxhiut si anëtar i Presidencës së Jugosllavisë nga Kosova, ishte shkallëzim i skajshëm i politikës së njohur serbe, për t'i mohuar popullit të Kosovës të drejtat kombëtare dhe Krahinës pozitive e saj si element konstitutiv i Republikës Federative të Jugosllavisë, të sanksionuar në Kushtetutën federative. Ky ishte momenti historik i papërsëritshëm.<sup>2</sup>

Shqipëria qysh në shtator të vitit 1990, e ngriti çështjen e vetëvendosjes së Kosovës në OKB.

---

<sup>1</sup> Arkivi i MEPJ (Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme), Fondi Komiteti, Viti 1991, Dosje 1601, fl.8-11 (Informacion i datës 19 shkurt 1991, mbi takimin e Kryetarit e Lidhjes Demokratike Shqiptare në Kroaci Tom Berisha me Presidentin e Republikës së Shqipërisë Ramiz Alia)

<sup>2</sup> Po aty fl. 16 (Deklaratë e zëdhënësit të MPJ)

Në korrik 1991 Shqipëria iu drejtua zyrtarëve të lartë të KSBE-së në Pragë, lidhur me privacionet, burgosjet, persekutimet dhe mohimin e të drejtave të njeriut në Kosovë.<sup>3</sup>

Po në korrik të vitit 1991 presidenti i vendit Ramiz Alia, me një letër u drejtohet kryetarëve të shteteve anëtare të përhershëm të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, kryetarit të Këshillit të Ministrave të KSBE-së dhe kryetarit të Komitetit Evropian, ku thekson se “Shqiptarëve në Jugosllavi, u janë hequr të gjitha të drejtat kombëtare dhe Kosova ku jeton pjesa e madhe e shqiptarëve etnikë, nga një subjekt konstitutiv i Federatës Jugosllave, është kthyer në një provincë e pushtuar nga Serbia. Janë të gjitha të dhënat se duke shfrytëzuar krizën aktuale jugosllave, Serbia po përgatit një gjakderdhje të re kundër shqiptarëve”.<sup>4</sup>

Në tetor 1991 Shqipëria përshëndet Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në të cilën Kosova shpallet shtet sovran dhe i pavarur, me të drejtë të pjesëmarrjes konstitutive në lidhjen e shteteve e të republikave sovraane në Jugosllavi. Qeveria e Shqipërisë njohu Republikën e Kosovës si shtet të pavarur.<sup>5</sup>

Kosova po përgatitej të ngrihej në luftë dhe të kërkonte të drejtat e saj, njëlloj si kombet e tjera. Ishin krijuar grupet e para të luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Institucionet ushtarake në Shqipëri i dhanë mbështetjen e duhur Kosovës, me gjithçka të mundshme, veçanërisht në stërvitjen ushtarake të grupeve të para të rekrutëve kosovarë me qëllim që të fillonin luftën çlirimtare në Kosovë.

Grupet e para të luftëtarëve të UÇK-së, kanë ardhur në Shqipëri në tetor të vitit 1991.<sup>6</sup>

Ushtarakët shqiptarë i përgatitën me njohuri mbi armët e këmbësorisë, si dhe zhvilluan përgatitje taktike. Edhe pse ky moment nuk del i dokumentuar, Shqipëria në fakt u bë baza kryesore e UÇK-së dhe e luftës së Kosovës.

Rekrutët u shpërndanë në shumë kazerma ushtarake shqiptare për t’u stërvitur në organizimin e aksioneve guerile kundër forcave policore serbe

<sup>3</sup> Arkivi i MEPJ, Viti 1991, Dosja 1602, Fleta 29, 30.

<sup>4</sup> “Zëri i Popullit”, Organi i Partisë Socialiste të Shqipërisë, e martë 9 korrik 1991, Nr. (13,410).

<sup>5</sup> Arkivi i MEPJ, Viti 1991, Dosje1601,fl.23,24. (Deklaratë e Qeverisë së RSH për njohjen e Republikës së Kosovës shtet sovran e i pavarur)

<sup>6</sup> Frashër Demaj, Stërvitjet ushtarake në Shqipëri dhe hyrja e rekrutëve të armatosur në Kosovë nën drejtimin e Sali Çekaj, Kumtesë, Pejë, 2.12.2021.

duke u bërë pararendësit e forcave të armatosura që do të krijoheshin në Kosovë.

Institucionet e larta shqiptare dhe kosovare u angazhuan tërësisht për mbarëvajtjen e këtij procesi.

Rekrutët shqiptarë të cilët filluan ushtrimet ushtarake, ishin grupi i parë i ushtarëve të Republikës së Kosovës dhe pararendëse të Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Koordinator i grupeve të stërvitjes ishte Sali Çeku i cili mbante lidhje me institucionet e Kosovës dhe ato të Republikës së Shqipërisë. Qeveria e Republikës së Shqipërisë ofroi gjithë kapacitetet fizike dhe kadrovike që grupet e rekrutëve brenda një kohe të shkurtër të stërviteshin sa më mirë që ishte e mundur për të qenë të gatshëm për sfidat që i prisnin në Kosovë. Nga këto grupe dolën kuadrot e parë që përbënin grupet bërthamë të luftës guerile në Kosovës dhe ishin aktorët kryesorë të Grupit të Dukagjinit që koordinoheshin nga Sali Çeku, Grupit të Drenicës nga Adem Jashari, Grupit të Llapit që kryesohej nga Zahir Pajaziti dhe Grupit të Ferizajt drejtuar nga Ahmet Hoxha. Këto grupe bartën përgjegjësinë e organizimit të aksioneve guerile kundër forcave policore serbe nëpër punkte dhe patrulla në gjithë territorin e Kosovës.<sup>7</sup>

Rekrutët shqiptarë të arritur në Tiranë nga të gjitha viset shqiptare dhe nga diaspora u akomoduan në Tiranë. Ata do të fillonin stërvitjet në kazernat e ushtrisë shqiptare. Vendimi i Ministrisë së Mbrojtjes së cilës i ka parapri një marrëveshje xhentëlmene në mes presidentëve të Kosovës, Ibrahim Rugova dhe të Shqipërisë Ramiz Alia, ishte që këta rekrutë të stërviteshin në Kampin e Surrelit larg syve të opinionit publik dhe ambasadave të huaja.

Sipas planit dhe programit të detajuar nga Shkolla Ushtarake e Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, në Surrel rekrutët do të përgatiteshin që nga ushtrimet fizike, xhenio, kimi, mbrojtje kundërajrore, artileri dhe gjuajtje me armë të kalibrave të ndryshme.<sup>8</sup>

Vendimin për lejimin e stërvitjeve ushtarake dhe vendin se ku do të mbahen ato, e lëshoi ministri i Mbrojtjes, Perikli Teta kurse përgjegjës i kampit u caktua zv. ministri Halil Hyseni. Grupi i parë i rekrutëve zbarkoi në Shqipëri në fillim të tetorit dhe u prezantua përmes Zymer Berishës një

---

<sup>7</sup> Frashër Demaj, “Angazhimi politik e ushtarak i Sali Çekut”, Kumtesë në përvjetorin e rënies së Sali Çekut në Betejën e Koshares, Prishtinë, 19.04.2016.

<sup>8</sup> Kastriot Hoxha, (deklaratë dhënë e dhënë studiuesit Frashër Demaj, më 6 Mars 2019 në Tiranë. Kastrioti ishte një nga oficerët shqiptar që stërviti rekrutët në Kampin e Surrelit), AIHP, Fondi “Sali Çekaj”, Video nr. 1.

aktivist i shquar dhe përfaqësues i zyrës së Kosovës në Tiranë. Berisha i njoftonte përgjegjësit se udhëheqës i grupit ishte Sali Çekaj.<sup>9</sup> Për të qenë më efikas në ushtrime ushtarake, rekrutët u ndanë në dy grupe stërvitore.

Një grup e drejtonte Kastriot Hoxha kurse grupin tjetër oficeri Hysen Imeri. Disa pedagogë si Ylli Mici, Armand Marku, Ramazan Selia, Lakja, Tan Gjika, Eduardi të tjerë të katedrës së shkollës ushtarake u morën me pjesën e ushtrimeve që nga përgatitja fizike e deri te nivelet më të larta të stërvitjes me armë dhe artileri. Përgjegjës për drejtimin e gjithë stërvitjes ishte caktuar oficeri me eksperiencë dhe njohësi i mirë i fushës ushtarake Qani Abazi.

Në fund të tetorit përfundoi stërvitja e grupit të parë dhe filloi stërvitja e grupit të dytë. Në stërvitjen e grupit të dytë Salihu nuk stërviste vetë, por e përcillte rrjedhën e aktiviteteve të këtij grupi.

Ushtrimeve ushtarake të rekrutëve shqiptarë brenda fazës 60 ditore të stërvitjes i kishte rënë në gjurmë ambasada e Jugosllavisë dhe ajo e Ruisisë. Ambasada ruse madje kishte dërguar notë proteste qeverisë shqiptare duke e akuzuar se po bënte diversion ndaj shtetit fqinj duke përgatitur agresion përmes eksponentëve të caktuar me kombësi shqiptare dhe shtetësi jugosllave siç ishin shqiptarët nga Kosova, Lugina e Preshevës dhe nga Maqedonia.<sup>10</sup> Edhe Jugosllavia kishte ngritur denoncime pranë OKB-së, duke e akuzuar Shqipërinë se po përgatiste “grupe terroriste” kundër ushtrisë dhe policisë së saj.

Pas 30 ditë ushtrimesh ushtarake shumica prej rekrutëve u kthyen në vendet prej nga kishin ardhur, kurse rreth 33 prej tyre u nisën drejt Kosovës. Ata me vete kishin armë të lehta rreth 75 pushkë automatike, kallashnikovë, municion dhe bomba dore. Qëllimi i futjes së ushtarëve dhe armatimit ishte krijimi i bërthamave të para të rezistencës ushtarake në Kosovë kundër regjimit të Beogradit.

Salih Çekajt iu besua roli që t’i printe grupit të parë i cili pas stërvitjeve do të hynte në Kosovë i armatosur duke respektuar hierarkinë dhe rregullat ushtarake.<sup>11</sup>

Arsyet pse Salihu do t’i printe këtij grupi ishin të ndryshme, por thelbësore ishte gatishmëria dhe njohuritë ushtarake që kishte, meqë kishte qenë edhe oficer rezervë i Armatës Jugosllave. Arsye po ashtu kuptimplote për rolin e prijësit ishte fakti se Salihu e njihnte mirë terrenin malor dhe

<sup>9</sup> Po aty, video nr. 1.

<sup>10</sup> Po aty, video nr. 2.

<sup>11</sup> Më gjerësisht: Frashër Demaj, Sali Çekaj, veprimtaria politike dhe ushtarake, monografi në dorëshkrim.

bjeshkor në marshutën që do të ndiqte grupi i armatosur për të kaluar kufirin nga Shqipëria në Kosovë.

Salih Çekaj dhe Zymer Luli kishin udhëtuar nga Shqipëria në drejtim të Kosovës për të bërë strehë për ushtarët dhe municionin që duhej të kalonte përmes njerëzve të caktuar dhe familjeve atdhetare, për arsye sigurie me qëllim që rekrutët dhe armatimi të akomodoheshin në vende të sigurta. Nga Zvicra me aeroplan në drejtim të Kosovës kishte udhëtuar edhe Saim Tahiraj që së bashku me Xhemail Berishën e kishin për detyrë të pritnim grupin prej 33 vetave, që do të vinin të armatosur nga Shqipëria.<sup>12</sup> Saimi, Xhemaili dhe aktivistë të tjerë kishin për detyrë të vëzhgonin edhe lëvizjen e forcave serbe, qofshin ato të policisë apo të ushtrisë. Ata në kontakt me Salihun e kishin sinjalizuar këtë të fundit që të mos niset sepse kishte lëvizje shumë të mëdha të ushtrisë dhe policisë, sidomos rreth kufirit në zonat e Rekës së Keqe e deri të Juniku dhe Pobergjë.<sup>13</sup> Për arsye sigurie Salihu e ndryshoi marshutën duke kaluar përmes një shtegu më të gjatë, por më të sigurt dhe në vend se të arrinin për 3 orë sa ishte paraparë, udhëtimi zgjati 9 orë nëpër bjeshkë e male të thepisura për të arritur më 2 dhjetor 1991, rreth orës 5 të mëngjesit. Pas hyrjes në Kosovë grupi i drejtuar nga Sali Çekaj u vendos në fshatin Voksh në shtëpinë e Salih dhe Avdyl Panxhajt. Të lodhur nga rrugëtimi e lanë armatimin dhe u ndanë në tri grupe. Një grup arriti në Beleg, bashkë me Sami Tahirajn që ishte pjesë e grupit, kurse të tjerët u vendosën në Kodrali në shtëpinë e Osman Ferizit, Hasan Ferizit dhe Shkëlzen Gjonit. Në mesin e 33 ushtarëve, që e kaluan kufirin nën komandën e Salih Çekajt, ndodhej edhe Adem Jashari, Ilaz Kodra dhe emra të tjerë të njohur të luftës.<sup>14</sup>

Grupi prej 33 rekrutëve që hynë në Kosovë nën udhëheqjen dhe komandën e Salih Çekaj në dhjetor të vitit 1991 pas përfundimit njëmuor të ushtrimeve intensive ushtarake në Kampin Ushtarak të Surrelit kishin sjellë me vete armë dhe municione aq sa kishin mundur të bartnin fizikisht. Rekrutët që u futën në Kosovë janë:

<sup>12</sup> Arkivi personal i Saim Tahiraj (materiale të autorit dorëzuar në vitin 2018), IHP, Fondi “Sali Çekaj”

<sup>13</sup> Po aty.

<sup>14</sup> Frashër Demaj, “Stërvitjet ushtarake në Shqipëri dhe hyrja e rekrutëve të armatosur në Kosovë nën drejtimin e Sali Çekaj”, Kumtesë, Pejë, 2.12.2021.

<b>Emri dhe mbiemri</b>	<b>Komuna</b>	<b>Nr. i armës</b>	<b>Krehër dhe Fishekë<sup>15</sup></b>	
1. Hasan Ferizi	Deçan	1 20102614		120
2. Shkëlzen Gjoni	Deçan	20097018		120
3. Sami Tahiraj	Deçan	17029554	44	120/5
4. Osman Ferizi	Deçan	4176733		120/20
5. Muharrem Boba	Prizren	7350		120/150
6. Hilmi Peci	Mitrovicë	12133987		120
7. Ramadan Begu	Mitrovicë	11113957		120
8. Nazmi Bajrami	Mitrovicë	4176505		120/6
9. Ejup Murseli	Mitrovicë	20115049		120/24
10. Mumin Bejtullahu	Mitrovicë	20112290		120/180
11. Lutfi Jonuzi	Mitrovicë	20060919		120
12. Fadil Kodra	Skenderaj	11112153		120
13. Iljaz Kodra	Skenderaj	111174110		120
14. Adem Jashari	Skenderaj	20109662		120/7
15. Murat Jashari	Skenderaj	20084113		130/28
16. Avni Rama	Skenderaj	20061583		120/38
17. Sahit Jashari	Skenderaj	20103940		120
18. Shaqir Salih	Skenderaj	11125407		120
19. Xhemajl Kelmendi	F. Kosovë	20096701		120
20. Naim Gubetini	Prishtinë	20098575		220/6
21. Shemsi Zeqiri	Prishtinë	20102917		120/32
22. Xhavit Gubetini	Prishtinë	20113567		120/240
23. Faton Gajtani	Prishtinë	20108076		120/2
24. Isuf Xhemajli	Prishtinë	20065291		120
25. Diton Restelica	Podujevë	11101858		120
26. Ekrem Sheholli	Podujevë	1112249		120
27. Qenan Azizi	Tetovë	20106021		120
28. Feris Xhemaili	Tetovë	20060106		120
29. Nuri Bexheti	Tetovë	20027760		120
30. Bujar Zeneli	Kumanovë	20063866		120
31. Orhani Ibrahim	Kumanovë	20050812	44	120
32. Jakup Limani	Shkup	411651	44	120
33. Halil Palloshi	Shkup	12123606	4	120

Ushtarët pasi pushuan në Beleg dhe Kodrali u shpërndanë secili nëpër shtëpitë veta për t' u rikthyer pas dy javësh në kushte më të favorshme për të marrë armët dhe municionet.

Në ndërkohë nga Vokshi armatimi ishte bartur në Pobergjë për t' u vendosur në shtëpinë e Fadil Tolajt. Kjo lëvizje bëhej me qëllime strategjike që eventualisht të mos zbulohet vendi dhe shtëpia ku ishin lënë armatimet, sepse mund t' i binte në gjurmë policia serbe. Pas disa ditësh armatimi u bart sërish nga Pobergjanë Bërliq në shtëpinë e Salih Çekut.

Në Bërliq, Saim Tahiraj, Xhemail Berisha dhe Sami Tahiraj i morën 34 pushkë automatike kallashnikovë dhe i shpërndajnë së bashku me Grupin e Deçanit, ku bënin pjesë edhe Osman Ferizi, Shkëlzen Gjoni e Hasan Ferizi.<sup>16</sup> Një kontribut të madh në këtë kohë kishin dhënë edhe Ismet e

<sup>15</sup> Arkivi personal i Saim Tahiraj (materiale të autorit dorëzuar në vitin 2018), IHP, Fondi "Sali Çekaj"

<sup>16</sup> Arkivi personal i Osman Ferizi (materiale të autorit dorëzuar në vitin 2018), IHP, Fondi "Sali Çekaj"

Bajram Tahiraj si dhe Avdyl Mulliqi, të cilët ndihmuan në vëzhgimin e situatës dhe krijimin e kushteve për bartjen e armatimit dhe për komunikim në mes aktivistëve të komunës së Deçanit.

Pas qetësimit të situatës, në kushte më të favorshme veprimi, për të marrë armatimet e sjella nga Shqipëria kishin ardhur për Grupin e Drenicës Adem Jashari, kurse për Grupin e Llapit, Xhafer Zena nga Majanci i Podujevës që jetonte në Prishtinë.<sup>17</sup> Salihu, Saimi dhe aktivistë e ushtarë të tjerë i kishin përgatitur Adem Jasharit dhe Xhafer Zenës 13 pushkë automatike kallashnikovë, si dhe një numër të karikatorëve me municion. Ademi dhe Xhaferi kishin udhëtuar me një veturë të tipit Opel Askona. Pasi kishin darkuar bashkë, në momentin e nisjes për në Drenicë e në Llap i fusin 12 kallashnikovë në “gepekun” e veturës, të cilën do ta drejtonte Xhaferi, ndërsa Ademi do të ulej përpara në anën e djathtë me qëllim që të ishte i gatshëm për situatë të papritur.<sup>18</sup> Ademi e mbante një kallashnikov në prehër pa e fshehur fare. Kur e sugjeruan Ademin ta maskonte pak kallashin ai përgjigjet: “me gjithë këto pushkë me veti, për t’gjallë s’ka kush që më nalë”.<sup>19</sup> Kështu Adem Jashari dhe Xhafer Zena pavarësisht rrezikut u nisën për të arritur të sigurt në destinacionin që kishin planifikuar.

Këta rekrutë, ushtarë të Kosovës filluan të parët aksionet guerile kundër forcave policore serbe në territorin e Kosovës. Grupi i Llapit kishte organizuar sulmin e parë mbi punktun e policisë, qysh në vitin 1991. Salih Çekaj me Grupin e Deçanit e sulmoi patrullën e milicisë serbe në aksin rrugor Deçan-Lumbardh. Ndërsa Adem Jashari me Hamzën organizojnë rezistencën në Prekaz në shtëpinë e tyre ku si rezultat i konfrontimit ishin plagosur dy milicë serbë. Në këtë kohë në Drenicë ishin mjaft aktivë edhe vëllezërit Geci nga familja e bajraktarit të Llaushës.

Ky është organizimi i parë masiv ushtarak me personalitete të shquara, disa prej të cilëve u bënë bartësit kryesorë të rezistencës dhe luftës së UÇK-së deri në çlirimin përfundimtar të Kosovës.

Si përfundim Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë krahas ruajtjes së sovranitetit të vendit, të angazhohej maksimalisht për përgatitjen ushtarake të djemve të Kosovës të cilët me sakrificat e tyre titanike dhe mbështetjen e SHBA-së dhe NATO-s lirinë dhe pavarësinë e vendit të tyre, Republika e Kosovës.

---

<sup>17</sup> Frashër Demaj, “Stervitjet ushtarake në Shqipëri dhe hyrja e rekrutëve të armatosur në Kosovë nën drejtimin e Sali Çekaj”, Kumtesë, Pejë, 2.12.2021.

<sup>18</sup> Frashër Demaj, “Stervitjet ushtarake në Shqipëri dhe hyrja e rekrutëve të armatosur në Kosovë nën drejtimin e Sali Çekaj”, Kumtesë, Pejë, 2.12.2021.

<sup>19</sup> Arkivi personal i Saim Tahiraj (materiale të autorit dorëzuar në vitin 2018), IHP, Fondi “Sali Çekaj”



Qerim Lita

## QËNDRIMI I PARTIVE POLITIKE SHQIPTARE NË MAQEDONI NDAJ ZGJEDHJEVE TË VITIT 1992 NË KOSOVË

### Përmbledhje

Në pjesën e parë të vitit 1990, në trevat shqiptare të Republikës Socialiste të Maqedonisë u formuan dy parti politike shqiptare: Partia për Prosperitet Demokratik (PPD) dhe Partia Demokratike Popullore (PDP). Në zgjedhjet e para shumëpartiake, të cilat kjo Republikë jugosllave i mbajti gjatë muajve nëntor-dhjetor 1990, këto dy parti shqiptare arritën të fitojnë 23 ulëse nga gjithsej 120 sa numëronte Parlamenti.

Meqenëse në atë periudhë kohore në Kosovë dhe në trevat e tjera shqiptare nën Jugosllavi, qenë formuar dhe vepronin më shumë parti, me nismën e partisë më të madhe shqiptare, Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe liderit të saj historik, prof. dr. Ibrahim Rugova, në Prishtinë u formua Këshilli Koordinues i Partive Politike Shqiptare të RSFJ-së. Ndër vendimet më të rëndësishme të Këshillit Koordinues, duhet veçuar vendimi për mbajtjen e Referendumit për “*Kosovën si shtet sovran dhe të pavarur, me të drejtë për pjesëmarrje në lidhjen e shteteve (në Jugosllavi*”, i cili u mbajt nga data 26-30 shtator 1991, si dhe vendimin për mbajtjen e “Referendumit për krijimin e Autonomisë Politike-Territoriale të Shqiptarëve në Maqedoni”, i cili u mbajt më 11-12

janar 1992. Natyrisht, këto vendime, vlenin vetëm në rast të ekzistimit të Federatës së atëhershme jugosllave, në të kundërtën, Këshilli Koordinues i Partive Politike Shqiptare, do të angazhohej për bashkimin e të gjitha tokave shqiptare në një shtet të përbashkët. Lidhur me këtë, Ibrahim Rugova, në kongresin e parë të PPD-së, i cili u mbajt më 8-9 shkurt 1992, ndër të tjera u shpreh se “..nuk mund të ketë Maqedoni të pavarur pa u respektuar vullneti i shqiptarëve për autonomi politike e territoriale, as pa pranimin e Kosovës Republikë. Nëse nuk realizohen kërkesat, vazhdon Rugova, atëherë do të kërkojmë të jemi të bashkuar...”.

Përmes këtij punimi studimor, synohet të hedhet dritë, mbi qëndrimin që dy partitë e atëhershme politike shqiptare në Maqedoni, PPD dhe PDP, e patën ndaj zgjedhjeve të para shumëpartiake në Kosovë, të cilat u mbajtën më 24 maj të vitit 1992. I tërë punimi, mbështetet në burimet arkivore, si dhe në shtypin e kohës.

*Fjalët kyçe:* Maqedonia, partitë politike, zgjedhjet në Kosovë, programet e partive politike.

Më nismën e një grupi të intelektualëve shqiptarë, më 15 prill të vitit 1990 më fshatin Xhepsahtit të Tetovës u formua partia e parë shqiptare e trevave lindore, e cila mori emrin “Partia për Prosperitet Demokratik” (më tej PPD). Kryetar të përkohshëm të pranishmit zgjodhën Nevzat Halilin, profesorin e gjuhës angleze<sup>1</sup>. Së shpejti, PPD-ja, e cila asaj kohe me të drejtë u konsiderua si lëvizje kombëtare e këtyre trevave shqiptare, hapi degë dhe nëndegë të veta në të gjitha vendbanimet shqiptare, si në: Shkup, Tetovë, Gostivar, Kumanovë, Dibër, Kërçovë, Strugë, Ohër, Prespë. Manastir, Prilep, Krushevë, Brod dhe Veles, me mbi 100.000 anëtarë.

Dy muaj më vonë, u formua edhe një parti tjetër shqiptare, e cila mori emrin “Partia Demokratike Popullore” (më tej PDP). Kryetar i përkohshëm u zgjodh kardiologu i njohur shqiptar, dr. Jusuf Rexhepi<sup>2</sup>,

---

<sup>1</sup> “Dita”, Revistë dyjavore, Nr. 1, Shkup, 15 mars 1991, fq. 6-7, Intervistë me Nevzat Halilin, kryetar i PPD-së.

<sup>2</sup> Dr Jusuf Rexhepi lindi në Tetovë, më 15 qershor 1922. Në vendlindje ka vijuar mësimet në shkollën fillore dhe gjimnazin në gjuhën serbo-kroate në Mbretërinë e atëhershme Jugosllave. Ka mbaruar maturën më 1942 në Normalen “Sami bej Frashëri” në Prishtinë. Studimet e mjekësisë i filloi gjatë Luftës së Dytë Botërore në Itali (Bari), i vazhdoi në Vjenë dhe diplomoi, pas lufte, në Beograd. Pasi punoi një kohë si mjek i

që më pas atë ta zëvendësojë Iljaz Halimi<sup>3</sup>. Përveç këtyre dy partive politike, gjatë vitit 1990 në RS të Maqedonisë u formua edhe Forumi Demokratik për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (më tej FDMDL NJ) me seli në Gostivar, me të cilin udhëhiqte, Milaim Fejziu<sup>4</sup>.

Më vonë, në skenën politike shqiptare në Maqedoni u paraqitën edhe dy subjekte të tjera politike: Partia e Aksionit Demokratik – Rruga Islame (PAD – RRI)<sup>5</sup>, si dhe Lidhja Demokratike Shqiptare – Partia Liberale (LDSH-PL)<sup>6</sup>.

Gjatë shpalesjes së programit politik të PPD-së, në mënyrë të qartë u vu në dukje se angazhimi primar i atij subjekti, do të ishte kthimi i të drejtave kombëtare, arsimore, kulturore, ekonomike, reduktimi i të cilave kishte filluar menjëherë pas demonstratave shqiptare të vitit 1981 në Kosovë, kur, siç është e njohur botërisht, udhëheqja e atëhershme maqedonase, në emër të “luftës kundër nacionalizmit dhe separatizmit shqiptar”, ndërmori një fushatë antishqiptare, e cila përfshiu të gjitha

---

praktikës së përgjithshme në Tetovë, shkoi në Shkup për të specializuar Mjekësinë Interne dhe si mjek specialist vazhdoi të shërbejë në Tetovë. Në ndërkohë në Beograd i kreu studimet postdiplomike në lëmin e kardiologjisë. Gjatë viteve 1967-1971 që zgjedhur deputet i Kuvendit të RS të Maqedonisë. Për shkaqe politike, në vitin 1972 lëshoi Tetovën për t’u vendosur në Prishtinë. Në vitin 1973 në Fakultetin e porsahapur të Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës emërohet ligjërues për lëndën e Mjekësisë Interne. Atje përgatiti dhe mbrojti tezën e doktoraturës me titull: “Studime epidemiologjike mbi faktorët e rrezikut të sëmundjeve koronare te punëtorët industrialë të Kosovës”. Profesor ordinar në lëndën e Mjekësisë Interne është emëruar në vitin 1985 dhe përveç punimeve shkencore përpiloi dhe botoi tekstin universitar: “Ekzaminimi klinik i sëmundjeve të brendshme”, tekst që u botua në vitin 1984. Përveç detyrës si ligjërues, gjer në pensionimin ka kryer detyrën e Kryeshefit të Kardiologjisë në Klinikën Interne dhe Shefit të katedrës për Mjekësi Interne. Në pjesën e dytë të tetorit dhe fillimi i nëntorit 1987, gazeta e atëhershme në gjuhën maqedonase “Veçer”, botoi fejtounin e porositur nga UDB-ja, prej 18 vazhdimeve me titull “Tetovari Jusuf Rexhepi nga një ballist në profesor i Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë”, të autorit Kosta Popovski, përmes së cilit u tentua të njolloset kjo figurë e madhe kombëtare e intelektuale shqiptare. Pas shpartallimit të komunizmit, ai kthehet në Tetovë, duke vazhduar punën si mjek, në ordinancën e tij. Më 23 qershor 1990 zgjidhet kryetar i përkohshëm i Partisë Demokratike Popullore, që më pas të tërhiqet nga ai post për të ngelur vetëm anëtar i asaj partie. Vdiq në moshën 82 vjeçare më 28 nëntor 2004, nga një sëmundje e rëndë.

<sup>3</sup> Iljaz Halimi, Morfologjia e një kauze kombëtare, Vëllimi I, SHB “Albas”, Tetovë, 2019, fq. 14-15: shih edhe, “Bisedë me Iljaz Halimin, kryetar i Partisë Demokratike Popullore”, “Flaka e Vëllazërimit”, Shkup, 5. XII. 1990, fq. 8.

<sup>4</sup> “Flaka e Vëllazërimit”, 2.XI.1990, fq. 8.

<sup>5</sup> Po aty, 29 maj 1992, fq. 4.

<sup>6</sup> Po aty, 1 prill 1992, fq. 7.

sferat e jetës, veçanërisht atë të arsimit dhe kulturës<sup>7</sup>. Kjo fushatë u rumbullakësua me amendamentet kushtetuese, të cilat Kuvendi i atëhershëm i RS të Maqedonisë i miratoi më 14 prill 1989, me çka shqiptarët përfundimisht u shpallën pakicë nacionale<sup>8</sup>.

Siç u theksua më lart, në përputhje me përcaktimet programore, Kryesia e PPD-së, që në ditët e para të aktivitetit të saj, u angazhua për kthimin e menjëhershëm të të drejtave të shqiptarëve në Maqedoni, në radhë të parë në fushën e arsimit e të kulturës, pastaj në zyrtarizimin e gjuhës shqipe në të gjitha nivelet, në problemin e përdorimit të toponimeve, në emërtimin e lirë të foshnjave, në përdorimin e lirë të simboleve kombëtare, në kthimin në punë të profesorëve dhe arsimtarëve të diferencuar për shkaqe ideologjike etj. Por, këto, si dhe shumë kërkesa të tjera të ngjashme, nga ana e udhëheqjes së atëhershme politike maqedonase, u konsideruan si “kërkesa nacionaliste” dhe të “rrezikshme për sigurinë e vendit”. Kryetari i Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit Komunal të Tetovës, Abdullah Ademi, në mbledhjen e jashtëzakonshme, e cila u mbajt më 15 gusht 1990, situatën politike e të sigurisë në Tetovë, e konsideroi si “shumë të përkeqësuar”, e cila sipas tij, vinte si rrjedhojë e “veprimtarisë së njëanshme” të partive politike shqiptare, si dhe “lidhjeve gjithnjë e më të dukshme me nacionalistët dhje separatistët shqiptaromëdhenj të Kosovës”. *“...Për momentin, shprehet Ademi, ndikim më të madh ka veprimtaria agresive e nacionalistëve dhe separatistëve shqiptarë, në bashkëveprim me alternativën në KSA të Kosovës dhe me emigracionin armiqësor shqiptar, të cilët përpiqen ta kosovarizojnë komunën dhe Maqedoninë*

---

<sup>7</sup> Државен архив на Република Македонија, Фонд Централен Комитет на Сојузот на комунистите на Македонија, кутија 408, док. бр. 42, стр. 481-508 (në vazhdim: ДАРМ.1.427.408.42/481-508), Осврт врз идејно-политичката активност на СКМ во остварувањето на Политичката платформа за Косово, за јакнењето на братството и единството и рамноправноста на македонскиот народ и народностите во СРМ и сузбивањето на албанскиот национализам и иредентизам и другите национализми; По ату, 1.158. кут. 18 (fondi i pasistemuar), Општествено-политички Собор на Собранието на СР Македонија, предлог за донесување на Закон за изменување и дополнување на Законот за лично име, Извршен совет на Собранието на СР Македонија, бр. 23-1801/1,12. XII.1985; По ату, 427.513.13/318-341, Програма на непосредните задачи на членството, организациите и органите на ЦК СКМ во остварувањето на Заклучоците од Деветата седница на ЦК СКЈ, Shkup, shtator, viti 1987.

<sup>8</sup> Службен весник на Социјалистичка Република Македонија, Број 16, година XLV, Shkup, 15 prill 1989, Одлука за прогласување на амандманите XXIV до LV на Уставот на Социјалистичка Република Македонија.

*Perëndimore, ku krijohet një atmosferë frike, kërcënimi, pasigurie dhe pritjeje të rezultatit në periudhën e ardhshme...”<sup>9</sup>.*

Po në këtë frymë është edhe shkrimi me titull “Grupimi i madh i shqiptarëve”, i botuar në gazetën “Nova Makedonija”, ku artikullshkruesi, në mënyrë të drejtpërdrejtë e akuzonte udhëheqjen e PPD-së, e cila, gjoja se “përmes programit të kompozuar me shumë mjeshtri” ka mundësuar që “nacionalizmi dhe separatizmi shqiptar të inkuadrohet gjerësisht në skenën e pluralizmit” politik të RS të Maqedonisë. Në vazhdim të artikullit thuhej: “...Si duket po na përsëritet historia, por në një mënyrë tjetër, më perfide. Tashmë është e qartë se nacionalizmi shqiptar po futet në dyert e mëdha të pluralizmit politik dhe se nuk ka kurrfarë lidhje me demokracinë. Nëse analizohet tërë ajo që po ndodhte viteve të kaluara, padyshim se, kërkesat dhe strategjinë që po e zbaton PPD-ja janë të njëjta dhe në nuk dallojnë në asgjë me kërkesat e nacionalizmit shqiptar gjatë vitit 1968 dhe 1981, kur publikisht e proklamuan platformën e tyre të përgatitur me vite të tëra për Shqipërinë e Madhe...”<sup>10</sup>.

Po kjo gazetë, në dy vazhdime (më 17 dhe 20 gusht 1990), shkruante se përpjekjet e PPD-së “për definimin, përkatësisht ridefinimin” e Maqedonisë, që ajo të jetë shtet i maqedonasve, shqiptarëve, turqve dhe të tjerëve që jetojnë në të, për shkolla të mesme e të larta me mësim në gjuhën shqipe, për zyrtarizimin e gjuhës shqipe etj., përbënin kërkesa “kundër sovranitetit maqedonas”, dhe se të njëjtat na ardhkan “nga pozitrat shqiptaromadhe”. Gazeta, që, në fakt, përbënte organin informativ të regjimit të atëhershëm komunist maqedonas, pasi theksonte se sovraniteti shtetëror në RS të Maqedonisë, i takuaka vetëm “kombit maqedonas”, dhe se gjuhë zyrtare në këtë shtet na qenka “vetëm gjuha maqedonase”, shtonte: “...Të gjithë ata të kombësisë shqiptare që mendojnë kësasi sa i përket kësaj kërkesë duhet ta kuptojnë se cilado gjuhë tjetër, e cilitdo shtet tjetër në Maqedoni janë gjuhë të huaja. Gjuhët e pakicave që jetojnë në Maqedoni (shqipja, turqishtja, greqishtja, bullgarishtja etj.), për maqedonasit në Maqedoni janë gjuhë të huaja...”<sup>11</sup>.

<sup>9</sup> Вонредна седница на Извршниот совет на Собранието на Општина Тетово, Партиите во спрега со косовската алтернатива, “Nova Makedonija”, 16 gusht 1990, fq. 3.

<sup>10</sup> Големо групирање на албанците, “Nova Makedonija”, 15 gusht 1990, fq. 2.

<sup>11</sup> Да ли им се скратени правата на албанците во Makedonija, “Nova Makedonija”, 17 dhe 20 gusht 1990, fq. 2.

Shovinizmi shtetëror maqedonas gjente shprehje, veçanërisht më 4 tetor 1990, kur policia maqedonase, pa asnjë paralajmërim, rrahu deri në alivanosje dhe arrestoi dhjetëra nxënës shqiptarë të gjimnazit “Pançe Popovski” të Gostivarit, vetëm pse ata, po atë ditë, kishin kërkuar një takim me drejtorin e gjimnazit, në lidhje me mësimin në gjuhën shqipe<sup>12</sup>. Menjëherë pas këtij intervenimi policor, doli me reagim Forumi Demokratik për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut në Gostivar, në të cilin thuhej se “...në rastin e tubimit të nxënësve shqiptarë, ka pasur thyerje dhe cenim të të drejtave dhe lirive njerëzore, familjare e kolektive nga ana e organeve të punëve të brendshme në Gostivar, si dhe nga disa persona të tjerë civilë, të cilët i ndihmuan policët gjatë arrestimit të nxënësve nëpër rrugët e qytetit...”<sup>13</sup>. Duhet theksuar se kjo lëndë, falë Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Kosovë, si anëtare e Federatës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut me seli në Paris, u shqyrtua nga ana e Qendrës për të Drejtat e Njeriut pranë Kombeve të Bashkuara në Gjenevë. Lidhur me këtë, ministri për Marrëdhënie me Jashtë, Denko Maleski, njoftonte Qeverinë e RS të Maqedonisë për sa më poshtë vijon:

*“Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut të Kosovës, si anëtare e Federatës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut (me seli në Paris), nga gushti i vitit 1990 deri në prill të vitit 1991 në mënyrë të vazhdueshme depoziton ankesa kundër gjoja shkeljeve të të drejtave të njeriut. Në mesin e ankesave (gjithsej 41) është përfshirë edhe rasti me grevën e nxënësve të kombësisë shqiptare nga gjimnazi ‘Pançe Popovski’ të Gostivarit të mbajtur më 4 dhjetor 1990. Federata për të Drejtat e Njeriut këto ankesa i ka depozituar deri te Qendra për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara me seli në Gjenevë. Sipas procedurës së Këshillit Ekonomik dhe Social, kjo ankesë, së bashku me ankesat e tjera të arritura, si material i besueshëm do i dorëzohet anëtarëve të Komisionit të KB-së për të Drejtat e Njeriut për mbledhjen e ardhshme të saj në Gjenevë...”*<sup>14</sup>

Në rrethana dhe kushte për afërsisht të këtilla, dy partitë e atëhershme politike shqiptare, PPD dhe PDP, morën pjesë në zgjedhjet e para shumëpartiake në RS të Maqedonisë, të cilat filluan më 11 nëntor

---

<sup>12</sup> ДАРМ.1.159 (fondi i pasistemuar), Република Македонија, Министерство за образование и физичка култура, бр. 02-1483/3, 16. 7. 1991.

<sup>13</sup> “Flaka e Vëllazërimit”, 21. X. 1990, fq. 5.

<sup>14</sup> Ро-ау, Република Македонија – Министерство за Односи со Странство, Бр. 1504-511/3, 13.6.1991, Скопје.

1990<sup>15</sup> (raundi i parë), dhe përfunduan më 9 dhjetor 1990<sup>16</sup>. Në to, PPD-ja dhe PDP-ja arritën të fitojnë 23 ulëse nga gjithsej 120 sa numëronte Parlamenti<sup>17</sup>. Njëkohësisht me zgjedhjet parlamentare u mbajtën edhe zgjedhjet lokale, në të cilat koalicioni i dy partive shqiptare fitoi shumicën e këshilltarëve në tri komunat e atëhershme: Tetovën, Gostivarin dhe Dibrën<sup>18</sup>.

Ndonëse shqiptarët fituan bindshëm në këto tri komuna, Qeveria e RS të Maqedonisë, suspendoi organet e dala në zgjedhjet e para postkomuniste, në komunën e Tetovës dhe të Gostivarit, dhe në vend të tyre emëroi të ashtuquajtura “këshilla ekzekutive”, të cilët do të kryenin detyrat që ishin nën kompetencë të organeve komunale. Një vendim të tillë arbitrar, Qeveria e atëhershme e RSM-së, e mbështeste në “nenin 14-a të Ligjit Kushtetues për zbatimin e Amendamenteve Kushtetuese të RSM-së”, sipas së cilit, në ato komuna ku nuk mund të konstituheshin kuvendet e porsazgjedhura “autorizohej Qeveria e Maqedonisë të themelojë këshilla drejtuese, të cilat do të udhëheqin me ato komuna deri në konstituimin e atyre kuvendeve”<sup>19</sup>. Çuditërisht, një nen i tillë, gjeti shprehje vetëm në dy komunat e përmendura shqiptare, ku konstituimi i kuvendeve nuk vihej në dyshim, për arsye se shumicën e këshilltarëve e përbënin dy partitë politike shqiptare. Ndërkohë, kjo nuk u zbatua në një numër të madh të komunave me shumicë maqedonase, përfshirë edhe qytetin e Shkupit, ku asnjë parti nuk e kishte shumicën e nevojshme për konstituimin e kuvendeve.

Politika represive ndaj popullsisë shqiptare në RS të Maqedonisë vazhdoi edhe në pjesën e parë të vitit 1991. Kjo politikë zbatohet veçanërisht kundër arsimtarëve shqiptarë, të cilët me përkrahjen e madhe që e morën nga prindërit, në fillim të muajit mars 1991, dokumentacionin dhe evidencën pedagogjike, filluan ta udhëhiqnin në gjuhën shqipe, si dhe kundër disa personaliteteve shqiptare me ndikim, me arsyetim se “e penguan” mbajtjen e regjistrimit të popullsisë. Kundër një politike të tillë doli udhëheqja e PPD-së, e cila përmes një

<sup>15</sup> Sot voton Maqedonia, “Flaka e Vëllazërimit”, Shkup, 11 nëntor 1991, fq. 1.

<sup>16</sup> 89 kandidat për 26 vende të lira në Parlament, “Flaka e Vëllazërimit”, 9 dhjetor 1990, fq. 1.

<sup>17</sup> Qerim Lita, Shenjat e kohës, përmbledhje studimesh, Konica press, Shkup, 2019, fq. 297; shih edhe, Zeqirja Rexhepi, Partia Demokratike Shqiptare- lindja, zhvillimi dhe veprimtaria, Tetovë, 2004, fq. 27-28.

<sup>18</sup> ДАРМ.1.159. ((fondi i pasistemuar), Список на избрани одборници во Собранието на Општина Тетово.

<sup>19</sup> По ату, Социјалистичка Република Македонија – Влада на Социјалистичка Република Македонија, Бр. 23-1959/1, 28. 10. 1991 година, Скопје.

shkresë kërkoj nga institucionet më të larta republikane, ndërprerjen e menjëhershme të masave represive kundër shqiptarëve, si dhe ndryshimin e dy ligjeve diskriminuese për shqiptarët: Ligji për edukimin dhe arsimimin parashkollor e fillor dhe Ligji për arsimin e mesëm të orientuar. *“Organet e pushtetit të Maqedonisë shumë nacionale, theksohet në shkresën e PPD-së, në vend se të gjejnë zgjidhje minimale civilizuese e demokratike, të cilat çojnë kah barazia e bashkëjetesa, ofrojnë dhe zbatojnë represion masiv mbi arsimtarët pjesëtarë të kombit shqiptar me ngritjen e padive penale e për kundërvajtje kundër tyre vetëm për shkak asaj se ashtu sikurse kolegët e tyre maqedonas evidencën pedagogjike e udhëheqin në gjuhën me të cilën zhvillohet mësimi... Duke e analizuar pozitën e shqiptarëve në Maqedoni, veçmas në fushën e arsimit Këshilli Drejtues konstatoi se shqiptarët në Maqedoni janë në pozitë më të keqe krahasuar me pozitën e shqiptarëve në Kosovë, Mal të Zi dhe Serbinë Jugore ku në shkollat në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe evidenca pedagogjike udhëhiqet në gjuhën e njëjtë e gjuhë në të cilën shqiptarët shkollohen edhe në shkollimin e mesëm...”*<sup>20</sup>.

Kërkesa e Këshillit Drejtues të PPD-së u shqyrtua në mbledhjen e Kuvendit të RSM-së, e cila u mbajt më 24 qershor 1991, me ç’rast, grupi parlamentar shqiptarë, përkatësisht, koalicioni PPD-PDP-së, mbrojtë denjësisht kërkesën e Këshillit Drejtues të PPD-së. Pikërisht, ky qëndrim dinjitoz i deputetëve shqiptarë, qe shkas që Qeveria e RSM-së, në mbledhjen e mbajtur më 27 qershor 1991, të dalë me një komunikatë, përmes së cilës ajo paturpësisht, dënoi, gjoja “sjelljen e pahijshme” të grupit parlamentar të PPD-PDP-së. Në komunikatë ndër të tjerash thuhej se: *“...Qeveria e Republikës së Maqedonisë vlerëson se sjellja e grupit parlamentar të PPD-PDP-së në Kuvendin e Maqedonisë meriton dënim për arsye se përpiqet t’i mjegulloj situatat e vërteta në realizimin e të drejtave të pakicës shqiptare në fushën e arsimit e më gjerë. Qeveria, vlerëson se, çështja minore rreth udhëheqjes së evidencës pedagogjike, shtrohet me qëllim të mjegullimit të të drejtave të gjera të pakicës nacionale që i gëzon në fushën e arsimit...”*<sup>21</sup>.

---

<sup>20</sup> По ату, До: Претседателот на Републиката; Претседателот на Собранието на СРМ; претседателот на Владата на СРМ; Министерството за образование; Предмет: Барање, Партија за демократски просперитет, Управен одбор, Тетово, 03. 05. 1991 година.

<sup>21</sup> По ату, Соопштение на Владата на СР Македонија, Скопје, 27 јуни 1991 година.

Meqenëse në atë periudhë kohore në Kosovë dhe në trevat e tjera shqiptare nën Jugosllavi, qenë formuar dhe vepronin më shumë parti, me nismën e partisë më të madhe shqiptare, Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe liderit të saj historik, prof. dr. Ibrahim Rugova, në Prishtinë u formua Këshilli Koordinues i Partive Politike Shqiptare në RSFJ. Është me rëndësi të thuhet se, një bashkëpunim të ngushtë ky Këshill vendosi edhe me partitë politike në Shqipëri, në radhë të parë, me Partinë Demokratike, por edhe me Ramiz Alinë, i cili asaj kohe mbante postin e kryetarit të shtetit. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, në pjesën e parë të muajit maj 1991, për Tiranë udhëtoi një delegacion i lartë i PPD-së, i udhëhequr nga kryetari Nevzat Halili, nënkryetari Sami Ibrahimimi dhe sekretari i përgjithshëm Mithat Emini. Në deklaratën dhënë TV Shqiptar, Nevzat Halili, ndër të tjerash tha se në Shqipëri po “vërehen proceset demokratike dhe pluralizmi politik” dhe se këto procese paraqesin “përkrahje të madhe për PPD-në”. Sipas tij, ndër më meritoret për demokracinë në Shqipëri ishte Ramiz Alia, prandaj ai u apeloj të gjitha partive shqiptare brenda dhe jashtë shtetit shqiptar “të mos i nënshtrohen urrejtjes ideologjike, posaçërisht tash në kohën e rëndë të krizës ekonomike...”<sup>22</sup>. Vizita e kreut të PPD-së dhe takimi me Ramiz Alinë, u kritikua ashpër nga një pjesë e veprimtarëve shqiptarë të trevave lindore, veçanërisht nga ish-kryetari PDP-së, dr. Jusuf Rexhepi, i cili në Kuvendin e dytë të PDP-së dega e Tetovës, që u mbajt në fillim të muajit qershor 1991, ndër të tjerash shprehet: “...Ajo Parti, është vazhdë e politikës së Miladin Popoviçit dhe Dushan Mugoshës që shkaktuan luftën civile, është parti që në vitin 1948 kthyen ‘vaporin’ dhe u bënë stalinistët më të njohur e nga frika e destabilizimit u lidh me Kinën në vitin 1960, duke e shkëputur Shqipërinë nga procesi social. Është agoni të jetosh me dekada në një sistem totalitar që solli popullin në një situatë edhe më të mjerë. Ramiz Alia është vazhduesi i një stalinizmi ortodoks, por ai është i detyruar të fillojë me reformat që ende për fat të keq janë gjysmake...”<sup>23</sup>.

Ndërkohë, gjatë muajve qershor-korrik 1991, në Federatën e atëhershme jugosllave filloi konflikti i armatosur, fillimisht në Slloveni që më pas të zgjerohet edhe në Kroaci<sup>24</sup>. Për ndërprerjen e këtij

<sup>22</sup> Delegacioni i Partisë për Prosperitet Demokratik në Tiranë, “Flaka e Vëllazërimit”, 15.V.1991, fq. 6.

<sup>23</sup> Kuvendi i dytë zgjedhor i Partisë Demokratike Popullore – dega në Tetovë, “Flaka e Vëllazërimit”, Shkup, 5. VI. 1991, fq. 5.

<sup>24</sup> ДАРМ.1.159. (fondi i pasistemuar), Записник од Деветнаесетата седница на Собранието на Република Македонија, одржана на 6 и 8 јули 1991 година.

konflikti, në sipërfaqe doli i ashtuquajtur “Programi politik për zgjidhjen paqësore të krizës jugosllave”, pas të cilit qëndronin kryetari i atëhershëm i Maqedonisë, Kiro Gligorov, dhe ai i Bosnjës dhe Hercegovinës, Alija Izetbegović<sup>25</sup>. Me një program të vetin, asaj kohe doli edhe Qeveria federative e Ante Markoviçit, i cili përfshinte tre pika kryesore:

*“Së pari, për vendosjen e paqes në Jugosllavi, nevojitet ndërprerja e menjëhershme e konfliktit, e njëkohësisht edhe pamundësimi i konflikteve të reja, të cilat mund të ndodhin në Jugosllavi dhe të kërkohet demobilizimi i të gjithë atyre njerëzve që janë të mobilizuar, të çarmatosen formacionet paraushtarake dhe njëkohësisht të shkohet në negociata për bashkëjetesën e mëtutjeshme në Jugosllavi.*

*Së dyti, në tre muajt e ardhshëm si domosdoshmëri parashikohet vendosja e disa funksioneve të sistemit, të cilat do të mundësonin kushte minimale për jetesë, duke filluar nga tregu, valuta, sistemi monetar, sistemi i pagesave etj., deri tek institucionet që do ta përmbyllnin atë rreth të funksionimit të Federatës Jugosllave.*

*Së treti, gjatë kësaj periudhe kohore të arrihet marrëveshje për marrëdhëniet e ardhshme të shtetit, duke filluar nga e drejta e çdo kombi, çdo republike, për vetëvendosje dhe pavarësi dhe brenda mundësive të negociohet për disa funksione të përbashkëta të mundshme, të cilët do të jenë në interesin e secilës republikë. Në rast se nuk ekzistojnë kurrfarë kushtesh për këtë, atëherë ndarja të kryhet në mënyrë paqësore dhe secila republikë ta konstitujë shtetin e vet”<sup>26</sup>.*

Është me rëndësi të vihet në dukje fakti se, si në programin politik të Qeverisë Federative për zgjidhjen e krizës jugosllave, sikurse edhe në atë të duetit Gligorov-Izetbegović, nuk u përfshinë as shqiptarët në përgjithësi, e as Kosova në veçanti, e cila me Kushtetutën e vitit 1974 kishte fituar statusin më të lartë të autonomisë. Lidhur me këtë, Kryesia e PPD-së vlerësonte se “...Jugosllavia në mënyrë indolente dhe indiferente u soll ndaj zgjidhjes së problemit të Kosovës, duke i përkrahur në këtë mënyrë masat diskriminuese të Serbisë ndaj shqiptarëve, masa këto që suprimuan edhe autonominë politike të Kosovës...”. Sa i përket ardhmërisë së asaj Federate, PPD-ja shprehte mendimin, se “...Platforma Gligorov-Izetbegović është e mirë dhe mund të shërbejë për

---

<sup>25</sup> По ату, Стенографски белешки од Дваесет и првата седница на Владата на Република Македонија, одржана на 11.VII.1991 година, shih fjalimin e kryeministrit të Maqedonisë, Nikolla Klusev.

<sup>26</sup> По ату, nga fjalimi i Ante Markoviçit.

*bisedime të mëtutjeshme, por me kusht që në këto bisedime të marrë pjesë Kosova dhe populli shqiptar*". Më tej ajo bënte me dije se në rast se Jugosllavia do të copëtohej dhe nëse nuk formohej ndonjë federatë e re ku shqiptarët do të ishin element konstitutiv, atëherë "popullit shqiptar nuk do t'i mbetet asgjë, pos referendumit për të shprehur vullnetin e vet..."<sup>27</sup>. Ndërkohë, kryetari i PPD-së, në intervistën dhënë revistës "Dita", ndër të tjerash deklaroi se "...Sa i përket definimit të Republikës së Maqedonisë si shtet, mund ta njohim vetëm me një kusht: që edhe shqiptarët të jenë element i shtetësisë së Maqedonisë. Kushtetuta eventuale që do të aprovohej me mbivotim, nuk do të konsiderohet Kushtetutë edhe e shqiptarëve"<sup>28</sup>.

Në korrik të vitit 1991, një delegacioni i LDK-së i kryesuar nga kryetari dr. Ibrahim Rugova u takua me udhëheqjen më të lartë të PPD-së në Tetovë. Menjëherë pas këtij takimi, udhëheqja e PPD-së, mbajti konferencë për shtyp, me ç'rast, sekretari i përgjithshëm, Mithad Emini, njoftoi gazetarët e pranishëm se "...emërues i përbashkët i këtyre bisedimeve ishte pozita aktuale e shqiptarëve në Jugosllavi". "*Vlerësim i përgjithshëm i këtyre bisedimeve, shprehet më tej Emini, ishte se kjo pozitë e shqiptarëve nuk është e kënaqshme. Faktet flasin se kohëve të fundit në Kosovë është bërë një grumbullim i armatimit. Prandaj kemi ardhur në përfundim se rrezikimi i cilësdo pjesë ku jetojnë shqiptarët, do të thotë atak mbi gjithë popullin shqiptar në Jugosllavi, e njëkohësisht obligim i të gjithë shqiptarëve për t'u ardhur në ndihmë vëllezërve të rrezikuar.*" Në fund, ai tha se do të ishte në të mirë të Maqedonisë dhe të popullit maqedonas "*që të përkraket populli shqiptar në Kosovë, sepse çdo çrregullim i situatës në Kosovë do të reflektohet edhe në Maqedoni*"<sup>29</sup>.

Paraprakisht, Partia Demokratike Popullore (PDP), doli me një deklaratë politike, e cila më 19 qershor të vitit 1991, u botua në gazetën "Nova Makedonija". Në pikën dy (2) të saj thuhej: "*PDP-ja është përcaktuar që popullsisë shqiptare në Jugosllavi t'i pranohet statusi i kombit (janë mbi 3 milionë) edhe atë si shprehje e lirisë dhe të drejtës për përcaktim të lirë nacional, për vetëvendosje dhe me të drejtë të shkëputjes nga robëria totalitare e asimiluese pan-sllaviste*"<sup>30</sup>. Një

<sup>27</sup> Konferencë shtypi e PPD-së "Shqiptarët në Jugosllavi do të mbrohen nga çdo sulm", Flaka e Vëllazërimit, Shkup, 17 korrik 19912, fq. 2.

<sup>28</sup> "Dita" Nr. 8, 1 gusht 1991, fq. 6-9.

<sup>29</sup> Po aty, fq. 50.

<sup>30</sup> ДАРМ.1.159 (fondi i pasistemuar), Политичка декларација на Собранието на Народната демократска партија.

qëndrim i tillë i PDP-së, thuhej në vazhdim të deklaratës, vjen si rrjedhojë e refuzimit të kërkesave të pareshtura të shqiptarëve nga udhëheqja maqedonase, e cila “në vend të progresit e zgjodhi regresin”, dhe si rrjedhojë janë bërë dhe po bëhen shumë reduktive e ndalime për shkollim në gjuhën shqipe, “...janë miratuar ligje diskriminuese në fushën e shkollimit, u mbyllën shumë shkolla të mesme në gjuhën shqipe, na urdhëruan të mësojmë në ‘paralelet e përziera’, administratën pedagogjike ta udhëheqim në gjuhë të huaj, sollën vendime për shkollim të mesëm të imponuar vetëm në gjuhën maqedonase, kërkesat gjithëshqiptare për mësim në gjuhën shqipe injorohen nga ‘shteti demokratik’, pasiviteti shtetëror, që i përket shkollimit në gjuhën shqipe, paraqet një politikë aktive të denacionalizimit dhe asimilimit të kombit shqiptar etj.”<sup>31</sup>.

Deklarata Politike e PDP-së, nxiti qarqet e atëhershme shoviniste maqedonase, të involvuara brenda “qeverisë së ekspertëve” (në të cilën pa dëshirën dhe vullnetin e shqiptarëve, merrnin pjesë edhe tre shqiptarë), të ndërmarrin masa ndëshkuese kundër popullsisë shqiptare në përgjithësi, e të aktivistëve të kësaj partie në veçanti. Ministria për Informim përmes një komunikatë të lëshuar më 27 qershor, Deklaratën e PDP-së, e kualifikonte si një “pamflet” që çon, siç thuhet “kah destabilizimi i Republikës, kah cenimi i marrëdhënieve ndërnacionale...”, krejt kjo “me qëllim të arritjes së funksionit të shkëputjes së pjesëve nga Maqedonia dhe krijimin e një fiksioni për Shqipëri të Madhe”. Ajo, “kulmin e agresivitetit” të PDP-së, e shihte në përpjekjet e saj, që bartës së sovranitetit të Maqedonisë të jenë edhe shqiptarët: “...Me këtë qëndrim të PDP-së, thuhet në komunikatë, në mënyrën më brutale të mundshme cenohet e drejta historike e maqedonasve të jenë bartës të sovranitetit në shtetin e tyre të vetëm kombëtar, Republikën e Maqedonisë...”<sup>32</sup>. Një vlerësim i tillë, i dalë nga një qeveri, e cila pretendonte se i përfaqësonte edhe shqiptarët, ishte tendencioz dhe i paqendrueshëm, për arsye se me Kushtetutën e vitit 1974 (neni 1), bartës të sovranitetit në RS të Maqedonisë, krahas maqedonasve ishin edhe shqiptarët dhe turqit<sup>33</sup>.

Ndërkohë, Grupi parlamentar i PPD-PDP-së, më 29 korrik 1991, Kuvendit të Republikës së Maqedonisë i dorëzoi “Deklaratën për

---

<sup>31</sup> По ату.

<sup>32</sup> По ату, Соопштение, 27. 6. 1991 година, Скопје, Министерство за информации на Владата на Република Македонија.

<sup>33</sup> Устав на Социјалистичка Република Македонија, Службен весник на СРМ, Скопје, 1974 година

statusin e barabartë të shqiptarëve në Maqedoni”, e cila përbëhej prej 10 pikave:

“1. Në Republikën e Maqedonisë të gjithë qytetarët në aspektin individual dhe kolektiv janë të barabartë, i posedojnë të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e barabarta dhe janë bartës të sovranitetit.

2. Organizimi dhe funksionimi i pushtetit në bashkësitë lokale dhe në Republikë bazohet mbi rezultatet e zgjedhjeve të lira e demokratike.

3. Përbërja nacionale e kuvendeve paraqet bazën themelore për përbërjen e të gjitha organeve të pushtetit shtetëror.

4. Në Republikën e Maqedonisë gjuhë nacionale janë: gjuha maqedonase, gjuha shqipe dhe gjuha turke.

5. Në Republikën e Maqedonisë gjuhë zyrtare janë: gjuha maqedonase dhe gjuha shqipe (në territoret ku jetojnë shqiptarët).

6. Republika e Maqedonisë garanton barazi në sistemin administrativ, informativ, arsimor, kulturor dhe shoqëroro-politik.

7. Të gjithë qytetarëve në Maqedoni u garantohet e drejta e shprehjes së kulturës së vet kombëtare dhe të themelojnë institucione dhe organizata për realizimin e atyre të drejtave, përfshirë edhe të drejtën e shënimit të ngjarjeve dhe datave historike, si dhe të drejtën e përdorimit të simboleve kombëtare e fetare.

8. Republika e Maqedonisë do të hartojë mekanizëm kushtetues-juridik me të cilin do të garantohet barazia kombëtare, për çka për të gjitha çështjet që u përkasin marrëdhënieve ndërnacionale dhe interesave të përbashkëta do të vendoset me konsensus.

9. Në Republikën e Maqedonisë shqiptarët kanë të drejtë të vendosin për fatin e tyre dhe në atë kontekst të bartin pjesën e vet të përgjegjësisë për fatin e Republikës.

10. Këto përcaktime do të inkorporohen në mënyrë përkatëse në Kushtetutën e Republikës”<sup>34</sup>.

Ngjashëm sikurse Deklarata e PDP-së, edhe Deklarata e mësipërme, u hodh poshtë nga Qeveria e RSM-së, me arsyetimin se “statusi i kolektiviteteve nacionale, pakicave nacionale dhe etnike dhe pjesëtarëve të kombeve të tjera” do të definohet me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë. Sipas saj, ishte e panevojshme “sjellja e çfarëdolloj Deklarate të veçantë për trajtim të ndarë të cilitdo status të

<sup>34</sup> ДАРМ.1. 159 (fondi i pasistemuar), Пратеничка група на ПДП-НДП, До претседателот на Собранието на Република Македонија, Декларација за рамноправен статус на Албанците во Македонија, Скопје, 29 јули 1991 година.

*barabartë, dhe në këtë kuadër edhe statusi i shqiptarëve në Maqedoni, sepse kjo do të çonte kah krijimi i veçantë i zgjidhjeve të ndryshme dhe të një paralelizmi të pashembullt...*<sup>35</sup>.

Në rrethana, kur Kosova gjendej nën pushtimin klasik ushtarako-policor serb nga njëra anë, si dhe refuzimit të vazhdueshëm për avancimin e statusit të shqiptarëve në Maqedoni nga ana tjetër, Këshilli Koordinues i partive politike shqiptare solli dy vendime shumë me rëndësi për kohën, si vendimi për mbajtjen e Referendumit për *“Kosovën si shtet sovran dhe të pavarur, me të drejtë për pjesëmarrje në lidhjen e shteteve (në Jugosllavi”*, i cili u mbajt nga data 26-30 shtator 1991<sup>36</sup>, si dhe vendimin për mbajtjen e *“Referendumit për krijimin e Autonomisë Politike-Territoriale të Shqiptarëve në Maqedoni”*, i cili u mbajt më 11-12 janar 1992<sup>37</sup>. Natyrisht, këto vendime, vlenin vetëm në rast ekzistimit të Federatës së atëhershme Jugosllave, në të kundërtën, Këshilli Koordinues i Partive Politike Shqiptare, do të angazhohej për bashkimin e të gjitha tokave shqiptare në një shtet të përbashkët. Lidhur me këtë, Ibrahim Rugova, në kongresin e parë të PPD-së, i cili u mbajt më 8-9 shkurt 1992, ndër të tjerash u shpreh se *“..nuk mund të ketë Maqedoni të pavarur pa mos u respektuar vullneti i shqiptarëve për autonomi politike e territoriale, as pa pranimin e Kosovës Republikë. Nëse nuk realizohen kërkesat, vazhdon Rugova, atëherë do të kërkojmë të jemi të bashkuar...”*<sup>38</sup>. Në fjalën hyrëse, kryetari i PPD-së, Nevzat Halili, ndër të tjerash foli edhe për moslejimin e kuvendeve të konstituara disa herë në Tetovë dhe Gostivar, që kjo sipas tij, përbënte *“shembullin klasik të aparteidit, që në Maqedoni u zyrtarizua më 16 prill 1991, me rastin e aprovimit të ligjit special që vlen për dy komuna dhe që bën dallim evident nga 32 komunat e tjera po në këtë Republikë. Edhe sot e gjithë ditën, u shpreh Halili, këto dy kuvende janë nën qeverisjen e dhunshme nga ana e Republikës së Maqedonisë...”*<sup>39</sup>. Më pas ai u ndal në bashkëpunimin e PPD-së me partitë politike shqiptare të Kosovës dhe Shqipërisë, në radhë të parë me LDK-në dhe PDSH-në, si dhe për formimin e Këshillit Koordinues të partive politike shqiptare në territoret shqiptare të ish-Jugosllavisë, i cili sipas tij: *“ishte dhe mbeti*

---

<sup>35</sup> По ату, Република Македонија, Влада на Република Македонија, комисија за политички систем, Бр. 09-89/15, 27. 08. 1991 година, Скопје

<sup>36</sup> Deklarimi për Kosovën e pavarur fillon nesër, “Flaka e Vëllazërimit, 25 shtator 1991, fq. 4.

<sup>37</sup> Qerim Lita, *Shenjat e kohës*, Konica press, Shkup, 2019, fq. 308-309.

<sup>38</sup> Filloi punën Kongresi i Partisë për Prosperitet demokratik, “Flaka e Vëllazërimit”, 9 shkurt 1992, f. 1.

<sup>39</sup> По ату.

*nevojë imediate e bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve ndërpartiake*<sup>40</sup>.

Më 21 prill të vitit 1992, kryetari i Këshillit Koordinues të partive politike shqiptare, dr. Ibrahim Rugova, i shoqëruar nga dy bashkëpunëtorët e tij, nënkryetarin Anton Kolaj dhe dr. Ali Aliun, zhvilloi një takim pune me kryetarin e PPD-së, Nevzat Halilin dhe nënkryetarin Sami Ibrahimimi, si dhe me kryetarin e PDP-së, Iljaz Halimi. Lidhur me këtë takim, shërbimi për informim pranë PPD-së, njoftonte se: *“në këtë takim, janë shkëmbyer mendime rreth gjendjes aktuale politike në republikat e ish Jugosllavisë, gjendjes aktuale të shqiptarëve në trojet e tyre etnike në këto republika, si dhe më gjerë. U bë fjalë edhe për pozitën e shqiptarëve në çastin e tanishëm të krizës kur mundësia e shpërthimit të luftës sikur të hapej “Fronti i Jugut” u kanoset edhe shqiptarëve. U potencua edhe qëndrimi i Bashkësisë Evropiane dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës ndaj çështjes shqiptare...etj.”*<sup>41</sup>.

Ndërkohë, më 28 prill të vitit 1992, në Prishtinë u mbajt mbledhja e Këshillit Koordinues e partive politike shqiptare, në të cilën në mënyrë unanime u përkrahën zgjedhjet e para shumëpartiake në Kosovë, të cilat ishin caktuar të mbaheshin më 24 maj të atij viti. Në komunikatën e lëshuar nga kjo mbledhje thuhej: *“Partitë politike shqiptare të Kosovës mbështesin rezultatet e Referendumit, me të cilin Kosova u shpall shtet i pavarur. Si shprehje e vullnetit politik të pjesës dërmuese të popullsisë së Kosovës, rezultatet e referendumit mbeten përcaktimi kryesor i punës së partive politike, të cilat edhe më tej, me gjithë gjendjen e rëndë do të vazhdojnë realizimin e përcaktimeve me mjete paqësore dhe në rrugë demokratike”*<sup>42</sup>.

Vendimi për mbajtjen e zgjedhjeve të para shumëpartiake në Kosovë, u përshëndet nga partitë, shoqatat dhe asociacionet shqiptare që vepronin në Maqedoni. Në konferencën për shtyp që PPD-ja e mbajti më 6 maj 1992, zëdhënësi i kësaj partie, Mahi Nesimi, para të pranishmëve u shpreh: *“Populli i Kosovës, e në të shqiptarët si popullatë shumicë, me anë të referendumit u përcaktua për Kosovën e pavarur dhe sovranë dhe këtë askush nuk mund ta mohojë. Prandaj, vetëm Republika e Kosovës dhe organet legjitime të saj kanë mandat për vendosje. PPD-ja përkrah edhe përshëndet vendimin e Kuvendit të*

<sup>40</sup> Po aty.

<sup>41</sup> Rugova u takua me udhëheqësit e PPD-së dhe PDP-së, “Flaka e Vëllazërimit”, 22 prill 1992, f. 4.

<sup>42</sup> Federata serbomalazeze s’ka të bëjë me shqiptarët, “Flaka e Vëllazërimit”, 29 prill 1992, f.4.

*Kosovës për shpalljen e zgjedhjeve të lira e shumëpartiake në Republikën e Kosovës si faktor i cili do ta hapë rrugën e mëtejshme për zhvillimin e gjithmbarshëm e demokratik të saj...<sup>43</sup>. Ndërkohë, më 9 maj 1992, në Tetovë u mbajt Kuvendi vjetor i PPD-së, me ç' rast, edhe nga ky tubim, zgjedhjet e para shumëpartiake në Kosovë, u vlerësuan si të drejta dhe të domosdoshme. Në referatin kushtuar gjendjes politike e të sigurisë, vihej në dukje se "...në rrethanat e ndërlikuara që dominojnë në të gjitha ish njësitë federale të Jugosllavisë, veçmas në Kosovë, Kroaci, Bosnjë e Hercegovinë dhe Maqedoni, PPD-ja bën përpjekje të vazhdueshme për zgjidhjen e tërësishme të çështjes kombëtare. Shikuar nga aspekti politik dhe i sigurisë, kjo zgjidhje mund të zgjasë edhe një kohë më të gjatë përderisa Bashkësia Evropiane dhe qarqet e tjera diplomatike nuk angazhohen drejtpërdrejt me të gjitha metodat që i kanë në dispozicion në zgjidhjen definitive të njëjës gordiane në Ballkan, çështjes kosovare. Është fakt se vetëm zgjidhja e drejtë e saj, përfundimisht do të kontribuojë edhe në zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare në hapësirën e Jugosllavisë...<sup>44</sup>.*

Zgjedhjet e 24 majit 1992 në Kosovë, u përkrahën edhe nga partia tjetër parlamentare shqiptare në Maqedoni, Partia Demokratike Popullore, e cila më 7 maj 1992 lëshoi një komunikatë për mjetet e informimit, me të cilën ajo parti u sugjeronte zyrtarëve maqedonas që të ndërpresin praktikën e dezinformimit të opinionit ndërkombëtar në lidhje me të "drejtat njerëzore" dhe të "pakicave" kombëtare në Republikë e në veçanti të "pakicës kombëtare shqiptare", e cila sipas saj përbënte afro dyzet për qind të popullsisë së përgjithshme të Maqedonisë. "...*Pakicë apo shumicë, thuhej në komunikatë, le të vlerësojnë vetë zoti Maleski dhe zoti Fërçkovski, të cilët patën rastin të dezinformojnë Misionin e KSBE-së për të drejtat njerëzore, i cili qëndroi në Republikën e Maqedonisë. Zoti Malevski dhe zoti Fërçkovski, por edhe të gjithë 'profiterët' e tjerë nga shpërbërja e ish- Jugosllavisë, duhet ta dinë se pa zgjidhjen e drejtë të çështjes shqiptare – me Kosovën si shtet sovran dhe të pavarur dhe shqiptarët si shtetformues në Maqedoni, nuk do të ketë zgjidhje të krizës në Ballkan e më gjerë<sup>45</sup>. Në kuadër të kësaj, duhet shtuar se menjëherë pas përfundimit të zgjedhjeve në Kosovë, Kuvendi i PDP-së, miratoi një rezolutë me këtë*

---

<sup>43</sup> Konferencë shtypi e PPD-së, "Flaka e Vëllazërimit", Shkup, 8 maj 1992, f. 5.

<sup>44</sup> Përgëzim i LDSH-PL-së dërguar Këshillit Koordinues të partive politike të Kosovës me rastin e zgjedhjeve parlamentare, "Flaka e Vëllazërimit", 29 maj 1992, fq. 4.

<sup>45</sup> Po aty, Kumtesë e Partisë Demokratike Popullore, Flaka e Vëllazërimit, 8 maj 1992, f. 5.

përmbajtje: “Zgjidhja e çështjes shqiptare në hapësirën e ish-Jugosllavisë duhet të bazohet në parimet e vetëvendosjes së popujve, e që në rrethanat konkrete nënkupton jetësimin e Republikës së Kosovës, kurse shqiptarët në Maqedoni dhe në republikat e tjera të ish- Jugosllavisë të jenë shtetformues”<sup>46</sup>.

Ngjashëm sikurse PPD-ja dhe PDP-ja, zgjedhjet në Kosovë u mbështetën edhe nga dy partitë e tjera jashtëparlamentare: Lidhja Demokratike Shqiptare – Partia Liberale<sup>47</sup> dhe Partia për Aksion Demokratik – Rruga Islame<sup>48</sup>, si dhe nga shoqatat dhe asociacionet e atëhershme shqiptare si: Forumi për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Shoqata e Intelektualëve Shqiptarë, Shoqata e Historianëve Shqiptarë në Maqedoni, Lidhja e Arsimtarëve Shqiptarë, Bashkimi i Rinisë Demokratike Shqiptare etj.

Rëndësi të veçantë këtyre zgjedhjeve i kushtoi gazeta e vetme në gjuhën shqipe në këtë ish-republikë jugosllave “Flaka e Vëllazërimit”, e cila aso kohe dilte tre herë në javë. Kjo gazetë, përmes korrespondentit të saj në Prishtinë, Blerim Reka, informonte gjerësisht për të gjitha ngjarjet dhe zhvillimet që u përkisnin këtyre zgjedhjeve<sup>49</sup>. Vetëm dy ditë para mbajtjes së zgjedhjeve, kjo gazetë në mënyrë ekskluzive botoi intervistën e gjatë të kryetarit të Këshillit Koordinues të partive politike shqiptare, dr. Ibrahim Rugova, i cili ndër të tjerash do të deklarojë: “...Duhet të insistojmë në opsionin tonë, Kosova të jetë e pavarur, gjë që do të jetë e rëndësishme si për shqiptarët shumicë, ashtu edhe për serbët. Realizimi i një qëllimi të këtillë do të ishte i rëndësishëm edhe për shqiptarët në Maqedoni, si edhe për shqiptarët në Mal të Zi. Ne kemi ndjekur këtë rrugë të vetëdijshëm se po të afirmohet Kosova, pozicionet e shqiptarëve do të jenë shumë më të forta edhe në rajonin e Ballkanit si dhe më gjerë...”<sup>50</sup>.

Kjo gazetë, më 27 maj 1992 njoftonte se në zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare të cilat u mbajtën më 24 maj në Kosovë, dr. Ibrahim Rugova, me 99,5% të votave është zgjedhur president i Republikës së Kosovës, ndërsa, LDK-ja kishte fituar 96 deputetë, 2

<sup>46</sup> Rezolutë e PDP-së për çështjen shqiptare në hapësirën e ish- Jugosllavisë F. e Vëllazërimit, Shkup, 8 korrik 1992, f. 4.

<sup>47</sup> Përgëzim i LDSH-PL-së dërguar Këshillit Koordinues të partive politike të Kosovës me rastin e zgjedhjeve parlamentare, “Flaka e Vëllazërimit”, 29 maj 1992, fq. 4.

<sup>48</sup> PAD-rruga islame përgëzoi I. Rugovën, po aty.

<sup>49</sup> Vota e demokracisë postkomuniste - edhe në Kosovë, “Flaka e Vëllazërimit”, 24 maj 1992, fq. 4.

<sup>50</sup> Intervistë e dr. Ibrahim Rugovës, “Flaka e Vëllazërimit”, 22 maj 1992.

deputetë i fitoi lista e kandidatëve të pavarur nga Ferizaj dhe Vitia, 1 deputet Partia Parlamentare e Kosovës dhe 1deputet SDA (PAD)<sup>51</sup>.

Këto zgjedhje, siç njoftonte korrespondenti i “Flakës së Vëllazërimit”, Blerim Reka, ishin vlerësuar si pozitive nga ana e vëzhguesve ndërkombëtarë: “...në raportin e vëzhguesve të Danimarkës, shkruante Reka, i cili iu dërgua Qeverisë daneze dhe Ministrisë së saj të Punëve të Jashtme, thuhet pos të tjerash se duke filluar prej legjislacioni zgjedhor e deri tek organizimi dhe mbajtja e tyre, zgjedhjet e Kosovës i plotësojnë të gjitha kërkesat elementare për zgjedhje demokratike, e njëkohësisht pakicave kombëtare u siguronin pjesëmarrje proporcionale...”. Zgjedhjet e 24 majit 1992 në Kosovë u përshëndetën edhe nga senatori i Belgjikës, Vili Kjupers, i cili në konferencën për shtyp që e mbajti më 4 qershor 1992 në sallën e Senatit, zgjedhjet e Kosovës i vlerësoi si “demokratike, legale dhe të organizuara jashtëzakonisht mirë”. Ai më pas foli për represionin serb në Kosovë, veçanërisht pas 24 majit, duke e veçuar vrasjen e Tahir Berishës në Leshan të Pejës dhe “armatimin e serbëve dhe malazezëve në Kosovë në mënyrë të haptë”<sup>52</sup>.

Për sa u tha më sipër, mund të konkludojmë se, lidhja, bashkëpunimi dhe koordinimi i partive politike shqiptare në Maqedoni me partitë politike shqiptare në Kosovë, në harkun kohor qershor 1990 – qershor 1992 ishte tepër i ngushtë dhe vëllazëror. Ky bashkëpunim gjen shprehje veçanërisht pas formimit të Këshillit Koordinues të partive politike shqiptare në territoret shqiptare të ish- Jugosllavisë, në të cilën merrnin pjesë edhe PPD-ja dhe PDP-ja, si dy parti parlamentare në Maqedoni. Më vonë, duke filluar nga muaji korrik 1992, do të vërehet një zbehje të këtij bashkëpunimi. Tërë kjo erdhi si rrjedhojë e ndërhyrjes së shërbimit sekret maqedonas, UDB-së, brenda strukturave të larta të PPD-së. Ministria e Punëve të Brendshme, më 24 shkurt 1992 njoftonte Qeverinë e Maqedonisë, për disa aktivitete, të cilat kohët e fundit ishin vërejtur në mesin e popullsisë shqiptare, për të cilat kjo ministri dyshonte se bëhet fjalë për krijimin e njësave ushtarake<sup>53</sup>. I njëjti burim, në mars të vitit 1992, përmes një informate konfidenciale, njoftonte Qeverinë e Maqedonisë, për një organizim ushtarak të shqiptarëve në Maqedoni, i cili veçmas gjente shprehje “pas realizimit

---

<sup>51</sup> Dr. Ibrahim Rugova kryetar, e LDK shumicë absolute në Parlament, “Flaka e Vëllazërimit”, 27 maj 1992, fq. 4.

<sup>52</sup> Blerim Reka, Republika e Kosovës – realitet i pamohueshëm, “Flaka e Vëllazërimit”, 5 qershor 1992, fq. 4.

<sup>53</sup> ДАРМ.1. 185, Пов. Стр. Пов. Бр. 172, Скопје, 24.02.1992.

të Referendumit për Autonomi Politike e Kulturore të Shqiptarëve në R. Maqedonisë<sup>54</sup>.

Nuk vonoi shumë pas kësaj, strukturat e atëhershme policore maqedonase e filluan një fushatë të egër kundër popullsisë shqiptare në përgjithësi. Në kuadër të masave që asaj kohe u ndërморën kundër shqiptarëve, duhen veçuar ekspeditat policore maqedonase në vendbanimet me popullsi shqiptare, siç ishte rasti i Dibrës<sup>55</sup>, Ladorishtit dhe ai më tragjik, rasti i Bit Pazarit, ku policia maqedonase vrau 4 njerëz të pafajshëm: Safet Sejfullaun, Memish Sulejmanin, Shemsedin Ibrahimin dhe Viktoria Geshovskën, pastaj rrahu dhe maltretoi 170 qytetarë të tjerë shqiptarë të pafajshëm ndërsa 84 të tjerë u dënuan për kundërvajtje<sup>56</sup>.

Në këto rrethana, një pjesë e mirë e udhëheqjes më të lartë të PPD-së (pjesa më e madhe e deputetëve) u tërhoqën nga opsioni për themelimin e Autonomisë Politike e Territoriale të Shqiptarëve në Maqedoni, nën pretekstin se një kërkesë e tillë ishte në “dëmin” e vetë shqiptarëve. Për rrjedhojë, ata në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me një pjesë të ish-udhëheqësve komunistë, siç ishin: Hysen Ramadani, Beqir Zhuta e disa të tjerë, të cilët tashmë vetëm se ishin involvuar brenda strukturave më të larta udhëheqëse të PPD-së, arritën ta bindin Kryesinë e PPD-së, jo vetëm që ta votojë Qeverinë e LSDM-së, në krye me Branko Červenkovskin, por edhe të jetë pjesë e atij koalicioni qeveritar.

---

<sup>54</sup> По ату, Пов. Стр. Пов. Бр. 317, Скопје, март 1992 год.

<sup>55</sup> ДАРМ.1.158 (fondi i pasistemia), Стенограмси белешки од Десетото продолжение на Педесет и третата седница на Собранието на Република Македонија одржана на 28 јануари 1993 година.

<sup>56</sup> По ату, Стенографски белешки на Дванесетото продолжение на Педесет и шестата седница на Собранието на Република Македонија, одржана на 5 мај 1993 година.

INSTITUCIONALIZIMI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
NË ZGJEDHJET PARLAMENTARE DHE  
PRESIDENCIALE TË VITIT 1992

Simpozium shkencor  
(24 maj 2022)

2022

*Botues:*

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

*Lektor:*

Bahri Koskoviku

*Redaktor teknik:*

ASHAK

*Madhësia:* 16 tabakë shtypi

*Tirazhi:* 300 copë

*Formati:* 16x24 cm

*Shtypi:*

Focus Print

Shkup

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

324(496.51)"1992"(06)

Institucionalizimi i Republikës së Kosovës në zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale të vitit 1992 : simpozium shkencor (24 maj 2022) = Institutionalization of the Republic of Kosovo in the parliamentary and presidential elections of 1992 : scientific symposium (24 May 2022) / përgatitur nga Frashër Demaj. - Prishtinë : Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2022. - 252 f. ; 24 cm.

Kosova -- Politika dhe qeverisja -- Simpoziume  
Zgjedhjet -- 1992 -- Kosovë

1. Demaj, Frashër

**ISBN 978-9951-26-064-0**

Aleph [000105272]